

SHYQYRI MOLLAJ

# Zogjtë ndërtojnë folenë

BIBLIOTEKA E

85H-31

M. 93

SHËTIT

GJIROKASTER



8SH-31

M 93

SHYQYRI MOLLAJ

8SH-31

15

# ZOGJTË NDËRTOJNË FOLENË

ROMAN

LIBRARI E SHTETIT  
SHKURTOR

~~453 E 5~~

8509

SHTETIA BOTONJËSE «NAIM FRASHËRI»

LIBRI I MË

NOGUTË NDERTOJNË  
FOLENË

ROMAN

1967

8000

Tirazhi 5000 kopje

Format 78x109/32

Stash: 2204-65

Shtyp N.I.Sh. Shtypshkronjave «MIHAL DURI» — Tiranë, 1967

**Ja kushtoj rinišë kooperativiste të  
brezit tim.**

**AUTORI**

## PARATHËNJË

Një djalosh i druajtur, me pamje punëtori dhe me fytyrë të rrahur nga dielli, hyri një ditë vjeshte në zyrat e «Shtëpisë botonjëse Naim Frashëri». Ai mbante nën sqetullë një vëllim të daktilografuar keq e keq, pikërisht dorëshkrimin titulluar «Zogjtë ndërtojnë fole në». Dorëshkrimi u lexua nga shkrimtarë e redaktorë të ndryshëm të cilët a vlerësuan si krijim i një të riu, që edhe pa përvojë të mjaftueshme letrare ka shprehur me sinqeritet dhe frymëzim ato që ai ndjen për jetën që e rrethon, për punën e rinisë në kooperativë, për ndryshimet e mëdha që kanë ndodhur e po ndodhin sot në fshatin tonë kooperativist. Pastaj dorëshkrimi i ridaktilografuar në disa kopje ju dërgua për lexim kooperativistëve të Dobraçit, prej nga është edhe autori. Ata e çmuan inisiativën dhe kurajon e shokut të tyre, shprehën kënaqsinë për shumë kapituj e ngjarje të romanit, po me syrin e tyre kritik nuk lanë pa vënë në dukje edhe ato dobësi e kufizime ideo-artistike që kish vepra.

Në një mbledhje të gjerë, ku merrnin pjesë shumë kooperativistë që e kishin lexuar romanin, shkrimtarë të rrethit të Shkodrës dhe vetë autori, u diskutua për të gjitha ngjarjet dhe personazhet e romanit. Në diskutimet e këtyre kooperativistëve kishte jo vetëm vrejste shumë të rëndësishme po edhe sugjerime kuptimplote që, po të vihehin në jetë plotësisht do të shtanin vlerën realiste dhe ideo-artistike të kësaj vepre.

Në ato diskutime e propozime kishte shumë sinqeritet, shumë mirëdashje që vepra e shokut të tyre të dilte sa më shpejt në dritë. Nuk më kish takuar herë tjetër që të shikoja se në ç'mënyrë interesante dhe të thellë e kuptonin këta kooperativistë një vepër letrare. Ata bënin vrejte dhe propozime jo vetëm për përmbajtjen por edhe për realizimin artistik të saj, për shkallën e tipizimit, për skenat naive dhe natyraliste që duheshin hequr, për gjuhën, madje dhe për vërtetësinë dhe ngjyrën origjinale që duhet të kishin dialoget e fshatarëve. Shumë nga këto vrejte e mendime, autori i pat parasysh gjatë përpunimit të veprës, dhe arriti t'i zbatojë. Të tjerat, qoftë për vështirësitë që kishin, qoftë për kohën dhe shkallën e përgatitjes së autorit, nuk u realizuan dot plotësisht. Po vepra me anët më të goditura të saj përmbante aq merita sa për t'u botuar e për t'u lexuar me qejf nga masa e gjerë e lexuesve, veçanrisht nga dhjetra mijë lexues të fshatit, të cilët do të përfytyrojnë në këtë vepër shumë tabllo dhe ngjarje të jetës, të ngjajshme me ato të tyre.

Autori i këtij romani, kooperativisti njëzetvjeçar Shyqyri Mollaj, është një i ri nga fshati Dobraq i rrethit të Shkodrës. Ai ka lindur në vitin 1946 nga një familje me origjinë të varfër fshatare dhe është, si të thuash, vërsnik me kooperativën e Dobraqit. «Familja ime ka qenë e këputun ekonomikisht. Babai im që në moshë të vogël ju vu punës për të fitue një kafshatë bukë. Ai punonte si kau në tokat e zotnive të Shkodrës. Mbas çlirimit të vendit, tue ju përgjegjë thirrjes së Partisë për t'u futë në kooperativë, një ndër 17 familjet e para që u regjistruan ishte edhe familja ime. Po në këtë vit lindi unë, tamam si një filiz i jetës së re, i botës pa halle, i stinës së madhe të socializmit... Mbarova tetë klasë shkollë dhe mandej hyna të punoj si punëtor në kooperativë. Aty gjeta shokët e njerëzit e dashun të punës që nuk kursenin asgja për të ba realitet fjalët dhe qëllimet e Partisë. Ata punonin në çdo front, në çdo teren, në vapë e në acar, në shi e në diell. Kur ishte

puna për të mbrojtë pasuninë socialiste dhe djersën e tyne, nuk kursenin as jetën... Të gjitha këto më mbushën me mbresa. E frymëzimi për të shkruar këto faqe nuk erdhi ashtu kot, e rastësisht... Ate e gjeja atje në gjiun e fshatarëve të mi, në mesin e fushës që ushtonte nga gjallëria, në fytyrat e shëndetshme e përherë e ma të çilta të fshatarëve. Nuk kisha shkruar ndonjëherë. Po parulla e madhe e Partisë «Te masat dhe për masat» më mbushi me besim e guxim. Kështu që në janar të vitit 1965 nisa të shkruaj faqet e para të këtij libri. Në dhjetorin e po atij viti e mbarova krejt pa u shkëputun asnjë ditë nga puna dhe prodhimi...»

Këto fjalë të autorit tregojnë se u poqën kushtet dhe fshati ynë i kooperativizuar mund të nxirrë shkrimtarët e vet.

Te «Zogjtë ndërtojnë follenë», autori përshkruan jetën e një grupi të rinjsh kooperativistë të Dobraçit gjatë 7-8 muajve të vitit 1964. Nga tablo të ndryshme të jetës kooperativiste, lexuesi përfytyron gjallërinë e fshatit tonë sot; autori spontanisht e në mënyrë të lirshme arrin të krijojë faqe letrare që kanë edhe vërtetësi edhe bukuri. Në shumë skena e përshkrime të librit, zihen jeta e gjallë aktuale, duket prirja e aty për atyshme për të dhënë realitetin në pamje të gjëra e jetësore, krijohen portrete të rinjsh e të rejash që duke luajtur një rol aktiv në punën dhe problemet e tjera shoqërore të fshatit, janë bërë më të pavarur, më praktikë dhe më të aftë për t'u dalë mbanë pengesave. Në të gjitha faqet e romanit ndjejmë jehonën e jetës fshatare aktuale, ndjejmë se sa përpara ka ecur jeta dhe njerëzit në kooperativat tona më të hershme. Edhe pse shpesh të përshkruara me një kolorit të theksuar romantik, lexuesi bëhet dëshmitar i një varg ndryshimesh të rëndësishme, i ngritjes së mirëqënies ekonomike në fshatin tonë, i besimit gjithnjë e më të madh që kanë fshatarët në frutet e ekonomisë dhe mënyrës kooperativiste të jetesës.

Ngjarjet dhe episodet e romanit ngjallin dashurinë për jetën dhe pronën kooperativiste, rrisin dëshirën për

t'u marrë me punë bujqësore dhe për ta zhvilluar, forcuar e drejtuar më mirë ekonominë dhe organizimin e jetës nëpër kooperativa.

Rrallë kam lexuar këto vitet e fundit ndonjë shkrim që të flasë për jetën e kooperativave të përparuara me kaq ngrohtësi të sigurtë, me një njohje të thellë të çështjes dhe jo pa një tingëllim poetik. Tani që bujqësia është vënë në qendër të vemendjes, kur Partia hodhi parullën që rinia të japë kontribut të madh për zhvillimin e bujqësisë, vëllimi i Sh. Mollajt duke përshkruar rininë energjike, punëdashëse, optimiste e të mëngur të një kooperative të dalluar, do të luajë një rol pozitiv.

Ndikimi pozitiv i veprës do të jetë edhe më i madh për shkak se çdo lexues do ta kuptojë qysh në faqet e para se autori përshkruan gjëra që i njeh shumë mirë, që i janë krejt familjare, se përshkrimi i tij është bërë me sinqeritet të madh, me ndjenjë të ngrohtë, me një hov rinije që na pëlqen edhe kur ka një formë disi naive, të ngathët dhe ende jo të pjekur sa duhet.

Lexuesi do të ndjejë këtu respektin për punonjësit e bujqësisë, do të shijojë anët poetike të jetës së fshatit, të mëngjezeve dhe muzgjeve pranveror, të gjelbërimeve plot frute, të optimizmit të njerëzve të fushës.

Në vepër tregohet se si gradualisht po ngushtohen dallimet midis qytetit dhe fshatit, se si në kushtet e jetës së përparuar kooperativiste, rritet një rini e gjallë, punëdashëse, optimiste, me koncepte revolucionare dhe me frymë e qëndrim të shëndoshë klasor. Ajo është e etur për kulturë, për art, për formimin e gjithanshëm të personalitetit të saj. Në mënyrë të veçantë na bie në sy sa përpara ka shkuar emancipimi shoqëror i vajzave të reja. Është meritë e autorit i cili ka vënë në dukje se ky proces është bërë i mundur kryesisht me pjesëmarrjen aktive të femrës në veprimtarinë shoqërore. Në episode kuptimplotë është treguar se ç'rol luan mbi brezin tonë të ri tradita e pasur, pozitive heroike e luftës nacional çlirimtare, e prindërve tanë patriotë, punëtorë e optimist. Në roman ka edhe dobësi artistike, faqe dek-



larative, veprime të përshkruara në mënyrë të ngathët e pa emocionet e dukura. Ka ngjarje të zgjatura dhe pa interes të gjallë. Po që të gjitha këto janë të kuptueshme e të falshme ndaj një të riu që e nisi romanin në moshë shumë të re dhe pa përgatitje letrare.

Për arsye që nuk na u dukën të rëndësishme, emri i fshatit ku zhvillohen ngjarjet u la Dobraçi, duke nënkuptuar këtu faktin që jo gjithçka e përshkruar në roman ka ndodhur në këtë fshat. Autori ka përdorur imagjinatën dhe fantazinë e tij ashtu siç e ka këtë të drejtë edhe çdo shkrimtar tjetër për përgjithësim artistik.

Romani i Shyqyri Mollajt do të jetë një pikënisje e sigurtë e krijimtarisë serioze të kooperativistëve tanë. Ai dëshmon se vetëm nën kujdesin e jashtëzakonshëm të Partisë mund të arrihej një ngritje e tillë e personalitetit të fshatarit tonë që ka të drejtë të botojë njësoj si të gjithë njerëzit e tjerë. E kjo do të ishte mbase ëndëra më utopike e një bujku para çlirimit.

A. K.

## PJESA E PARË

### 1

Mëngjes pranvere. Fushat po flinin gjumin e lehtë të stinës së përtëritjes. Mbi kreshtën e naltë të Cukalit nisi të vizohej një vetull e hollë drite ngjyrë çeliku. Yjtë vezullonin nga larg dhe ende derdhnin ndriçimin e tyre të mekun mbi napën e grisun të natës. Era e lehtë, që frynte nga lindja, sikur e shtyn-te tutje errësinën tue sjellë në vend të saj dritë dhe bardhësi. Ajo lëkundte kallinjte e grunit, fijet e barit dhe lulet e përgjumuna të fushës. Ato qenë të ngarkueme me bulëza vese dhe tashti, që sapo kishte dalë agu, dukeshin sikur të ishin djersitun nga ngrohtësia e rrezeve të diellit.

Larg, nga ana e mbjellun me jonxhë, u ndigjuen zhurmë hapash që afroheshin. Në dritë, që nga çasti në çast po shtohesh, mund të dalloje se qenë kooperativistë. Kishin ndezun cigare dhe, kur i thithnin, ato u dukeshin si xixëllonja të fiksueme mbi fytyrë. Dy burrat arritën pranë bahçes përbri udhës dhe qëndruen nën një man të madh, ku drita ende s'kish përshkuar plotësisht. Përnjherë u ndigjue një e trokitun e thatë metalike...

— Merre litarin dhe shishen e benzinës që i ke

nën sedile — tha burri me za të trashë prej basi. Mandej u ndigjue edhe një krisëm e lehtë, e mbas pak një tjetër e randë sikur të binte diçka në tokë.

— Kujdes!... u ndigjue zani i parë dhe përsëri u ba një heshtje e shkurtën. Ate qetësi e prishën uturima shurdhuese e motorit që zgjatej e bahej gjithnji e ma e shpejtë, krisma e ingranazheve dhe zhurma e dy motorave që dalloheshin nga njëni tjetri. Ajo e motorit të parë pushoi, teksa buçitën katër pistonat e motorit të madh, që filluen punën e tyne të shpejtë. Traktori nisi t'i zgjonte fushat e përgjumuna të fshatit. Buçitja në atë mëngjes të qetë sikur e trembi natën që po largohej gjithnji tue ja lëshue vendin ditës. Traktoristi muer litarin me të cilin ndezi motorin, kapi shishen e benzinës dhe hyni në kabinë e i la ato nën sedilje; sa u ul qiti kryet nga dritarja e vogël e kabinës dhe vrejti fytyrën djaloshare të ndihmësit të ri, që qëndronte ndenjün në sediljen e plugut.

— Gati?... thirri me të madhe, që zani i tij të mos mbytej në buçimën e motorit.

— Gati — u përgjegj ndihmësi tue ja pohue fjalën edhe me kokë.

Traktoristi solli kryet përpara, i dha gaz traktorit, shkeli freksionin, futi marshin e parë dhe traktori eci me ngadalë në drejtim të lavrës. Ndihmësi i dha levës së automatit të plugjeve dhe e gjithë shasia me plugjet u ul përdhe. Atëherë gradoi thellësinë me timonin që e sillte me të shpejtë, ngriti dorën nalt dhe traktoristi, kur pa shenjën që i bani ndihmësi, i futi në çast marshin dhe traktori çau tue tërhequn nga mbrapa me forcë plugjet e futun thellë në dhe. Ndihmësi ish një djalosh me trup të gjatë, flokëzi, me dy sy të zez dhe të shkëlqyeshëm mbi fytyrën pak të dobët po gjithmonë të buzëqeshun. Timonin e lëvizte me lehtësi dhe shpejtësi. Megjithëse ishte i randë, forca dhe muskujt e tij e banin çdo gja të lehtë.

Nga plugjet filloi të derdhej anash toka e shkrihtë dhe e butë. Plugjet lenin brazda të cekta, që formonin

vija në lavrën e lanë pas, vija të cilat i zhdukte lesa prej hekuri.

Traktoristi thithte cigaren dhe vazhdimisht tërhiqte levën e majtë, vështronte motorin, shikonte zinxhirët e traktorit që të mos shkelnin lavrën e re, por as mos të largoheshin prej anës së saj. Vazhdimisht sillte kryet mbrapa, për të shikue ndihmësin në plugje. Kur çdo gja që në rregull, fishkëllonte një kangë, të cilën herë-herë e mbytte buçitja e traktorit. Ndhimësi, vrente thellësinë e punimit të tokës, dheun e avullt që vërtitej ndër plugje e mbrapa plugjeve, shikonte lesën prej hekuri që vinte zvarë e tërhequn prej traktorit dhe kënaqej me lavrën e kuqremtë dhe të butë që lente mbas. Ai mendonte se mbas disa orësh, në këtë tokë të butë do të vinin punëtorët e brigadës IV, për të mbjellun duhan, do të shikonte garën që do të bahej në ate mbjellje. Po, po, në mbjellje duhani kooperativistët gjithmonë bajnë gara në mes të njeni tjetrit. «Po kush do ta fitojë garën?...» pyeste ai me vete. Mendonte për punëtorët që mbillin ma shpejt. «Kush asht ai që mbjell ma shpejt?» pyeste përsëri me vete dhe menjherë i shkoi mendja te tabela e të dalluemve në mbjellje dhe e gjeti. Të parët në tabelë ishin Qemali dhe Suada.

«Po kush do të fitojë, Qemali apo Suada?» pyeste përsëri veten dhe nuk qetohej për asnjë çast nga këto pyetje. «Do të fitojë Qemali, shoku i im ma i ngushtë, apo Suada, e fejuemja e ime?» Sado që e rrihte me mend këte problem, nuk e zgjidhte. Tek mendonte kështu, tërhoqi levën e djathtë, traktori eci pak dhe përsëri mori kthesë djathtas. Atëhere ndihmësi uli poshtë levën e automatikut dhe plugjet ranë përnjherë përdhe.

Ndhimësi shikonte gjelbërimet e asaj pranvere, mjegullën e hollë të mëngjezit që po largohej, malet që e rrethonin ultësinë e madhe të qytetit, mbështjellë në një si kunorë shekullore. Ai ndjente flladin e ditës së re, që bashkohej me aromën e luleve të fushës,

mbushte mushkënitë dhe shpirti i lehtësohej nga një ndjenjë kënaqësie, të cilën po ja falte ky mëngjes pune e zgjimi pranveror. Shikonte tokën e lavrueme të kuqërremtë, e imtë, e shkrihtë dhe të lavruemen, që dukej e zbardhun, e ngjeshun. Kur shikonte gjithë ate punë që kishin bamë, çuditej me veten e tij dhe mendonte: «A mund të mbjellin ata gjithë këte tokë që do të lërojmë na sot? Po... jo... jo, se na do të lërojmë sot sa e sa hektarë. Po, po, do të mbjelljet, se nuk do të mbjellin vetëm sot, ka edhe ditë të tjera. Po kush do të fitojë?» — dhe përsëri i shkoi mendja te gara. Për njeriun asht e pamundur të punojë dhe të mos mendojë për punën që ban. Nji njeri që nuk mendon kështu nuk e din as si punon dhe as pse punon — tha me vete.

Traktoristi solli kryet nga ndihmësi i tij që po i bante me dorë «ndal». E ndali traktorin përnjherë sepse kujtoi mos i kishte ndodhë ndonji difekt në plugje dhe doli nga kabina.

— U prish gja?

— Jo, jo, çdo gja asht në rregull, po hajde dridhe një cigare, hajde — foli gjakftohtë ndihmësi dhe nxori kutinë nga xhepi.

— Cigaren! po ta jap unë, se i kam të hekurosuna.

Dridhe këtu tek unë, se e kam duhanin e fortë, — dhe zgjati kutinë që t'ja jepte traktoristit.

— E sheh, paskemi bamë do punë — foli ai ndër-sa mori kutinë e duhanit. — E pra edhe unë u çudita parë.

Traktoristi filloi të dridhte një cigare të trashë. — Po e dredh të trashë, që të baj disa rrugë pa e mbarue. A je i fejuem? — i tha traktoristi ndihmësit, kur i pa unazën në gisht. — Po, — u përgjegj ndihmësi me buzëqeshje.

— Ashtu? Po ku, këtu në fshat?

— Po, në fshat.

— Atëherë pra, u trashigofshi, se unë nuk e kam ditë. Po cila asht?

— Suada Seferaj.

— Ahaaa!... e kuptova, të kam pamë disa herë me te. Keni pasë dashuni njeni me tjetrin, e? — foli duke qeshun traktoristi. Tjetri u skuq dhe vuni buzën në gas.

— Fillojmë nga puna tashti? —

— Fillojmë. Dhe traktoristi shkoi shpejt në traktor. Traktori tërhiqte me forcë plugjet dhe ai fishkëllonte një kangë që nuk e ndigjonte asnjëri përveç tij. Ndihmësi me trupin gjysmë të përkulun i mbante duart të mbështetuna në timonin e plugjeve. Traktori po bante rrugën e fundit të asaj shkuemje afër grunit. Nga kreshta e naltë e Cukalit u derdhën mbi fushat e Shkodrës rrezet e ngrohta të diellit pranveror. Gjithçka u ndriçua e u la si me argjend.

Vesa shkëlqente si gur i çmueshëm në kallinj të e grunit dhe në fijet e barit të gjelbër. Era e lehtë dhe e kandshme e atij mëngjesi ta ledhatonte fytyrën, kallinj të e grunit lëkundeshin valë-valë në dallgë të vogëla. Ai fllad i lehtë mëngjesor kundërmonte erën e kandshme të luleve shumëllojshme dhe shumëngjyrëshe të fushave.

Vesa dhe brazdat e tokës nisën të avulloheshin edhe ma dhe avujt e tyne ngriheshin nalt si re të vogla, të bardha, që fshiheshin në hapësinë. Aty matanë, liqeni shëndritte nga rrezet e diellit si një pasqyrë e shtrime për tokë. Zogjtë filluen të zgjoheshin dhe të fluturonin nëpër pemët e bahçes që ish e rrethueme në anët e saj me mana të mëdhej. Në mes zbardhnin trunget e lloj-lloj pemëve që ishin lye me gëlqere të bardhë dhe që dukeshin sikur të gjithë kishin veshun nga një fustan të njillojtë, kurse në kokë mbanin kultura të ndryshme. Traktori vazhdonte punën, brazdat dhe vesa avullonin nga rrezet e ngrohta të diellit dhe në shpirtin e traktoristit dhe ndihmësit të tij lindnin plot ndjenja e mendime të bukura.

Arat që e rrethonin fshatin në një anë ishin mbjellë me grunë, tërshanë dhe jonxhë. Ato dukeshin si një

det i gjelbër, ndërsa shtëpitë e grumbullueme të fshatit në anën tjetër, si një ishull në mes të një deti gjelbërimi. Dy shtëpi të ndame nga fshati qëndronin në mes të valëve të këtij deti të gjelbër dhe dukeshin si dy anije të mëdha, që presin të zbarkojnë në ishull. Disku i diellit ishte ngritur pak nga kreshta e Cukalit, zogjtë e pulëbardhat vinin mbas plugut dhe hanin krymbat e tokës. Ato rrinin paksa në një vend dhe largoheshin menjherë, sapo shikonin gja në sipërfaqen e lavrës së re. Donin të futnin kryet aty afër plugut posa e nxirrte plugu ndonji krimb të bardhë e të trashë ose të kuq e të hollë dhe të zgjatun si fije makaronash.

Pulëbardhat e buta, të bardha si qumësht, fluturonin mbi traktor dhe gadi sa nuk preknin kryet e ndihmësit, po ai s'e kish mendjen te ato. Hodhi vështrimin atje larg dhe pa punëtorët tue ardhun grupe-grupe. Në këte çast e ndjeu veten të vetmuem nga diçka që as ai vetë nuk e dinte përse. Punëtorët dalngadalë po afroheshin. Mbasi traktori bani edhe dy të kthyeme, ata arritën në atë vend ku kishin hy të punonin me traktor qysh në mëngjes herët.

Brigadierja qëndronte në krye të lavrës dhe prishte traktorin që po kthehesh. Kur arriti afër brigadieses ajo u largue nga ana e lavrës. Traktoristi e përshëndeti ate me kokë dhe ajo ja ktheu përshëndetjen me buzëqeshjen e saj të natyrshme.

Brigadierja nxori metrin, mati thellësinë dhe i bani shenjë traktoristit që të ndalonte. Ai frenoi dhe shikoi ate kur po afrohej te traktori.

— Sa asht thellësia? — pyeti ndihmësi pa luejtun nga sedilja. Kujtoi se mos e kish lavrue ma cekët se për ma thellë ish i sigurt se atij nuk i thonë gja.

— Thellësia asht në rregull, ashtu mbaje — ju përgjegj brigadierja ndihmësit, i cili vetëm atëhere e ndjeu veten të qetë. Ajo u afrue dhe i tha traktoristit: — Karburantin e ke aty te qoshja e bahçes, te stallat ku kanë qenë pulat. Traktoristi pohoi me krye, e sho-

qëroi me shikim nga mbrapa, mbasandaj i dha traktorit.

Punëtorët që kishin ardhë aty u ulën në barin e njomë anës bahçes. Ata pritnin karrocën që t'u silte koshat me fidana duhani. Disa, që s'u bahej me ndejë, u ngritën për të mbledhun lule që kundërmonin erë të kandshme. Bujqit po prehnin qetë e tyne për në lesa druni, që të lesson nga ana e kundërt e lavrës së punueme nga traktori. Menjherë ja filluen punës. Qetë, me hapin e tyne të ngadaltë, tërhiqnin lesën prej druni mbi të cilën kishin hypë bujqit. Ata i thumasnin nganjherë me bodecin e ngulun majë hostenit. Bujku, kur shikonte kaun që tërhiqte ma pak, e thumbonte dhe e bante të shkonte paralel me të parin.

Ndërsa vajzat mbledhnin lule, erdhi karroca e ngarkueme me koshat e mbushun me fidana duhani. Brigadjerja i thirri vajzat. Ato mbanin në dorë lule që i kishin mbledhë e bamë tufë. Nurija, një vajzë e gjatë zeshkane, me një palë sy e vetulla të zeza ja dha tufën e luleve të saja Suadës dhe i tha: «Suada, merre këtë tufë me lule dhe dhuroja Agimit». Suada buzëqeshi tue thanë: «Po njisoj i kemi lulet, si ato të tuejat i kam edhe unë, mandej unë ja kam dhurue disa herë atij dhe ai e ruen kujtimin tim; por ti, Nurije, rueja dhe dhuroja atij tandit». Nurija u skuq pak në fytyrë nga fjalët që i tha Suada, por se si i lindi një dëshirë që ato lule t'i mbante e t'i shtërngonte. Po kujt t'ja dhuronte?... dhe i shtërngoi lulet me dorën e djathtë. Suada e shikoi, ju afrue pranë dhe i tha diçka. Nurija nuk foli por rrinte si, e krekun prej ndonji kujtimi që ndoshta ju ngjall në atë çast...

— Jo, Suada, nuk e mora për të keq, na jena shoqe dhe nuk duhet të keqkuptohemi — foli Nurija mbas një heshtjeje të shkurtën dhe të dyja u afruan afër shoqeve të tjera që kishin rrethue vendin që do ta pastronin nga barnat e këqia.

Traktori po afrohej. Suada u ngrit në kambë, mori në dorë një çantë ushqimi prej lëkure dhe po i dilte



përpara. Traktoristi shikonte me habi vajzën që po e priste aty në krye të lavrës tue mbajtë diçka në dorë. Kur ai e pa fytyrën e saj të hieshme, atë buzëqeshje të kandshme nën atë shami të bardhë, e njohu dhe solli kryet mbrapa nga dritarja e vogël për të shikue ndihmësin. E pa dhe ja luejti kryen tue vu buzën në gaz.

Vajza kish zanë vend në tokën e lavrueme dhe kambët i kishin humbun në dheun e butë. Traktori mori kthesë, ndihmësi i dha levës nalt dhe plugjet u ngritën. Pulëbardhat, që vinin mbas traktorit, i fluturonin Suadës mbi krye dhe sa s'e ciknin. Edhe ajo e kish shaminë e bardhë në krye si pulëbardhat. Aty, fare afër, traktori mori kthesën dhe ndihmësi i bani me dorë që ta ndalte. Ai e ndali, nxori nga xhepi paketën e cigareve, e ndezi një dhe filloi ta pinte ngadalë.

— Puna e mbarë, Agim! — i foli Suada ndihmësit kur ju afrue plugut ku qëndronte. —

— Mbarë paç, Suada, a u lodhët? A je çue herët?

— Na herët jena çue me shkulë resat, po ju jeni çue edhe ma herët se na. Kur shkuem në resat ndigjuem traktorin që punonte.

— Eh, tashti që filloi fushata, s'duhet të pyesim ma për kohën herët a vonë, — fliste Agimi ulun ndejun në sediljen e plugut.

— Kujtimi desh që ta binte nadjen<sup>1)</sup> (Kujtimi ish vëllai i vogël i Agimit) dhe unë e takova në rrugë; atëhere ja mora ushqimin për mos me ja dhanë atij atë rrugë deri këtu.

— Mirë ke bamë. Të lumtë... — Suada ja dha çantën e ushqimit të Agimit dhe me dorën tjetër i dha tufën e vogël të luleve. Mandej i uroi punë të mbarë dhe iku. Agimi shikoi lulet, u mori erë, u ul nga sedilja e plugut dhe shkoi te traktoristi në kabinë. Ai pinte cigare i menduem. Kur Agimi ju afrue dhe traktoristi e pa i tha:

---

1) Mëngjesin

— He, ç'ka tha? për takimin, sigurisht, në orët e vona, ee? — bani shaka ai.

— Ate nuk ta diftoj tashti, por vetëm mbas takimit. Hajde, ulu prej traktorit, e të hamë nadjen, — i tha Agimi.

— Po mirë, të shohim se çka të ka përgatitë e fejuemja, i ka gatue mirë apo jo, — bani shaka përsëri dhe u hodh nga kabina në tokë.

— S'do mend që i ka gatue mirë, si për të fejuemin ma...

— Po, po, u muer vesh ajo punë... Shkojmë te ai mani aty në mes, se asht vend i mirë? — pyeti Agimi.

— Atje po shkojmë, — pranoi traktoristi dhe u nisën. Shkuen te vendi ku thanë dhe u ulën në barin e njomë. Agimi nxori ushqimin nga çanta, i shtroi gjanat mbi një mbulesë, nxori thikën dhe preu bukën në copa të vogla. Traktoristi mori vezët e ziera dhe nisi t'u qëronte lëvozhgat. Filluen të hanë bukë tue bamë bisedë njeni me tjetrin. — Ama kjo e fejuemja jote i paska gatue mirë kërtollat<sup>1)</sup>.

— Jo, mor vëlla, të gjitha i ka gatue nana e ime, por ajo vetëm se i ka prue deri këtu.

— Ashtu?... foli traktoristi dhe e futi lugën e mbushun në gojë. — Po mue ai furnizuesi i ushqimit tash po m'len pa bukë. Kam ikë prej bllokut atje, afër Kirit, e kam ardhë këtu, afër liqenit. Ai tash po kujton se kam shkue në ndonji kooperativë tjetër.

— Pse, ke frigë se s'po na del ushqimi-a? Paska prue nana për dy vetë e ma tepër.

— Jo mor, s'po ankoj për ate punë... foli traktoristi dhe vazhdoi të hante. Aty ma tutje, punëtorët mbaruen pastrimin e duhanit, u ngritën dhe u banë gadi për mbjellje. Skuadërkomandanti mori shënuesin dhe filloi të bante vizat për rreshtat e duhanit. Të tjerët nisën të ndanin nëpër vija fidanat. Mbas tyne vinin mbjellësit. Të gjithë përnjherësh ia filluen

---

1). Patatet

punës. Agimi solli kryet nga punëtorët dhe shikoi Qemalin, Suadën dhe në tjetrën Shpresën kurse të tjerët vinin mbas tyre. Vetëm tashti që filloi puna po e shikonte Qemalin. Me një herë i shkoi mendja te gara dhe tha me vete: Kush do të fitojë? Po ata nuk ja filluen garës. Ata nuk dinin se Agimi kish dëshirë që ta dinte këte sa më parë. Agimi hante dhe mendonte; punëtorët punonin dhe mbrapa tyre lenin fidanat e duhanit të mbjellun, që ashtu në vija të drejta dhe të radhitun njeni mbas tjetrit dukeshin si rreshta ushtarësh. Hangri bukë shpejt dhe po priste traktoristin që të kryente edhe ai, po kur e pa se nuk kish vu në mend të shpejtonte, u shtri sapak në barin e njomë. Traktoristi hante ngadalë, shikonte nga punëtorët që po mbyllnin dhe thoshte në vete: «Çfarë duersh të shkathëta kanë fshatarët! Ja, e ngulin dorcën e drunjtë në dhe, aty dorca në vendin e ngulun len birë, atëherë e marrin fidanin e duhanit në dorë, e futin në vendin e hapun me dorcë, prapë dorcën e ngulin në dhe, e shtërngojnë fidanin me te, mbyllin vendin e hapun që len dorca, dhe të gjitha këto veprime që i do çdo fidan i kryejnë me një shpejtësi të mahnitshme. Po sa mija e mija fidana mund të mbjelli një njeri si këto në ditë dhe me këte shpejtësi?... — Kjo shpejtësi dhe shkathësi e bante të mendonte traktoristin qytetar. Agimi rrinte i shtrimë në shpinë. Zemra i trokiste me forcë dhe ai çuditej përse ndodhte kjo, aq ma tepër në këte kohë kur trupin e kish të shtrimë dhe të qetë. Shikonte nalt qiellin blu të pastër dhe pa asnjë re. Në hapësirën e lirë dhe të pafund fluturonin shpendët shtegtarë, të cilët erdhën bashkë me pranverën dhe ngrohtësinë.

Agimi kënaqej nga kjo pamje. Bilbili në gemat e mollës dhe në mesin e atyne luleve i dukej si një solist në një skenë fantastike.

Qetësinë e shkurtën e prishi traktoristi dhe gjallëria e njerëzve.

— Sa bukur punojnë! E gjithë puna shkon zinxhir! Na lëvrojmë tokën me traktor, mbrapa nesh e lesojnë

bujqit edhe një herë, skuadërkomandanti ban vijat, disa shpërndajnë e të tjerët mbjellin, mbas mbjelljes do të prashitet disa herë, mandej do të vilet dhe me kosha duhani do të transportohet në stalla. Gjeth për gjeth do të përshkohet në vargje, do të thahet, do të lehet deri në vjeshtë, në magazinë ose në stalla, i vjerrun; mbasi shinat e vjeshtës të kenë ra, i gjithë duhani do të paloset, mbas palosjes do të lidhet në denga dhe do të transportohet në fabrikë. Aty kushedi sa herë merret nëpër duer deri sa të dalin cigare. Prej aty ai do të merret dhe do të përhapet nëpër dyqane; atëhere blerësit do ta bajnë të gjithë shtëllunga tymi — dhe kështu mbaroi bisedën e tij. Agimi, që ishte ngritë ndenj, po i ndigjonte fjalët dhe mendimet e stërgjatuna të traktoristit dhe, meqenëse nuk i kish ndjekun me vëmendje të gjitha, sidomos ato të fillimit, për t'i tregue shokut se e kish pasur mendimin tek ai, shtoi diçka edhe ky:

— Ti s'e ke kapë prej mbjelljes së farishteve; ajo ka procese të thuesh edhe ma shumë, mandej ti harrove se do të transportohet prej fabrikës në Portin e Durrësit, e atje do të ngarkohet në anije dhe do të dalë jashtë shtetit, e kushedi kush e pi duhanin tonë e hu, u, u...

— Ashtu asht — vërtetoi traktoristi që po hante kafshatën e fundit.

— A çohena e fillojmë punën? — foli ndihmësi i traktoristit.

— Çohena! dhe traktoristi u ngrit. Agimi mblodhi ato që kishin teprue nga ushqimi, i futi në çantë dhe atë e vari në një gëm mani. Tjetri ndërkaq kish shkue te traktori. Hyni në kabinë, i dha gaz motorit dhe priste Agimin të vinte dhe të ulte plugjet. Ndhmësi hypi në plugje, i bani me dorë tjetrit dhe atij i buzëqeshi fytyra e gjanë me mustaqet e holla e të zeza dhe balli i zhigatun me voj motori. Solli kryet dhe pastaj i dha traktorit.

— Pulëbardhat të gjitha kishin ikun, tashti Agimi

s'kishte çfarë të shikonte aty përrreth. Vetëm më tutje vuni re Qemalin, Suadën dhe Shpresën, që ishin shkëputun prej të tjerëve dhe po i jepnin shpejt që të tre. Mbas tyre shpejtonin edhe të tjerët dhe ai tha me vete: «Gara paska fillue» Që atë çast shikimin e mbante mbrapa.

Qemali ishte para të gjithëve, mbas tij vinte Suada dhe mbas saj Shpresa. Mbas Shpresës vinin të tjerët, që i jepnin me gjithë shpirt.

Vijat e duhanit ishin të gjata dhe mbjellësit kishin ende kohë të arrinin deri në fund. Ndhimësi shikonte duert e shpejta që mbillnin duhan, i vrente me admirim dhe maste me sy fundin e vijave. Traktori mori kthesë, Agimi s'e kish mendjen fare tek ai, kish harrue ta ngrinte levën e plugjeve, dhe po vazhdonin të rrinin të nguluna në dhe, po kur traktori mori kthesë, motori gjëmoi; traktoristi me të shpejtë ndërroi marshin dhe desh t'i jepte përpara, por motori gjëmonte dhe s'mund të mirrte kthesën. Kur ndigjoi gjëmimin e motorit, Agimi solli kryet prapa dhe e pa gabimin e tij.

Traktoristi i shqetësuem zbriti marshet, ndali gazin e traktorit dhe desh të shikonte se ç'ngjau me motorin; por sapo zbriti në tokë dhe shikoi plugjet e futuna thellë në dhe u qetësue. I lëvizi kokën Agimit në shenjë qortimi miqsor dhe hyni përsëri në kabinë. Atë çast Agimi e kuptoi edhe një herë se s'mundesh me punue mirë pa e pasë mendjen dhe sytë atje. Posa traktori eci pak drejt, Agimi i dha levës nalt dhe plugjet u ngritën. Atëherë rrotat ecën lehtë, bani kthesën dhe hynë përsëri në lavër. Mbasi uli plugjet, rregulloi thellësinë dhe u sigurue që çdo gja ishte në rregull, hodhi sytë sërish andej nga ishte tue u zhvillue gara dhe ndjeu se nuk qenka aq lehtë ta përqëndrosh mendjen në një punë kur në po ate çast të tërheq diçka tjetër.

Tashti punëtorët i kishte përpara, në të djathtë të tij. Ata i ishin afrue fundit të vijave. Qemali, Suada dhe Shpresa qenë në krye. Në fundin e vijave ku do

të përfundonin qëndronte flamuri që lëvizte palët e tij të kuqe.

Ai që do të fitonte garën do të mirrte flamurin. Suada i dha vetes me të gjitha forcat e saj dhe arriti të barazonte me Qemalin. Që të dy u banë paralel, të dy i jepnin gjymtyrave me mish e me shpirt. Mbas tyne vraponte edhe Shpresa. Agimi shtërngonte timonin e plugut sikur donte t'u jepte forcë. Po kujt? — Asaj... apo atij...

Ai s'e ndante shikimin nga ngjarja që e tërhiqte aq shumë dhe e mundonte njikohësisht aq shumë. Hoqi duert nga plugu dhe nuk e shtërngoi ma. Të tre mbjellësit s'kishin veçse pak për të arritun flamurin. Ai kuqëronte dhe lëvizte ngadalë nga era sikur i grish-te mbjellësit që të vinin sa ma shpejt tek ai. Traktori-stit se si i shkuen syt andej nga punëtorët dhe pa garën që po zhvillohej. Skuadërkomandanti, bashkë me disa punëtorë, ishin ngritun në kambë dhe po shikonin edhe ata këte fund gare. Qemali jepte e merrte me të gjitha forcat e tij për të arritun Suadën, që i kish dalë pak përpara dhe e kish kaluem nja dhetë a pesëmbëdhjetë fidana duhani; ai punonte me të gjitha energjitë; shpejtonte dhe bante të gjitha përpjekjet për të fitue garën.

Shpresa nuk u ndahej, ajo vazhdonte t'i ndiqte që të dy të parët dhe ishte kambëngulëse. Agimi rrinte në plug; të gjithë vemendjen e kish përqëndruë te gara dhe thoshte me vete: «kush do të fitojë?». Kjo pyetje, që deri tashti i mbeti e pazgjidhun, po i zgjidhej. Po çasti ma i fundit, minuti ma i fundit po ju dukte shumë i gjatë.

Zemra i trokiste me forcë dhe e ndjente si të shqetësuem. Qemali e kaloi pak Suadën dhe ajo, kur e pa mblodhi të gjitha forcat e saj ku i kishte e ku s'i kishte që të mos humbte garën. Qemali, nga shpejtësia, një fidan duhani e mbolli me rranjë përpjetë. Mbasi mbolli dy tre fidana të tjerë u kthye, e shkuli dhe e mbolli një tjetër. Por ato ishin momente, distanca ishte

shumë e shkurtën, koha s'e lejonte që ta shkulte atë fidan e t'u kthente dhe ta mbillte përsëri. Suada e kaloi, u shkëput. Ai edhe sikur ta kalonte Suadën dhe ta linte fidanin me rranjë përpejtë do ta humbte. Suada s'e kish flamurin tash as një metër e gjysëm larg. Qemali i mblodhi edhe ato forca që i kishin mbetë dhe vazhdoi mbjelljen me shpejtësinë ma të madhe të tij. Por nuk vonoi shumë, Suada mbolli fidanin e fundit, shkuli flamurin dhe e ngriti nalt.

Urra a a a... e fitoi!... u ndigjue zani i gëzuem i vajzave. Kur ndigjoi Qemali thirrjen e vajzave ngriti kryet dhe shikoi se s'kishte asnjë metër largësi që të mbaronte. Suada qëndronte në kambë me flamurin në dorë. Atëhere u ngrit dhe shikonte punëtorët që në atë kohë po qëndronin në kambë. Mbrapa vetes ndjeu diçka që punonte, që ecte; solli kokën mbrapa dhe pa Shpresën. Ajo po barazonte. Qemali pa humbun kohë u ul dhe me të shpejtë mbolli ato pak fidana që i kishin mbetun dhe zuni kështu vendin e dytë. Aty pranë pa Suadën dhe e uroi me zemër:

Të lumtë! — Ja shtërngoi dorën miqësisht dhe shkoi nëpër mend sa i lumtur do të ndjehej Agimi.

— Agim, o Agim — thirri traktoristi. Agimi solli kryet nga ai dhe e ngriti pak nalt që t'i jepte të kuptonte se ai po e ndigjonte.

— A i pe ata? — dhe ngriti vetullat e zeza nga punëtorët.

— Po po, i pashë, jepi traktorit të punojë... Traktoristi buzëqeshi duke ja luejtun kokën Agimit, u suall përpara dhe i dha traktorit...

Të tre konkuruesat e parë të garës ishin rreshtue njeni mbas tjetrit dhe dukeshin të lodhun e të djersitur nga gara.

— Të lumtë! flamurin e fitove dhe tashti mbaje deri në fund. — i tha skuadërkomandanti Suadës.

— Unë sot fitova por nuk don me thanë gja, se ndoshta nesër ma merr ndonji tjetër, — i foli ajo. — Si, mor Qemal, për pak ta mori garën ty? bane edhe

nji garë tjetër dhe merrja flamurin, — i tha Meti, një djalë i shëndoshë me një palë nofulla të zgjanueme. Kur foli ai ju dukën dy dhambët e parë, të ramë dhe flokët si të kuqremtë, që nuk i rrinin kurrë të kre-hun mirë.

— Jo, nuk ban ashtu, asaj bravo i qoftë! Me punën dhe fuqinë e saj e ka fitue. Gara po bajmë për çdo ditë, do të bajmë edhe nesër dhe në qoftë se ajo e mban, asht një meritë e saj, — i foli Qemali Metit... Ato që s'i kishin mbarue ende vijat e tyne i mbaruen dhe u bënë gati të fillonin të gjithë përnjherë.

Qemali e ndërroi dorcën e duhanit me atë të Suadës, sepse ja kishte dhanë ma përpara se t'ja fillonin garës. Dorca e tij ishte ma e mirë dhe, ndërsa i ndërruen, shikuen njeni tjetrin. Ai vrejti fytyrën e Suadës pak të hequn, të bardhë e të njomë. Vetullat e saj të zeza qëndronin si hark mbi ato dy sy të gështenjta dhe gjithmonë të qeshun. Në ballin e saj të rregullt dhe në mollzat e kuqe të faqeve ndrisonin disa bulëza të shpeshta djerse. Ishte djersa e punës së frytshme.

Kur ajo buzëqeshi ju dukën dhambët e bardhë, të rradhitud si rruza.

— Je lodhë? — pyeti Qemali Suadën, ndërsa po shkonin të fillonin vijat e reja.

— Po... gara asht sulm, luftë, përpjekje, dhe pajtjetër do të ketë lodhje, apo jo? — foli buzëqeshun Suada.

— Ashtu asht! — tha Qemali dhe filluen vijat.

Atë çast ja behu Ibrahimimi, një burrë i pjekun, si në moshë ashtu edhe në muhabet, me një trup mesatar, flokëzi, syzi dhe me një fytyrë bojë gruni. Ishte skuadër komandanti. Mbas kish kontrollue fidanat që ishin mbjellun gjatë garës solli lajmin e mirë se asnjë fidan nuk qe mbjellun keq.

— Fidanat janë mbjellë mirë — tha ai dhe mori shënuesin e vijave.



Të gjithë filluen punën përnjiherë dhe me një ritëm të shpejtë. Punuen kështu orë të tana dhe çdo udhëtar që mund të kalonte aty do të vinte re se si qenë përqëndruar me mend, me sy, me gjymtyrë mbi vijat e gjata ku do të mbilleshin fidanat. Tek i vështroje ashtu të ngulun me zemër mbi punën, ndjeje se çfarë nevoje e ushqimi shpirtor ishte ba puna për këta kooperativistë.

Aty përtej, në drejtim të qytetit, në barin e njomë të bahçes të binin në sy dy të rinj me libra në dorë që flisnin njeni me tjetrin. Ata kishin ardhun për të mësue bashkë në natyrë po tek kqyrnin bukuritë e pranverës e braktisën dhe studimin.

Punëtorët kishin lanë punën dhe po pushonin në barin e njomë të bahçes. Dielli kishte fillue që të lëshonte rrezet për çdo ditë e nga pak ma të ngrohta. Anës bahçes kalonte një grup tjetër punëtorësh, nga ata të brigadës së perimeve që punonin ma poshtë, në arat buzë liqenit.

— Qemal, Qemal! — thirri një vajzë nga grupi që mbushte ujë.

— Qemal, Qemal! — thirri një vajzë nga grupi që po kalonte në anë të bahçes. Qemali solli kryet dhe pa një vajzë që u shkëput nga grupi. U kthye dhe mori drejtim nga ajo. Ajo po vraponte në drejtim të tij nëpër mes bahçes.

— Qemal! ke një letër prej Hajredinit — foli vajza ndërsa po e ngadalësonte vrapin.

— Mirë, Afërdita, po mos vrapo ashtu — i foli Qemali.

— Po më ikin shoqet, Qemal.

— Kush ta dha këtë letër?

— E mora në kooperativë dhe, posa e pashë, ta solla ty — fliste Afërdita dhe mezi ngopej me frymë.

— Dita...

— Urdhëno Qemal.

— Faleminderës shumë!...

— Nuk ka gja, Qemal, ditën e mirë!

— Shikuen njeni tjetrin deri sa ajo u kthye përsëri nga erdhi dhe filloi të shpejtojë hapat që të zente shoqet.

Qemali hapi letrën që i dërgonte shoku ushtar dhe u nis të mbushte katrovën.

Mbasi erdhi Qemali, disa pinë nga pak ujë dhe nisën përsëri. Të gjithë punonin me një ritëm të shpejtë. Traktori punoi deri në orën katër mbas dreke, pastaj nga ajo parcelë shkoi të punonte në një tjetër, aty afër. Dielli perëndoi, mbrapa vargmaleve dhe atje sipër tyne, afër perëndimit, qielli mori ngjyrën e verdhë sikur të ishte ngritun poleni i të gjitha atyne luleve të fushës që t'i jepte bukuri atij perëndimi. Nji re e vogël notonte në atë fushë të verdhë e dukej sikur ishte ndonji bletë që po thithte nektarin e ambël të fushës së lulzueme. Pjesa e poshtëme e saj, e verdhë dhe herë-herë ngjyrë argjenti, të kujtonte kambët e verdha të bletës, që duke shëtitur lule më lule, mbushet gjithë polen.

Bujqit atje në fundin e arës me qerret e tyne po niseshin për në kooperativë. Ritmi i punës akoma s'ishte ndërpre. Traktorët buçitnin nëpër ara. Era e freskët dhe e kandshme e perëndimit frynte lehtë, punëtorët ndjenin përkëdheljen e këtij perëndimi dhe shtonin forcën ma tepër në punë.

Fidanat e duhanit të mbjellun kishin ngritun kokën nalt dhe nga era e lehtë, e freskët, lëviznin gjethet e tyne të vogla. Edhe ato sikur ndjenin kënaqësinë dhe përkëdheljen e muzgut që po afrohej.

Atje, buzë atij perëndimi, qielli po e humbiste ngjyrën e verdhë dhe dalngadalë era që frynte sikur po e shkundte polenin dhe po e hidhte poshtë mbi valët e liqenit, të cilat njena mbas tjetrës po e përcillnin në breg. Ajo re ngjyrë argjenti u shkund nga poleni që mbante, mori ngjyrën e përhimtë dhe, e ngopun në nektar, vrapoi në koshere tamam si një bletë e vonue-me që ka frigë të mos e zëjë nata.

Brigadjerja mori kompasin dhe maste punën e kryeme. Mbase mati gjatësinë dhe gjanësinë, hapi bllokun, i shumëzoi ato, dhe një buzëqeshje e kandshme ja ndriti fytyrën e saj rrumbullake.

Ishte e kënaqun që punëtorët e tejkaluën normën dhe u drejtue nga ata që kishin lanë punën dhe po visheshin. Rreshtat e duhanit ishin të drejtë, aq të drejtë sikur ndonji gjeometër të kish vu spangë për çdo rresht. Brigadjerja kalonte anës tyne dhe kënaqej kur shikonte këtë punë të mirë të punëtorëve...

2

Të gjithë lanë punën, u veshën dhe u banë gadi për t'u kthye në shtëpi. Qemali e pyeti brigadjerën për realizimin e normës dhe ajo i tha me kënaqësi: Sot kemi ba nga një normë e tetëdhjetë — Nesër do të bajmë dy, ja preu fjalën Skënderi.

— Tue punue kështu fushatën do ta kryejmë shpejt — u foli brigadjerja.

Suada mbante flamurin që e kish fitue në garë. Qemali e shikonte flamurin dhe thoshte me vete: «për pak ma mori, po të shohim nesër, do ta marrë apo jo; ajo sot e meritoi» dhe largonte shikimin.

Kish ra muzgu dhe nga perendimi, mbrapa malit Tarabosh, po shuhej edhe ajo pak dritë. Nata dalngadalë po mbulohej me perden e saj të zezë dhe yjet filluen të vezullonin të dendun. Traktorët kishin ndezun dritat dhe rrezet e tyne derdheshin në tokën e lëvrueme e të butë. Ndhmësi lëvizte timonin e plugut dhe gjysmën e trupit ja zbulonte drita e traktorit që lëshohej nga mbrapa. Anës jonxhës së xhelepeve po kalonin punëtorët.

Në të djathtë të jonxhës ishte mbjellë grunë. Të gjithë ecnin tue bisedue. Qemali bisedonte me Suadën për garën që kishin bamë, kurse të tjerët banin biseda dhe shaka të ndryshme.

Nji za i kthjellët e i qartë vinte prej së largu, ndoshta nga livadhet para liqenit apo nga diku tjetër. Qemali ndali bisedën që kish nisë me Suadën dhe po ndigjonte zanin që vinte që andej.

— Po më duket si zani i Faikut — foli Qemali që akoma nuk e kish ndamë vështrimin nga ajo anë.

Kanga sa vinte afrohej dhe bahej ma e bukur, tek shpërndahej ashtu e lirë në natën e pafund. Fjalët nuk mund t'i kuptonin nga zhurma e kambëve të punëtorëve që shkelnin barin e rritun e të njomun nga mjegulla e hollë që kish nisë me ra.

Të gjithë ecnin nëpër vragën që kishin bamë karrot dhe qerret. Disa ecnin ma mbrapa dhe qetësisht për me ndigjue kangën që vinte nga livadhet. I joshun prej kangës së tjetrit edhe Meti ja nisi me za të lehtë. Ai nuk kish za për kangë, por kanga i pëlqente dhe prandaj desh t'i nxitë të tjerët që t'ja fillonin asaj përpara brigadës tjetër.

Nurija hyni në kangë me Metin; ajo nuk e kish zanin e keq dhe Meti ja la kangën asaj. Ajo e vazhdoi deri në fund e mandej pushoi.

— Mos e len, Nurije — filloja një tjetre — i foli brigadjerja. Nurija kish si turp t'ja fillonte kangës vetëm dhe i tha Suadës që të këndonin bashkë. Që të dyja ja filluen. Shokët i ndigjonin me kënaqësi dhe hapat e tyne i hidhnin lehtë mbi bar që të mos jepnin as ma të voglën zhurmë. Kangën «Lulëzon Kooperativa» e dinin të gjithë të rinjtë dhe të rejat dhe posa mbaroi njena strofë, ja filluen edhe të tjerët, kështu që u ba një si kompleks i krijuem aty për aty. Suada e Skënderi mbanin zanin e parë, disa të tjerë zanin e dytë. Era e lehtë që frynte lëkundëte jo vetëm kallinjte e njomë të grunit që gjasonin me dallgët e vogla të detit po dhe tingujt e kangës që lundronin sipër tyne.

Brigadjerja e ndjente veten të gëzueme në mesin e punëtorëve. Ajo kujtonte se si e kish këndue këte kangë me oktetin e vajzave kur u ba festivali i kan-

gëve dhe i valleve për fshatin. Dhe tani kish qejf dhe dëshirë që atë gëzim që ndjente nga kujtimi i asaj çfaqjeje ta derdhte në kangë. Shikonte shokët e shoqet që këndonin për bukuri, shikonte Suadën me fytyrë të qeshun dhe shpeshherë e ngrinte flamurin që lëvrinte palë-palë nga era. Solli kryet nga mbrapa dhe atje poshtë pa dritat e traktorit që ndriçonin si fenerë; pa përsëri punëtorët dhe tha me vete: «Këta sikur s'e ndejnë lodhjen aspak»... këqyri ata ma të pjekunit në moshë që ndigjonin dhe ecnin të heshtun, pastaj shtoi: «Eh po kjo rinia kështu e ka, s'e ndjen lodhjen; bilbili kur ndërton çerdhen në pranverë, s'mund të rrijë pa kangë. Me punë e ndërtojnë folenë, jetën e re, dhe me kangë i këndojnë asaj». Një natë natë pranvere përzjeheshin shumë zana, shumë kangë, shumë tinguj: këndonin ata të brigadës IV, mbas tyre ata të brigadës së perimeve dhe ma tej i ndiqte buçima e traktorëve.

Në mesin e xhelepeve ishte një kanal i gjanë, i thellë, i cili kishte pak ujë të rrjedhshëm. I pari që e kaloi atë ishte Qemali. Ai zbriti poshtë, kapërceu ujin dhe u ngjiti nalt, në anën tjetër të kanalit të thellë. Këtu kanal kooperativistët e kishin çelë për tubacionet e ujësjellësit të qytetit, i cili do të furnizonte veç qytetit edhe fabrikën e letrës dhe objekte të tjera që po ndërtoheshin. Kanali, me një thellësi dy metra e ma, ishte çelun me traktorë dhe eskavatorë, por nuk kishte qenë ma e pakët edhe puna e kooperativistëve dhe të rinjve të qytetit që kishin ardhë për punë vullnetare. Uji do të mirrej nga livadhet ku ishin çelun pusët para dy vjetësh.

Suada zbriti poshtë në kanal dhe po shikonte se ku të vinte kambën. Po aty s'kish ndonji gur, pastaj ajo pa Qemalin dhe i tha:

— Më ndihmo, më jep dorën!

Qemali shikoi poshtë Suadën që kish zgjatur dorën. Atëhere rregulloi kambën mirë, në mënyrë që të mos binte dhe që të mos e mirrte pesha mbas vehtes,

zgjati dorën poshtë dhe Suada ja kapi dorën atij. Ai e tërhoqi atë me forcë dhe e nxori nalt.

— Faleminderës! — i tha ajo — s'ka gja, — u përgjegj Qemali dhe u përgatit që të ndihmonte tjetrën që vinte pas. Ujin, që ecte ngadalë, e kapërceu edhe Nurija. Këte Qemali e tërhoqi nalt ma me lehtësi, sepse kjo ishte ma e gjatë se e para. Pastaj Qemali ua dha dorën Fatimes dhe Shpresës. Zyka, që ishte ma e vjetra ndër të gjithë, u mat që të kapërcente, por kish frikë.

Edhe Nurija doli në breg dhe të dyja po prisnin të tjerët. Brigada e perimeve gjithnji po afrohej.

— A e ndigjoni Faikun sa bukur po këndon? — pyeti Suada Nurijen.

— Me të vërtetë ka një za të bukur, më pëlqen shumë zani i tij — foli Nurija. Mendimet ua ndërpreu atë çast diçka që lllapashiti në ujë. Zyka që ishte batu dhe qe ba qull në ujin e kanalit, doli e lagun, me fustanin ngjitur për trup, dhe si për t'ua çfajsue foli me shaka:

— E, more bir, po kur kapërdihet qerrja gjithmonë gjindet shtegu, — dhe i shoqrronte fjalët me të qeshun. — Mandej unë jam ma plaka në të gjithë këte grumbull njerëzish, e më falet kur pengohem.

— Po po, gjithmonë tufa e deleve e ka një që çalon, — foli Nurija nga bregu dhe përsëri Zyka qeshi me të gjithë. Filluen të kalonin edhe ato që kishin mbetun andej. Brigada tjetër po afrohej dhe Suada dalloj aty afër zanin e shoqes së saj. Afërdita ishte shoqja ma e afërt e Suadës, ajo këndonte ma mirë nga të gjitha vajzat dhe dinte shumë kangë popullore e të muzikës së lehtë.

Afërdita dhe Faiku po këndonin duetin që e kishin këndue në festivalin e kangëve dhe të valleve të fshatit. Qemali, Suada, Nurija dhe Shpresa, që kishin dalë mbanë kanalit, po prisnin brigadën tjetër. Edhe shokët e shoqet e tyre po ecnin ngadalë që të bashkoheshin me brigadën tjetër.

Qemali po i përfytyronte të dy kur dolën në skenë. Ata kënduen duetin e përfunduen dhe atij ju ba sikur ndigjoi duertrokitjet e spektatorëve. Po kësaj radhe kanga i dukej ma e bukur, zani ma i ambël dhe skena ma e gjanë, ma e madhe. Ata nuk ishin në sallë ku ndriçonin dritat dhe prozhektorët e teatrit Migjeni të qytetit, por në fushë, ku ndriçonin yjet dhe hana e ku përreth nuk kishin spektatorë po shokët e tyne të punës. Ndaj edhe kanga dilte ma e lirë e ma e sigurt.

Qemalit, ndonse e kish ndigjue edhe ma parë, ju dukte se po e ndigjonte për të parën herë. Ata të brigadës tjetër u afruen. E gjithë ajo brigadë ate ditë kish mbjellun domate; edhe atyne u ishte hapun fronti i punës si në çdo fushatë pranvere; ata punonin deri në orët e vona të mbramjes për të krye mbjelljet pranverore, fushatën për t'u dalë mbanë zotimeve të marra para anëtarve të kooperativës, para Partisë, kryesisë dhe organizatës së rinisë.

Punëtorët genë të gjithë të pajisun me diçka në dorë apo në sup: dikush kish shat, kovë, ujitëse, disa çanta ushqimi, kurse ata të fundit njeni andej dhe tjetri këndeje mbanin dy kosha të boshatisun. Para se të arrinin ndanë kanalit njeni propozoi:

— Ma mirë të dalim andej kah ura, mos të dalim këtu.

— Jo jo, se na bjen ma gjatë rruga andej, por po e këpusim këtu ku kaluen të tjerët — ja pritën disa.

Tefiku, një djalosh trupmadh, i shëndoshë, që po ecte para të gjithëve, dredhoi rrugën e karrocës, e cila të çonte tek ura dhe u kthye nga ana ku e prisnin shokët e brigadës tjetër e do të kalonin të gjithë një nga një.

Kur arritën te kanali, Faiku dhe Afërdita ndalën kangën. Ata që kalonin kanalin zbritnin nga bregu ku bashkoheshin me ata të brigadës tjetër dhe ecnin ngadalë që të prisnin shokët e shoqet që s'kishin dalun ende.

Të parët kaluen burrat. Pas tyre mbetën vetëm gratë:

— Ju, në qoftë se s'mund të kapërceni ujin, ma mirë kaloni andej kah ura, vendi ku do të kaloni asht i lagun e mos t'ju ndodhi edhe juve si ne — u foli Qemali atyne që kishin ngelun andej. Disave u hyni frika dhe thanë të kalonin nga ura, por njena prej tyre u dha zemër dhe nuk shkuen. Gratë filluen të kalonin dhe Qemali vazhdonte t'i ndihmonte të ngjiteshin.

Ato kishin pak vështirësi të kalonin, sepse vendi ku u ngjitën ishte i lagun nga ujët dhe shpesh u rrëshqitnin kambët. E fundit mbeti Afërdita. Ato që kalonin filluen të ecnin, edhe Suada bashkë me dy shoqet që po prisnin sipër bregut të kanalit zbritën poshtë dhe filluen të ecnin tue bisedue njena me tjetrën.

Dy brigadat u bashkuen dhe kooperativistët nisën nga pyetjet që i banin njeni tjetrit për punën gjatë ditës. Afërdita rregulloi çantën që mbante në dorë, e përcolli flamurin nga e djathta në të majtë dhe dorën e djathtë e la të lirë. Shikoi Qemalin dhe zbriti poshtë. Ajo vuni kambën në mesin e dërrasës dhe u hodh andej ujit. I dha vehtes përsëri nalt, që të ngjitej, shtriu dorën që ta kapte Qemali: posa i dha vehtes i rrëshqiti njena kambë në përzhizën që ishte ba, i mori në një anë dhe tjetra, dhe kupat e gjunjëve ju ndeshën në tokë. Ajo kujtoi se po binte poshtë, por dora e fortë dhe e sigurt e Qemalit e kishte kapë fort dhe s'e linte të binte poshtë. Posa u ngjit shikoi gjunjët e saj që ishin bamë me baltë dhe këputi një grusht bar për t'i fshimë.

Kur ajo ngriti kryet shikoi mbrapa malit hanën që lindi: rrezet e saj të prarueme u derdhën mbi fushat e gjelbra, mbi tokën e lavrueme, mbi fidanat e mbjellun të duhanit, mbi dallgët e grunit dhe të liqenit dhe mbi fytyrat e tyre të heshtuna. Ajo shikonte hanën me vetullat si të ngrysuna dhe sikur po e mallkonte që lindi, dhe doli nga kreshta e atij mali.



Nuk i pëlqeu që këtë çast rrezet ja ndritën fytyrën e kuqun para Qemalit. Prandaj shikoi punëtorët që po ecnin para, në drejtim të fshatit. Ata dredhuen dhe dolën në xhade. Suada, Nurija dhe Shpresa ishin të fundit dhe ecnin ngadalë tue bisedue. Suada solli kryet mbrapa, shikoi nga Qemali, mandej vazhdoi bisedën me Shpresën.

Ato bisedonin për ditën e nesërtme kur nuk do t'u çonin herët për të mbjellun e shkulun resat duhani, sepse nuk kish nevojë për të mbulue duhanin, kurse ditën e mbasnesërme e ma tej do t'u ngrinin shumë herët, se atëhere fillonte fushata tamam. Por Afërdita në këtë mbramje ishte si e tulatun; në krye dhe në zemër po i vlonte diçka tjetër. Ecte e heshtun... mendonte...

— Çka kena andej nga brigada e juej ndonji të re? — pyeti Suada Afërditën.

— Mbjellja e domateve u përfundue sot dhe unë fitova flamurin e garës në mbjellje — foli Afërdita shkurt dhe pak me vonesë ndërsa vazhdoi të ecte me krye ulun. Kthyen nga xhadeja e Koplikut dhe dredhuen në një rrugë që ishte në të majtë, e cila të çonte në fshat.

Rruga e Koplikut u boshatis, të gjithë kambësorët u shkëputën nga ajo dhe vetëm dy vetë, që kishin ardhun mbas këtij grupi, po vazhdonin rrugën për nga qyteti.

Punëtorët e tjerë kishin hymë në fshat. Disa filluen që të kthehen në shtëpitë e tyre, kurse të fundit sapo hynin. Shpresa ju uroi «natën e mirë» grupit dhe ndaloi në shtëpinë e saj. Rruga ndante fshatin më dysh. Në mesin e saj, aty ku ndaloi Shpresa, ishte një pus dhe në të dy anët e rrugës vinin shtëpitë. Kur arritën në mes të fshatit u kthyen edhe Suada me Nurijen, që i kishin shtëpitë afër njena tjetrës. Mandej rruga në mes të fshatit merrte një kthesë të vogël. Nga shtyllat elektrike lëshonin dritë llampat dhe e banin rrugën fare të qartë. Nga shtëpitë vinin tingujt e ra-

diove. Pleqhtë ishin mbledhun në një tapalok me bar dhe bisedonin duke thithun cigaret e tyne të trasha dhe të dredhuna me nge dhe mandej nxirrnin tymin në shtëllunga të denduna, i cili ngjitej nalt e zhdukej në errësinë.

Qemali dhe Afërdita po ecnin rrugës vetëm për vetëm. Ajo ecte me sy për tokë dhe nuk fliste. Heshte e tronditun. E kish pushtue diçka që nuk e linte të qetë.

Në këtë çast që ish vetëm me Qemalin e mundonte ma fort një shqetësim që i kish hy mbrenda në shpirt... Qemali në të djathtë të saj e vrente dhe herë herë i takonin vështrimet, ulnin kryet dhe banin sikur nuk kishin pamë gja.

Kjo heshtje e saj sikur e mërziti Qemalin dhe ai foli:

— Afërdita, mbasi mbaruet mbjelljen e domateve a do të na ndihmoni neve në mbjelljen e duhanit? — Kjo pyetje që sa për të çelun bisedë. Afërdita kur ndigjoi zanin e tij të qetë e shikoi; asaj ju duk sikur u lehtësue nga ajo që e mundonte, e atë çast zorri i doli si lamsh bashkë me fjalët që nxori ai:

— Nuk e di, Qemal, ndoshta edhe vimë por ndoshta edhe jo! — belbëzoi. — Po ju, a keni shumë për me mbjellë?

— Po ne tashti posa filluem, fushata e duhanit asht një fushatë e madhe dhe duhen ditë në të... Afërdita në mendjen e saj e pandehi veten të pasigurt dhe harroi se mbjellja kish fillue ato ditë.

Biseda ishte me të vërtetë e shkurtën, por e shkurtën ishte në ato çaste edhe rruga e tyne: ata do të ndaheshin, sepse ju afruen shtëpive të tyne. Tashti që u çel biseda, ajo kish qejf të bisedonte. Arritën te shkollë e fshatit. Dritat e shkollës ishin të ndezuna. Nga rruga shikuen nëpërmjet dritares një burrë që shkruente në dërrasë të zezë, pranë tij mësuesja lëvizte me një dorë dhe tregonte diçka në tabelë. Aty mësonin nxanësit e shkollës së natës. Nga gjysma e dritares që

qe e hapun dalluen kooperativistë që i kishin në brigadat e tyne.

Erdhi edhe ndarja. — Natën e mirë, Qemal! — përshëndeti në mënyrë të zakonshme Afërdita.

— Natën e mirë! — ja ktheu gjithashtu edhe ai. Afërdita ktheu në rrugicën që të çonte në shtëpinë e saj. Të dy anët e rrugicës ishin thurun me listela, kurse në pjesën e pashkelun të anëve kishte bar të njomë. Ajo solli krye mbrapa dhe shikoi Qemalin, që po kalonte përmes rrezeve të dritës së llampës që ishte varun në shtyllë.

Ndërsa Qemali po shkonte rrugës takoi shokun e tij, Agimin.

— Mirë mbrama, Qemal! —

— Mirë se vjen, Agim!

— A je lodhë? —

— Rinia nuk lodhet, apo jo?

— Me të vërtetë që ashtu asht, po nga po vjen?

— pyeti Qemali.

— Po vij prej sallës së leximit.

— Pse?

— Më një të muejit tjetër bahet festivali i estradave të fshatit. Nazmiu më kishte çue fjalë në shtëpi se në orën shtatë duhet me qenë në sallë të leximit. Posa e lashë punën erdha në shtëpi e më thanë se më ka kërkue Nazmiu. Pushova pak dhe shkova atje. Aty gjeta atë tue pikturue një portret. Posa më pa më tha: «Bane mirë që erdhe. Më datën një të muejit të ardhshëm bahet festivali i estradave të fshatit. Lokaliteti i Qendrës dhe fshatrat si Dobraqi, Berdica, Ajasma, Vraka, Gruemira e të tjera do të japin çfaqje në skenën e sallës sonë».

Lajmëruem edhe Njazinë, po ai tha se nuk mund të vinte, mbasi qe i lodhun prej pune, dhe, fundi fundit, përse duheshin mbledhun me kaq urgjencë? Mandej pat shtue: — Po qe se doni të dalim mirë në këtë festival, na që jemi caktue si solista e me role të veçanta, të kthehemi ma herët nga puna se me trup

të lodhun sikur asht zor me kërcye e me këndue. Pengesa të tilla kishin qitë edhe disa të rinj të tjerë.

Për të gjetë elementët e grupit diletant qe e lehtë, por, kur erdhi puna që t'i thërrisnin për të ardhë në prova mbas orarit të punës, një pjesë e tyre nuk donin të vinin. Nazmiu bisedoi me secilin prej tyre. Dikush i thonte që nuk mund të vi se mbas orarit kam punë të tjera, due të mbaroj së punuemi kopështin personal. ose, një tjetër pat thënë: ç'më intereson të shkoj në prova mbas orarit të punës kur kemi punë sa të duesh në tre dynymsh. E fundi fundit, thonin ata, bima nuk pret ajo kërkon prashitjen, kurse estradën do e pre-gatisim kur të kemi kohë të lirë e të kemi mbarue punët tona. Këto fjalë e shqetësonin shumë Nazmiun, sepse dita që ishte caktue për festival afrohesh gjith-nji. Ai bisedoi me sekretarin e organizatës së rinisë se si mund të gjente mënyrën e t'i sillte ata që ngu-ronin në provat e grupit diletant. Sekretari i rinisë e pyeti: — Kush nuk të ka kundërshtue nga ato?

— Qemali, Tefiku, Zana e Nuri, kurse Afërdita thotë që nuk dal në skenë se më vjen turp.

— Për këtë mos u ban merak se edhe të tjerët besoj që do vinë. Së shpejti kemi mbledhjen e orga-nizatës së rinisë dhe aty do ta shtrojmë këtë çështje.

Dhe kështu vepruen. Në mbledhje u ngrit me të madhe edhe kjo çështje. Por ato që kishin kundër-shtue ma parë, përsëri kundërshtonin. Atëherë sekre-tari u tha atyne që ishte turp t'ua kalonin kooperati-vat e tjera, kur kjo e tyre ishte një ndër ma të mirat. U ngritën edhe vetë anëtarët e bashkimit të rinisë dhe kritikuen ata që kundërshtonin.

— Pse nuk vjen Meti kur një pjesë e mirë vjen? — u ngrit e foli Tefiku, ne nuk duhet të shikojmë thjeshtë interesin personal por atë të përgjithshmin, të gjithë kemi parcela personale, po pse e le Qemali apo ndonji tjetër. Pse ata mendojnë drejtë, i japin shoqë-nisë dhe duen ta gjallnojnë jetën tonë në fshat edhe ma tepër.

— Meti, Nazmi dhe ndonji tjetër, që ishin caktuar për të marrë pjesë në grupin diletant, po e ndjenin veten ngusht nga kritikrat e shokëve. Ai bahesh gati të ngrihesh e të thonte që do vinte, por përsëri i shkante mendja të kopështi personal. Në ndërgjegjen e tij po luftonin ndjenja të kundërta: «Po unë pse të ndahem nga shokët; mos jam ma i mirë se ata». Kështu mendonte ndërsa vazhdonin diskutimet.

— Pse atëhere kur jepet çfaqja këta shokë që kundërshtojnë vinë ta shohin? — dëgjoi Meti zanin e Nurijes që e përshkoi si ndonji plumb. E pa ate vajzë mu në fytyrë, dhe dalloj qartë që ajo nuk çfaqte ndonji farë inati, por gjithnji dashamirësi. E, teksa uli kryet, zuni përsëri fillin e mendimit dhe shtoi me vete: «Pse nuk veproj si shokët, nuk kanë punë edhe ata si ne, jo, unë nuk do të ndahem nga ata ashtu si në punë do jem kudo me ta». Pastaj ngriti kryet, shikoi shokët e u ngrit të thonte që do mirrte pjesë. Mbas tij dhanë fjalën edhe të tjerët. Në sallë u ndje një atmosferë gëzimi. Nazmiu i entuziasmueu si asnji herë u tha që së shpejti do t'u jepte pjesët e do të fillonin nga provat. Mandej ju tregoi se ç'randësi të madhe kish ky festival, ç'rol do të lunte lëvizja amatore në fshat dhe të tjera.

— Ata që marrin çmimin e parë si lokalitet do të paraqiten për çfaqje në teatrin «Migjeni» të qytetit, ku do të jenë të gjithë fituesit e çmimit të parë të lokaliteteve. Për çdo lokalitet do të ketë nga një kooperativë dhe këto të gjitha do të konkurojnë për çmimin e parë në rreth.

Folën me Nazmiun për të caktue pjesëmarrësit. Ma vonë erdhi edhe Sekretari i Partisë, ai i Rinisë e me ta së bashku caktueu njerëzit që do të marrin pjesë.

— Po drejtues muzike kush do të jetë? pyeti Qemali.

— Po. Gadi harrova! — tha dhe vazhdoi: — Teatri «Migjeni» i ka shpërnda të gjithë aktorët dhe drej-

tuqit e muzikës nëpër kooperativat bujqësore me i  
ndihmë në përgatitje.  
naiminac në përgatitje.

Na kemi dirigjentin e Orkestrës së estradës së Te-  
atrit «Migjeni», Kolën.

— Asht djalë shumë i mirë e i thjeshtë. Ai na ka  
drejtue korin tonë që kishte gjashtëdhjetë e pesë veta.  
shumica vajza. Ne atëhere morëm çmimin e parë, pa  
na e marrë mendja.

— Po të punojmë pa u lodhë edhe këtu do të fi-  
tojmë çmimin e parë.

— Po kur do të fillojnë provat? — pyeti Qemali.

— Tashti shpejt, shpejt do të fillojmë — u për-  
gjegj Agimi — do të grumbullojmë materialet; Nazmiu  
më tha që të përgatitish ti ndonji send, i ndajmë teks-  
tet sejcilit dhe atëhere së shpejti... Po normën e tej-  
kaluet sot?

— Posi, e realizuem dhe e tejkaluem. Nesër do  
ta kalojmë edhe ma tepër, do të bajmë nga dy, sepse  
e kemi tokën ma të mirë. Normën e tejkaluem, por  
flamurin na e fitoi Suada.

— E pashë, për pak ta mori. Por s'ka gja, tash e  
merr nesër.

— Mor, po ajo kur të shikon ty sikur merr forca  
të rejal!

— Epo mirë, merre mbasnesri që nuk jam unë  
aty, — bani shaka Agimi. Nesër paradite mbjellni du-  
han sikur sot, a do të çoheni herët? — pyeti Agimi.

— Jo, nesër mbjellim mbas dite dhe nuk çohena  
herët, do të çohena me dritë mbasnesri e mbrapa, sepse to-  
kës vjen tue i ikë lagështina, duhettë lagët rranjë për rra-  
një dhe të mbulohet vendi i lagun. Ato fidana që i  
kemi mbjellë sot paradite janë fishkun, kurse ato që  
janë mbjellë mbas dite janë shumë mirë. Për këtë  
arësye brigadierja me agronomin e anuluen mbjelljen  
e duhanit paradite. Nesër deri në orën dhetë shkulum  
resat duhani me farishte. Prej orës dhetë gjer në orën  
e mbjelljes që cakton brigadierja pushojmë dhe rrimë  
vonë në mbjellje.

— Në ç'farë ore filloni me shkulë resat, besoj se nuk ja filloni herët? — pyeti Agimi.

— Pse po më pyet?

— Unë kam mendue që nesër nadje — filloi Agimi — të çohemi herët pa zbardhë drita dhe të shkojmë para liqenit për me xanë krap. Unë po marr çiften bashkë me zagarë, kurse rrathët i kemi atje. Çiften po e marr, që kur të kthehena në mujsha me vra ndonji shpend për pikë ose ndonji gjah tjetër. Sonte pas mezit të natës duhet të dalë krap patjetër, se gjatë ditës dielli e ka nxe ujin.

— Po a do të flegmë ndopak? — pyeti Qemali.

— Për gjumë ankon ti! Pesë orë gjumë i ban sonte, nesër në mesditë, kur të pushoni, bjer në gjumë, mandej për një natë nuk bahet gja se po rrin pa fjetë.

— Mirë atëhere, ti do të vijsh e do të më çojsh nga gjumi. Unë flej andej kah dritarja që asht afër fikut.

— Në regull, unë do të vi herët. Natën e mirë!

— Natën e mirë dhe gjumë të ambël! — U ndanë dhe morën drejtimin nga shtëpitë e tyne.

Qemali e ndjente veten sikur diçka i kishte humbur, e sikur ajo diçka ishte ndonji gja me vlerë të madhe. Donte ta gjente sa ma parë, ta kish sa ma afër dhe po të ish e mundur aty, para syve të tij.

\* \* \*

Afërdita posa arriti në shtëpi, hyni mbrenda, mori ujin e vokët dhe filloi që t'i lajë gjunjët e vramë. Shikoi gjunin e gërvishtun, që kish nxjerrë gjak dhe ish përzi me baltën e ngjitun. Uli duert nga beli. I fërkoj gjunjët lehtë duke hedhun nga pak ujë të vokët. Mbasi u la e u fshi mirë e mirë, u ul pranë radios, të cilën e kish hapun e motra dhe nisi me ndigjue Radiopostën. E ama e pa të lodhun dhe e shtroi të hante. Desh t'i thoshte s'amës: «nuk due», por të punosh aq

shumë e të mos hash ishte diçka në kundërshtim me arësytën, dhe ky mendim e bani vajzën që të hante pak sado me zor. Filloi por nuk i shkonte. Kafshata sikur i ngelte në grykë. Nuk bisedonte, rrinte e hesh-tun. Vetëm ndonji pyetjeje i jepte përgjigje.

Rradio-posta, me kërkesën e dy punëtorëve të Kombinatit të Tekstilit Stalin dhe të një punëtoreje kooperativiste të Fierit, transmetoi kangën e mbjellse-ve. Kjo kangë i futi zjarrit dru të tjera... Sa përfundoi kanga ajo u ngrit. Sd'inte as vetë se çfarë po bante.

— Afërditë, pse nuk po han, bija e nanës, çka ke, që je e ligë?<sup>1)</sup> — e pyeti e ama me dhimbsuni.

— Jo, nanë, nuk jam e ligë, po nuk po më shkon buka, po shkoj e flej, se jam lodhë — dhe u nis për në dhomën ku flenin.

E ama u pre fare nga e bija; edhe asaj nuk ju ba ma për të ngranë.

— E shkreta vajzë, asht lodhë bija e nanës, as buka nuk i shkoi! — foli me vete dhe u ngrit.

Posa hyni në dhomë, Afërdita ndezi llampën dhe u gjend para pasqyrës së madhe të raftit të rrobeve trekapakësh. Me të pamë veten u ndal. U shikue në pasqyrën e madhe dhe vuni re që ishte skuqun në fytyrë. Ju duk se edhe fytyra i kish marrun një pamje tjetër: ose kish diçka ma tepër a ma pak nga ç'kish pasë... këtë s'dinte ta përcaktonte. Nji za i mbrendshëm sikur i fliste... U afrue edhe një hap para pasqyrës dhe mërmëriste me vete: «Ç'asht kjo që po ndjej dhe s'po e kuptoj: gëzim, dëshirë apo dëshpërim?!...» Shikoi veten në sy dhe vazhdoi tue ngritun dorën në gjoks: «jo, pse dëshpërim, çfarë dëshpërimi? pse më tha Shpresa që unë të mirrja Qemalin? Jo, ky nuk asht aspak dëshpërim, përkundrazi do të ishte... Po çfarë, atëhere, çfarë, gëzim apo dëshirë? As unë s'e di! Po ja, në zemër, në shpirt, më vlon diçka,

---

1) E smundë



sonte lindi, mori shkëndijë diçka, diçka e re, që s'e kam ndjemë kurrë dhe që nuk e njoh. Më lindi një dëshirë... Të këndoj? Jo, as të këndoj. Po pse të mos këndoj, unë para pak kohe këndova... po, po, por atëherë... Po kjo përse? Unë nuk jam e friksueme — dhe vuni dorën në krahnor. Përse jam e shqetësuar, nga çfarë... nga turpi apo nga ajo që s'mund ta mbaj. Sidoqoftë s'mund ta fshehi këte zjarr që më vlon në krahnor. Zjarr, zjarr në trupin tim!» Asaj ju dukte se po jetonte në një botë fantastike dhe ngadalë u largue nga pasqyra. U afrue pranë shtratit, e rregulloi ngadalë, u xhvesh dhe u shtri.

Në dhomë hyni motra ma e vogël e Afërditës. Mandej hyni edhe e ama me djalin e saj shtatëvjeçar. Afërdita kish mbyllë sytë, sikur flinte.

E ama dhe motra e saj e dytë kur e panë që po flinte si banë za dhe dolën jashtë. Petriti, vëllai i saj shtatëvjeçar, u xhvesh dhe ra edhe ai në anën tjetër të shtratit dopio.

— Dita ke fjetë, a? — e pyeti. Afërdita e ndigjoi dhe një herë heshti, por kur ai e pyeti për të dytën herë ajo ju përgjegj:

— Jo, xhani i motrës.

— Pse ike aq shpejt e nuk ma mësove abetaren si netët e tjera? Unë nesër do të marr notë të keqe. Pse nuk flet, a je lodhë, a?

— Po xhan, jam lodhë.

— Nesër mos puno shumë, se do të më mësosh abetaren. Asht edhe kjo një punë që e ke marrë përsipër.

— Ç'ka ke xhan, ta mëson motra ty. Flij tashti se asht vonë.

Petriti u mblodh kruspull, u mbulue dhe ra në gjumë. Mbas pak erdhi të flinte edhe Vjollca. Ajo shuejti dritën dhe ra në gjumë. Me t'u shue drita, dhoma u errësue. Vetëm njena pjesë e shtratit ndriçohej nga rrezja e hanës që hynte nga dritarja dhe i jepte pak dritë dhomës.

Afërdita ishte ende e zgjueme. Ora e madhe e varun në mur numronte me shpejtësi sekondat. Akrepat gjithnji lëviznin dhe shënonin orët që kalonin. Po ja, ajo ende nuk po flinte; s'kish gjumë. Diçka e mban-te zgjuem dhe nuk e lejonte të mbyllte sytë.

Sa gjana të ndryshme i kalonin asaj nëpër mendje, në atë dhomë të qetë, ku ndigjoheshin vetëm trokitjet e orës dhe të zemrës së saj! Ashtu tue mendue dhe përsëritun e zuni ma në fund gjumi, me fytyrë nga nalt, gjysmën e trupit të zbuluem, me krahët e hapun sipër mbulesës, sikur donte të përqafonte dike...

### 3

Agimi, para se të flinte, e kish kurdisun orën e tryezës me zhavorinë. Në tre të natës e zgjoi zilja. U ngrit, lau sytë, u vesh, hodhi çiften në krah dhe doli jashtë. Drita nuk kish zbardhun. Ishte natë e qetë, yjet dhe hana, që akoma nuk kishin perëndue, ndriçonin atje nalt në qiell si gurë të çmuem.

Nuk kishte asnji lëvizje.

Vetëm Lajdi, që po flinte në sanën e mullarit në kopsht u kollit pak dhe mandej u zgjue. Vështroi, ngriti veshët nalt dhe solli kryet sa andej këndeje tue përgjue. Mbasi nuk ndigjoi ma gja, ndejti në bisht me kryet gjithnji përpjetë.

Agimi qëndronte në kambë tue rregullue rripin e fishekëve që ndriçonin zbetë me ngjyrën e tyne të verdhë dhe dukeshin si dhambë të veshun me flori. Hoqi çiften nga krahu, e hapi, i futi dy fishekë të mbushun dhe e mbylli me forcë. Metali lëshoi një kris-më të thatë të ndrydhun. Lajdi u ngrit në kambë dhe lehu i gëzuar. Ai e dinte se çfarë krisme ishte ajo, sepse kushedi se sa herë e kish ndigjue. Mbasi hodhi çiften në krah, Agimi mori drejtim nga kopshti ku ishte Lajdi i lidhun që lehte dhe i jepte vetes të këpuste zinxhirin e gjatë. Kur ju afrue Agimi, ju hodh në gjoks me të dy kambët e para.

Rri! — bërtiti i zoti me qortim. — Lajdi i uli të dy kambët e para në tokë dhe s'bani za. Agimi i hoqi zinxhirin nga qafa dhe e lëshoi. Zagari nisi të bredhë me vrap nëpër kopsht tue nuhatun me hundë për tokë.

Lajdi, hajde! rri, mos luej! — i foli Agimi përsëri me një ton qortues. Lajdi ju afrue pranë, ecte me hapin e të zotit, s'bante za dhe vetëm bishtin e luente nganjherë.

Si zhurmë e largët dhe e mbytnun që e sillnin valët e erës ndëgjohej buçima e traktorit. Agimi doli në rrugën e fshatit dhe mori drejtimin nga shtëpia e Qemalit. Ju afrue shtëpisë së tij dhe shkoi te fiku pranë dritares. Trokiti në xham dhe me të trokitunat e para u hap drita. Qemali hapi derën e dhomës me kujdes dhe shkoi në kuzhinë që të lante faqet. Çdo lëvizje e bante ngadalë, me kujdes dhe pa zhurmë, që të mos zgjonte të tjerët. Mbasi u rregullue shuejti dritën dhe mori të dilte jashtë.

Agimi zbriti nga fiku i madh ku kish hipun për me zgjue Qemalin dhe shkoi e duel para shkallëve të shtëpisë.

— Nadja mirë, Agim! — përshëndeti Qemali ndër-sa po mbërthente pullat e xhaketës.

— Nadja e mirë, e mirë se vjen! — i tha tjetri dhe filluen të ecin.

— Tamam në orën e caktueme paske ardhë.

— Po, tamam në kohë. Ma nxori gjumin sahati me zile, që e pata kurdisë mbramë — i tha. Lajdi po shëtiste nëpër kopshtin e Qemalit. Kur pa që këta të dy ikën, u lëshue me vrap dhe i arriti. Ju afrue Qemalit, e nuhati dy tri herë dhe, si e njohu, kaloi para duke luejtë bishtin.

Po çizmet pse nuk i ke marrë Agim? — pyeti Qemali Agimin, ndërsa dolën në dritën e rrugës dhe e pa se çfarë kish mbathë.

— Pse, a thue t'i marr, a? — foli Agimi si me dyshim.

— Posi, mor, mos më i marrë, ti boll që lagesh nëpër

vesën e livadheve; atje asht bari i gjatë deri në gjunjë, po pate çizme ato të shpëtojnë.

— Mirë thue, po shkoj vrap.

— Mos i bjer rrugës, por kalo nëpër shteg të kopshtit të Xha Brahimit dhe del te shtëpia jote ma shkurt. Agimi kapërceu gardhin me listela dhe kaloi nëpër shtegun midis kopshtit. Lajdi, posa e pa, ju vu me vrap tue kërcitë nëpër kashtën e thatë që ishte e shtrime në kopsht. Kur e pa zagarin që po i shkonte mbrapa, Agimi pati frikë se mos lehte dhe e shikonte ndonji njeri tue vrapue, prandaj u kthye te Qemali përsëri.

— Qemal, na çiften, se po më vjen zagari mbrapa. Qemali mori çiften dhe e hodhi në sup.

— Kujdes, Qemal, se asht mbushë me dy fishekë!  
— porositi Agimi.

— Mirë — u përgjegj Qemali dhe i bani za Lajdit që po rrinte tue shikue andej gardhit. Ishte gadi të shkonte mbas Agimit, por, kur Qemali ja ngriti çiften nalt që ta shikonte, lëvizi nga vendi dhe u hodh në rrugë: Qemali mandej filloi të ecë ngadalë për të pritun Agimin që nuk vonoi.

— Kah po shkojmë, kah shtëpia e Selimit apo kah vija e Nuzos?

Ma mirë këndeje kah shtëpia e Selimit — u përgjegj tjetri dhe filluen të shpejtojnë. Agimi tue ecë nxori paketën e cigareve nga xhepi i pantallonave.

— Merre një — i tha Qemalit.

— Jo, nuk due, ti e di se unë nuk e pi.

— Këtë e di unë, por të paktën ndize kot, se s'më ka lezet me e pi vetëm.

— Mirë, po e marr, mbasi ke vendosë, tashti vetëm me e ndezë, due, se të tjerat i kam vetë, — i tha Qemali Agimit, ndërsa ai po e nxirrte çakmakun nga xhepi.

Mbasi ecën edhe pak, u shkëputën nga fshati dhe dolën në xhaden e kopshtit para SMT-së.

— Po a shkojmë kah xhelepet? — i tha Agimi Qemalit dhe dredhuen andej. Hynë në jonxhë dhe po

kalonin nëpër rrugën që kishte bamë karroca me të dy rrotat e saj, tue shkelë mbi jonxhën e njomë. Kjo rrugë i kujtoi Qemalit ngjarjen që kish ndodhë disa orë ma përpara. Në shpirt ndjeu diçka, sikur u zgjue nga gjumi i trembun dhe i trokiti fort në zemër. Ai po përfytyronte tash të gjitha ato fjalë të natës së kalueme, të cilat i kishin mbetun të gjalla në mendje. Tek mendonte kështu ndëgjoi zanin e shokut.

— E çka na thue ndonji send, çka ke që rrin i hesh-tun, mos të mundon gjaja?

— Po asht e ditun se heshtja ka mendim. . .

— Ashtu asht, por qoftë ndonji gjaja e mirë, apo andërrim — foli Agimi me shokun. Lajdi kishte mbetë mbrapa dhe shëtiste nëpër jonxhë. Kur i hynte lagështina në hundë shfrynte me nervozitet. Nga lindja sapo kish fillue të zbardhonte. Agimi solli kryet dhe shikoj zagarin që ecte ngadalë dhe duke marrë erë fort lëvizte bishtin shpejt.

— Qemal! — thirri Agimi, — Lajdi ka ra në erë gjahu, shikoje!

Qemali hoqi çiftin nga krahu dhe e bani për qitje.

— S'ka gjaja tjetër përveç lepur. A i shikon lëvizjet, hajde të ecim mos të humbasim kohë, se ata janë të ndaluem tashti në pranverë.

Jo, jo, mbaje në shenjë, se ndoshta asht dhelpën.

— Ç'farë dhelpne, mor, a nuk e sheh se si lot zagari? po të kishte qenë dhelpën ishte çue me kohë — fliste Qemali po pushkën e kish bamë gadi. Ndërsa po vështronin, Lajdi lehu dy herë dhe shpejt diçka u hodh para tij.

Qemalit i rrahu zemra si nga diçka e papritun e u ba gadi të gjuente por ndali. Lajdi ju vu mbas gjahut që vraponte. Lepuri mezi vraponte nëpër jonxhë, sepse ajo ishte e gjatë dhe e pengonte. Ai i jepte me të gjitha forcat për të çu jonxhën, që të shpëtonte nga rreziku. S'i mori drejtim nga Qemali dhe Agimi, dredhoi pak dhe doli në rrugën e karrocës, tue rendë me të katra.

Lajdi, ecë këtu! — thirri Agimi me një ton të ash-

për por ai s'e ndigjoi. Vraponte mbas lepurit. — Lajdi i... thirri fort edhe një herë Agimi. Atëhere Lajdi u ndal dhe solli kryet nga i zoti. — Ec këtu! — bani edhe një herë ai. Lajdi, si i pakënaqun, u kthye te i zoti tue kthye kryet mbas nga gjahu që vraponte.

— I shkreti lepur, rrezik me i dalë pistonat e zemrës jashtë nga friga, — foli Qemali tue i shoqñue me të qeshun fjalët që tha:

— Nuk ka ma frikacak se sa lepuri, — foli Agimi ndërsa po shikonte lepurin që po zhdukej me vrap në fundin e jonxhës.

Mbasi mbaroi blloku i gjatë i xhelepeve, ata dolën në rrugën e Balijeve, një rrugë e drejtë që fillonte që nga xhadeja e Koplikut dhe mbaronte pa asnjë kthesë në livadhe.

— Ecim pak shpejt, — foli Agimi.

— Ecim — pranoi Qemali.

Të dy shpejtuan kambët dhe hynë përmes livadheve. Ga-ga-gatë e bretkocave filluen që të ndigjohe-shin që pak para se të hynin në livadhe. Bari ishte i rritun deri në gjunjë. Kaluen anës vijës së Lugut, e cila kishte ujë sa një boj njeriu. Agimi ecte pranë vijës dhe vështronte se mos kish hy krap në vijë të ujit.

Atij ju duk se peshkun e mori vala e ujit para dhe thirri i gëzuem: Qemal, paska hy peshk mbrenda në vijë, eja shikoje. Qemali u afrue pranë dhe dalloi valën që po u largonte andej nga fundi.

— Duhet të kenë dalë edhe në breg të liqenit po le të shpejtojmë! — i tha Agimi dhe u nis i pari. Kalonin nëpër mesin e shelqeve të mëdha që ishin mbjellë në rreshta dhe i ndanin livadhet në katrorë.

— Agim, po shkoj e marr rethin te stalla e lopëve, — bani Qemali dhe tregoi me dorë stallën verore të lopëve, e cila s'ishte as dyqind metra larg tyne.

— Mirë, Qemal, po mos u vono, — i tha Agimi dhe shkoi pranë vijës që të shikonte. Drita po bahej gjithnjë ma e qartë, Lajdi mbante vetullat e ngrysuna

dhe e shkundte trupin e tij lagë e bamë qullë. Nuk vonoi dhe Qemali erdhi me rrethin në krah.

Vazhduen rrugën, kaptuen tri livadhe nëpër mes dhe dolën te një vijë tjetër akoma ma e thellë. Kjo ishte vija e Gallatës. Sa ma shumë i afroreshin liqenit aq ma e thellë dhe e gjanë bahej vija e ujit dhe, në ate thellësi, nuk mund të dallohej në se kishte peshk apo jo. Në disa vende kishte purteka të trasha shelqesh, që këpusnin vijën nga njena anë në tjetrën. Këta e kishin ba gjahtarët e peshkut për kalim.

Zagari vraponte sa në njenën anë në tjetrën nëpër livadh. Pllum... u ndigjue një e zhytun në ujë dhe një kërcitje druni që erdh nga vija para liqenit. Pastaj u ndigjuen edhe disa lëvizje të mbytuna nëpër ujë, të cilat i binte era e qetë e liqenit. Lajdi, që kish ecë përpara, posa e ndigjoi u lëshue me vrap andej nga ndiheshin llapashitjet.

— Nuk ka mundësi të rahë krapi ashtu! — i tha Agimi Qemalit.

— Duhet të jetë këputë ndonji send nga shelqet dhe ka ra në ujë, por as ajo s'duhet të jetë, se krisma e drunit që u thye ishte e fortë, — foli Qemali, që kishte ndalue në vend dhe po vështronte.

U ndigjuen të lehunat e zagarit; të lehunat e tij qeni filloi t'i shoqënojë me të qame. Kur ndigjuen këte, të dy shokët shikuen njëni tjetrin dhe heshtën... Ndihmë... u ndigjue një za që gjasonte me zanin e një të mbytuni. Lajdi vazhdonte të lehte.

— Diçka ka ndodhë patjetër. Ai asht za njeriu që po mbytet. Eja të shpejtojmë, — tha Qemali dhe përnjiherësh hodhi rrethin në tokë dhe u lëshue me vrap andej nga lehte Lajdi. Mbas tij vraponte edhe Agimi.

Kur u afruen dalluen Lajdin, që ishte hedhun në vijë dhe notonte tue lehë. Qemali dalloi edhe një njeri që po jepte e mirrte me dur dhe që pastaj u fundos.

Qemali hoqi xhaketën me rrëmbim, çizmet, këmi-shën, pantallonat, dhe u hodh zhyt e në ujë. Agimi, gjysmë i xhveshun, priste se çfarë po bahej. Qemali

doli sipër ujit, shikoi mos kish dalë i mbytuni sipër dhe përsëri u zhyt kur s'pa gja.

— Lajdi, pusho, ec këtu! — i bërtiti Agimi. Ai pushoi së lehuni dhe po bante përpjekje të dilte.

Agimi shikonte sipërfaqen e ujit, aty ku delnin filluska. Njena kokë doli paksa sipër ujit dhe përsëri u fundos. Atëhere Agimi u ba gati të hidhej, por s'vonoi dhe Qemali doli bashkë me të mbytunin, të cilin e kish kapun për flokësh dhe s'e lëshonte. Me not ju afrue bregut. Agimi përkuli trupin dhe zgjati dorën që ta kapte. Me njenën dorë Qemali u kap në disa rranjë shelgjesh dhe me tjetrën mbante të mbytunin. Agimi e arriti, e tërhoqi nalt, e ndihmoi me njenën dorë dhe Qemali me vështirësi e nxori sipër bregut të vogël.

— Po ky qenka Halimi, — foli Agimi i çuditun dhe i tronditun në kohën kur e shtriu në bar. Agimi nisi ti' lëvizte krahët, ndërsa Qemali përpiquej të dilte në breg.

— A asht gjallë? — pyeti Qemali kur doli nga vija i lagun.

— Nuk e di, nuk e pashë, — i tha Agimi që po vazhdonte t'ja lëvizte krahët. Ai ishte habtiun, e kish humbë mendjen dhe kish harrue që t'i shikonte pulsin.

— Po, gjallë asht, — foli Qemali kur i ndjeu pulsin. Vija ishte e gjanë dhe e thellë, uji ishte i qetë, sepse ishte afër liqenit. Mbi ujë rrinte një purtekë, kurse një tjetër nuk e takonte ujin dhe të dy majat e tij rrinin sipër dy anëve të bregut. Agimi, shunië i shqetësuem, tregohej i ngrimë e i ngathët. Ishte tronditë shumë nga kjo e papritun. Bante njimijë lëvizje po s'ndimonte dot për asgja.

— Më ndihmo që t'i çojmë kambët nalt.

— Si të të ndihmoj? — pyeti Agimi që nuk dinte nga ta kapte, nga koka apo nga kambët.

— Ja, kambët e tij duhet t'i çojmë nalt, kryet duhet t'ja mbajmë poshtë, në mënyrë që uji që ka pi t'i dalë jashtë, — i tregoi Qemali Agimit dhe ashtu vepruen.



Kambët i vunë në supet e Qemalit, koka e të mbytnit mbeti poshtë dhe ujët nisi t'i rrjedhë, ma përpara nga çizmet e gjata dhe pastaj nga goja e hundët.

Agimi thoshte me vete se çdo gja që po banin po e banin kot, sepse njeriu dukej fare i vdekun. Mbas pak rrjedha e ujit filloi të paksohej deri sa u ndal fare. Barku i frymë u ul. Ata e mbajtën edhe pak dhe e shtrinë në bar. Agimi filloi përsëri që t'i bante frymëmarrje artificiale. Qemali mudohej që t'i hiqte çizmet nga kambët e të mbytnit.

— Me siguri kur ka marrë Halimi që të kalojë andej vijës, asht thye ai trau atje ku asht ma i hollë dhe mandej ai ra mbrend, — fliste Qemali që po i tërhiqte çizmet nga kamba.

— Unë çuditem, — tha Agimi — Halimi e din notin shumë mirë, bile ma mirë se të gjithë ne të rinjtë e fshatit.

Ashtu asht, pohoi Qemali, po a nuk ja shikon që ka veshë çizme të gjata gjuetarësh që i binë deri në rranzë të kofshëve. Këto janë të randa pa gja mbrenda, e jo ma të mbushuna plot me ujë. Prandaj ai s'ka mujt me luejt kambët. Teshat i janë lagun dhe do të ketë ra në mezin e vijës. Atëherë sk'a pasë ç'ka me bamë, ato janë momente... foli Qemali dhe ja hoqi njenën çizme.

Halimit i ishte ulun barku, rrethi i syve dhe buzët i ishin nximë. Në njenën dorë mbante barë të njomë dhe s'e lëvizte, kurse tjetra ishte me baltë. Flokët e lagun i kishin shkue në një anë, syt filluen t'i hapen si të vyshkun. Puls i filloi t'i rrahë pak ma gjallë. Në atë çast drita kish dalë mirë. Ata ja hoqën të gjitha rrobet e laguna dhe i veshën rrobet e tyne të thata. E ngritën tue e kapë të dy krah e qafë: Njenën dorë ia kishin hedhë në qafën e Qemalit, kurse tjetrën në qafën e Agimit. Halimi erdhi pak në vete. Kjo e gëzoi Agimin.

— E çojmë te xha Murati? Ai asht plak dhe di ma tepër për të mbytnin. Ka edhe zjarr e ngrohet, — foli Qemali.

— Po, e çojmë, — pranoi Agimi dhe dy shokët i futën krahët e tyne ma mirë nën krahët e Halimit dhe filluen të ecnin. Halimi i hidhte hapat të lëshuem dhe në kambë s'mbahesh fare. Kryet i shkonte në një anë, kurse sytë i mbante gjysmë të mbyllun. E gjithë pesha e trupit të tij të madh randonte mbi krahët e dy shokëve. Herë herë shtërngonte veten dhe lëvizte kryet. Ndjente turbulli në bark. Ju afruen kasolles. Nga sipër ajo nxirrte pak tym.

— Shyqyr paska zjarr! — i foli Agimi Qemalit kur pa tymin që dilte nga kasollja. Halimi shtërngohesh nganjherë.

— O xha Murat! — thirri Qemali kur u afruen te dera që ishte gjysmë e mbyllun.

— Hajde byrum! — thirri xha Murati nga mbrenda në kohën që po i frynte zjarrit, i cili nuk po i ndizej por ma tepër po nxirrte tym.

Xha Murati nuk lëvizi nga vendi, sepse në këtë kohë që gjuhej krapa i vinin me dhjetra në ditë e në çfar do kohe. Qemali hapi derën fare primitive prej dërrase dhe, kur mori të hynte në kasolle, e përkuli trupin sepse ajo ishte ma e vogël se gjatësia e njeriut. Mbas Qemalit hyni Agimi. Në mes mbanin Halimin i cili ishte varun në krahët e tyne. Xha Murati i shikoi dhe i habitun u tha:

— Hajrli, po kjo punë kështu? — dhe hoqi pipin e gjatë nga goja. — Po ç'ka mor djema? — pyeti xha Murati.

— Ka ra në vijë xha Murat.

— Po në cilën vijë mor! — pyeti përsëri dhe u ngrit nga vendi.

— Në vijë të Gallatës, u përgjegj Agimi.

— Po ju a ishit aty?

— Jo na ishim larg, por e ndigjuem edhe shkuem shpejt.

— Ju lumtë o burra, keni shpëtue një shok tuejin, keni bamë atë që ju takon — dhe e ulën në mindër. Në kasolle kandili akoma ishte i ndezun. Në mes zgjatej

nji flakë e kuqe që lëpinte qoshet e errëta, në anën tjetër, një dritare e vogël ndriçonte një minder dërrasash ngritur nalt nga toka, që shërbente edhe për të ndejë edhe si dollap, ku xha Murati mbante ato orendi të pakta që kishte. Sipër mezi dallohej pushka e gjatë dhe e vjetër. Xha Murati u ngrit dhe e çoi pak kandilin që të ndriçonte ma tepër. Mbasi u largue nga kandili, mori një qilim të vjetër që e hidhte në minder dhe e shtroi poshtë afër zjarrit. Mandej u tha dy të tjerëve të merrnin Halimin dhe ta shtinin në qilimin që posa e shtroi. Ja ngriti kapakun e sipërm të synit, e shikoi, e preku në duer, në krahnor dhe i tha Agimit që ta ngrinin ndenjün.

— Duhet t'i bajmë përsëri frymëmarrje, hala nuk asht mirë, — foli xha Murati që po ia lëvizte krahët.

— Ujët të gjithë e nxorri? — pyeti Qemalin. — Ne e mbajtëm deri sa e nxorri të gjithë, — u përgjegj Qemali. — Asht shumë i shqetësuem, ende nuk ndjehet mirë, e bajmë provë mos i ka ngelë ma ujë — foli xha Murati dhe u ngrit. E shtinë sërish, i kapën në kambët e ja vunë që të dyja në supet e Qemalit. — Ç'ka bani ma... lëshoi një za fare të këputun Halimi e mandej u pre fjala e tij sikur ja mbylli gojën dikush.

— Qemal çoje njenin gju në barkun e Halimit me qëllim që t'ja shtypish e të dalë po që se ka ujë. Qemali veproji ashtu siç i tha xha Murati dhe mbas pak nga goja filloi t'i dilte pak ujë.

— E shikoni, ai ujë që bie poshtë sado pak që asht e mundon. Tashti ta shtrijmë afër zjarrit e t'i bajmë lëvizje se vjen në vehte ngadalë, — foli xha Murati kur pa që ju ndal ujët. E ulën ndenjün pranë zjarrit tue ia lëviz krahët. Halimi i kishte sytë të hapun plotësisht dhe shikonte ndriçimin e flakës si nëpër mesin e një mjegulle. Pastaj, dalëngadalë ngrohtësia e zjarrit po e sillte në vehte gjithnji dhe mjegulla po u largonte nga sytë e tij. Ai e ndjente vehten ma mirë dhe tashti ishte në gjendje të dëgjonte se çfarë flisnin. Po vinte në vehte si një zog i mbërdhitun nga bora e

pastaj mbasi ngrohet, i shkrihet gjaku dhe asht gadi të fluturojë.

— Si e ndjen vehten Halim? — Mirë xha Murat, — u përgjegj ngadalë Halimi.

— Shtriju në qilim deri sa të forcohesh mirë, — i tha xha Murati dhe Halimi ashtu veproji. U shtri, mbylli sytë sikur flinte dhe fjalët e bisedat që dëgjonte i dukeshin sikur të ishte në andër.

— Po si ra? — filloi të pyesë përsëri xha Murati kur e rregulluen Halimin.

Kur ka marrë me dalë andej vijës njeni tra prej shelqeje i asht thye dhe ka ra mbrenda.

— E o bir, ju kam thanë se rruga e shkurtën të qet nga një herë ma gjatë. Kur duhet të shkurtojsh rrugë gjithmonë duhet me mendue mirë. Duhet me mendue fundin qysh në fillim. Ky, po të mos kishte pritue me shkue ma andej, ka pasë urën për me kalue. Por ka dashtë me ra ma për shkurt dhe tash, në vend që me shkue në shtëpi me kambë të veta, po shkon me kambë të hueja. — U fliste xha Murati dy djaloshave dhe ata e ndigjonin atë me vemendje.

Qemali e vrente kur fliste. Në fytyrën e tij të rrudhun, pak të gjatë e të hajme dhe në sytë e tij që ishin si të shqiponjës kishte diçka krenare. I shikonte mustaqet e bardha, qeleshën, flokët e zbardhuna nga vitet dhe dorën e gjatë e të dobët por të ashpër që mbante pipin e gjatë dhe thoshte me vete: Ky plak kush e di se sa çaste të vështira ka kalue! Gjithmonë kur i kallxon diçka, ai të përgjigjet me një këshillë që të vlen për jetën, pastaj përfundon me një fjalë të urtë.

— Shyqyr që ka shpëtue me frymë se tash vjen në terezi kadalë. Unë ja pëlqej gjakftohtësinë Qemalit. Ashtu duhet me kenë e jo si Agimi. Njeriut i dalin gjithfarë të papritunash në jetë gëzimi a trishtimi. Nuk duhet me u hutue e me e humbun kontrollin e vetvetes. Sikur të kishte kenë edhe Qemali ashtu si Agimi nuk do të dihej fati i jetës së shokut. Por tue kenë gjakftohët s'do me thanë me kenë i ngadaltë a i ngathët.

Duhet me kenë shumë i shpejtë. Them gjakftohët që me dijtë me i dhanë xhevap ose haber nevojës, me ju përgjegjë ashtu si ta kërkojë, mos me u rrëmbye si thotë rinia, mos me u rrëmby prej turbullisë e hallit se mundesh me ra viktimë e tij edhe ti. Gjithçka duhet ma parë me e mendue mandej me veprue... Në këtë kohë kur plaku ende po fliste një burr thirri xha Muratin nga jashtë. Pastaj hyni mbrenda. Ishte Selimi, rojtari i kuajve, një burr i shkuem nga mosha, me një palë sy të mëdhaj e vetulla të ngjyruna, po me fytyrë të shëndoshë. Ai po vinte nga shtëpia. E kishin cue nga gjumi shokët dhe i kishin thanë se ka peshk. Për gjah Selimi nuk pritonte, po, sikur të ish djalë i ri, ish veshë e i kish hypë kalit shpejt. E gjithë kooperativa e njihte atë kalë që ishte i Selimit sepse kur shkante nga stallat në livadhe, i hypte në shpinë, kur kthehej po kështu dhe kur i binte ndonji rast si ky, nuk pritonte të shkante në stallë ta mirrte dhe të shkante për peshk. Atë kalë as ata të kooperativës nuk ja zenin në karrocë. E po një Selim ka kooperativa, thoshte kryetari me shaka, kurse kuaj ka boll. Mandej Selimi asht rojtar kuajsh qysh se asht formue kooperativa dhe në vendet që ruen ai s'ka humbë kurrëgj. Mbasí ka punue mirë, le të bajë qejf Selimi, por të mos ja japin kujt tjetër kalin e të mos lëvrojë tokën personale me te. Kur hyni dhe pa Halimin, Selimi u trondit thellë po e bani veten burrë dhe duroi.

— Po pse e keni lanë kështu, — pyeti i tronditun.

— Tashti ai asht në rregull po e lamë ashtu të nxehet e të marri veten.

— Bahet gja sikur ta lëvizi? — pyeti.

— Gja nuk bahet por lene në qetësinë e tij, — i foli xha Murati. Por Selimit nuk ju durue dhe e lëvizi te supet.

— Halim, si dukesh? — Halimi lëvizi pak, u suell në një anë, hapi sytë dhe foli.

— Mirë Selim mirë, nuk jam keq.

— A vjen me mue të shkojmë në shtëpi se kam marrë kalin?

— Jo, jo, edhe pak sa të marr veten se vi me kambët e mia.

— Ma mirë shko me Selimin tashti e pin edhe ndonji ilaç në infirmjeri se ke përziemje, — i foli xha Murati.

— Mirë thue, — foli Halimi me za pak dhe mori të ngrihej ndejun. E ndihmoi të ngrihet edhe Selimi që ishte te koka.

Halimi ishte komshi i Selimit. Mbasi u interesue për të gjitha, Selimi bashkë me të tjerët u ngrit, i hypi kalit, e vunë Halimin para dhe u nis për në fshat. Bashkë me Selimin desh të shkonin edhe Qemali me Agimin por ai nuk i la.

Që të tre u ndanë, Selimi me Halimin shkuen për në fshat. Qemali dhe Agimi morën sërish nga liqeni dhe xha Murati hyni në kasolle. Tue ecë rrugës të rinjtë bisedonin:

— Kjo që ngjau nuk më hiqet mendësh, më duket se e kam para syve, — tha Agimi mbasi e kaluen vendin e ngjarjes.

— More tashti nuk po kam gajle se ai shpëtoi, por sikur të na ishte mbyttë atëhere s'do ta kishim harrue për gjithë jetën — foli Qemali dhe, mbasi ecën edhe pak, arritën tek amulli i liqenit.

Qemali e kishte marrun rrethin në krah, atje ku e kish lëshue, kurse Agimi e kish bri amullit të liqenit mbështetun për një shelqe.

— Si ta merr mendja a ka peshk? — pyeti Agimi.

— Tashti duhet të ketë ikë; kur ka dalë drita dhe deri para një gjysmë ore duhet të ketë pasë. A e ndigjove se ç'ka tha Selimi? Tashti duhet të ketë ikë në thelloje — u përgjegj Qemali që në atë çast shikonte një gjahtar tue hedhë rrethin në ujë e tue u përkulë për të pa peshkun e zanë.

— Paska peshk! — i tha Qemali Agimit pa ndalë shikimin nga peshkatari.

— Po, e pashë edhe unë, bani Agimi. Posa arritën në amull, ecën anës tij tue vështruar dhe ndejtën larg njëni tjetrit. Në thellojë dëgjohej si rrihte krapi. Të dy gjahtarët e rinj prisnin me padurim që ai të afrohej te bregu. Përnjherë u ndërpre çdo gja, uji u qetsue pikrisht atje ku e përziente krapi. Tue shikue njëni tjetrin së largu, ata pritën edhe pak dhe qenë gati t'i thonin shoshoqit eja të shkojmë. Por atë ças Qemali vuni re para tij ujin që formonte rrudhëza të vogla. Ju afruen bregut dhe ai i hoqi vemendjen shokut:

— Agim, Agim, — kujdes se po afrohet! — Të dy gjahtarët e rinj u banë gadi që t'i lëshonin rrethin sipër dhe t'i zinin.

Ata kishin hy në ujë dhe uji u kalonte gjysmën e çizmes. Sipër ujit, afër bregut kishin nxjerrë kryet majat e gjetheve të holla dhe lulet e bardha të kakaosit. Dy gjuetarët shikonin edhe majat e tyne, sepse peshku, kur vjen në ujë të cekët, i bie me trup e i lëviz dhe kjo ja ban të ditun gjahtarit me saktësi se ku asht ai.

Agimi shikonte se mos po lëvizte gja. Kishte ba gadi që të lëshonte rrethin e rrumbullakët me rrjetë teli të hollë. Nga që shikonte me vrejttje vetëm në një pikë, nuk e vuni re se bretkocat ja lëviznin kakaosin.

Pllum... ndigjoi në krahun e djathtë të tij. Solli këmbën andej dhe shikoi Qemalin që po shkonte te rrethi.

— Po unë, tha me vete dhe shikoi edhe një herë ujin që kish përpara. Ju duk se lëvizti, u ba gadi, shikoi edhe një herë laçkeçak.<sup>1)</sup> E hodhi rrethin pak para femnës dhe vrapoi për te rrethi, i kërceu sipër që të mos i dilte ndonji nga nën te dhe shikoi se mos kish mbulue ndonji. Posa e futi kambën mbrenda dhe e çiku femnën, ajo nisi t'i jepte vetes me sa fuqi që kish që të dilte jashtë. Donte të shponte rrjetën me turi dhe e bani ujët shkumë. Por kish ra në kurth e s'kish nga të shkonte. Agimi hoqi liçarin nga brezi, futi dorën në rreth dhe filloi t'i kapte një nga një dhe t'i përshkonte në liçar. Të parën kapi femnën. Ja afroi dorën te

1) Quhen krepët që kanë peshë një kilogram e gjysmë e poshtë.

sytë dhe pastaj përshkoi të tjerët që ishin ma të vegjël. Vështroi përsëri se mos dukej gja, po asgja nuk dukej, veç bretkocave që zhyteshin në ujë me ga-ga-gatë e tyne që të shurdhoin veshët. E hodhi rrethin edhe njëherë por nuk zbuloi gja. Peshku iku dhe s'jepte as shenjë ma të vogël. Kur e pa Agimi se s'ishte gja ma, hodhi rrethin në krah dhe shkoi te Qemali.

— Qemal, eja të shkojmë se nuk duket gja. Mos humbim kohën kot, pa gja fare s'u ndamë.

Qemali doli nga uji.

Dielli po lindëte. Rrezet e tij u përhapën kudo nëpër fushë. Pikat e shpeshta të vesës, me fijet e barit të dendun qëndronin të varuna si vath të shkëlqyeme, të bardhë.

— Po i çojmë te Xha Murati se tashti kena mbjelljet e nuk vijmë dot ma për peshk; kurse mbas mbjelljes ikën edhe stina e krapit — foli Qemali.

— Po tashti me të vërtetë nuk vijnë ma dhe rrathët po i lamë në kasolle. Rrugës në mujsha me vramë ndonjë sorrë ose gja tjetër për pikë<sup>1)</sup> se krapimbaroi — bani Agimi dhe ndezi cigaren që e kish mbajtur një copë rrugë në gojë të pandezun.

Ata po kalonin nëpër mezin e livadheve. Lulet e bardha të kakaosit, lulet e verdha të zhabinës, livadhi gjithkund i gjelbër, nëpër dendësinë e të cilit kish edhe lule të tjera të ndryshme, i jepnin natyrës një pamje të mrekullueshme. Dukej sikur pranvera e kish shtrure këtë qilim për të kënaqun andjet e njerëzve të punës.

Shelgjet e rradhituna njena mbas tjetrës, të nalta, me gjethe të reja, në mezin e të cilave kishin ndërtue foletë zogjtë, hijeshonin në të dy krahët.

Të dy shokët ecnin të kënaqun, tue soditun këtë natyrë të heshtun përmes barit dhe luleve. Mendonin... Mendonin ndoshta për mjeshtërinë e pranverës, të asaj pranvere që mund të krahasohej vetëm me rininë e

---

1) me gjuejt për pikë d.m.th. me tregue nishanin si gjuetar në shpent që s'hahen.



tyne. Thurnin andra për pranverën e cila asht e punës, e luleve, e bukurisë, e rinisë dhe e dashunisë... Kambët e tyne shkelnin dhe rrëzonin barin e rritun.

Lajdi ecte para tyne me kokë poshtë ashtu i lagun e i bamë qull në të gjithë trupin.

— Agim, në çfarë ore ja fillon punës me traktor?  
— prishi heshtjen Qemali.

— Në çfarë ore që të shkoj. Kam folë me Cadin e ai më tha hajde kur të duesh. Po unë zakonisht shkoj nji orë pa zbardhë.

Dredhuen nga ana e vijës dhe ju afruen kasollës. Hoqën rrathët nga krahu ndanë peshkun në nji enë dhe rathët i mbështetën për kasolle në anën e mbrapme.

— O Xha Murat! — hajde, hajde hyn, foli xha Murati brenda kasollës i shtri në minder. Agimi dhe Qemali hynë brenda dhe xha Murati i ftoi të rrinin pak. Ai u çue, u mbështet në jastekun që e ngriti dhe e theu në dysh.

— A zutë gja o djelma?

— Zumë diçka sa mos me u kthye pa gja, shkuem vonë.

— Po po herët ka pasë, pak mbasi shkuet ju erdhën Burhani me Samiun e kishin zanë do kokërta të mira. Vetëm herët ka pasë se ma vonë ka hy në thelloje. Qemali dhe Agimi e varën peshkun që kishin zanë në nji gremçë druni dhe pastaj u ulën. Agimi u ul pranë xha Muratit, kurse Qemali u ul në një stol pranë zjarrit, të ndezur.

Xha Murati nxori kutinë e duhanit nga xhepi dhe u tha dy djaloshave: dredheni nga nji cigare.

— Jo xha Murat merre ti te na, — i tha Agimi që e kish bamë gadi paqetën.

— Jo jo, se më keni ra në oxhak, ju më keni gjetë këtu e jo unë juve. Ju e dini zakonin, — atëhere Agimi e mori dhe nisi ta dredhë.

— T'u rritë ndera xha Murat! — i tha Agimi dhe zgjati dorën që t'ja jepte atij.

— Ndeze dhe ti Qemal nji.

— Falemnderës, nuk më shijon xha Murat.

— Këtu ma ke ba qejfin. Plakut çdo gja ndigjoja po kur të thotë dridhe një duhan, mos ja blej fjalën. Për këshilla e fjalë të tjera lypset gjithmonë me i ndigjue të moçmit në vjete. Më kujtohet kur isha shumë i ri e më tha gjyshi: Murat shko e lëshoji delet në kullotë se unë tash po vi ma vonë. Mirë gjysh i thash po i lëshoj. Jo jo, tha, lëshoji njitash. Unë ika te një shok e i thashë po i lëshoj mbas pak. Gjyshi i kishte nxjerrë delet prej vathit e i kishte lëshue vetë.

Kur shkova në shtëpi më thanë se gjyshi i kishte çue delet në kullotë. Vajta atje dhe i thashë: Gjysh shko se po i ruej unë delet. Me ju thanë të drejtën isha skuqë në fytyrë prej turpfit. Ai u kthye e më tha: «Shko mor bir, ti je i ri, por gjyshi i yt asht plakë. Ndoshta s'ka me të takue me të urdhënue ma e as me ndigjue ma, shko se tash delet i ruej unë». Unë kujtova se ai po më shan e s'po më le gja pa thanë, por doli ndryshe.

Kjo shkoi dhe unë gati e harrova. Por ma vonë ngjau diçka që u pendova për tanë jetën. Më urdhnoi baba një ditë të shkoj te gjyshi për një porosi dhe unë u nisa nëpër piskun e zhegut. Ju nuk ja keni mërri, katundi nuk ka kenë kështu. Gjithëkund ka pasë fera, disa rrugë që u xeshin prej tyne u mbyllshin krejt dhe duhej me gjetë anën tjetër të rrugës. Rrugës ndeshësia me qindra gjarprij që më shtishin harminë; kërkush nuk kujdesej për me i pre. Ato toka i kishte në dorë tjetër kush se po t'i kishin katundarët i bajshin tokë buke. Por ata që kishin tokat jetonin mirë e nuk çajshin kryet për ne.

Mbas pak, tue pasë në mend gjithnji atë kohë, xha Murati ofshani thellë e tha: Pishman që më ka mbetë! Edhe sot e kësaj dite kur i kujtoj ato çaste, se si mbaroi ai burrë, më ther në shpirt. Shkova në livadhe. Delet ishin mbledhë nën hijen e shelqeve dhe po mri-zojshin. Në një hije tjetër, aty afër, pashë gjyshin e shtrimë. Një herë kujtova se asht fjetë, se sytë i kishte

si të mbyllun; Gjysh gjysh, o gjysh! e thirra, por ai s'më dha përgjigje. Dorën e djathtë e kishte vënë në zemër e mezi hiqte frymë. Shikova andej e këndej për ndonji njeri por nuk dukej kush. U ula, e thirra, e lufta. Diçka belbëzati lehtë. E Avita veshin dhe e ndigjova se më tha: «Ma ban hallall». U mundonte me folë edhe diçka tjetër por vetëm buzët i lujshin.

Atëhere m'u kujtue ajo fjala që më tha para dy ditëve e me ato buzë që i lujshin sikur ndigjova: Gjyshi po vdes, nuk po të urdhënon ma. Hoqi dorën prej zemre, mënjanoi kryet në një anë, hapi edhe një herë sytë e vokun, më shikoi e sikur më buzëqeshi. Atëhere thirra i gëzuem: Gjysh! Por gjyshi mbylli sytë e vdiq. Thirra edhe një herë emnin e tij me vajë e i rashë në gjoks... Qava me të madhe, gadi plasa sipër tij tue i përkëdhelë fytyrën e rudhun e të tretun prej vdekjes, tue ja largue këmishën tanë arna, tue ja hapë gjoksin tanë koca e tue luejt kryet andej e këndej sipër tij.

U ngrita, Duhej me e çue në shtëpi po kërkush nuk ishte aty afër. Thashë të shikoj nëpër livadhe për çobaj të tjerë. Kur u largova tre katër hapa larg tij e shiqova ashtu të shtrimë dhe m'u duk sikur më tha me za të butë: «Jo mos shko, unë nuk të urdhënoj ma, tash gjyshi i vdekun nuk të thotë të shkojsh kund».

Përsëri ja dhashë vajit, ngava nëpër livadhe tue qa. Ma larg ishin tue mritzue delet e Haxhi Zenelve, pasanikëve të katundit, që i kishim diçka të afërt në fis, por të largët në ndihmë. Nën hije gjeta Ramadanin që po flinte. Në fillim edhe ai m'u duk i vdekun, por kur e thirra me emën, u çue përnjherë bashkë me pushkën që e mbante nën vedi.

Ramadani na donte shumë dhe me gjithë zemër të gjithëve. Ishte zemërmirë dhe kur kishte gja në dorë na ndihmonte. Por ata kishin të zotin e shtëpisë koprac të madh. Kur më pa mue tue qa, u çue me vrap në kambë e më pyeti:

— Çka ka ndodhë mor bir?

Atë çast unë s'mujta më i diftue se ka vdekë gjyshi, më lëshoi zemra në vaj. Kur i tregova, mori pushkën me fishekë, i hypi kalit, më tha edhe mue të hidhem në kal e më vuni përpara.

— Kah me shkue? — më pyeti. I kallzova me dorë dhe gjithnji qajshe. Me njenën dorë më mbante mue dhe pushkën, kurse në dorën tjetër dyzinat (frenat) e kalit.

Laroshi u vu mbrapa nesh.

— Mos qaj më thonte nga një herë, se ja rregulloj unë atyne. Kur mrrini te mrizi, delet u trembën prej kalit që ngante vrap dhe prej Laroshit që kur pau dele lehu. Ramadani ndali kalin, u hodh poshtë e mbas tij edhe unë. I shkoi afër gjyshit, uli pushkën në tokë, shikoi se mos kishte varrë pushke ose thikë, hetoi për gjak e mandej më tha:

— Kur ka vdekë?

— Parë, i thashë tue qa.

— More pusho klithi e m'u gërmush, a s'të vjen turp me qa kështu, ti je për pushkë... Atëhere unë pushova.

— Si e ke gjetë?

— Tue vdekë, i thashë; ri këtu! — më tha. Pushkën ma la mue, me ardhë kush prej nemcelive me të qitë delet jashtë ose me i marrë kallzoje veten... nuk je i vogël... mos u ban frikacak... unë po shkoj në shtëpi u kallzoi e marrim tabutin në xhami dhe vijmë me karrocë. Më dha pushkën në dorë e më pyeti:

— A din me shprazë?

— Po, i thashë, më ka mësue gjyshi.

U nis vrap me kal. Edhe Laroshi shkoi mbas Ramadanit. Kur e sollli kryet Ramadani, pa Laroshin që po e ndiqte nga mbrapa dhe e ktheu. Laroshi erdhi tek unë, ndejti pak dhe u nis për te delet.

Unë mbeta vetëm me gjyshin e vdekun, me delet, dhe me pushkën e Ramadanit që m'u dridhëte në dorë. Aty m'u kujtue edhe një herë qortimi i gjyshit dhe u

shkriva në vaj. Edhe sot e kësaj dite më ka mbetë vrragë në shpirt ai qortim, se gjyshi nuk priti të çfajsohem.

Ramadani u kthye shpejt dhe më pyeti:

— A ka ardhë kush?

— Jo i thashë.

— Po a ke pasë frikë.

— Jo i thashë prap. Ai ma mori pushkën e shikoi dhe kur e pa se kishte fishekun në gojë më tha:

— Kështu duhet me kenë tamam zog shqiptarit si tash: Zemrën me e pasë trime, me e pasë të fortë sa me e mujt të keqin e të fortin, mos me njoftë frikën e mos me dijtë se ç'ka don me thanë me derdhë lotin. Kur shikoi në plaçkat që u mbulonte gjyshi natën, se ai flente atje, gjeti pushkën e gjyshit. E mori e më tha:

— Ja pushka e gjyshit që ta la trashigim, mbaje me nder ashtu si gjyshi i yt, ti je i ri dhe kur të plakësh trashigoje edhe ti, të mbrojë të mirën e të vrasë të keqen.

Edhe kur ishte gjyshi gjallë më thoshte e më porositte: Ndigjo biro, i dashtun me miq, e i rreptë me anmiq, mos qaj për një njeri tandin se vdiq se nuk vjen gja prej qamjes, por qaje dhe gjeje pse vdiq. Në qoftë se vdiq prej exhelit<sup>1)</sup> mos e qaj shumë edhe në qoftë se asht i ri, në qoftë se e vret kush pa hak, merr hakun e tij.

Në qoftë se u vra djali në luftë për mbrojtjen e vatanit çoje në luftë edhe djalin tjetër; po s'pate tjetër zënja vendin ti o at i të vramit.

Kështu më mësonte gjyshi plak. Erdhi koha edhe unë u plaka, pushkën s'e kam hequr kurrë prej krahu, trashigimin e gjyshit... Kështu o bijt e mi ishte historia e gjyshit tim.

Shqipnia gjithmonë ka pasë një kafshatë buke e një trajisë me fishekë. Këtu shumë i kanë bamë varrin

---

1) Kur njeriu vdes nga një sëmundje a diçka e papritun.

vedit prej sa e sa kombësive që i kam pamë e ba me duert e syt e mi. Ndërruen edhe nga një duhan dhe Qemali me Agimin i lanë përshëndetjen plakut.

4

Kur arritën në fshat, Qemali dhe Agimi u ndanë. Agimi mori drejtimin nga shtëpia e tij, që ishte në të majtë, kurse Qemali u kthye në të djathtë.

Ndërsa Qemali po kalonte pranë shtëpisë së Afërditës, solli kryet andej dhe e pa atë tek po ujitte lulet. Shtëpia e saj ishte dykatëshe. Në ballkon kishte vendosun disa saksia. Njena dritare, ajo e katit të poshtëm, pothuej ishte zanë krejt nga lule gërhane, të cilat ishin lëshue si tendë hardhie e qenë përhapun deri poshtë. Te pusi para shtëpisë ishte një man i madh. Anash oborrit, Afërdita kishte mbjellun lule të ndryshme. Qemali e vrente Afërditën me kujdes. Ai mori frymë thellë dhe fort, sikur donte të thithte të gjithë aromën e atyne luleve...

Të dy shikuen nga larg njeni tjetrin.

Vajzës ju ndalën duert. Ujitësja nuk nxirrte ujë dhe gadi i shpëtoi. Nji ndjenjë e zjarrtë e përshkoi, vajza u skuq në fytyrë. Në këtë çast Qemali i humbi nga sytë. Ishte largue.

— Dita! i thirri dikush nga kopshti. Ajo uli ujitësen dhe shkoi te kopshti ku e thirri shoqja e saj.

— Ndigjo Dita, — foli shoqja e saj, një vajzë topolake me dy sy të shkruem dhe me flokë gështenjë të bame gërsheta. Isha parë në kooperativë për me marrë vesh se ku do të punojmë sot. Brigadjeri më tha që t'i shkojmë në ndihmë brigadës së Bardhës. Posa më pa, Nazmiu më thirri e më tha: Thueji Afërditës se do të marri pjesë në grupin e estradës së kooperativës. Kështu që nesër mbrama ta lamë punën pak ma herët dhe të shkojmë në vatër të kulturës.

— Po kush e kush janë? — pyeti Afërdita.

— Prej vajzave jena unë, ti, Nurija, Suada, Fatmira, të tjerat nuk i di.

— Nuk mundem, Zana!

— Pse? — pyeti Zana dhe e shikoi drejt në sy.

— Po unë s'kam dalë kurrë në skenë para popullit, veç vjet që dola si soliste kur u ba festivali i kangëve dhe i valleve të fshatrave. A e di se sa me turp kam dalë atë ditë, gadi mbeta në gjysmën e kangës. Qysh atëherë kam thanë se s'dal ma, me u turpue.

— Ehu, Dita! ti e ke pasë të vështirë me dalë të parën herë, se tash s'ka gajle. Ti, bile, që këndon në arë sa herë, s'duhet të tronditesh. Ata që të ndigjojnë në arë do të të ndigjojnë edhe këtu. Apo jo?

— Po po, por e ke vue re, ndonjiherë, kur mundo-hemi me e bamë punën ma mirë e bajmë ma keq. Mandej peni aty ku asht ma i hollë këputet.

— Kështu po të them, Dita, do të marrësh pjesë, do të ndigjosh shoqen tande. Unë tashti po shkoj në shtëpi, po baj gati ato që duhen me marrë dhe po të thërres edhe ty dhe shkojmë bashkë. Po mos u vono!

— Mirë, Zana, nuk po vonohem, ma parë duhet të shkulim resat duhani, e?

— Po, edhe mbasdite do të mbjellim, -- u përgjegj Zana edhe iku.

Afërdita u largue nga gardhi, mori ujitësen dhe hyni në shtëpi. Mandej doli në ballkon për të thirrur Petritin që të hanin. Mëngjezin e hangri shpejt dhe u ngrit e para, mori dorcën dhe ushqimin e drekës dhe u nis për në punë.

— Dita, Dita! — thirri nga jashtë Zana.

Ajo doli në ballkon dhe i tha se po vinte. I grumbulloi të gjitha e shkoi edhe një herë në kuzhinë.

— Nanë, po shkoj, ditën e mirë!

— Udhë e mbarë, bijë, punë të mbarë, — ja ktheu e ama, dhe e bija doli jashtë.

Afërdita kishte dhe një vëlla tjetër, që ishte në vitin e dytë në teknikumin bujqësor të Kavajës. Baba

i saj nuk ishte në mëngjes, se rrinte roje nate në kooperativë. Në rrugë po e priste shoqja e brigadës së saj, Zana. Ajo kishte mbushun katrovën me ujë dhe që të dyja nisën ta mbanin bashkë.

Rrugës bisedonin. Po shkonin në farishten e duhanit, ku do të shkullnin resate që do t'i mbillnin mbasdite. Takuen edhe bigadjerin e brigadës së dytë, Hekuran Shabanin me një shat në krah. Ai dukej i lodhun; flokët e gjatë dhe si të bardhë i kishin ramë në një anë, pantallonat i kish të laguna deri në gju. Kishte ndenjë tanë ate natë pa gjumë dhe ish nisë nga fshati i tij deri në Dragoç ku ndahet ujët e kanalit. Atij i kishte shkue gjithë nata tue i mbyllë vendet e hapuna, të cilat ishin lanë ashtu që në vitin e kaluem gjatë gjithë kanalit.

«Duhet ujë, se pa ujë duhani nuk ka se si të zejë; ujë, ujë, që i jep shpirt duhanit; s'duhet të marrim parasysh lodhjen, — thoshte Hekurani — duhet të punojnë edhe brigadierët ashtu si edhe punëtorët, si i madhi ashtu dhe i vogli, duhet të marrim pjesë në mbjelljet e jo veç me urdhnue».

Brigada e tij ishte një ndër ma të këqijat e kooperativës. Të gjithë e kritikonin, në mbledhje, në biseda njeni me tjetrin e kudo. Por ç'të bante Hekurani i shkretë kur nuk u rritën farishtet e duhanit? Vendi ku skuadra e tij kishte mbjellun farishte kishte qenë tokë e ftohët dhe resatet s'u banë që s'u banë. Pastaj nuk i mbeti gja tjetër veçse të organizonte të gjithë punëtorët bashkë me vet-veten e tij dhe kështu bani: «Sepse vetëm një organizim i tillë i punëtorëve, — thoshte Hekurani — më nxjerr mue nga kjo gjendje...».

Në fillim e ndjeu veten ma ngushtë se kurrë, ai kish luftue, kish ça dhe shpartallue anmikun në luftën partizane, por si kësaj radhe s'e kishte ndje veten kurrë.

U foli punëtorëve të brigadës së tij me hollësi mbi tanë procesin e punës që do të bahesh dhe për kujdesin që duhej pasë në çdo çast. Pastaj vazhdoi:

E shikoni, pra, o shokë, se e gjithë puna shkon zin-



xhir, që në shkulje dhe deri kur ta mbjellim. Mjafton vetëm njena dorë ta bajë keq punën dhe fidani damtohet, nuk zen. Për shembull, në qoftë se e shtypim në shkulje, ai ka zor, sikur ne ta shkulum mirë dhe ta mbjellim keq, sa të duesh hudhi ujë, sa të duesh bani mirë të gjitha shërbimet e tjera, mbjelljet keq se keq do të zajnë. Ose në rastin e kundërt po ta mbjellim mirë dhe t'i hedhim ujë sa me e rrejtë, ai nuk zen, se nuk e rrejmë atë po në radhë të parë rrejmë veten tonë. Vetëm puna e mirë e secilit mund të na nxjerrë nga kjo gjendje ku jemi ne.

Po punuem mirë, të gjithë do të kemi përfundime të mira dhe kemi besim se në punën tonë të pastër, me cilësi dhe sasi do t'ua kalojmë brigadave të tjera...» Kështu u tha Hekurani punëtorëve të tij. Ato që i thonte i bante ai vetë përpara, punonte krah për krah me punëtorët edhe pse ishte brigadier. Pikërisht atë mbramje megjithëse kishte punue tanë natën e përparshme, mbasi hangri bukë, ndërroi rrobet, u nis përsëri për në farishte. Atje u gjend para punëtorëve që kishin fillue punën shumë vonë.

Afërdita dhe Zana, posa arritën te farishtet, u takuen me brigadjerin. Ajo u uroi mirëseardhjen dhe u tha duke qeshun:

— Ndigjoni, duhanin due me ma mbjellë mirë e jo dosido.

— Të gjithë e kena për shtëpinë tonë, punën e bajmë njisoj, — foli me buzë në gaz Zana. Shumë punëtorë kishin ardhë dhe kishin fillue shkuljen. Brigadjerja u tregoi vendin se ku do të shkulin dhe dy vajzat filluen punën.

Mbas pak erdhën edhe punëtorët dhe punëtoret e tjera të brigadës së perimeve, kurse ato të brigadës së katërt kishin fillue pak ma herët. Të gjithë ishin përhapun nëpër zagna dhe po shkulin fidanat e mirë me kudjes, që të mos i shkulin pa rranjë dhe as të mos i shtypnin. Nji vajzë për çdo skuadër mblidhte tufat e shkulluna dhe i vendoste lehtë në kosha. Afërdita dhe

Zana po shkulin pranë e pranë njena tjetrës. Fytyrën e kishin nga dera e resateve ku qenë punëtorët e brigadës së katërt.

Afërdita shikonte andej me vretjtje dhe nën shami, sikur kërkonte diçka. Suada, që kishte shpinën nga kjo, e solli kryet nga brigada e perimeve dhe takoi në vështrimet e Afërditës. Dy shoqet e përshëndetën njena tjetrën me krye. Mandej Afërdita uli kryet poshtë dhe vazhdoi përsëri punën.

— Lyeji kambët me gur kali! — briti roja nga fundi i resateve.

— Si urdhënon! — u përgjegj Qemali dhe lagu shoqet e këpucëve me gur kali të shkrimi. Këte e kishte për detyrë ta bante çdo njeri që hynte dhe kjo gja filloi që atë vit kur i ra vrugu duhanit.

Kur ndigjuen rojtarin, të gjithë e ngritën kokën dhe panë se kujt i foli. Afërdita, posa e pa Qemalin, uli kryet poshtë dhe vazhdoi të shkulte resat. Ajo e kërkonte këte qëkur, po tash që ai erdhi, vajza nuk e ngriti kokën, i dukej sikur do të tradhëtonte veten.

Qemali u ul dhe filloi punën si shokët.

— Ku ishe, Qemal? erdhe pak me vonesë — pyeti Ibrahimimi.

— Po, u vonova, Ibrahim, sepse më doli një punë ashtu.

— Ashtu? Mirë, vazhdo punën, — dhe Qemali nisi punën e ndërpreme. Posa i mbushën koshat me resatin e nevojshëm, ata u ngritën, i mbuluen koshat me bar, u hodhën ujë sipër, që të rrinin rranjët fresk dhe mandej u nisën disa për në shtëpi dhe disa të tjerë për te bahçja, ku do të mbillnin mbas dite.

Që të mos humbte kohë, Qemali e kish marrun ushqimin e drekës me vete dhe donte që të flinte ato orë që do të pushonin sodopak. Për fat të tij, që të dy brigadat e lanë punën në orën 11. Qemali i kish thanë Ibrahimimit që kur të vinte në punë, ta ngrinte nga gjumi.

Qemali eci shpejt e shpejt nëpër bahçe dhe ra të

flejë në gjumë. Afër tij, në një vend të shtruem me bar, pushuen edhe vajzat. Një herë filluen të bisedojnë dhe të qeshin me të madhe, por kur Suada pa Qemalin që po flinte, u foli shoqëve dhe u tha se nuk asht mirë me qeshë ashtu kur njëni afër tyne flen.

Të gjithë pushuen përnjherë të qeshunën. Qemali, që ende s'kish fjetun, e ndigjoi vrejten që u bani Suada shoqëve, i ndigjoi edhe vajzat që heshtën. Ndenji edhe pak i shtrimë në shpinë, u suell në një krah dhe mandej e zuni gjumi.

Vajzat nuk biseduen më me za të naltë dhe as qeshën me të madhe. Afërdita ndonjherë e sillte shikimin nga Qemali, por ai ishte shtrimë në bar dhe kish humbun në të. I dukej vetëm këmisha që kishte hedhun mbi fytyrë.

Të gjithë ishin bamë gati që të hanin drekën, por po pritnin Nuriën bashkë me Zanën që të binin ujin e ftohtë. Punëtori që lodhet kurrë nuk e shijon ngranjen pa pasë ujin afër. Mbasi pinë ujë të gjithë dhe u freskuen, filluen të hanë.

— Qamil, o Qamil! — thirri dikush nga bahçja dhe mandej vërshëlleu. Qemali u zgjue nga gjumi dhe u ngrit ndenj. Ai po thërriste edhe një herë emnin Qamil dhe Qemali, kur e ndigjoi se ai nuk thërriste Qemal por Qamil, u qetësue përsëri.

Suada, që ishte karshi Qemalit, e pa se ai u ngrit e i tha:

— Qemal, eja të hamë bukë bashkë!

— Jo, nuk due Suada, se kam hangër pak para se të vini ju... Afërdita pa vendin ku ishte ajo dhe u largue pak sikur donte t'ja lironte atij në qoftë se do të vinte.

— Epo hajde, se edhe po qe se ha dy herë nuk të ban keq, por më duket se nuk ke hangër as dhe një herë, — i tha Suada.

— Jo, jo, më beso Suada, kam hangër. — Falemnderit, ju baftë mirë — dhe përsëri u shtri që të flente. Afërdita e pa edhe një herë kur ai u shtri, mandej e solli shikimin nga shoqet.

— Pse i bane za që të vinte, ai ka hangër një herë? Mandej edhe sikur të mos ketë hangër si po e bjen këtu në mes të gjithë këtyne vajzave ti? — foli Hanifeja, e vetmja plakë që ishte me to.

— Na të gjithë jena si vëllezën e si motra. Me ta punojmë përherë. Ai asht ndër djemtë ma të mirë të fshatit. Për te as mund të flasë kush një gjysmë fjale. Kur punon me ne, qesh e flet me ne, rrin me ne, pse të mos hajë me ne? — i tha Suada asaj plake që donte të futte ndonji thumb, sepse Hanifeja gjithmonë këto raste të ruente.

— Ai djalë edhe mue më pëlqen shumë, asht shumë i sjellshëm, punëtor, s'di të flasë as të shajë shokët kurrë, — tha Nurija, ndërsa po ndante kafshatën e bukës. Ja çka na ndodhi një ditë...

— Lene, pashë zotin, po çka po ju duhet Qemali? — ndërhyri Hanifeja. — Kapni ndonji muhabet tjetër, në qoftë se ju pëlqen e asht punëtor e i sjellshëm besa edhe me e pa nuk asht i keq, merrnie ndonjeha...

Të gjithë e shikuen atë grue me keqardhje.

Afërdita i ndigjonte me vemendje fjalët që flisnin për Qemalin. Shumë i kish ndigjue shoqet apo shokët tue folë mirë për te dhe në tilla raste kish qejf të rrinte e të ndigjonte gjithçka... Ajo ishte rrëmbye prej tij, vetja nuk i përkiste vetëm asaj, ajo i ishte falun edhe atij. Por ja, u ba një kohë që e donte kaq shumë, sa disa herë i kishte lejuë Qemalit që ta kuptonte se çfarë kish ajo. Por një natë edhe Qemali ja tha tërthorazi, dhe kjo e kuptoi shumë mirë se ç'ndjente ai, por ja kundërshtoi, i tha ate që s'donte t'ja thoshte kurrë, por ç'të bajsh? ajo u tha...

Të gjithë hanin bukë tue bisedue, kurse Afërdita hante ngadalë dhe nuk bisedonte.

— Pse nuk ha, Dita? — e pyeti Suada Afërditën që po përtypej shumë ngadalë.

— Nuk po më shkon, — tha si me ankesë. — Disa hangrën, kurse disa të tjera vazhdonin që të hanin. Mbas

pak hangrën edhe të tjerat dhe ma e fundit në të gjitha mbeti Hanifeja.

Mbasi hangrën, u ulën të pushonin në barin e njomë. Qemali kishte ra në gjumë të thellë; ai ishte ulun që të flinte në anën e një hijeje fiku, sepse aty ishte bari ma i mirë, por, nga që kishte ecun hija, trupi gati i kish dalun në diell. Ibrahim i erdhi në orën e caktueme dhe, kur pa se ende s'kishin ardhë punëtorët, nuk e zgjoi Qemalin nga gjumi por priti sa të vinin të gjithë. Ai kish zanë vend në hijen ku ishte Qemali. I mbështetun pas trupit të fikut, thithte cigaren, shikonte Qemalin që po flinte dhe i vinte keq që do ta trazonte për me e zgjue.

Punëtorët filluen të vijnë. Nga larg Ibrahim shikonte traktorët që po punonin njëni mbas tjetrit, atje, në brigadën e perimeve, kurse një tjetër po drejtohej andej nga ai. Bahçeja gjithkund gjelbëronte dhe nëpër degët e pemëve me lulë të bukura gjithfarësh, zogjtë cicëronin dhe këndonin. Qemali kish dalun në diell dhe, nga që filloi të nxehet, lëvizi e, mbasi u suell disa herë, i doli gjumi. U ngrit ndenjun dhe pa Ibrahim që po rrinte i mbështetun dhe po thithte cigaren si i menduem. Ai nuk e vuni re Qemalin që u zgjue nga gjumi, sepse shikimin dhe mendimin i kish tretun diku larg.

— Paske ardhë, Ibrahim? — pyeti Qemali ndërsa po fërkonte sytë me shami.

— Tashti posa erdha, — u përgjgj ai.

— Sa ka shkue ora, edhe sa kena me fillue punën?

— Edhe një çerek ore.

— A shkojmë te puna, o Ibrahim, se sa çohemi e rregullohemi tamam një çerek ore bajmë.

— Mirë thue, — tha tjetri dhe u ngrit në kambë. U tha që të çoheshin edhe vajzave dhe me të shpejtë edhe ato u ngritën. Katër vetë të njenën skuadër morën dy koshat e mbushun me fidana duhani. Njenin kosh e mori Suada me Qemalin, kurse tjetrin Ibrahim me Nuriën, dhe të gjithë u nisën për në fushë.

Shkuen te vendi ku do të punonin, hapën një gropë të vogël, hüdhen ujë mbrenda, pleh organik e mandej pak ekzaklorant dhe i përziën bashkë. Të gjithë u afruen rreth koshave dhe filluen të pastronin duhanin e keq nga barnat e këqia, t'i barazonin rranjë të mandej t'i lyejnë me plehun dhe ujët që e përziën në gropën e vogël.

Brigada që u kish ardhë në ndihmë zuni vend në mes të bllokut. Atyne ua kishin zgjedhun tokën ma të mirë, sepse kishin ardhun si miq. Edhe ata u ulën dhe filluen të pastronin fidanat e duhanit, t'i lyejnë, t'i fusin në kosh, që të ishin gadi për mbjellje. Në bllok u dukën gjashtë grupe njerëzish, gjashtë rrethe. Në skuadrën e Ibrahimit të gjithë rregullonin duhanin dhe vetëm Zyka dhe Hanifeja, që ishin dy punëtorët ma të vjetra, i lyejnë rranjë të duhanit në gropën që kishin ba dhe i vendosnin në kosh. Mbasi rregulluen njeën kosh u ngritën për të fillue punën.

Ibrahimi mori i pari shënuesin dhe po caktonte vijat. Mbasi bani një dy a tri të kthyeme, nisën shpërndarësit e fidanave dhe fill mbas tyre mbjellësit dhe vaditësit që e lagnin duhanin rranjë për rranjë. Suada e fundit, sepse ndenji për të mbulue koshin e duhanit që të mos i fishkte dielli resatet.

Në njeën dorë mbante flamurin që e kish fitue në garën e ditës së shkueme dhe në dorën tjetër dorëzën e duhanit. Nguli shtizën e flamurit në dhe, dhe ai nga era e lehtë që frynte filloi të rrahë palët e tij të vogla. E pa edhe një herë dhe ja filloi punës. Shokët dhe shoqet e saj kishin kalue përpara, ajo punoi shpejt dhe i zuni ata. Mbasi tyre u ngritën edhe punëtorët e skuadrave të tjera dhe atëherë u përhapën nëpër bllokun e lavruem dhe e mbushën plot. Puna filloi të zjejë.

Ibrahimi, që po shënonte vijat atje në fund, mbasi mbollën një copë të mirë, u tha punëtorëve të tij: Ndigjoni! Kur të kryeni edhe nga një vijë mbas tyre mos harroni me bamë garën.

— Jo, jo, — u përgjegj Meti — nuk harrojmë. Sot due me marrë pjesë edhe unë në garë. T'jua marr unë një herë flamurin juve, që jeni mësue me e mbajtë. Unë sot do t'jua marr, se s'ban; po desha unë s'ma kalon njeri në mbjellje — tha me mburrje Meti.

— Mos thuej ashtu, — ndërhyri Skënderi, se ai që lavdërohet ndodh shpesh që edhe e humb.

— Tashti unë s'po them se e fitova e mori fund, po në mbjellje nuk ma kalon njeri, tjetër gja se unë nuk marrë pjesë në garë, po sikur të marr pjesë fitoj...

— Do të shohim kur të bajmë garën, asaj po ja lemë fjalën, tashti flasim kot, mos u mburr për pa e fitue, të paktën fitoje e atëhere mburru — i tha përsëri Skënderi atij njeriu që ishte pak ambicioz dhe nuk i vinte mirë kur ja kalonte kush.

Ai luate shumë mirë edhe futboll, dhe nganjëherë, kur e mirrte topin, mbërrinte me top deri te porta e gjuente me sa fuqi që kish dhe, kur e nxirrte topin jashtë, thoshte: «s'dojshe ta baja, se ai shkonte si hallva», ose kur golin e bante ndonji tjetër thoshte: «po po golin e shënove ti, por ai ishte pasi i im i sigurt e ti s'pate gja tjetër vetëm ta gjuejshe në portë». Këto i kishte zakon. Ate çast mbaruen edhe rrjeshtat që tha Ibrahimimi dhe po prisnin njenin që ta mbaronte vijën dhe pastaj t'u rreshtonin të gjithë së bashku.

— Ndigjoni, — tha ai! — Në garë duhet të marrin pjesë të gjithë, pa përjashtim; në garë janë të gjithë mbjellësit dhe shpërndasit. Ajo do të zhvillohet me vijat fund e krye, kur të mbarojë gara unë do të kqyri cilësinë e punës, në qoftë se ai që fiton garën e ka cilësinë të keqe, garën e humb dhe e fiton i dyti, në qoftë se edhe i dyti e ka keq cilësinë, garën e fiton i treti e kështu me radhë. Flamurin e kam ngulë atje në krye të vijave dhe tamam në mes. Atëhere shpërndasit të fillojnë! — Dhe shpërndasit filluen të shpërndajnë me të shpejtë. Duart e tyne lëviznin si maqina automatike dhe i nxirrnin fidanat një nga një.

— Gati edhe mbjellësat, filloni! dhe të gjithë filluen shpejt. Gara filloi...

Skuadrëkomandanti i skuadrës së parë të brigadës së perimeve, Gjergj Vila, po shënonte vijat e duhanit dhe shikonte garën që po zhvillohej. Shikonte skuadrën e Ibrahimit, që lëvizte tanë gjallëni.

Para të gjithëve ishte prapë Suada, pak mbas Suadës vinte Qemali, mbas Qemalit Shpresa, Skënderi, Nurija, Meti...

Afërdita shikonte garën me vemendje, Qemali barazoi me Suadën dhe e kaloi pak. Asaj filloi t'i trokiste zemra shpejt, edhe ma shpejt se sa zemra e Qemalit, që po bante garën.

— Kush dëshiron ti që ta fitojë garën? — pyeti Zana Afërditën, — Suada apo Qemali?

— Po nuk i dihet se kush do ta fitojë.

— Ajo dihet se garën do ta fitojë njeni prej të dyve, ata janë pak ma përpara se të tjerët dhe mbjellin ma shpejt. Po cilin ke qejf ti që të fitojë? — Këtu e zuni ngushtë dhe tjetra s'dinte çka t'i thoshte.

— Si the, thueje edhe një herë? — pyeti Zana sikur s'e kish të kjartë. — Kush dëshiron ta fitojë? — përsëriti ajo.

— Qemali — u përgjegj Afërdita.

Qemali dhe Suada barazuen, ju afruen shumë edhe Shpresa bashkë me Skënderin dhe këtyne të fundit u erdhi pranë Nurija. Që të gjithë i derdhnin forcat me shpirt. Meti kishte mbetun i pesti dhe herë mbas here shikonte shokët a e kishin kalue shumë.

— Pse ke qejf që garën ta fitojë Qemali? — pyeti Zana mbas pak. Afërdita u çudit nga kjo pyetje që i bante shoqja e saj, por nuk vonoi për t'i dhanë përgjigje.

— Se ata të dy janë punëtorë, si Qemali si Suada, a i shikon se si shkojnë paralel!? Dje flamurin e ka pasë Suada, kurse sot Qemali, — tha Afërdita tue shikue garën dhe tue kujtue se shoqes i dha një përgjigje pak a shumë të arësyeshme. Po i afroreshin fundit të vijave, pikërisht aty afër flamurit.



Të gjithë po i mblidhnin forcat ku i kishin e ku s'i kishin për të mbërri... Edhe ai që ishte i fundit i jepte me të gjitha forcat, që të paktën të mos cilësohej i fundit fare dhe ma dembeli por të paktën të zente vendin e para fundit.

Meti që e ngrinte kryet nalt tash e parë dhe shihte se mos po mbarojnë vijat shpejt, sepse i pesti dhe i gjashti po ja kalonin, i kish humbun shpresat që të fitonte flamurin, po mundahej dhe luftonte që të mbante vendin që kish. Ai ish ma dembeli i skuadrës dhe kjo u provue edhe kësaj radhe.

Posa u ngrit, solli kryet andej e këndej dhe pa skuadrën e Gjergjit. Të gjithë punonin shpejt. Gjergji shihte se si po punonin; edhe punëtorët që lagnin duhanin me lagësa rrinin në kambë, shikonin me vemendje dhe diçka bisedonin njëni me tjetrin, pastaj njëni prej tyre bante me gisht për punëtorët që ishin para tyre dhe që punojshin me të shpejtë. Qemali dhe Suada ishin paralel, nuk mund ta kalonin njëni tjetrin, por kur ndigjuen zanin e skuadërkomandantit «hajde jepni, edhe pak mbeti», i dhanë vrull edhe ma tepër, dhe Qemali u shkëput pak nga Suada që i jepte duerve me mish e me shpirt. Kur e pa Suada që Qemali u shkëput, i dha vetes, por shpejtësia e duerve dhe e punës nuk shkonte ma tepër. Ai punonte me të shpejtë dhe i jepte sa nuk shkonte ma. Kur mbërrini në fund dhe shikoi se s'kishte fidana duhani të shpërndame thirri me të madhe:

— Hidh fidana — dhe u ngrit në kambë, por kur pa flamurin dhe vijat që kishin mbarue e kuptoi që e kish fitue.

— Të lumtë!... briti Beqiri, atje në fund të vijave, ku po lagte duhanin dhe ngriti duert nalt me gjithë lagësen. Pak mbas Qemalit e përfundoi mbjelljen edhe Suada. Ajo qëndroi në kambë pranë tij. Të dy ishin djersitun dhe lodhun. Suada e fshiu djersën e ftyrës me shami, mori flamurin dhe ja dha Qemalit.

— Merre, se e meriton — tha ajo. Mbas Suadës e

përfundoi Shpresa, mbas Shpresës Skënderi, Nurija dhe Meti, kurse të tjerët i kryen të gjithë përnjiherësh. Ibrahimimi u kontrolloi punën të gjithëve. Të gjithë kishin mbjellun mirë dhe asgja nuk gjeti keq përveç nja katër fidana duhani nga ato që kish mbjellë Meti.

— He, Met, e fitove garën? — i tha Skënderi atij.

— Jo, mor, shikoje se me çfarë dorçe kam mbjellë, por edhe në këtë tokë nuk bahet garë, atje në brigadë tjetër asht tokë e mirë — foli Meti dhe ju duk se gjeti justifikimin e humbjes së garës.

— Nuk gjete justifikim të bukur si herët e tjera — tha Ibrahimimi — por ti edhe sikur të fitojsh garën do ta humbsh, se ke mbjellë keq. Meti nuk foli ma dhe e ndjeu veten ngushtë.

— Të lumtë, Qemal! — i thanë shokët e skuadrës.

— Tashti filloni prapë nga puna, kjo u pa, garën sot e fitoi Qemali, dje Suada, kurse nesër të luftojë ndonji tjetër për t'ua marrë flamurin. Por puna asht që gjithë dita e punës të jetë garë, se gara nuk vlen vetëm për një vijë.

Atëhere të gjithë u radhitën simbas rreshtave që kishin dhe ja filluen punës përsëri. Tash ishin vu në garë të dy skuadrat dhe të gjithë punonin për nderin e kolektivit. Nga të katër anët të zinte syni vetëm punëtorë me krahë të shpërveshun që lëviznin panda.

Tefiku i jpte vetes me të gjitha forcat e tij dhe shpejtoi sa asnji tjetër, kur pa që Afërditën s'e kishte larg as gjysmë metre. Zana mbeti mbas Afërditës dhe kur ajo ndjeu dorën e Tefikut, që i ngulte fidanat me të gjithë forcën zhup-zhup... i dha vetes që të kalonte ma shpejt por s'mundesh. Duert i saj nuk mund të luenin ma shpejt. Duert e asaj vajze të re, ma e reja në ate skuadër, ende nuk i kishin fitue ato shprehi që krijon puna, ato dridheshin nga shpejtësia, kurse Tefiku, që ishte një djalosh i fortë, sado shpejt që të mbillte e kish dorën të sigurt. Ai u shkëput nga Zana dhe e la mbas. Afërdita e ndjeu Tefikun që i vinte nga mbrapa, i dha vetes që të mos humbte garën që kish

edhe pak metra sa të përfundonte. Ata të skuadrës së Ibrahimit, kur morën vesh se gara sosej edhe për pak, u ngritën të gjithë dhe shikuen.

Afërdita dukej e vendosun. Garën dhe flamurin do t'i merrte me doemos. Ajo ndigjonte në krahun e diathtë të saj dorcën që ngulte Tefiku në tokë dhe thoshte me vete se garën po e humbte, por, kur desh të mirrte fidanet e hedhun në tokë dhe t'i mbillte, nuk i gjeti. E shtriu dorën edhe pak ashtu me krye ulun dhe takoi flamurin që ishte gati ngjitë me te.

Suada po rrinte ende në pozicionin e maparshëm. dhe kur pa se garën e fitoi vetëm për pak, lëvizi nga vendi dhe thirri: — Dita-a! — dhe ngriti duert nalt. Afërdita në këtë çast e ndjeu veten të gëzueme dhe i dukej sikur kishte mbërritë diçka shumë të madhe me shkathtësinë dhe shpejtësinë e saj. Solli kryet nga Suada dhe i buzëqeshi. Sytë i shndritën nga gëzimi, i qeshte fytyra.

Shikonte Qemalin dhe sikur donte t'i thoshte: që «garën e fituem të dy, prandaj eja këtu që t'na përgëzojnë të gjithë».

— Bravo i qoftë Ditës, nuk e lëshoi flamurin që e fitoi dje! — i tha Suada Qemalit — Me të vërtetë bravo i qoftë, se ajo kishte dy konkurenta të fortë dhe ata s'donin që t'ja lëshonin, por ajo nuk i kurseu forcat.

Edhe punëtorëve të tjerë të skuadrës së Ibrahimit u tërhoqi vemendjen kjo garë që zhvillohej. Të gjithë u gëzuen që garën e fitoi Afërdita. Këtë gja e vuni re edhe Qemali dhe e ndjeu veten edhe ma të gëzuem. Mbas përfunduen edhe ata të fundit u rreshtuen simbas radhës dhe skuadërkomandanti u tha se ashtu siç ishin të radhitun t'ja fillonin punës.

E para qëndronte Afërdita, mandej mbas saj vinte Tefiku, Zana, Faiku, e të gjithë të tjerët, një mbas një. Këta të fundit kishin përfundue vijat përnjiherë dhe s'dinin cilin të lenin në vendin e tretë: Zanën apo Faikun. Njeni propozoi Zanën, sepse ish ma e re, kurse Ramizi, që po vinte me një lagës në dorë tha:

— A po ma leni mue ta zgjedh?

— He, jepe mendimin tand! — i tha skuadërkomandanti.

— Mirë, pra, — foli Ramizi dhe uli lagësen në tokë — Faiku me Zanën janë me pikë të barabarta dhe tashti unë jam i mendimit që vendin e tretë ta zejë Faiku se, simbas klasifikimit sportiv, kur dy skuadra janë me pikë të barabarta, vendin ma të parë e zen ajo që asht me golaverazh ma mirë. Faiku asht ma mirë, sepse disa herë ka fitue në garë dhe disa herë ka dalë i dyti, kurse Zana ma rrallë dhe ma pak se Faiku.

— E, shokë, si thoni ju, a jeni në një mendje me Ramizin?

— Po o... jena dakord, thanë disa tue qeshë me shakanë që bani Ramizi. — Atëhere pra vendi i tretë i takon Faikut. Të gjithë ishin rreshtue një mbas një, afër bahçes.

— Sikur të kemi ndonji aparat fotografik! — u tha Tefiku shokëve.

— Mos lueni, se erdha — foli Nazmiu, përgjegjësi i votrës së kulturës, një burrë pak i gjatë e i shëndoshë. Në krye nuk kishte flokë përveç anash, fytyrën të gjanë dhe sytë të mëdhaj dhe të gështenjtë. Ai po vinte nga bahçja dhe gati ish afrue pranë tyne. Në dorë mbante një aparat fotografik.

— Oh, sa mirë që erdhe! — i tha skuadërkomandanti:

Nazmiu, mbasi i përshëndeti të gjithë, pyeti:

— Si janë rreshtue këta?

— Këta, — foli skuadërkomandanti — janë rreshtue simbas klasifikimit të garës që u zhvillue pak para se të vije ti. I pari që fitoi garën fillon nga Afërdita, mandej vinë një mbas një.

— Shumë mirë, — tha ai dhe bani aparatin gati që t'i mirrte. — Afërdita, mbaje flamurin në dorë. — Ajo mori flamurin në dorë dhe përsëri u ba gati. Ne atë çast dikush foli:

— Do të ishte ma mirë që t'na merrshin në fotografi tue ba garën.

Si e mbaruen edhe këtë punë, Nazmiu ju afrue Afërditës dhe e pyeti:

— A të ka thanë gja Zana për nesër mbrama që ta leni punën pak para shokëve e të vini në votrën e kulturës?

— Po, më ka thanë por...s'...

— S'ke çka me ba, do të vijsh që të nderosh kooperativën... — dhe u drejtue nga skuadra e brigadës së katërt.

— Puna e mbarë, o shokë!

— Të mbarë paç! — ju përgjegjën punëtorët në kor.

— Ibrahim, brigadierja a asht këtu? — pyeti Nazmiu.

— E ke atje afër grunit, te bujqit.

— E shoh, — u përgjegj Nazmiu. — Ndigjo, Ibrahim, brigada juej ka një fletë-rrufe nga komisioni i emulacionit socialist, prandaj do të mblidhen të gjithë vetëm dhjetë minuta dhe mandej mund të filloni punën përsëri.

Mbasi u mblodhën të gjithë, Nazmiu u ngrit në kambë dhe foli: «Komisioni i emulacionit socialist analizoi dhe të gjithë punën e kooperativës dhe mandej në veçanti punën në çdo brigadë dhe skuadër. Simbas analizës që u ba, brigada juej doli një ndër brigadat që kanë punue ma shumë dhe ma me cilësi. Tashti unë po e lexoj fletë-rrufenë dhe ju ndiqeni me vemendje». Çfletoi fletoren që e mbante të thyeme në dorë dhe lexoi: «Shokë dhe shoqe kooperativistë!

Fushata e mbjelljeve po ecën me një ritëm të shpejtë në të gjithë kooperativën. Për të krye këtë fushatë të madhe janë mobilizue të gjithë kooperativistët. Gjatë kësaj fushate ata mobilizohen tue punue që në mëngjes herët me orë të zgjatuna deri në orët e vona të mbramjes.

Pjesëmarrja në punë e anëtarëve kooperativistë ka qenë thuejse e plotë. Në të gjitha brigadat ka pasë përpjekje për të mbjellë shpejt dhe në kondita agroteknike. Këtij qëllimi ja ka arritë ma parë dhe ma me sukses Brigada IV. Komisioni i emulacionit socialist analizoi punën në të gjithë kooperativën dhe vendosi që të nderojë Brigadën e IV me flamurin tranzitor për pe-

riudhën e mbjelljes së duhanit. Gjatë kësaj periudhe janë dallue edhe skuadra e II, e Brigadës së IV, që drejtohet nga shoku Ibrahim Asllani. Janë dallue shokët e shoqet: Qemal Ahmeti, Suada Seferaj, Shpresa Hasa, Skënder Beqiri. Ndërsa nga brigadat e ndryshme dallohen Afërdita Malo, Tefik Ramadani, Suzana Alija, Feride Kasemi, Agim Hysen Gurra. U lumtë shokëve e shoqeve që kanë punue dhe që punojnë për të nderue veten, skuadrën dhe brigadën në të cilën bajnë pjesë!

Nga komisioni i emulacionit socialist».

Kur mbaroi Nazmiu dhe ja dorëzoi flamurin brigadës, e mori fjalën brigadjerja:

«Siç e ndigjuet edhe ju, ne morëm flamurin tranzitor si brigadë. Tashti ne na mbeten si detyrë jo vetëm që ta mbajmë deri në fund, por ta nderojmë brigadën me punë edhe ma të madhe. Ne do të mobilizohemi me të gjitha forcat dhe mbjelljen e duhanit do ta kryejmë para afatit dhe para të gjithëve...» përfundoi brigadjerja dhe nuk zgjati shumë në mënyrë që të mos pengonte punën. Të gjithë u ngritën në kambë, Suada shkoi te Nazmiu dhe i kërkoi që t'i bante një fotografi bashkë me një shoqe. Ai pranoi dhe Afërdita me Suadën dolën krah për krah njenatjetrës.

Atë çast u afrue aty Qemali. Suada, që gjeti tamam çastin, foli si pa të keq:

— E bajmë një edhe me Qemalin?

— Si të duesh ti — tha Afërdita — unë nuk ta prish qejfin ty.

— Qemal, e bajmë bashkë ne të tre?

— Unë ku ta gjej tash një fotografi të tillë!

Afërdita shikonte dhe nuk bante za, por ma në fund i tha edhe ajo Qemalit që të rrinte dhe të bante fotografinë bashkë me to.

— Ku po e bajmë, Nazmi? — pyeti Suada.

— Për mue ku të doni ju, po unë them te ajo pema e vogël që ka çelë lule të bukura, mbas së cilës janë tendat e hardhive. Besoj se do të dalë një fotografi e mrekullueshme, — tha ai.

Që të katërt shkuen te ajo pema. Nazmiu u ndal para pemës, kurse tre të tjerët shkuen të merrnin pozën. Dy vajzat e futën Qemalin në mes. Të tre u afruen dhe Nazmiu u ba gati që t'i mirrte. — Qeshuni de, ç'më rrini kaqë varshëm? — foli Nazmiu me shaka dhe shkrepri aparatën.

— Të na i lajsh mirë dhe sa ma shpejt — i tha Suada.

Afërdita dhe Qemali tash e ndjenin veten ma afër njeni tjetrit. Ndjenin një ngrohtësi dhe gëzim që e ruenin për veten e tyre dhe që s'ja tregonin kujt. Filluen të ecnin, në mes hyni Suada.

— Ky do të jetë kujtimi ynë ma i bukur, apo jo? — tha Suada.

— Me të vërtetë ky asht një kujtim shumë i bukur, — përsëriti Afërdita.

— Po ja që Qemali, si djalë nuk u tregue... duhet me na pasë thirrë ai për një kujtim si ky. Ne sot jena të rinj dhe kena kujtime plot, si kah jeta, puna, shoqëria e kahdo. Kjo jetë asht, e nuk i dihet se nga bredhim.

— Jo, unë s'e bana për ndonji send Suada, por thashë se ju të dyja jeni shoqë të ngushta njena me tjetrën dhe s'desha t'ju përzihem.

— Ti je shoku ma i ngushtë i Agimit dhe unë jam shoqja ma e ngushtë e Afërditës. Kur të jesh diku në ndonji qytet tjetër do të shikosh fotografinë tonë, do të kujtosh të fejuemen e shokut tand dhe shoqen time të ngushtë njëkohësisht, apo dy shoqet e tua të punës, me të cilat ke punue bashkë disa vjet. Atëhere do të thuesh: Ja edhe Afërdita, shoqja ma e ngushtë e Suadës, kështu na s'do të harrohena kurrë, apo nuk asht kështu?

— Ashtu asht, — pohoi Qemali, që i kuptoi kurrihin këto fjalë.

Të gjithë punëtorët kishin mbërri te vendi i punës dhe ishin gadi që t'ja fillonin. Nazmiu po bisedonte diçka me brigadjerën atje ku zhvilluen mbledhjen.

— Punë të mbarë! — u tha Afërdita Suadës dhe Qemalit.

— Punë të mbarë dhe ju! — ja kthyen ata dhe u ndanë për në skuadrat e tyne.

Dielli po perëndonte, ndërsa në fushë akoma ziente puna. Në këtë kohë, para perëndimit të diellit dhe pak mbas tij punëtorët punojnë edhe ma shumë, megjithëse ka kohë që ja kanë fillue punës. Kur moti nis të freskohet ata e ndjejnë veten sikur janë të çlodhun, sepse filladi i lehtë e i freskët pranveror, ajri i pastër i fushave e i livadheve e çlodh trupin dhe i jep fuqi të reja për punë.

Dalëngadalë dielli po fshihej mbas maleve. Ai po humbiste në retë që qëndronin si shtëllunga tymi të verdha. Ato shtëllunga, ca të denduna ca të përhapuna, kishin marrë ngjyrën e flakës së kuqërremtë dhe ngjyrë bakri, që, sa ma nalt ngjitej, aq ma e përflaktë bahej. Ai nxori kryet edhe një herë mbrapa reve, të cilat kishin lanë një boshllëk të vogël dhe lëshoi rrezet e tij në liqe, pastaj përsëri u fsheh në mes, tyne sikur të donte t'i përshëndette kooperativistët edhe një herë e t'u thosh-te natën e mirë.

Bujqit po i nisnin qerret e tyne në stallë, kurse traktori ende vazhdonte të punonte. Ai po punonte në brigadën e perimeve, sepse ai traktor që kish punue po në atë bllok ishte prishun që në mes të ditës. Pikërisht në këtë traktor që po lëvronte në brigadën e perimeve ishte Agimi.

Mbasi perëndoi dielli, erdhi Cafi, ndihmësi tjetër që do të zavendësonte Agimin në turnin e natës. Kurse ai që do të zavendësonte traktoristin nuk kishte ardhun ende. Agimi, posa la punën, shkoi në vijë të lante fytyrën, krahët dhe të pastrohej. Xhveshi këmishtën, u freskue me ujin e ftohtë të burimit që rridhte nga ana e bregut e binte në vijën e gjanë dhe plot ujë dhe mandej, nëpërmes gjelbërimesh, e çonte ujin në dredhëza e në liqen. Kur u la dhe u freskue shkoi te brigada e Qemalit dhe atje ku punonte brigada e tij. I gjithë ai bllok zjente nga punëtorët dhe asnjëri nuk shikonte tjetër gja përveç punës. Agimi vërente punëto-



rët që punonin dhe që lëviznin duert e tyne të forta dhe të shkathta. E atë çast mendonte e thosh me vete: «Çudi, të gjithë këtyne punëtorëve nuk u ndigjohet një gjysmë fjale, asnjëni nuk bisedon përveç kur e kërkon vetë puna të flasë; fjalët dhe bisedat ja kanë lanë punës». I shkoi mendja te një parullë, të cilën e kishte lexue edhe në sallë të leximit, në anën e kundërt të hyrjes. Ajo shkruente: «Nuk duem fjalë po punë», dhe ai mendonte se sa kuptimplotë asht ai citat i atij njeriu të mirë e të madh.

«Me të vërtetë mendonte ai — sikur të gjithë këta punëtorë të shikonin, të banin biseda, nuk do të banin punë aq sa kishin bamë, dhe me të vërtetë, atje ku ka fjalë shumë ka punë pak.

Brigadjerja, që po maste punën e kryeme, ju afrue fare afër Agimit. Kur u ndal, shkroi diçka në bllok.

— Agim, a u lodhe?

— Rinia nuk lodhet — u përgjegj Agimi i buzëqeshun.

— Ke ardhë që të shikosh të fejuemen? — e pyeti brigadjerja me shaka.

— Sigurisht, por këtu kam edhe të tjerë përveç të fejuemes, kam brigadën që ju ka ardhë në ndihmë, kam shokët e brigadës sime, shokët që punojnë në brigadën tjetër, shokun tim Qemalin. E shikon pra se unë s'kam vetëm të fejuemen por edhe sikur të vija për te nuk do të baja gjynaf, — i foli Agimi me seriozitet të shtirun.

— O, sa shpejt more qëndrim serioz! po hajde qesh një herë! — e ngacmoi ajo.

— S'kena ç'të bajmë, kur s'kena për çka të qeshim duhet të rrijmë serioz — dhe s'ju durue pa vue buzën në gaz.

— Mirë, mirë, po mos shko te e fejuemja, se do ta lesh pa punë, — shtoi brigadjerja, mbasi eci disa metra.

— Përkundrazi do të punojë ma tepër, — tha Agimi tue qeshë dhe mori drejtimin nga brigada e tij.

Nga fundi i bllokut po afroreshin kryetari dhe agro-

nomi. Ata vinin tue kontrollue dhe shikue mbjelljet që ishin bamë atë ditë dhe katër ditë përpara.

— He, Agim, si shkuen punët sot? — pyeti kryetari Agimin, kur u afrue bashkë me agronomin.

— Shumë mirë, shoku kryetar — u përgjegj ai i buzëqeshun dhe plot respekt.

— Po ai traktori i prishun a u rreguliu? — pyeti përsëri kryetari dhe ju afrue Agimit.

— Jo, shoku kryetar. Nesër në ora 7 të mëngjesit ai asht gadi. Po më duket se ju që të dy ishit kah traktorët, apo jo? dhe sigurisht do t'i keni pyetë ata para meje se si shkuen punët dhe kur rregullohet traktori.

— Po, ne pyetëm por beso dhe kontrollo, — tha kryetari dhe u përkul që të shikonte një fidan të mbjellun.

— Si t'u duk puna që kam ba sot, shoku agronom? Puna asht bamë shumë e mirë, por kujdes atje ku asht toka me kurriz... Që të tre, kryetari, agronomi dhe Agimi, ju afruen skuadrës së Ibrahimit. Ata ndalën te brigadjerja që po shënonte disa shifra në bllokun e saj. Bllokun e mbante të shtrimë në dorën e majtë, kurse me të djathtën shkruente. Kompasën e vinte mbështetun në trupin e saj. Ajo nuk i kish vu re që ata po vinin.

— Sa e kanë realizue normën sot, shoqja brigadie-re? — pyeti kryetari tue ju afrue; ajo e njohu menjherë zënin e tij dhe u përgjegj: — tashti po e baj hesap, — mori e bani shpejt e shpejt dhe i lexoi shifrat tue mos i nda sytë nga letra që kish shkruar:

— Mirë paskan punue. — E çka na thue ti për mbjelljet? — pyeti kryetari.

— Mbjelljet shkojnë shumë mirë dhe të gjithë punojnë pa u kursye. Sot më tha agronomi që mbjelljet të bahen me ujë. Kjo punë edhe mue m'u duk e mirë, sepse lagështina ka fillue me i ikë pak tokës dhe për të sigurue zanjen e duhanit pa firo po e lagim rranjë për rranjë.

— Po ujin kush shkoj për ta marrë atje në Dragoç?

— Ujin e ka marrë Hekurani. Ai ka shkue që në mbramje, ka punue gjithë natën tue mbyllë vendet

e çiluna që kanë kenë këtu e deri në vend. Gjithë natën ai ka punue tue ndenjë pa gjumë. Edhe tashti gjatë ditës ka qëndrue me punëtorët në mbjellje.

— I lumtë Hekuranit! Ai brigadën e tij do ta nxjerrë nga mbrapambetja. Sakrifikon gjithmonë për të mirën e përgjithëshme, ka çfaq vetmohim që në luftën partizane, në operacionin e dimnit, e deri tashti në drejtimin dhe përgjegjësinë që ka. Ai gjindet kudo; len bllokun, merr shatin, lopatën, çel vijën, merr dorcën dhe mbjell me punëtorët, atëhere si s'ka me përparue brigada e tij?

— Po mirë, shoqja brigadjere — ndërhyini agronomi — kur do ta mbuloni me dhe të butë vendin e lagun aty te rranja e fidanit?

— Këtë e kemi lanë për nesër nadje herët, sepse, po t'i hyjmë dhe ta mbulojmë tashti, ndalet mbjellja. Prandaj e lamë për nesër nadje herët, se natën asht fresk e nuk i ban gja. Kështu na tha edhe xha Selimi që ka qenë bujk me përvojë.

— Ndigjo, — foli agronomi, — përsa i përket mbulesës me dhe të butë duhet pasun kujdes të madh, sepse po të mbulohet keq, rrezet e diellit do ta thajnë lagështinën. Ajo mandej forcohet, bahet si tullë dhe atëhere bima ose thahet ose, për shkak të shtrëngimit, nuk zhvillohet. Më kupton? Ja, më shiko mue si po e mbuloj; megjithëse ti e di, unë po e baj edhe një herë. — Dhe agronomi filloi që të mbulonte vetë disa fidana duhani, të cilat ishin mbjellun herët. Megjithëse ishin lagun, rrezet e diellit i kishin ba që të vareshin pak.

— Më kuptove?

— Po, të kuptova, — tha brigadjerja.

— Nadje do të vini herët këtu? — pyeti agronomi.

— Posi, unë bashkë me ta do të vij shumë herët. Ti e di se fushata e mbjelljeve asht terr më terr. Kur të përfundojnë mbjelljet, puna asht me orar.

— Tashti e kemi shumë vështirë. Punëtorët lodhen, derdhen djersë; po djersa e madhe tashti duhet të derdhet, se kjo asht themeltarja... Ashtu asht —

ndërhyni kryetari; djersë, punë, lodhje, vullnet, sakrificë, të gjitha tashti duhen, fushata e ka këtë.

— Shkojmë te punëtorët?

— Shkojmë — pranoi brigadjerja dhe shkuen te skuadra e Ibrahimit.

— Puna e mbarë! — u thanë shokët që erdhën punëtorëve.

— Mbarë paçi! — u përgjegjën ata dhe u ngritën në kambë.

— Punoni, punoni! — u tha kryetari.

— Po a po lodheni në këtë fushatë? — pyeti përsëri kryetari kur hyni në mes të atyne që po punonin. Në atë moment asneni nuk ju përgjigjei, jo se nuk dinin, por të përgjigjeshin të gjithë nuk mirrej vesh. Qemali u ngrit në kambë dhe, kur pa se nuk po mirrte kush që të fliste, tha:

— Sidoqoftë në fushatë të mbjelljeve të duhanit kërkohet punë e madhe. E kur të bajsh një punë të madhe, patietër do të kesh edhe lodhje, por ne nuk ndiejmë lodhje, sepse nga lodhja që bajmë dhe djersa që derdhim sot në këtë fushatë mvaren të ardhurat nesër. Ne të rinitë nuk duhet të lodhemi.

— Kështu duhet, bravo ju qoftë! sepse, po të mos ienë punëtorët të tillë, atëhere me të vërtetë punët do të na lodhin — dhe kryetari i kënaqun i rrahu supet Qemalit. Pastaj ai uli kryet dhe ia filloi punës. Kryetari ishte i kënaqun, sepse të tilla fjalë, qoftë ai, qoftë sekretari i partisë, që kishte për kontroll givsmën e zonës, i kishin ndigjuar nga goja e shumicës së kooperativistëve. Ata vërenin Qemalin që punonte jo për dukje po sepse ashtu e ndjente. Shokët e kishin kaluar pak, por ky i dha vetes shpejt dhe i zuni. Aty erdhi brigadjeri i brigadës së perimeve, një burrë dyzet-vjeçar, me trup pak të shkurtër, fytyrë të gjatë dhe me disa vija që shkonin paralel me pjesën e sipërme të ballit. Sytë i kishte të thellë dhe ngjyrë gështenje, kurse vetullat me qime të gjata si të zbardhuna nga dielli. Ai ishte Marku. Dy brigadjerët, Mar-

ku dhe Bardha, po bisedonin bashkë me kryetarin dhe agronomin për punën e fushatës.

Kryetari kish dhanë urdhën që në bllokun ku do të mbillej bostani të punonin tanë natën pa ndërpreme dy traktorë. Kurse agronomi i tha Bardhës që të nesërmen punëtorët e spërkatjes duhet të spërkatin grunin me herbicid. Ata do të vinin të nesërmen në grunin e brigadës së saj, prandaj ajo të mirrte masat e nevojshme. Të caktonte një punëtor ose punëtores që nuk mbjell shpejt duhan, t'i mbushte fuçiat me ujë skuadrës së spërkatjes, të dërgonte një karrocë në brigadën e gjashtë të Golemit për të marrë fuçiat ku kish mbarue spërkatja dhe t'i binte në grunin e brigadës së saj. Mbasi biseduen edhe pak, kryetari dhe agronomi u nisën dhe i ranë përmes grunit tue vëzhgue efektin që kish bamë herbicidi. Atë parcelë gruni e kishin spërkatur para se të fillonte mbjellja e duhanit.

Dielli tashti kish kohë që kish perëndue. Vetëm mbrapa malit, atje ku ai humbi, retë, po merrnin edhe ato ngjyrën e hekurit të skuqun që dalngadalë e humb të skuqunin dhe vjen tue u nximë.

Muzgu i mbramjes filloi të përhapej. Mjegulla e hollë dhe e lagësht, që vinte gjithnji nga liqeni, nisi të afrohej. Skuadra e spërkatjes po kalonte tash atje në anën e grunit. Punëtorët me pompat e spërkatjes në shpinë dukeshin si alpinistë që po ngjiteshin majave të nalta të maleve.

Andej vinte duhma e randë e herbicidit, që lëshonte një erë të cilën njeriu i pamësuem s'mund ta durojë. Spërkatësit, megjithse ishte erë e randë, nuk e ndjenin, por kur afrohej ndonjeni që s'dinte se ata punonin në spërkatje, i habitun thoshte: «Ç'asht kjo erë, nga vjen? Duket si me kenë era e jodjos!» Në rrugë, atje në fund të bllokut, nga liqeni, ndigjoheshin blegërimat e qingjave të vonë, që kthenin nga kullota e livadheve. Herë ndigjoheshin blegërima të zakonëshme dhe herë ndigjohej blegërima e ndonji qingji që thërriste dhe kërkonte nanën e tij për qumësht. Blegë-

rima e tij e çjerrë ndihej nga larg si thirja e ndonji fëmije që në mes të një turme njerëzish thërret nanën e vet me atë zanin plot ankim. Ky qingj, që thërriste nanën e humbun në tufë, s'pushonte deri sa e gjente, dhe nana e tij, me të dallue zanin e kërthiut, e thërriste edhe ajo dhe mandej të dy gjenin njëni tjetrin.

Edhe qingji që asht kafshë e dallon zanin e nanës së tij, mandej vrapon nëpër tufë tue blegëruë. Posa e gjen, ulet në gjunjë dhe thith nga gjitë e saj qumështin e ngrohtë dhe të ambël që e ama i grumbullon gjatë ditës. Atje te qoshja e bahçes dhentë kthyen në stallat e tyne. Stallat ishin të ndërtueme me tara-ba dërrasash në vend të murit me gur dhe sipër qenë mbulue me zhavor kashte pylli. Afër tyne që edhe stalla e pulave që u kishte ra sëmundja e pseudopes-tit dhe i kishte zhdukë që të gjitha. Kështu që dhentë i kishin sjellë këtu, që të kalonin pranverën dhe verën, mbasi stalla ishte e përshtatshme për këto dy stinë.

Ndërsa po i futnin delet e tyne në stalla, çobanët shikuen punëtorët që deri atëhere punuen dhe po baheshin gadi që të shkonin. Mbramja kish ramë. Të gjithë grupe-grupe ecnin rrugës.

Faiku, që s'dinte ta mbante kurrë kangën sipas ritmit, filloi të këndojë. Sa e sa herë i kishin thanë shokët: «Si nuk u lodhe një herë bre?» Këndoi edhe Afërdita, këndoi Nurija, kënduen të gjithë. Ata për çdo natë këndonin kur kthenin nga puna, tamam sikur partizanët që ktheheshin nga fitorja. Vazhduen të ecnin me kangë në gojë deri sa hynë në fshat... Kështu i kalonin fushatat, netët... Ashtu porsi zogjtë që vijnë në pranverë nga vendet e largëta dhe megjithëse bajnë qindra kilometra fluturim, posa arrijnë te çerdhet e tyne të maparshme, pa pushue nga rruga që kanë bamë, fillojnë e cicërojnë, këndojnë për çerdhën e re që do të ndërtojnë mbi çerdhen e vjetër. Dhe harrojnë lodhjen e ja thonë kangës. Vetëm dembelëve u dukeshin këto mbramje të amullta, pa shije. Ata, ashtu sikundër në trupin e tyne, nuk mund ta dallonin e ta ndjenin përtëritjen as në natyrë.

## Pjesa e dytë

### 1

Kaluen disa ditë. Fushata e mbjelljeve të duhanit mbaroi para afatit. E para që e mbaroi këtë fushatë të madhe ishte brigada e katërt, ajo e Bardhës. Mbas saj e mbaroi brigada e dytë, që drejtohej nga Hekuran Shkambi. Katër ditë mbas mbjelljes u ba vlerësimi i fidanave të duhanit. Flamurin e kryesisë e mori brigada e katërt, që nuk e kish lëshue as edhe një ditë. Kurse atë të skuadrës ma të mirë e fitoi ajo e brigadës së katërt, që drejtohej nga skuadërkomandanti Ibrahim Asllani.

Atë mbramje anëtarët e grupit të estradës banin prova të vazhdueshme. Natën e parë, kur shkuen atje, Nazmiu u ndau tekstet dhe u caktoi rolet që do të luenin. Aty ishte edhe drejtuesi i muzikës që kish ardhun nga qyteti. Ish një burrë tridhetë e pesëvjeçar i gjatë e i mbushun. Ai të bante menjëherë për vete me sjelljen e tij plot thjeshtësi. U dha kangët solistave që t'i mësonin, banë disa prova tue i lexue e këndue kangët simbas roleve dhe natën e parë e mbyllën me aq. Natën e dytë të provave pothuej të gjithë i kishin mësue tekstet dhe, kur shkuen aty, sekretari i Partisë dhe Nazmiu mbetën shumë të kënaqun. I kënaqun mbeti edhe drejtuesi i muzikës, Kola, që ishte dirigjent i orkestrinës në estradën e qytetit. Atë mbramje ishte nata e katërt që po banin prova. Të gjithë ishin mbledhun afër lapidarit, mbi të cilin qenë skalitë këto fjalë: «Kë-

tu, në këtë vend, më 17.11.1946 u krijue Kooperativa nga 22 familje fshatare tue ju përgjegjun Thirrjes së Partisë». Aty afër disa pishave të reja ishin vendosun karrike.

Lapidari ndodhej në krye të rrugës që të çonte në kooperativë. Përpara tij vinin tri dyqane: një dyqan me artikuj ushqimorë, një tjetër në mes, me artikuj industrialë dhe një tjetër pak ma tej me rrobe e këpuçë të gatshme. Mbas lapidarit vinte salla e teatrit, e gjatë dhe me pisha përpara. Në ballë të kësaj rruge vinte zyra e kooperativës, ndërsa në rrazë të lapidarit shkonte rruga e fshatit që kishte anash shtëpi të reja, të sistemueme një mbas një dhe të rrethueme me pemë. Në të kundërt të lapidarit shtrihej bahçja e kooperativës. Dikur kjo bahçe e madhe, që gjindej në mes të fshatit, ashtu si dhe ato të tjerat larg fshatit, atje ku tashti janë stallat e pulave, ishin të zotnive të Shkodrës.

Salla e teatrit ishte e rregullt. Kishte dyqind vende për spektatorë. Skena ishte e zbukurueme. Në sallë të leximit, që vinte ngjitur mbas saj, kishte gjithfarë librash, romane të ndryshme, tekste për bujqësi, për kultivimin e duhanit, vitikulturë, tekste veterinarie, dhe të tjera. Të gjithë të rinjtë e fshatit, miq të këtyne librave, kërkonin çdo ditë libra të reja. Në të hymë të sallës qendra e zanit përhapte tingujt e radios nëpër altoparlanta të vendosun në çdo kand të stallave të kooperativës.

Kur kaloje sallën e leximit, rruga që ndahet nga oborri i madh, të çonte përmes stallave. Në të dy anët e kësaj rruge ishin radhitun stallat e lopëve, magazina e madhe, hangaret e duhanit, stalla e qeve, stalla e dhenve dhe në fund fare vinte stalla e kuajve. Vetëm stallat e derrave ndodheshin jashtë fshatit. Ato i kishin ba atje sepse kishin edhe kullotat në vënd.

Të rinjtë, që po rrinin në karrike, nën pisha, bisedonin dhe banin prova tue përsëritun tekstet. Posa erdhi nga qyteti, ku kish qenë për të blemë disa mate-



riale për estradën, Nazmiu hapi derën e sallës së teatrit. Hynë në dhomë ku liheshin materialet e pregatitjes dhe Meti mori fizarmonikën e filloi t'i binte. Ai prekte tastot e saj pa rregull, basat i rrihte pa kohë e i mbante shumë; fizarmonika lëshonte tingujt të vrazhdë që të vrisnin veshin. Qemali mori kitarën dhe filloi t'i stërvitte gishtërinjtë me të shpejtë nëpër tastat e saj.

— Lene, se na shurdhove; kur s'din me i ra pse e merr kot në dorë — i tha Ademi.

— Me të vërtetë, Met, lena ta ndigjojmë Qemalin, — i tha Tefiku.

— Atëherë Meti hoqi nga krahët rripat e fizarmonikës, e mbylli dhe e la sipër tryezës.

— Bjeri, Qemal, lueje të shkretën! — i thirri Gjergji i gëzuem, kur ndigjoi që nga jashtë tingujt e ambël të kitarës.

— Po Faiku nuk ka ardhë? — pyeti Gjergji tue shikue nëpër dekoret e skenës.

— Jo, ende nuk ka ardhë, asht jashtë, — i thanë të tjerët.

Të gjithë ishin ulun në karrike dhe ndigjonin Qemalin që po i binte kitarës. Kish mësue t'i binte në shtëpinë e kulturës së qytetit. Për një kohë të gjatë kishte shkue në qytet me biçikletë, deri sa e kish mësue mirë. Kurse Faiku kish mësue t'i binte fizarmonikës në ushtri dhe nuk i binte keq. Kur bashkoheshin që të dy, njeni me kitarë dhe tjetri me fizarmonikë, rreth tyne grumbulloheshin menjherë të rinjtë dhe ata rrinin tue këndue deri vonë. Në sallë hynë edhe vajzat, posa ndigjuen tingujt e kitarës. Mbas pak erdhi edhe Faiku. Pa mbërrir mirë aty, e banë që të kapte fizarmonikën. Faiku, për kangë nuk kundërshtonte kurrë. Ai i bante që të dyja, edhe i binte fizarmonikës edhe këndonte vetë. I përshkoi gishtrinjtë disa herë me radhë dhe mori një kangë nga ato të muzikës së lehtë. Kanga ma e preferueme e tij ishte ajo e «endëses». Ai e nisi, dhe Qemali fill mbas tij e shoqnoi me kitarë.

Të gjithë ndigjonin dhe shikonin të buzëqeshun.

E ndjenin veten të gëzuem dhe plot andje për me këndue...

Dhoma, në të cilën lenin rrobat dhe visheshin amatorët, ishte e gjanë. Në mes kishte dy tryeza të gjata dhe të rrethueme me karrike. Vetëm një dritare e vogël, që ishte nalt shtinte pak dritë. Po të doje të shihje nga dritarja jashtë nuk mundeshe pa hypun mbi një karrikë ose diçka tjetër.

Ajo ishte ba ashtu apostafat për atë punë. Dhomën e ndriçonin dy llampa elektrike. Në njenën anë ishin rreshtue djemtë dhe në anën tjetër të tryezës vajzat, kurse Qemali me Faikun qëndronin në mes.

Faiku vazhdonte të këndonte dhe t'i binte fizarmonikës dhe Qemali të mbante kohën me kitarë. Mandej hodhën valle popullore dhe çifte çifte.

Syloja, që po punonte atje mbas sallës së teatrit, kur ndigjoi kangë, fizarmonikë, mori shkallën dhe e vuni në dritaren e vogël që të shihte. Ai e hoqi qelshen e bardhë nga kryet sepse kishte frikë mos ta shifshin në rrezen që lëshonte drita elektrike. Megjithëse ishte plak, kishte qejf që të shihte të rinjtë që këndonin dhe vallëzonin. Ndërsa kqyrte nga dritarja, thoshte me vete: «Eh, kjo rini e shijon jetën, e jo si na dikur! Lene që s'dijshim të tilla gëzime, por as nuk mundeshim të bajshim kësi qejfi. Po sikur të kishim pasë, ndoshta edhe do të kishim ditë të bajshim njëfarë qejfi...»

Tuë thirrë: «Eh rini e shkretë që na shkove në të errët!» fshani me dhimbje. Kur fisarmonicisti lëvizte gishtrinjtë me shpejtësi, çiftet vallëzonin dhe tingujt e fizarmonikës që bashkoheshin me ata të kitarës dhe të solistit, delnin të ambël dhe me shpejtësi nga dritarja, gjysmë e hapun.

Syloja shihte se gjithçka para tij lëvizte me shpejtësi dhe dukej se gjithçka po kërcente, po këndonte. Atëhere edhe ky filloi t'i binte me duer murit të dritares, sikur t'i binte ndonji lodre dhe mundohej t'i mbante kohën kangës. Nganjëherë, kur harronte dhe i binte

fort, e ndalte dhe e shkundte dorën, sepse i dhimbte nga përplasja me murin e fortë. Nga mbrapa ndigjoi që po vinin disa të rinj. Me të pa këta, zbriti shpejt, kapi shkallën e shtrii rranzë murit dhe bani sikur po punonte. Atë çast Faiku e ndali kangën dhe me të shpejtë nisi një rumba. Qemali la kitarën sipër tryezës, i bani Afërditës me shenjë të afrohej dhe kërcëu me të. Mandej nisën nga puna.

— I keni mësue mirë tekstet? — pyeti Kola.

— Të gjitha i kena mësue, — u përgjegj Ademi.

— Atëhere të dalim në skenë dhe të fillojmë nga provat. Kaluen sa ditë me prova; asnjë provë s'duhet t'i ngjasi tjetrës, çdo provë duhet të jetë ma e mirë se tjetra. Erdhi koha, s'na mbeti veçse një javë... Kujdes, mos u ngutni... s'asht puna vetëm të harxhojmë ato fjalë që kena për me thanë dhe të dalim nga skena. Nazmiu të rrijë në vendin e spektatorëve dhe të na korigjojë për ndonji send, tha Kola dhe mori fizarmnikën dhe foli: Gati! — dhe skena u hap. Të gjithë ishin mbas dekoreve. Nazmiu kish zanë vend në mes të sallës.

Kur dolën në skenë, nga dera përkarshi u duk sekretari i partisë. Nazmiu pa fytyrën e tij të lodhun, flokët e gjatë, të zez, pak të shtrimë dhe trupin e naltë. Ish veshun thjeshtë dhe sa ma tepër që afrohej te skena kuptohej që vinte nga arat.

— Vazhdoni, vazhdoni, — foli ai me zanin e tij të trashë prej basi. Nazmiu, që po i shikonte nga mesi i sallës, solli kryet mbrapa, pastaj i bani spikerit me dorë të vazhdonte.

Sekretari u ul pranë Nazmiut dhe po shikonte me vemendje pregtitjen e çfaqjes. Ai sa ndenji aty herë qeshte me të madhe, herë vente buzën në gaz dhe fytyra i mirrte një shprehje të veçantë dhe shtangej.

Kur mbaruen programin, u ngrit dhe, mbasi thithi edhe një herë cigaren, e hodhi në kutinë e mbeturinave, uli kryet dhe foli:

— T'ju them të vërtetën çfaqja më pëlqeu, megjithëse ndoshta keni fillue ma përpara.

— Jo, njatherë sa filluem, — i tha Nazmiu, ndër-  
sa po ngrihej nga karrikja ku ishte ulun.

— Në ndonjë vend çaloni, për shembull në atë  
skeçin e dembelit; Meti, që asht brigadjer ngurron pak  
në të folun dhe disa fjalë i përsërit, kurse Agimi, që  
asht dembeli, megjithëse brigadjeri e ka gjetë fjetë  
nën hije, nuk ngurron aspak por flet qartë dhe i vendosun,  
sikur nuk ka ba asgja. Kurse në jetë ndodh ndryshe.  
Fajtorit i mirret goja e i ngatrohën fjalët, ndër-  
sa ai që e padit asht i qetë e i premë. Këtu duhet e  
kundërta. Meti duhet të jetë në të folun i qartë, i  
vendosun, sepse ai asht në rregull, kurse dembeli edhe  
duhet të justifikohet, se ai asht në gabim. Duhet kujdes,  
se nuk na ndajnë veçse shtatë ditë për të dalë në festival.  
Para se të dalim në festival duhet që të japim  
dy çfaqje këtu, në fshatrat që i kemi afër ose ku të  
keni qejf. Po deshët shkojmë edhe me maqinë se e  
kemi tonën. — Po, para së gjithash, do të shkojmë në  
Dragoç, se ata kanë ardhë vjet dhe kanë dhanë çfaqje  
këtu te ne, — foli Ademi nga skena dhe në dorë mban-  
te një letër që po e paloste.

— Mirë, — tha sekretari.

— Shoku sekretar — foli Qemali që mbante në  
qafë kordonin e kitarës dhe po zbriste nga skena.

— Urdhëno, Qemal.

— Në nëndorin e kaluem u ba festivali i kangëve  
dhe i valleve të fshatit dhe kur na mblodhët, ju na  
thatë që, në qoftë se e fitonim çmimin e parë, do të na  
çonit në ekskursion pranverën e ardhëshme. Pranvera  
erdhi. Sekretari ndigjonte dhe buzëqeshte tue shikue  
të gjithë pjesëmarrësit.

— Ja tashti, erdhi koha që të dalim edhe ne në  
festivalin e estradave të fshatit dhe kena besim se për-  
sëri do të fitojmë çmimin e parë. Po ti a do ta mbajsh  
fjalën e dhanë apo jo?

— Unë atë ditë mora angazhim para jush. Këtë e  
kena diskutue edhe në mbledhjen e organizatës dhe aty  
vendosëm. Mbasi të mbarojë mbjellja e duhanit do të  
shkojmë në Durrës.

— E bajmë edhe një provë tashti? — u tha Kola.

— Po, po, duhet ta bajmë edhe një, — tha Nazmiu. Të gjithë hynë në skenë dhe u fshehën mbrapa deko-reve. Sinjali ra dhe skena u mbyll. Mbas një çasti dy copat e kadifesë së kuqe u ndanë dhe në skenë u shtuen dritat elektrike. Mandej doli Afërdita, shikoi nëpër sallë dhe foli me za të ambël, me fjalë të qarta e me siguri. Sekretari ja kishte ngulun sytë kësaj vajze dhe çuditëj që kjo vajzë e turpshme, që nuk fliste as dy herë rreshtë, të kishte atë ton të theksuem në të folun. Fytyra e saj e bukur, fjalët e saj plot gjallni, i jepnin skenës një pamje edhe ma të bukur dhe atij nga për-shtypja dhe mbresa që po i lente ju duk si e pabesue-shme dhe e bani të mendonte. Sipari i dytë filloi të ngrihej nga poshtë nalt. Ai shëndriste me ngjyrën e tij të verdhë pak si të mbyllun. U ndigjue melodia e postjerit. Meti, i veshun si postjer, me një çantë në dorë, filloi kupletin satirik. Sekretari kënaqej nga ky kuplet i bukur dhe i spikatun mirë. Kur në skenë u banë katër vetë, Postjeri, Zylfija, Ceni dhe Zyberi ske-na u gjallërue. Hynë edhe të tjerët, dikush me kazmë dhe dikush me lopatë dhe filluen edhe ata të këndojnë.

Postjeri shpërndante letrat që u kish dërgue krye-sia atyne që s'dilnin në punë, dembelave dhe atyne që dilnin me vonesë. Mandej, kur u dhanë këtyne të treve lopatat dhe kazmat që të shkonin në punë, Zylfija, e inatosun, u tha atyne që po qeshnin me gjestet e saj:

— Pse qeshni? — dhe të gjithë u përgjegjën një-zani:

«Edhe ne në fshat punojmë, qeshim dhe këndo-jmë». Ky ishte edhe titulli i çfaqjes. Mandej e gjithë ajo turmë punëtorësh i mori dembelët përpara në punë dhe skena u zbraz.

Sekretari solli kryet nga Nazmiu dhe i tha:

— Mrekulli! Kjo asht hapja... apo jam gabim? —

— E mirë asht hapja. Paraqitjen e aktorëve me spektatorët e ka punue shumë mirë.

— Kush e ka punue? — pyeti sekretari.

— Këte e ka punue Qemali — foli Nazmiu pa i ndamë sytë nga skena.

— Po të tjerat? — pyeti përsëri ai.

— Të tjerat, që vejnë në lojë të metat e disa anëtarëve të kooperativës i kena pregatitë bashkarisht, kurse një pjesë tjetër vetëm Qemali; ndonji skeç e kena marrë edhe nga ato të shtëpisë qendrore të Krijimtarisë Popullore dhe e kena përpunue. — Sekretari solli kryet dhe shikoi nga skena. Në gjinin e këtyne kooperativistëve ai e ndjente veten të gëzuem. Ai kënaqej që kooperativistët dinë të punojnë, të ndërtojnë, të këndojnë, të lozin role edhe në skenë. Ai shikoi Afërditën që po zbriste nga skena dhe e çmoi edhe një herë hijeshinë e saj aty në skenë. Mbresa që i la ajo ende nuk i ishte hequn.

— Nazmi, na jep sonte fizarmonikën? — pyeti Faiku.

— Po mirë, o Faik, merre po të kesh kujdes — e!

— Mos ki dert për këte, — dhe mori fizarmonikën në krah.

— Shkojmë tashti, — tha Kola.

— Shkojmë, pranoi Nazmiu.

— E Kolë, si duken këta solista, e kanë ndopak vesh për këtë punë, se unë s'marr vesh nga kjo gja.

— Të them të drejtën, — tha Kola, — kur kam ardhë për të parën herë kujtova se do ta kem vështirë me solistat, por ndodhi e kundërta. Në nandorin e vitit të kaluem, — vazhdoi ai, përveç Faikut, të gjithë ishin të drojtur në fillim, e sidomos Afërdita. Asaj sigurisht duhet t'i kenë folë mjaft, se ajo me atë turp që kishte s'do të kish ardhun kurrë.

— Atë e ka bamë organizata e rinisë që të vijë patjetër — ndërhyri sekretari.

— Kur i dhashë tekstin e kangës që ta mësojë, ajo më tha se e dinte dhe me të vërtetë e dinte. Kështu më ndodhi edhe në provën e parë. Ajo u skuq në fytyrë e u ba si gjaku. Atëhere e lashë, fillova me të tjerët dhe në fund ja mora me fizarmonikë kangës së saj;

vetëm atëhere filloi të këndojë. Këndonte me krye të ulun dhe krejt e drojtun. Kurse tashti nuk asht aqë e turpshme si në nandorin e kaluem, asht ma e çiltë. Ka nji vesh të hollë muzike. Jam shumë i kënaqun nga të gjithë, sillen mirë me mue, më respektojnë.

— Po si çfaqje estrade në tanësi si asht?

— Mirë asht — tha Kola — dhe at çast mbërrinë te dera që të çonte në oborr. Pak përpara kish kalue Faiku me fisarmonikë që ecte tue i ramë. Atë e kishte futun në mes i gjithë grupi. Qemali po ecte me Afërditën. Ai rrëshqiste penën e kitarës nëpër telat e saj. Mandej filloi t'i bjerë kitarës dhe të shoqëronte këngën që këndonte Faiku, i cili ishte para tyne dhe po i priste shokët te rruga kryq. Të gjithë u mblodhën aty sipër urës ku ishte Faiku. Në anën e sipërme të urës ndriçonte rrugën llampa elektrike, së cilës ja prisnin pak rrezet degët e gjata dhe me hala të pishave. Ato lëviznin nga era e lehtë që i trazonte së bashku me hijet e zgjatuna dhe të zeza. Nën atë pishë u mblodhën të gjithë. Sekretari nuk desh t'i lejonte Kolën dhe Nazmin që atë natë të shkonin në qytet, por të rrinin mysafirë për darkë tek ai. Ata s'ndigjuen. Kola tha se të nesërmen do dilte herët në punë. Ata pranuen se do të vinin nji natë tjetër dhe, mbasi u përshëndetën, i uruen njeni tjetrit natën e mirë, u hypën biçikletave dhe morën rrugën për në qytet.

Edhe sekretari u uroi të rinjve natën e mirë, sepse ai e kishte shtëpinë para qendrës së kooperativës, kurse të tjerët ma tutje.

Djemtë donin të ndaheshin në tapalokun që ishte afër shtëpisë së Qemalit, ku rrinin dhe grumbulloheshin zakonisht të rinjtë mbramjeve. Ecën rrugës bashkë me gjithë vajzat. Faiku vazhdonte t'i binte fizarmonikës dhe të këndonte, kurse Qemali e shoqëronte. Kur u afruen pranë tapalokut që ndriçohet nga drita, ndeshën në disa fëmijë që po loznin. Tapaloku ishte me bar pak të rritun, afër ishte nji urë dhe nji hendek.

Mbasi u përshëndetën me vajzat, u ndanë. Ato shkuen në shtëpitë e tyne, kurse djemtë ndalën aty. Fëmijët, posa panë Qemalin me kitarë dhe Faikun me fizarmonikë, bërtitën të gëzuem: «Erdhi Faiku, Erdhi Qemali...» Që të shtatë u ulën në tapalok.

— Ndigjoni, në qoftë se ju doni të lueni, ikni në ndonji vend tjetër; në qoftë se doni që të rrini me ndigjue, ndigjoni dhe mos bani fjalë.

— Çka doni: me luejtë apo me ndigjue? — u tha Gjergji fëmijëve.

— Do të ndigjojmë, — u përgjegjën të gjithë njizani.

— Atëhere rrini pa fjalë!

Kanga përhapej nëpër fshat. Shumë të rinj, që ishin nëpër shtëpitë e tyne, erdhën dhe u mblodhën aty. Aty erdhi edhe Lec Doda, një djalë i ri e i paedukatë. Këtë vit ai kish hy në Kooperativë, kish qenë edhe në shkollë dhe për çrregullime që kish sjellun atje e kishin përjashtue nga shkolla. Posa erdhi aty, filloi të përzihej në kangë me Faikun. Gjergji që ishte ma i rrituni nga të gjithë, bile ishte dhe i martuem, i tha një herë Lecit që të pushonte, por ai nuk mori vesh dhe vazhdoi siç i thoshte mendja. Po tjetri nuk duroi; u ngrit në kambë dhe e nxori për krahësh jashtë atij grupi gazmor. Ai kundërshtoi dhe s'desh të ikte as me zor as me vullnet, por Gjergji ju kërcënue, e kapi për fyti dhe ai u detyrue që të largohej.

Afërdita, që sapo shkoi në shtëpi mori punëdoren, ndezi dritën e ballkonit, dhe, së bashku me nanën, motrën dhe vëllaun, e saj doli në fresk që të shlodhej. Secila bante nga një punëdore. Ajo e kishte të gjithë vemendjen e saj te kanga, te tingujt e kitarës që preknin zemrën e saj. Këndonte ngadalë dhe si nëpër dhambë ate kangë me tingujt të ambël. Herë-herë ndigjonte disa zana që i drejtoheshin Qemalit për t'ia marrë kangës «Moj e mira që mblodhe bletën», por ai nuk ndigjonte, sepse këtë kangë e kishin në programin e estradës.

Ai nuk këndonte kangë popullore as të muzikës së



lehtë, jo se ato nuk i pëlqenin por se nuk kish za, kurse kangët me çifteli i këndonte shumë bukur. Zani i tij u shkonte atyne kangëve. Po këte radhë dëshira që kishin shokët dhe kambëngulja e tyne e banë që të këndonte. Kangën që nisi shpesh e këndonte me Afërditën shoqënie me çifteli, por tashti kanga do të nisej me fizarmonikë dhe strofat që i këndonte vajza i mori Faiku.

Posa ja filloi Qemali, Afërditën sikur e theri diçka në zemër dhe u ngrit. Duke qepur ajo lëvizte duert në mënyrë të pavetëdijshme e të pakontrollueme, aq sa gjylpana befasisht ju ngul në mish dhe ajo nxori një «oh» që ju shkul nga zemra.

— Po pse ashtu, moj bijë? — i foli e ama, — kur mendjen e ke tjetërkund, pse punon me gjylpanë? Kaq fort u there? — e pyeti ajo me dhimbsuni dhe zgjati kryet që t'ja shikonte.

— Jo, nanë, nuk më dhemb.

— E, moj bijë, i riu si veriu, ti je e re dhe t'i ka marrë mentë muzika.

Afërditën diçka e banë me dyshue këto fjalë. Prandaj ajo tha me vete: A thue ka marrë vesh gja kjo?... Heshti e mendueme dhe tha përsëri: Po unë përse mendoj kështu? S'ka as një orë që u ndava nga Qemali. Ajo nuk e di se unë s'e ndjej fare tashti vendin e therun. Teksa mendonte kështu, grupi i të rinjve të fshatit s'u ndie ma. Si duket u shpërndanë. Tue shkue për në shtëpi Qemali shikoi nga dritarja e Afërditës dhe e pa atë që u ngrit në kambë. Shikoi nalt hanën, yjtë, që shëndrisnin, ndjeu freskinë që e ledhatoi sikur ta prekte dhe ju kujtue diçka... Pastaj solli kryet përsëri nga Afërdita sikur të donte t'i thoshte «natën e mirë».

Afërdita kishte dalë në ballkon dhe po vështronte rrugën, po Qemalin s'po e shihte. Qemali përshkoi penën mbi gjashtë telat e lirë të kitarës, që lëshuen njëherësh gjashtë tinguj të ndryshëm dhe vuni re në dritën e ballkonit se Afërdita buzëqeshi ja bani

me dorë dhe shkoi mbrenda si keç i trembun  
Kanga pushoi. Fshati u zhyt në qetësi. Të gjithë  
flinin. Afërdita u shtri në krevat, po për një kohë të  
gjatë i rrahu zemra si zog, se Qemali me kitarë i  
rrinte para syve dhe ajo i shikonte me symbyllë ças-  
tet ma të kandëshme të takimeve me te, deri sa e  
zu gjumi buzagaz.

## 2

Kryetari dhe Sekretari i organizatës së Partisë  
kishin dhanë urdhën që të gjithë pjesëmarrësit e  
grupit të estradës të punonin së bashku, me qëllim që  
kur, të jetë puna për prova, të mos ishin njeni në  
breg të liqenit dhe tjetri në Zall të Kirit, të mos vinte  
njeni herët dhe tjetri vonë, por kur të vinin të vinin  
të gjithë në një orë. Ditën e fundit, kur banë prova,  
ishte e shtunë dhe ate ditë e kishin vendosë që të  
bajnë prova edhe ditën e nesërme mbas dreke, mbasi  
ishin të lirë. Të nesërmen u mbloodhën në orën e  
caktueme. Erdhi edhe Kola që nuk e shkelte orarin  
kurrë, po vinte në ate orë që thoshte.

Provat shkuen për mrekulli dhe Kola me Nazmiun  
e ndjenin veten të sigurt dhe kishin besim që edhe  
me një provë mund të paraqiteshin në festival. Kur  
mbaruen provat, ata hartuen këtë plan: Ditën e hanë  
të kenë pushim, të mos bajnë prova. Të martën mbra-  
ma e caktuen që të jepnin çfaqje në njenin nga  
fshatrat e largëta. Nazmiu do të bisedonte me përgje-  
gjësat e vatrave të kulturës dhe, te ai fshat që do të  
ishte gadi për pritjen e tyne, atje do të shkonin. Kjo  
çfaqje do të ishte e potë, me të gjitha, tamam sikur të  
ishin para komisionit. Këto çfaqje do të ishin edhe si  
prova. Kurse të shtunën do të mobilizoheshin me të  
gjitha forcat dhe do të jepnin çfaqje para kooperativis-  
tëve të tyne. Të dielën e ardhshme do të banin edhe  
ndonji provë dhe, në qoftë se s'ishte nevoja, atë ditë  
do të pushonin dhe të hanën do të jepnin çfaqje për-

sëri në sallën e fshatit të tyne, ku do të bahej festivali dhe do të ishin edhe konkuruesat e kooperativave të Lokalitetit Qendër.

Kola i porositi që të merrnin të gjitha materialet e nevojshme për çfaqje; rrobot, ndonji skenë të lëvizshme e të tjera. Të gjithë do të mblidheshin në ora tre mbas dreke, sepse në orën tre e gjysëm do t'i hypnin maqinës dhe do të shkonin për në fshat.

Të gjithë ishin në një mendje. Mbas kryen punë, disa shkuen në qytet dhe disa të tjerë ndenjën në shtëpi, që të kryenin ndonji punë. Të nesërmen u kish thanë brigadjeri i blegtorisë që së bashku të shkonin e të mblidhnin sanë në pyll. Të gjithë u gëzuen, sepse kishin qejf të mblidhnin sanë atje.

Të nesërmen lindi një ditë e bukur. Punëtorët u banë gadi që të shkonin në punë. Kishte kohë që fushata e mbjelljeve të duhanit kish përfundue. Duhani po rritej. Edhe grunit të gjelbër filloi t'i dalë ngjyra.

Atë mëngjes Agimi kish marrë çiften e tij që rrugës, nga të shkonte, të gjuente sorra apo ndonji shpend tjetër grabitqar, me qëllim që t'i plotësonte ato pak pikë që i kishin mbetur. Bashkë me Qemalin dolën ma herët se shokët dhe shoqet e tjera. Morën sfurqet, ushqimet e drekës dhe u nisën për në livadhe. Kaluen fshatin, i ranë anës grunit të Balijeve dhe, posa kaluen atë fushë, kapërcyen një kanal kullues, mandej u futën në barin e livadheve të Lugut, kapërcyen vijën e lugut nga një urë që ishte ndërtue për të kalue bagëti dhe qerret apo karrot e ngarkueme me sanë. Gjysma e livadheve të lugut ishte kositun. Aty këtu ishin kapat e sanës të mbledhun si mullar. Para tyne, rrethue me një brez shelqesh, ishte stalla verore e lopëve. S'kishte as katër ditë që të gjitha lopët dhe kuajt ishin shpërngulun nga stallat e kooperativës dhe kishin ardhun këtu. Disa mjelëse me grykëse dhe me shami të bardha po lanin bidonat e qumështit me ujët që rridhte nga çezmja. Selimi po lëshonte kuajt. Në dorë mbante ushqimin e tij të varun në një shkop të zbukuruem,

kurse në dorën tjetër mbante një çifteli, të cilën e mirrte gjithkund mbas vetes dhe hiqte me te mërzinë atje në livadhet e parapyllës.

Posa i lëshoi kuajt, mazat dhe hamshorët e rritun që vraponin nëpër livadh tue ngacmue njeni tjetrin dhe tue hingëllitun dhe hedhur shqelma, Selimi nuk mund t'i komandonte ma, sepse ata turreshin me vrap të shpejtë sa që po t'i vije re thojshë se po të shtypnin me shkelma. Toka ushtonte nga shkelmat e tyne. Morën drejtim andej nga pylli. Agimi dhe Qemali mbrapa tyne lanë stallat e lopëve dhe livadhet e Lugut, të cilat nga fundi ishin të gjitha të kosituna. Filluen të hynin në livadhet parapyllës. Aty, me anën e një ure të drejtë, të cilën e kish rregullue Selimi, këputën vijën e Gallatës. Kësaj i thoshin vijë, por ajo ishte katër metra e gjanë dhe dy metra e gjysëm e thellë. Ura mbahej në dy trarë të trashë që nga njena anë e vijës në anën tjetër të saj. Aty ishte rrëzue një shelg me trup të gjatë dhe të trashë. Kurse në anën tjetër ishin dy shelgje të rrituna fare buzë bregut dhe rranjët e tyne s'e kishin lanë dheun që të shkasë poshtë. Këtu ishte pika ma e ngushtë e vijës. Vija anash ishte me nga dy ose tre rreshta shelgjesh që e shoqnonin ate që nga fillimi deri atje ku futej në liqen. Shelgjet mbijnë vetë kudo dhe sido. Por dora e njeriut gjithnjë i ka premë, i ka shkulë dhe i ka lanë që të rriten dhe të mbillen në rregull. Në livadhet para pyllit kishte shumë kanale kulluese të cilat shërbenin për të kullue tokat e lagështituna. Çdo kanal kishte në të dy anët e tij shelqe të rreshtueme një mbas një. Trupi i tyne në disa livadhe ishte i mbuluem prej thanave të egra që ishin të shpeshta, me thupra të holla, të gjata dhe me lëkurë të kuqe. Gjethet e shpeshta në fillim vinin të rrumbullaktë dhe puplore.

Kishte edhe verdhëza, të cilat nganjherë rrite-shin të gjata sa shelgjet, po zakonisht i gjeje të shtrimë për tokë e me degë të gjata, me gjethe pak të ashpra por shumë të gjelbra.

Nëpër to gjindesh edhe sallgami i egër, që nuk rritej si ai i buti. Ai ishte i shkurtën, as gjethet nuk i kish si gjethet e sallgamave të butë, por ma të shpesh-të, ma të vegjël dhe ma të imtë.

Këto të gjitha gjindeshin të përzieme me njena tjetrën dhe formonin gardhiqe të gjata në anë të livadheve, ndanin livadhet në katrore dhe mjerisht zenin sipërfaqe të madhe toke të mirë. Në mes tyne rrite-shin barna të gjata, që çelnin lule të bukura. Sipër këtij gardhi nxirrte kryet kuqja, siç i thonë fshata-rët; si një çadër e kuqe, ajo hapte degët me lule dhe shëndriste. Në anën e tyne rritej kastravec, speci dhe shalqini i egër.

Ndërsa po kalonin urën, Qemali shikonte gjithçka që e kish para syve dhe i foli Agimit:

— Nji njeri që nuk e njeh këtë vend bahet romantik, kur shikon nalt qiellin e kaltër, gjelbërimet, lulet shumëngjyrëshe që rriten anës vijave e që shkojnë në nji drejtim dhe vetëm sa mbulojnë trupin e shelgjeve.

Flladi i freskët i nadjes të sjell ajrin e pastër plot aroma lulesh dhe zanat e zogjve. Posa të zbresish nga kjo anë, e ve kambën në lulet e bukura të likajve, që janë të mbushuna me polen të verdhë dhe japin nji shkëlqim të ndritun nga uji i bollshëm. Sa të vjen keq kur je i detyruem të shkelish atë njomësi dhe ato lule, sepse natyra me skalitjen dhe mjeshtërinë e saj ka krijuar kaq gjana të kandshme, tërheqëse, të bukura dhe të qeta...

Ai pa zogjtë që këndonin mbi çerdhen e tyne. Mandej, si plumbi e çau ajrin nji sqifter dhe u lëshue mbi dy zogjtë, që, me të pamë ate, u futën në çerdhe. Qemali bani gadi çiften. Njeni zog, që ishte i fshehun nën çerdhe, doli sipër për të shikue se mos u largue anmiku dhe menjherë hyni përsëri nën te. Qemali kish ndenjün gadi për qitje.

— Çka don me gjuajtë, Qemal? — pyeti Agimi.

— Nji skifter — tha Qemali, shikoi Agimin dhe

përsëri solli kryet në pozicionin e maparshëm. Por shpendi nuk kish kohë të bisedonte, hyni nën çerdhe dhe në çast u ndigjue cicërima e tij vajtuese. Qemali priti sa të dilte nga ai vend mandej të gjuente, sepse po të gjuente aty, çerdhja do të hidhej me gjithë zogjtë. Posa skifteri doli, Qemali e qëlloi me të parën por ju duk se ate nuk e kapën asnji nga saçmat dhe e gjuejti me të dytën. Skifteri lëshoi zogun dhe mbas pak ra dhe ai. Zogu mezi shkoi deri në shelgje. «Sa gjana të bukura, të kandshme, tërheqëse e të qeta aq edhe të shëmtueme, të pakandshme, grabitqare dhe të tmershme ka krijue natyra» tha Qemali me vete tue shikue përreth; por natyra përsëri ishte e qeshun ashtu si ma parë dhe, ndërsa ai shkoi të mirrte skifterin e vramë, sikur u pendue për atë që tha.

Mbasi solli skifterin e vramë, ua dhanë kambëve dhe ecën përsëri nëpër livadhin e pakositun. Vesa nuk kish avullue ende dhe shëndriste kudo bashkë me ngjyrën e luleve të livadheve. Shkuen anës barit të shkelun nga disa kambësorë që kishin kalue para tyne, përshkuen livadhet me gardhe të ndame dhe dolën para pyllit. Para tyre shtrihej pylli i Rranzë, kështu i thoshin fshatarët atij pylli të dendun me drunj kallamishteje, rrogözë, xhavare e të tjera. Ky vend gjatë stinës së dimnit mbulohej i gjithë nga uji. Gjatë pranverës uji niste të largohej. Dalngadalë, aty nga mesi i verës, atje nuk rrinte ma asnji pikë uji. Fshatarët gjatë verës nxirrnin dru dhe materiale të tjera.

Mblodhën sanë dhe e shtruen që të rrinin në te, sepse toka ishte me lagështinë. Të dy hangrën mëngjesin dhe prisnin që të vinin shokët dhe shoqet. Kostarët erdhën. Ata u ulën nën hijen e një shelgu të madh nën të cilin kishin pushue çdo ditë, që kur kishin fillue të kositnin. Posa u ulën hangrën mëngjesin dhe morën të rrifnin kosat e tyne. Mbështetnin tehun e mprehtë në kudhrën e vogël të ngulun në dhe dhe me çekiçin e lëmuem në të dy anët e rrahjes rrihnin kosat. Të trokitunat e tyne kishin një ritëm të çrre-

gullt; posa kërciste njeni, ja priste tjetri... Mbasi i rrafën, u ngritën në kambë, pinë nga katrovet dhe bucelat nga dy tri gllanka ujë, i ranë tehut të kosës edhe një herë me grihën e zmerilit, e futën atë në kutinë që e mbanin mbas vetes dhe mandej mbështetën kosat për shelgjesh.

Punëtorët filluen të zhvisheshin. Të gjithë ishin burra të pjekun. Ma i vjetri në të gjithë ishte Zeqiri. S'asht për t'u besue, por ishte plak shtatdhetë vjeçar dhe punonte me kosë. Edhe fshatarët çuditëshin për shëndetin dhe forcën fizike të këtij plaku që s'e kishte lëshue ende rinia. I pari që doli nga hija me kosë në dorë ishte Zeqiri. Ai ishte zhveshun dhe kishte dalun në brekë, që i binin deri në gju; ai nuk i bante ma të shkurtna, sepse ishte plak dhe ende e mbante pak ajo fryma e vjetër. Mbas tij dolën edhe kostarët e tjerë. Zeqoja, Zeqo e thërrisnin të gjithë e jo xha Zeqo, sepse ai nuk ishte për t'u thirrë xha Zeqo nga që ishte edhe ma i fortë se të rinjtë, u printe të gjithëve në kosë. Edhe kur mblidhnin kostarët ma të mirë të kooperativës për të kositë ndonji livadh me bar të rrëzuem, që ishte vështirë për t'u kositun, i pari në të gjithë ishte Zeqiri. I mësonte të rinjtë të kositnin me teknikë ma tepër se sa me forcë. Zeqiri, që printe i pari, kish zhveshun këmishën dhe shpina, që kish fillue t'i rrihej nga dielli, i shndriste bashkë me kryet e zbardhun e të thinjun. Të gjithë ata që kositnin e lëviznin trupin e kërrusun nga kosa, kurse Zeqiri kërrusej fare pak dhe s'i jepte ashtu me trup si ata. Ai mundohej që t'u mësonte teknikën e tij edhe shokëve, por ata nuk mundnin kurrë të banin si ai.

Kur kryen radhën e parë, të gjithë u rreshtuen nëpër vende, ngritën tehet, nxorën grihën nga kutia e llamarinës dhe filluen që t'i mprehin edhe një herë. Në këte kohë po vinte Selimi.

— E, more Zeqir, deri kur do t'ja lesh rinisë?

— E, deri sa të plakem... — u përgjegj Zeqiri.

— Po pse, o Zeqir, hala nuk u plake ti? Unë të kam pasë thanë se s'mundesh edhe një vjet, kurse ti

po kalon katër qysh prej asaj dite. Si e ke vu në tezezi do të plakësh edhe një grue tjetër — foli Selimi tue ngritun zanin dhe tue bamë shaka.

— Po s'do të thotë gja ajo, — tha Zeqiri — i fortë jam hala, i pashëm jam diçka, flokët i kam të tanë, megjithëse i kam të bardha, po kjo s'ka randësi; po ashtu edhe dhambët i kam të gjithë në gojë. Po çka don tjetër? Me qitë pushkë e përlej venë. Edhe i hajrit e për shtëpi jam. Sa për një grue, e mbaj si edhin<sup>1)</sup> në dërrasë, «ha,ha,haaa»... qeshën të gjithë me të madhe. Aty erdhi dhe Qemali me Agimin.

— Epo dhambëve nuk ju besojmë, i ke të huejt e s'janë të tuet — i foli Selimi që sa u ul në sanë.

— Puna e mbarë, shokë!

— Të mbarë paçi — ju përgjigjën të katërt.

— Po ju, Qemal, çka po punoni? — pyeti Zeqiri.

— Do të mbledhim sanë — u përgjegj Qemali.

— Atje fillonja, afër rrugës së pyllit, se atje kena kositë ditën e parë, — dhe tregoi me dorë vendin ku kishin kositun një ditë përpara.

— Zeqir, ma lësho një herë kosën mue — i tha Qemali.

— Po, mor, posi, prij ti përpara Caf, kurse ti, Qemal, rri i fundit, — i tha Zeqiri dhe kostarët hynë simbas radhës. Kosa e prente barin deri në rranjë, e mirrte mbarë, mandej e mënjanonte në një anë. Qemali i jepte kosës me sa fuqi që kish. Po, kur i dha disa herë e desh të shpejtonte, ju ngul maja në tokë. Atëherë e mori kosën Zeqiri dhe i tha:

— Më shiko mue! — Dhe Qemali e vrente me kujdes Zeqirin se si i jepte kosës, ja shikonte muskujt që i kishte tanë gunga dhe me vija. Kur i takonte kosës që të priste ndonji shtëllungë barë të ngatërruem, Zeqiri i jepte me forcë dhe vizat e muskujve u banin ma të denduna dhe ma të thella. Kur e mori Qemali kosën

---

1) edhe — keçi; e mbaj si edhin në dërrasë, shprehje popullore, që do të thotë e mbaj mirë.



përsëri, e rregulloi dorën. Zeqiri i shkonte mbrapa dhe nganjherë i thoshte: Jo ashtu! ti rri në mes të redit, trupit mos i jep herë andej, herë këndej, se ashtu e lodh vetën. Ai mundohej të shkonte ashtu si i thosh Zeqiri, por e kishte të vështirë ta bante si thosh ai.

Në fillim dhe deri në gjysmën e redit e pati të vështirë, por ai nuk hoqi dorë deri sa erdhi duke e përmirësue nga pak. I doli në fund të rendit, i kërkoi Zeqirit grihën që të mësonte dhe të mprehte kosën, megjithëse nuk kishte ndonji vështirësi. Zeqiri ja dha dhe Qemali filloi që ta mprehte atë ngadalë e mandej ma shpejt.

— Ma ngadalë, se po pret duert, — i tha Zeqiri, dhe me të vërtetë gadi i ndeshi gishti në tehun e kosës, ndërsa i jepte grihës herë nën teh dhe herë sipër. Ndërsa ky po e mprehte, kostarët filluen dhe kaluen pak para tij, atëhere Qemali bani përpjekje që t'i zajë ata, Rendin e dytë e kositi ma me lehtësi se të parin dhe gjithnji mundohej të punonte siç e këshillonte Zeqiri. Ai kositi redin e tretë, të katërt, të pestë por mandej ja dha kosën Zeqirit, se filloi të lodhet.

### 3

Nga larg u dukën tek po vinin edhe shokët e tjerë. Në sanë nuk zbatoheshin orari, sepse sana e thatë e ndjen lagështinë; kur të avullohej e gjithë vesa atëherë mbledhesh ajo. Qemali i tha Agimit të shkonin te shëlgjja ku kishin lanë ushqimin dhe sfurqet. Të dy shokët shkuen atje ku thanë. Dielli ishte ngritur dhe hijet e shpeshta të shëlgjeve po zvogëloheshin gjithnji. Shokët dhe shoqet e tyne po afroheshin. Meti, me zarin e tij të përcartë, po këndonte një kangë të vjetër shkodrane, nga ato që i kish për zamat Zeqiri e që i këndon Bik Ndoja; kangën e «Kalasë së Shkodrës».

«O o o, se 'çpo punojshin tre vëllazën». . . Dhe aty ku duhej zgjatun, ju mirrte zani si i ndonji gjeli të keq.

Mandej u ndigjue zani i Tefikut që i tha:

— Pllakën e ke të mirë, po ndërroji gjylpanën se po ta gërvisht. — Të gjithë qeshën, por atij s'ju bante vonë dhe ashtu vazhdoi deri sa gadi i doli gurmazi.

Selimi, që po e ndigjonte atë, i tha me za të naltë:

— O, lene, he të lumtë! — dhe ja dhanë gazit të gjithë kostarët e dy shokët që ishin nën shelgje.

— O Selim, a han ai qen, a ka nevojë me u lidhë?

— Jo, jo, nuk han, asht i butë.

— E po qejfi kur të vjen nuk të pyet për nadjen, — tha tue qeshun Cafi. Grupi që po vinte, doli nga katrorët e livadheve të vogla, të rrethueme dhe të ndame me gardh në një livadh të madh dhe të kositun.

Të gjithë ecnin tue bisedue e tue qeshun. Në krye ecte Meti. Në krah mbante cfurkun dhe në majë të tij kishte varun çantën e ushqimit. Në kokë mbante një kapelë kashte me strehë të madhe rreth e rrotull, për ta mbrojtë fytyrën nga rrezet e diellit. Pas tij vinte Suada dhe Afërdita, që kish hedhun cfurqet në krah, njena në të djathtin dhe tjetra në të majtin.

Që të dyja mbanin me nga një dorë katrovën e ujit të pishëm; megjithëse aty kishte burime, uji i fshatit ish ma i mirë.

Të tjerët vinin mbas. Në çast vunë re dy shokët që kishin ardhun para tyne.

— Nadja e mirë, o shokë!

— Mirë se vini!

— Ndigjoni, foli Gjergji, — të hamë bukë dhe të mos vonojmë, se sana edhe pak bahet gati për me u mbledhë.

— Po, po, të hamë shpejt dhe të punojmë tashti sa nuk ka fillue të nxehtit, ndërhyri Tefiku.

Qemali qe mbështetur në trupin e trashë të shelgut dhe ngacmonte dhambët me një fije sane.

— Agim, hajde të hamë bukë, — i thanë shokët.

— Kena hangër bukë, ju bafë mirë.

Nga grupi i vajzave u ngrit Afërdita me një letër në dorë, ajo e la ate para Agimit dhe Qemalit dhe u tha:

— E keni prej grupit.

Agimi hodhi sytë në letër dhe pa dy copa byrek të ndamë në madhësi të barabarta dhe mandej foli:

— Si the ti, Afërditë?

— Urdhëno, — u përgjegj Afërdita.

— Si the, e kemi nga grupi këte?

— Po, prej grupit e keni.

— Po pse, grupi juej e ka ba këte?

— Po...

— Jo besa, more Agim, atë e ka ba e fejuemja jote po e ka porositë Afërditën që t'i thotë se e kemi prej grupit — tha Nurija.

— Me të vërtetë Suada? — pyeti Agimi të fejuemen.

— Po haje një herë, se s'ka randësi ajo.

— Nuk ma japin mue që s'bjaj za por ta japin ty — foli Meti që ishte në të kundërt të Agimit.

— Mor ty po ta ha dreqi në bark, — i tha Nurija.

— E po ta ha një herë, ta hedh në bark, mandej le ta hajë dreqi, s'ka gja. Po leni pak për mesditë, mos e mbaroni — foli Meti me një ton hem si tallës hem si porositës.

Kur fliste Nurija, të gjithë kënaqeshin, sepse kjo s'i linte me luejtë gjurmën dhe, kur ishte puna për shaka, kishte një natyrë që i jepte shumë seriozitet.

Si hangrën bukë, u ngritën, mblodhën plaçkat, i varën për një degë shelgu dhe mandej u banë gadi që të punonin.

— Ndigjoni, — foli Qemali, — Zeqiri na tha që të fillojmë andej kah rruga e pyllit, se atje kanë kositë ditën e parë.

— Mirë — pranoi Gjergji, atje po shkojmë, por këto orë pune t'i bajmë orë sulmi.

— Po, ashtu do të bajmë, — pranuen të gjithë. Pinë ujë nga katrova e freskët, mandej hodhën cfurqet në krah dhe shkuen atje ku do të mblidhnin sanën. Të gjithë u rreshtuen sipas redave të kosës. Redi i kositun kish fillue të gjelbëronte përsëri fije të holla, të

reja dhe dukej si një krye i qethun me brisk që një herë zbardhon si patate, ndërsa mbas disa ditësh e humb ngjyrën e bardhë të kokës dhe merr ngjyrën e flokëve të maparshme që fillojnë e rriten.

Redat e sanës ngjyrë kashtë të thatë, të radhitun njëni mbas tjetrit, nga një hap e gjysmë larg, duke-shin mbi tokën e gjelbër sikur mbi këte livadh fryntë erë dhe ngrinte dallgë deti plot shkumë. Toka dhe bari i lagështitun avullonin bashkë me sanën e thatë dhe kundërmonin erën e bukës së grunit të posadalë nga furra.

— Fillojmë, shokë — u tha Gjergji shokëve dhe shoqëve të tij kur mbërrinë në vend.

— Fillojmë, — u përgjegjën të gatshëm shokët e tjerë. Atëherë Gjergji nguli cfurkun në palën e sanës dhe filloi ta mblidhte në grumbuj, mandej vazhduen edhe të tjerët, djem e vajza. Sa bukur dukeshin të rinjtë kur punonin! Ja ngulnin cfurkun sanës, e ngrinin pak nga toka, e shtynin ma tej e ja ngulnin përsëri edhe palës së dytë, pala dyfishohej, trefishohej dhe mandej me forcë ja ngulnin edhe palës së madhe dhe e bashkonin me atë të shokut që kishin në të djathtë. Rreshtat e sanës së kositun i banin grumbuj të mëdhenj. Mbasi banë disa të kthyeme, i lanë ato reda që hija e shelgjeve nuk i kishte lëshue ende dhe dolën në livadhin tjetër. Kur kapërcyen kanalën e vogël kullues dhe dolën në livadhin matanë, Gjergji e shikoi sanën dhe tha se ajo kishte nevojë të sillej, sepse ai livadh ishte kositun një ditë mbas të parit. Gjergji, për t'i nxitë ata ma tepër, kaloi para dhe u tha:

— Hajdeni, lueni pak duert, a e shikoni se ju kalova?

Atëherë të gjithë punuen shpejt për të mbërrir Gjergjin dhe, të thoshte mendja, se po ja ngulnin cfurqet njëni tjetrit në kambë, aq afër ish-in. Ai kujtoi se me ta zanë, ata do ta ulnin ritmin e punës, por s'ndodhi ashtu.

Kostarët hodhën kosat në krah dhe shkuen nën

hije që të rrihnin tehet e kosave dhe të pushonin pak. Hija në këtë kohë, ishte e nevojshme, sepse dielli kish fillue të nxejë.

Filluen me mbledhë sanë edhe në livadhin tjetër që ishte i vogël. E mblodhën me të shpejtë atë livadh dhe mandej shkuen të pushonin nën hije. Prinin sa ta përthante dielli sanën e sjellun. Ata që nuk e kishin mbledhun grumbuj-grumbuj do ta mblidhnin dhe do ta banin kap (mullar të vogël), kurse këte që sollën ma parë, do ta mblidhnin grumbuj. Porsa shkuen, u freskuen në ujin e freskët të katrovës, e cila e kish mbajtur ujin të freskët, sepse e kishin mbulue me bar të njomë.

Pushuen pak edhe u ngritën përsëri. Shkuen atje ku filluen në mëngjes për të parën herë. Mblodhën sanën që ishte nën hije e që e kishin lanë pa mbledhun dhe mandej e banë kapa.

Kështu punonin, njeni vinte tjetri shkonte, dhe kapat baheshin shpejt e shpejt. Qemali e ndërroi cfurkun me ate të Afërditës, sepse cfurku i tij ishte ma i mirë dhe kapi me te një grumbull, e vendosi sipër të dytit, mori një të tretë dhe e hodhi sipër të dyve. I ra një herë sipër me cfurk, me qëllim që ta ulte pak, se kishte arritur gati gjatësinë e tij dhe me forcë ja nguli në mes gjysmës së tre grumbujve; mandej me një hov tjetër e ngriti nalt. Maja e atij grumbulli sane mbërrinte naltësinë e shtatit të Afërditës. Kur e pa ajo u çudit për shkathtësinë dhe fuqinë e Qemalit. I shikoi muskujt e tij të dalë e të fortë dhe buzëqeshi e kënaqun që Qemali kish gjithë këte forcë. Për të mos ramë në sy se po e vrente aq shumë, mori një grumbull sane, edhe një tjetër bashkë me gjysmën e një të treti dhe punoi atje afër tij.

Filluen me ba kapën tjetër, po Gjergji mezi e mbërrinte me cfurk majën e saj. Puna ecte me një ritëm të shpejtë. Dielli ishte ngritur nalt dhe po i afrohej zenithit. Punë kishin bamë boll, pothuej e kishin tejkalue normën.

E si të mos banin punë ato krahë dhe ajo forcë që e çonte kapën të gjithë përpjetë me një të ngritun cfurku? Punëtorët nga të nxehtit e diellit dhe të punës ishin djersitun, po asnjani nuk e ndalte hovin. Vetëm mbas shumë kohe kostarët e lanë punën, morën edhe kosat dhe shkuen në hije. Aty, mbasi pushuen pak dhe ndejtën sa të kalonte të nxehtit, u ngritën që të freskoheshin në vijën e ngushtë të ujit që kalonte afër tyne. Dikush pyeti për orën.

— Dymbëdhetë — tha Meti që e kish mendjen vetëm te pushimi.

— Mirë, po pushojmë — tha Gjergji dhe nguli cfurkun në tokë. Të gjithë u çuditën se sa shpejt shkoi ora dymbëdhetë.

— Po ju, mor shokë, ku po shkoni të gjithë? — tha Tefiku që s'e kish marrë vesh ende se kish zanë mesdita, — hajdeni, se na s'kena ba gja punë. Solli kryet mbrapa dhe, tue pa gjithë ate punë që kishin bamë, numëroi kapat. Pa edhe dy livadhet e tjera që gati i kishin përfundue dhe tha: «Këte s'vonojmë me e krye mbas dite, bile i japim fund herët». Nguli cfurkun në tokë dhe u drejtue nga shokët.

U freskuen në ujin e vijës dhe erdhën përsëri te vendi ku pushonin. Njeni propozoi që të shkonin të laheshin në liqenin që vinte andej pyllit, por të tjerët i thanë se ish ma mirë të pushonin. Edhe ai hoqi dorë. Dy të rinj dolën nga hija dhe morën nga një krah bar të kositun për t'u ulë dhe ndenjën në te.

U shtruen për bukë të gjithë së bashku. Hangrën me shije dhe kohën që u mbeti e kaluen me të qeshuna. Mandej ranë të flinin pak. Kostarët, që po pushonin ma andej, po hanin bukë. Ata pyetën Cafi që ishte ma i riu ndër to: «Po ç'kanë ata që s'pushuen të qeshunit qysh se janë ulë?»

— Epo ba me kenë ti aty ndigjon gjithfarë qyfyresh, janë mbledhë ata ma të kulluemit e kooperativës — u përgjegj Cafi.

— Po kush janë ata? — pyeti Zeqiri.

— Janë ata të estradës, që nxjerrin gojën vesh në vesh. Do t'i shikosh kur të japin shfaqjen në kooperativën tonë.

Ndigjo ç'ka i ka ba Qemali Sadik Lanit: Tash nja tri katër vjet, kur Qemali ishte shumë ma i ri. Ky, së bashku me Agimin, Fatimen, Hajrijen, Lejlanë e Shabanit dhe Zyhranë e Velisë, që asht si fuqi vene, shkojnë afër vendit ku rrinte Sadiku. Ai ishte roje bostani po edhe vjelte. Nji ditë ulet Sadiku e merr nji pjepën të madh dhe e ndan në thela të trasha. Ai asht tepër i turpshëm e i dridhej dora ndërsa i priste thelat para vajzave; për me qenë i drejtë i thotë Qemalit me i mbyllë sytë, me sjellë kryet në anën tjetër dhe me i nda thelat me short.

Qemali i tha Sadikut që ta sjellte ai kryet. Sadiku nuk ndigjoi nji herë, por Qemali e bani t'i mbyllte sytë dhe ai ktheu kryet në nji anë. Qemali u ba gati, vajzat ishin rreth e rreth. Sadiku kishte sjellë shpinën.

— E kujt asht kjo? — i tha Qemali Sadikut. Ai nuk bani me dorë në drejtim të thelës së bostanit po në drejtim të Fatimes.

— E Agimit — u përgjegj Sadiku me sy të mbyllun.

— Po kjo? — pyeti prapë Qemali tue diftue me dorë Hajrijen.

— E jotja, — u përgjegj Sadiku prapë.

Vajzat filluen me qeshë me të madhe. Sadiku kujtonte se ato qeshnin pse u takojshin thelat e mëdhaja ose të vogla e s'po i vente vesh.

— Po kjo? — pyeti prapë Qemali dhe bani me dorë për Zyhranë e Velisë.

— E imja, a më ka ra e madhe? — pyeti Sadiku.

Të del e të tepron — u përgjegj Qemali. Kur Qemali i diftoi Canit për Zyhranë e Velisë, Sadiku u çue vrap dhe iku prej asaj hieje. Atij i vinte turp me u pa me vajzat dhe për tri ditë s'asht ndeshë me to.

Posa mbaroi Cafiq Zeqiri qeshi me të madhe dhe pas tij qeshën dhe të tjerët.

— Oh, po ai shejtan i shejtanit, qenka edhe për kësi shakash — thoshte Zeqiri tue qeshun, po ai s'duket pra ashtu. . .

Mbasi fjetën një copë herë, u ngritën dhe morën kosat që t'u rrihnin dhe t'u mprehnin tehet. Krisma e çekiçeve zgjoi Lahin nga gjumi. Mandej ky i zgjoi të gjithë. Kur u zgjuen, filluen të qeshnin njëni me tjetrin për sytë që u ishin fry.

— Ah, të na kishin lanë piten e drekës për tashti! — foli Meti si i babëzitun e tue fërkue sytë. Disa qeshën fort dhe disa me përtesë.

Kostarët ja filluen punës. Mbas tyne ja filluen edhe mbledhësit e sanës. Kur mblodhën edhe sanën e livadhut të dytë, i thanë Qemalit që të mirrte katrovën dhe të shkonte te kroi në pyll. Ai e mori dhe u nis për atje ku i thanë shokët. Sapo hyni në pyll pa Afërditën, që edhe ajo me bucakun në dorë, kish shkue me mbushë ujë për kostarët.

Rruga kah shkoi ajo ishte e drejtë dhe e ngushtë, anash kishte kallamishte të gjata dhe gjethe të gjata që vareshin dhe i binin syve. Në kallamishte kishte zhavor (një lloj bari që rritet në trungje, me fije të holla, të gjata, që kur asht i njomë të pret duert si brisk dhe përdoret për mbulesa kasollesh). Toka nuk dukej fare prej barit, zhugave e drunjve të shumtë. Ajo u ndal dhe ndigjoi Qemalin që po fërshëllente një kangë. Mandej, si padashje, shpejtoi hapin për të mbërri dhe me dorën e lirë largonte kallamishtet dhe gjethet, që të mos i binin syve dhe fytyrës.

Kur mbërrini te fundi i rrugës kambësore nuk dinte nga të shkonte, se ajo ndahej në dysh.

— Qemal! — thirri me za të dëshpruem dhe vështrori në atë anë. Ai s'ndigjoi, por Afërdita ktheu nga e djathta, andej nga vinte fërshëllima dhe ju afrue ma shumë. Ai mbërrini te kroi dhe u ul të mbushte katroven. Kroi duronte në rranjët e një shelgjeje të madhe. Në majë ishte ndërtue një çerdhe zogjsh dhe ata rrinin sipër saj.



Rreth e rrotull vendi ishte mbulue me kallamishte të dendura, zhugë, shelgje të mëdha, të shtrime dhe ujëse, që vende-vende ishin fare të pastra. Kishte edhe dru të tjerë që rriten të shtrime, të cilat nganjherë baheshin edhe të pkalueshme.

— Qemal!... — u ndigjue një thirrje, dhe jehona e saj u përsërit disa herë nëpër pyll.

Qemali po vrente rrugën nga vendi ku ishte ngjitur dhe dalloi në mes kallamishtesh Afërditën. Ajo po hiqte shaminë që i ish ngatërrue te një dru.

Kur iu afrue njani tjetrit, Qemali u hodh nga vendi ku ishte ngjitur dhe që të dy u përqaftuen. Ajo mbështeti kryet e saj në krahënorin e Qemalit. Sa s'i dilte zemra nga krahënorin...

— Dita... thirri Qemali dhe përkëdheli me njenën dorë shpatullat e saj dhe me tjetrën supet, flokët...

— Qemal! — thirri dhe ajo me za fare të lehtë dhe të papërmbajtun-sa e kam andërrue këtë çast!

Qemali largoi pak trupin e tij, Afërdita ngriti kryet nga krahënorin dhe e pa atë drejt e në sy.

Ashtu të bashkuem, të heshtun e të etun, qëndruen një copë herë tue u ngrohun me afshin e njëni tjetrit. Sytë e tyre të ndezun nuk tregonin gja tjetër përveç dashunisë dhe sinqeritetit rinor.

Afërdita mbylli sytë sikur të ishte në andër. Në puthjen e parë e ndjeu atë që s'e kish ndie kurrë... sa e kandshme, e ambël dhe e zjarrtë ju duk asaj ajo puthje e parë! Ashtu e heshtun, e pushtueme në atë krahënor që dëshëronte, e ndjente veten të lumtun dhe s'kish qejf të ndahej kurrë prej tij. Mollëzat e saja të fryeme, të forta si dy ftoj, shtërngoheshin në gjoksin e Qemalit.

Në të majtë të tyne, disa metra larg, Ahmet Shabani ishte ulun në një trung të butë xhavori dhe po pushonte. Tanë atë ditë ai kishte korrur zhavar pranë kroit për një kasolle verore të blegtorisë.

Krejt pa dashë, po i shikonte i heshtun të dy të rinjtë e dashnuem. Në ato çaste Ahmeti solli kryet në

nji anë dhe po kujtonte dashuninë tragjike të vëllait të tij, në kohën e rinisë, e cila kish përfundue si mos ma keq.

Kjo skenë i ringjalli kujtimet dhe ai filloi të përfytyronte atë çka i kish ndodhë Sulejmanit. Në përfytyrimin e tij lindi një mëngjes i bukur; nëpër bukurinë e atij mëngjesi pranveror bridhnin njerëz të lodhur, të vuejtun, të uritur... Sulejmani i ri, i pashëm, i hijshëm si lulet e asaj pranvere po dhe i lodhur e i vuejtun si një lule në thatësinë, me buzë të dridhur por i buzëqeshin bridhte ndër fusha. Atë ditë i ishte plotësue edhe atij endra e dashunisë.

Po ajo andërr dhe dëshirë ishte e bukur, e vuejtun e dridhur si ditët dhe orët që kalonin njerëzit dhe e trishtueme si lulet e pranverës që çelin me zor në një stinë të vranët... Ditët u buzëqeshnin njerëzve por njerëzit ditëve jo.

Atë mëngjes, Sulejmani kish ndenjün me të mbesën e qahajaj të cilës ja kish shijue buzët. Mbesa e qahajaj i ish përgjegjë dashunisë që ja kish shfaqun ai fshatar i vorfën i rrekosun, por i pashëm, shpirtmirë dhe i zgjuet. Që atë ditë ai ishte nën mbikqyrjen e xhajës së saj.

Kujtesa e Ahmetit filloi të punonte si një aparat filmi ku shiritët prej celulozë kalonin me shpejtësi...

Fytyra e Afërditës i kujtonte të gjitha tiparet e fytyrës së Fatimes dhe të gjitha po i delnin para syve: Fatimja me trupin e saj të hedhur, me shami të bardhë në krye, nën të cilën fshihej një gërsheet i gjatë, i zi dhe i trashë, fytyra e saj pak e hajme dhe syt e ndritun që shkëlqenin kur i fliste Sulejmanit:

— Sulejman, po t'na shohë axha do të na vrasit të dyve... dhe Sulejmani i thoshte:

— Po t'më vrasit mue nuk ka gja, me të vërtetë vdes i vorfën dhe i uritur, por të paktën vdes tue dashunue, tue të dashunue ty dhe jetën e vorfën.

— Jo, Sulejman, po të të vrasin ty, le të më vra-

sin edhe mue. Të vdesim që të dy ose të jetojmë që të dy...  
— Dhe Ahmetit ju duk se ata u ngjallën edhe një herë dhe po flisnin aty pranë.

— Jo, Fatime, ti e ke të zorshme me më dashunue mue. Ti je në një familje të pasun, kurse unë i vorfën.

— Pse thue njashtu, Sulejman? Edhe unë jam e vorfën si ti, unë e di se axha me aganë e nëpërmjet tyne edhe na, hamë punën dhe djersën tuej. Unë ha bukën që prodhon ti, për këtë punë unë të due aq fort, sa due të vdes me ty ose të jetoj me ty. Babë e nanë nuk kam, ata më vdiqën, kam mbetë në dorën e axhës shpirt lig. Unë jam një qingj në strofullin e ujkut; ai më kqyrë me sy të keq, vetëm te ti e gjej dashuninë, askush s'më përkëdhel përveç teje! Oh, kur të shoh se punon ashtu! Oh sa më dhimbesh, si po të shkon kjo rini!...

— S'ka gja, Fatime, kështu kam lindë unë, asht koha me punue për të tjerët, por inshalla tash ka me ardhë ndonji ditë e bardhë edhe për ne: me punue për vedi e jo për të tjerë.

— Jo, Sulejman, — i fliste Fatimja e mallëngjyeme dhe e përlotun — deri sa të jetë gjallë axha i im me again në krye nuk do të punosh për vedi.

— Po, Fatime por edhe ujku ha e ha e mandej e paguan me lëkurë.

— Kam frikë Sulejman, se këtyne ujqve tash ju zanë vendin ujë të tjerë.

— Fatime, pse mendojmë për ditët që nuk i njo-him? Inshalla bahet ashtu si duem na, por atë s'e dimë me siguri e s'kena çka bisedojmë për te, se ata ujqën ndoshta janë fort larg. Po më shiko një herë — dhe Sulejmani puthi tanë afsh faqet e përlotuna të vajzës.

— A shkojmë tashti, Fatime, mos të na diktojë axha i yt? Tash takohena prapë sonte katër net atje në kallomoq, jo këtu, se duhet me ndërrue vend. Unë të pres mbasi të erret e deri kur të vijsh. Natën e mirë! — dhe u puthën përsëri. Ahmeti i kish takue

kur po kalonte. Pothuej për çdo takim që e dinte se do të banin ata, i ruente, megjithëse ishte ma i ri se Sulejmani. Me një revolver të gjatë që kushedi ku e kish gjetun, u bante roje, por pa ditun gja as Sulejmani e as Fatimja. E tash Ahmeti mudohej të sillte ndër mend takimin e tyre të fundit. Ishte natë me hanë. Sulejmani po priste Fatimen me padurim; ma në fund ajo erdhi.

— Sulejman, jam vonue pak, por prita deri sa të binte axha me fjetë. Më duket se ka ra në erën tonë se e pashë kur po fliste me Agai dhe me inat më kqyrshin mue si gjarpnin. Të përmendnin emnin ty dhe më shikojsnin mue. Agai ka qejf me më marrë mue për djaln e tij...

— Ndigjo, Fatime, — fliste Sulejmani — në qoftë se ka ra në gjurmë tonë, të mos takohemi shpesh, ma vonë vendosim për këtë.

— Mirë, Sulejman, po merri këto pare dhe bleji ndonji palë tesha për vedi, ja mora axhës fshehtaz.

— Jo, jo, nuk i due, këtë mos e ban ma për mue.

— Do t'i marrish!

— Nuk i marr paret e tjetërkujt.

— Jo, Sulejman, këto pare janë tuejat, këto janë djersa dhe mundi yt, këto nuk i fitoi axha por ti me krahët e tu, merri se asht djersa jote... dhe Sulejmani u ngrit në kambë.

— Oh, Fatime, sa të due, sa të bukur po ma ban jetën time të vorfën! — dhe u përqaftuen.

Qehajai, që kish ra në gjumë dhe kish bamë sikur po flinte, kur pa se Fatimja u zhduk, u ngrit, u vesh, mori revolverin me dorçë sermi dhe doli jashtë. Brodhi nga fudi i bahçes andej e këndeje, ju ba dyshim sikur ndigjoi za vajze dhe nga ajo anë mori drejtimin. Sytë i panë mbesën e tij që puthej me atë fshatar të vorfën.

— Ah, qen e bir qeni, me gjithë bushtrën time që ka gjetë atë lyps e fukara të qelbun që e mbaj unë... — dhe ngriti revolverin e i vrau që të dy.

Të parin vrau Sulejmanin, i cili ra në barin e butë tue shtërngue fort gjoksin. Kur ai ra, foli me rënkim: «Ah, gjarpën, më vrave, të vrafshin» Pas tij dhe sipër tij u dergj edhe Fatimja. Kryet e saj ra mbi plagën e Sulejmanit, që i nxirrte gjak si burim...

Që të dy shikuen njeni tjetrin në heshtje dhe sikur buzëqeshën me dhimbje.. Shtërnguen trupin nga dhimbjet e plagëve, mandej që të dy mbyllën sytë.. Ahmeti nuk po e shihte se ku ishte qehajaj, sepse ky ishte futun në misër të gjatë e të rritun. Vetëm kur mori të ikte, misri i gjatë lëvizi në dritën e hanës dhe Ahmeti e pa.

— Ndal, o gjarpën e gjakpirësi ynë, ndalu dhe merr ato dy plumba, paguej gjakun e të pafajshmëve, se s'ke ku shkon!... — dhe e qëlloi dy herë. Qehajaj ra përdhe dhe po jepte shpirt tue u shkarravitun nëpër misër si ndonji derr.

Ahmeti përfytyroi edhe një herë dy të rinjtë e vramë e të heshtun dhe dy pika lot që formonin vija në faqe, ashtu si ai kroi aty në pyll, i rrëshqitën teposthtë. Po gëzimi ja mbushi kraharorin dhe të rinjtë e dashnuem ju dukën si lulet e pranverës që lulëzojnë buzë një lumi të rrëmbyeshëm e të dlirtë.

Përfytyroi edhe një herë dashuninë tragjike të të vëllait, atë skenë bashkë me Fatimenë atë dashuni të pastër, të singertë që u mbyt në gjak dhe thellë nga shpirti ju këput një ofshamë dhimbjeje, njerëzit tashma ishin të lirë në ndjenjat dhe dëshirat e tyne fisnike.

Qemali dhe Afërdita mbushën ujë, u drejtuen për te shokët e tyne. Ajo ishte gëzue, sikur fluturonte dhe puthjen e ndjente si një zjarr të ngjitun mbi fytyrë. Mudohej që këtë gëzim ta fshihte, ta mbante dhe të mos binte në sy të shoqeve. Mori bucakun dhe ua dërgoi kostarëve, atje ku po kositnin. Kostarët e falënderuen shumë dhe pinë të gjithë me etje.

Ndërsa po e përfundonin livadhin, Faiku ja filloi një kange. Selimi, që ishte në një livadh tjetër, u afrue që të ndigjonte dhe u mbështet në kapë të sanës.

— Selim, ma jep çiftelinë që të këndo një kangë?  
— i tha Qemali.

— Pse, din me i ra ti? — pyeti Selimi si i çuditun. — Unë kam kujtue se ti din me i ra vetëm asaj veglës që e ke me gjashtë tela e që e ke pasë blemë tash një vjet e ma.

— Unë i kam të dyja në shtëpi. Dhe çiftelisë i bie ma me zemër.

— Hadje, merre pra edhe na këndo një kangë — i tha Selimi. Qemali mori çiftelinë, nguli cfurkun në tokë, e ngriti kambën e majtë aty ku ndahen çinet e cfurkut dhe nisi t'i bjerë kangës që kishin për të këndue edhe në shfaqjen e estradës bashkë me Afërditën. Të gjithë e ndaluen punën dhe po ndigjonin. Mbasi e mori në fillim me çifteli ja filloi kangës:

E-ej, moj e mira që po mbledh bletën,  
A ma kallxon-o, lum tata, të drejtën,  
A do të rrish-o me mue tanë jetën?

Kjo kangë gufonte nga dy zemra, nga dy zemrat e dashnueme që e këndonin me gjithë shpirtin dhe pasionin e tyre. Selimi kënaqej, dhe nga ky gëzim i papërmbajtun i buzëqeshte e gjithë fytyra. Kostarët kur ndigjuen këtë kangë, e lanë punën dhe qëndruen në kambë. Atë kangë e kishin ndigjue edhe në radio, por në këtë fushë, në këtë gjelbërim afër atij pylli, u vinte edhe ma e bukur se në radio. Dhe kanga buronte nga zemra sikur ai burimi atje në pyll.

— O, po këta ditkan të këndojnë bukur! — foli Zeqiri i kënaqun dhe i buzëqeshun nga që kanga i pëlqeu shumë.

— Epo tash ke me i ndigjue të shtunën mbrama ti — foli Cafi.

— E pasha zotin i pari due me këndue e me u ulë në karrikë atë natë. Po kur ja kena mërrri na kësaj dite që t'i shohim e t'i ndigjojmë fëmijët tanë kështu tue këndue e tue gëzue tanë bashkë?...

Kur Qemali mirrte refrenin e kangës në melodi të çiftelisë, zemra i dridhej e tana dhe kur Afërdita hyn-te në kangë, humbiste e dukej sikur notonte në tingujt e lehtë të asaj çiftelie që sa vegël e vjetër asht aq tigull të bukur ka; jehonën e asaj kange e përcillte pylli tue e përsëritun dhe mandej kanga derdhej në liqen, lundronte e qetë dhe humbiste në gjanësinë e tij.

Shokët dhe shoqet e Qemalit, që i ndigjonin, sikur u çlodhën.

Mledhësit e sanës i dhanë fort dhe e kryen të gjithë atë punë. Gjergji shkoi te kostarët dhe mori kompasin për matje. E hapi kompasin dy metërsh dhe filloi të bante matjen e livadhit të madh dhe të tjerëve. Mblodhi shumën e tri livadheve, mandej e pjestoi dhe dolën tetëmbëdhjetë norma. Këto i pjestoi për dy-mbëdhjetë vetët që ishin. Secili kish ba nga një normë e gjysmë.

Si ndenjtën pak që të pushonin, mblodhën plaçkat dhe së bashku u nisën për në shtëpi. Dielli gadi po perëndonte. Livadhet ku mblodhën sanën u mbuluen nga hijet e gjata të shelgjeve. Kapat e sanës dukeshin herë si mullarë të ngushtë, herë të gjatë dhe të shpeshtë. Sana e thatë kish nisë të njomej pak nga lagështina dhe mjegulla e hollë, që filloi të përhapej nga pylli dhe liqeni. Po kostarët ende po punonin dhe donin të mbaronin edhe një copë të vogël që u kishte mbetë. Me kangë në gojë të rinjtë po shkonin nga shtëpia.

— Eh, si asht kjo rinia, ja filluen kangës prapë, a thue se nuk u lodhën tanë ditën? — tha Zeqiri.

Grupi po kalonte përmes atyne livadheve plot gjelbërim e lule, plot gurgullime uji e kangë zogjsh. Dhe këto kënaqësi i ndjen thellë njeriu i punës, punëtori i fushës, ai që asht mësue me ajrin e pastër të fshatit .

Ditën e nesërme u përgatitën për të shkue në fshatin ku do të jipnin shfaqje.

Moti ishte prishë dhe të gjithë fshatarët prisnin që të binte shi. «Duhet të ketë shi; shiu e ban duhanin të fluturojë, thojshin pleqtë, «se vaditja asht si me t'i lagë kambët e trupin me ta lanë thatë...»

Posa dolën nga fshati dhe hynë në qytet maqina mori drejtim nga kodrat e lindjes së qytetit. I ranë nga spitali, parku, fabrika e konservave, e fermentimit, kaluen pranë fabrikës së telit dhe të letrës, që ishin në përfundim e sipër, dhe kur mbaroi rruga e asfaltueme, morën një kthesë të fortë. Aty rruga mirrte përpjetë. Pasagjerët shikuen dhe, kur u ngjitën në Stom të Golemit, panë së largu fshatin e tyne që gjithnji po u humbiste nga sytë. Po ecnin buzë Kirit. Në të djathtë të tyne kodrat gjelbëronin, poshtë kodrave zbardhonin gurët dhe zallet e Kirit, i cili në atë kohë e kish ulun nivelin e ujit dhe si gjarpën çante zallin përmes. Në të majtë dredhonte një rrugë, në fund të së cilës ish një urë. Afër saj qenë ngritë dy shtylla të nalta të betonueme. Majën e njenës e lidhte me majën e tjetrës një hark i madh hekuri, në të cilën qenë shkruar me germa të hekurta dhe të lyeme me bojë të kuqe: Ferma «Perlat Rexhepi Sektori Nr. 1». Mbas saj shtrihej vneshta e Shtojit.

Para çlirimit e gjithë kjo fushë ishte plot gropa, ferra dhe fier. Në to kish vetëm lepuj dhe kafshë të tjera të egra. Kurse sot sa e sa tonelata rrush nxirret për çdo vit prej asaj vneshte aq të madhe dhe prodhuese! Ndërsa po shikonin vneshtën, sipër kaloi një aeroplani që spërkaste hardhitë me solucion. Sa me kënaqësi e shikon udhëtari këtë gja, këtë sukses të bujqësisë! Partia që ajo që e bani këtë fushë dikur të papërdorshme një sipërfaqe kaqe prodhuese. — tha dikush.

Aeroplani fluturonte si zog, fare ulët, sipër hardhive. Mbrapa lente si re të dendun solucionin, i cili



binte nëpër hardhi. Në mes të kësaj vneshte ishte një fushë aeroplanësh dhe Faikut, që binte shpesh në andrimë, i bahej sikur mbas vitesh avioni mund t'u ngarkonte në mes të vneshtës dhe nga mesi i saj të ngrihej.

Maqina gjithnjë ecte nëpër rrugën e shtrueme me kalldrëm prej kohësh që i kujtonte udhëtarit shumë gjana. Shumë të huej kanë kalue e kanë punue në të. Në radhë të parë turqit, austro-hungarezët (ose nemcelitë siç i thonë pleqt e kësaj ane), serbët dhe ushtarët italianë...

Sa e sa ushtarë të kombësive të ndryshme kaluen, luftuen dhe lanë kockat e tyne nëpër këtë Shqipni të vogël... Në të djathtë anës bregut të Kirit, ishin disa shtëpi plot pemë dhe në disa vende dukeshin suka të ngrituna me dhe, që gjasonin me kodra të vogla, të cilat fshihnin në vete tuma të moçme, varre të stërgjyshnave tanë Ilirë. Para qëndronin male. Në majën e Cukalit zbardhonte ende dëborë dhe Maranai në majë dukej si piramide.

— A asht e vërtetë që në majën e Cukalit ka një fushë që i thonë fusha e liqenit? — pyeti Gjergji, që ishte në të djathtë të karrocërisë dhe shikimin s'endante nga ai mal plot me pyje ahu.

— Po, — i tha Ademi, dikur në majën e atij mali ka kenë vullkan dhe me gjurmë vullkani asht edhe fusha e liqenit. Bile malcorët në majën e atij mali dhe në atë fushë kosisin bar. Gjergji shikonte si i çuditun. Maqina ktheu në të majtë të asaj rruge të drejtë dhe të gjatë dhe hyni në një rrugë tjetër që të çonte pranë një kodre të thatë. Mbas asaj kodre vinte Maranai. Fshati qëndronte në rrazë të kodrës. Posa mbërrimë në qendër të fshatit, shokët e fshatit, që ishin aty, dolën dhe i pritën. Të gjithë amatorët e grupit të estradës folën me shokët që i pritën, mandej morën materialet dhe u futën në sallën ku do të jepnim shfaqje.

Filluen të vinin gra e vajza, të rinj e të vjetër. Për çudi vajzat nuk vinin një nga një por grupe-grupe dhe nuk dalloheshin lehtë se cila ishte vajzë dhe cila grue.

Të gjitha ishin të veshuna me kostumin karakteristik të asaj krahine që njihet me emnin «Veshje Postri-pore». Në kokë mbanin peshqir të hollë të punueme nga ato vetë. Fytyrën e kishte të zbulueme. Në gjoks mbanin një xhamadan të vogël, i cili e puthiste gjoksin mirë. Nuk kishin fustane, por këmisha të bardha, që u rrinin nën xhamadan. Në bel lidhnin dy mbësntjellca të punueme në dorë me pe leshi të kuq që mbërrinte deri nën gju.

Suada, Afërdita dhe Nuriya i shikonin me veme-ndje këto fshatare me veshje karakteristike. E kishin pa dendun këtë veshje, por kur shikonin gjithë ato vajza e gra të veshuna njilloj përshtypja e tyre bahej ma e madhe.

Që të trija këto shkuen në mes të atij grupi vaj-zash dhe biseduen me to miqësisht.

— Suada! — thirri Qemali.

— Urdhëno.

— Ejani të bahena gadi, se do të fillojmë.

— Erdhëm — dhe u ndanë prej tyre dhe hynë, në sallë.

Mbas tyre filluen të hyjnë edhe fshatarët dhe fshataret. Skena ishte fare e thjeshtë, perdet ishin të reja. Mbrenda në skenën e mbyllun Nazmiu dhe Kola po merreshin me rregullimin e rrobeve që do veshnin si-mbas roleve.

— Ndigjoni, të keni kujdes, të qetë! — u thoshte Kola.

— Ti, Afërdita, kur të dalësh, se ti do ta hapësh e para programin, mos fol papushue të gjithë, se ka zhurmë. Të kesh kujdes dhe të jesh e qetë. Kur fliste Kola ashtu, Afërdita e ndjente veten sikur lehtësohej dhe impresionimi i ikte i gjithë... Sipari u hap. Zhurma filloi të pushonte. Në skenë doli Afërdita veshun me një fustan të bardhë, flokët i kish lëshue deri në supe.

Të gjithë fshatarët shikonin Afërditën me admirim. Mbasi u ba hapja, mbrenda në skenë filloi melo-

dia e kangës së postjerit. Meti doli në skenë me çantën në dorë dhe filloi kupletin satirik. Të gjithë qeshnin.

Programi u mbyll me kangën «Në njenën dorë kazmën dhe në tjetrën pushkën», të cilët e kënduen të gjithë së bashku tue dalun në skenë. Vendasit duartrokitën nxehtësisht. Kryetari dhe sekretari i asaj kooperative, posa dolën nga skena të gjithë amatorët, i falënderuen për çfaqjen në emër të të gjithë fshatarëve vendas.

Faleminderit... udhë e mbarë... natën e mirë... ndigjoheshin zana që i përshëndetnin; maqina eci shpejt dhe uturima e saj mbyti zanat që ende falënderonin. Koha ishte vrenjtun edhe ma tepër. Vetëtima të largëta çanin qiellin e errët. Nganjihërë vetëtimat që dukeshin si kamxhikë të hekurt, të skuqun, që rrihnin qiellin, u verbonin sytë.

— Jepi, Gjini, se na zuni shiu! — i tha kryetari nga karrocëria. Ai ishte atje bashkë me fshatarët e tij (kurse në kabinë ishte Kola). Sa u ngjiten në maqinë filluen komentet për çfaqjen.

Në rrugën e drejtë dhe të kalldrëmtë maqina s'pyeste për gropa. Ajo sa s'fluturonte nga shpjetësia. Të gjithë fshatarët thonin për Gjinin se nganjihërë asht kokëshkretë, të gjitha kthesat i bante tue e ulë fare pak shpejtësinë.

— Në baftë me ja dhanë ndonji hendeku, — t'ju la porosinë... tha Ademi ndërsa fytyrën ja ndriçoi një vetëtimë e afërt.

— Ky asht i zoti për timon të maqinës — foli një za që me sa dukej ishte zani i Tefikut.

Kryetari rrinte i heshtun dhe i menduem. Ai mendonte se këto vetëtima të largëta, që vinin nga jugu, tue u afrue gjithnji ndoshta mund t'i sjellin ndonji dam bujqësisë.

Mbërrinë te fabrika e letrës që po ndërtohej buzë lumit të Kirit, te uzina e fermentimit, e konservavet, te fabrika e telit dhe hynë në qytet. Binte një shi i rrallë, me pika të mëdha, mandej u dendësuen dhe fill me to

nisi edhe një erë e fortë që vinte nga jug-perëndimi. Kryetari i tha Gjinit që ta ndalonte maqinën dhe të futeshin në ndonji vend deri sa të kalonte stuhia. Maqina eci dhe pak dhe u ndal para një shtëpie dykatëshe, njerëzit e së cilës i njihte Kola. Zbritën nga maqina, morën rrobat që kishin në te dhe hynë mbrenda. Era gjithnjë vinte e shtohet. Kryetari dhe të gjithë po rrinin sipër, në katin e dytë në një dhomë nga lindja.

Ai rrinte përsëri i menduem. Shikonte nga dritarja në rrugë dhe thoshte me vete: Do të ketë patjetër damtime nga kjo erë e mallkueme. Po sana, po njena, po tjetra?... Po stallat e deleve ku kanë kenë pulat? Nuk asht e forcume, mirë, ja në këto ditë e kisha në plan dhe fillova të marr masat...

Po sikur t'i zaje delet ajo? Po sikur të digjet nga stufa ku ata pregatisin gjellën?

Diçka i vërshëllente në vesh. Dhe para syve të tij, në rrugën që ndriçonte nga llampa e varun në shtyllë kaloi me shpejtësi të madhe zjarrfiksjja. Kryetari i flaku të gjitha mendimet përnjiherësh, zgjati kryet dhe pa përsëri zjarrfiksen që u zhduk në errësinë.

Zemra i trokiti me forcë, u kthye dhe hypi te dritarja që shihte nga veriu. Të gjithë panë me habi dhe diçka i shqetësoi. Nga dritarja dukeshin flakë të kuqe, ajo ngjitej nalt dhe bashkë me tymin bahej e kuqëremtë. Qielli sikur ishte ndezun dhe retë dukeshin se kishin marrë ngjyrën e flakës.

— Gjini — thirri kryetari, — shpejt te maqina, zjarr në kooperativë!

Gjini u afrue te dritarja dhe shikoi që flaka vinte larg, larg, andej nga liqeni.

— Shpejto Gjini. Ju rrini këtu, kur të kryejmë punë do të nisim maqinën me ju marrë, të gjithë rriini.

— Jo, do të vimë edhe na — i tha Qemali dhe hoqi xhaketën e mirë që kishte veshun, ja dha Afërditës dhe mori një tjetër nga ato që i kishin ma të vjetra. Të gjithë zbritën shkallët mbas kryetarit.

Gjini ndezi maqinën.

— Ku shkoni ju? — pyeti kryetari kur mori të hypte në maqinë.

— Me ty, i tha Qemali.

— Ju rrini! —

— Na do të vimë! — thanë të gjithë të vendosun dhe u hodhën në karroceri.

— Ju vajzat hyni mbrendë — u foli kryetari dhe i largoi nga maqina.

— Gjergj rri me vajzat dhe kur të kryejmë po nisim maqinën me ju marrë. Po ti, Kolë?

— Po edhe unë do të vi, shoku kryetar, asht e kotë të më kundërshtoni, tha Kola tue mbërthye xhakët në gjoksin që ja hapte era.

Kryetari hypi. Gjini ja shkeli maqinës sa s'nxirrte ma, vajzat që qëndronin akoma jashtë, e shikuen si u zhduk në furtunë me shpejtësi.

Njerëzit e asaj shtëpie u çuditën për këta fshatarë kaq të vendosun e të lidhun mbas pasunisë së kooperative.

Maqina çante përpara përmes furtunës dhe shiut. Ajo sikur donte të hahej me shpejtësinë e erës. Kaluen qytetin dhe Gjini dalloj zjarrfiksen që po bante kthesë dhe po mirrte drejtim nga rruga e Koplikut. Atë e kishin orientue keq për në stallat e Fermës. Maqina vazhdonte të ecte nëpër rrugën e Koplikut dhe mori një kthesë aq të fortë sa që as Gjini nuk e dinte se si e mori atë, por ai dinte vetëm që në këto çaste njeriu nuk merr asgja parasysh; jeta s'asht kurrëgjja në të tilla raste. Nji si fuqi e mbinatyrshme e ndihmonte; guximi dhe vendosmënia që lind nga një dëshirë e madhe.

Kthyen në rrugën që të çonte te stallat. Flaka dhe ndriçimi i saj s'tohej sa ma shumë afroheshin. Mbasi bani edhe dy kthesa të forta, maqina mbërrini te bahçja. Kryetari shikonte fshatarët e tij tue vrapue e tue u vërvitë drejt flakës.

Gjini frenoi stop dhe maqina eci pak e frenue-

me nga vrulli që kish. Të gjithë u hodhën dhe vrapuen te zjarri. Hilmi Kurti dhe Ali Xhepa ishin tue vrapue nëpër flakë e tue nxjerrë disa dhen. Që të gjithë u lëshuen në zjarr.

Ja se si u dogj stalla. Aty ishin tri stalla. Njena që ish ndërtue dy vjet ma përpara, shtrihej për së gjati në drejtim jugë-veri. Në të flinin dy çobanë që mbanin edhe stufë. Stalla tjetër ishte e shtrime në drejtim lidje-perëndim, ndërsa stalla e tretë paralel me stallën e parë ku ndizej stufa. Këto ishin ma të gjata se gjashtëdhjetë metra. Dy të fundit kishin një vit që ishin ndërtue dhe kishin formën e një patkoi ose të germës U. Çobanët po përgatitnin darkën dhe atë çast, krejt pa u vumë re, furtuna kish përhapun ca shkëndia zjarri, të cilat i dhanë flakën barit të thatë, që përdorej për shtroje.

Kur filloi të fryjë era Hilmi Kurti, një djalë i shkurtën, i shëndoshë, i ri e me fytyrë bardhoshe, mori kovën e ujit që të shuente zjarrin. Kësolla me taraba dërrasash prej pishe u lëkund dhe mandej u mënjauë dhe ra. Hilmiu, ashtu i zanë nga taraba, mundohej që t'ja hidhte atë pak ujë stufës së rrëzueme nga kova që ende nuk ish mënjauë. Çdo gja ishte e kotë.

Kashta e thatë filloi të digjej. Kur e pa se çdo gja po përfundonte, u mundue që të arrinte te dritarja që kishte xham dhe nga xhami i thyem ose që mund ta thyente të dilte jashtë. S'mundi të arrinte aty megjithëse ishte fare afër, sepse një dërrasë nuk e lejonte të hynte barkazi nën te.

Të gjitha këto ishin çaste; zjarri po bante punën e tij dhe Hilmiu duhej të vepronte: ose të dilte me forcë dhe të thente çdo pengesë, ose të digjej aty nën ato taraba. Mblodhi të gjitha forcat e tij, i nguli duert në dhe, vuni edhe gjunjët nën vete; shpina i kish takue në tarabë; mandej me forcë i dha vetes që të ngrihej. Nuk mundi. Në shpatull ndjeu një dhimbje. Por Hilmiu e dinte që në këtë çast kish o vdekje o shpëtim. I dha edhe një herë vetes, shtërngoi trupin me sa forcë

që kish. Dhambët i kërcisnin kur shtërngonte nofullat. Afshi i nxehtë i zjarrit gjithnji bahej ma i padurueshëm për të. Uli shpinën nga taraba dhe me forcë e shpejtësi i dha nalt. Nji dërrasë e mbërthyeme u shkul me gjithë gozhdë. Hilmiu i jepte gjithë trupin që të dilte nga ai vend i dërrasës, por hapsina e krijueme ishte e ngushtë. Tue u shtërngue dhe tue vra mishtë doli ma në fund sipër saj.

Posa doli, era që përziente zjarrin ja mori mend dhe e flaku në zjarr. Ashtu me të shpejtë, tue e ndjekun zjarri, iku dhe doli nga ana e kundërt e tij. Dësh të shkonte dhe të hapte ndonji tarabë të stallës dhe të nxirrte dhentë jashtë, por kur ndigjoi rënkimet e shokut nën tarabë, që përziheshin me lamshin e furtunës dhe të zjarrit, ju kujtue se ishte aty edhe Aliu.

Ai ishte përcëlluem dhe s'kish mundë të vepronte sikur Hilmiu. Atëhere Hilmiu mori sopatën që ishte në qoshe të stallës, aty pranë një fuçije me ujë, dhe filloi të çante tarabën. Era e fortë gadi sa s'e mirrte ta hidhte në zjarr. Kur e çau tarabën, Aliu u ngrit i përgjakun. Flaka po mirrte kasollen mbarë.

— Na sopatën dhe çaji tarabat me nxjerrë delet — i tha Hilmiu tjetrit dhe ai shkoi të mirrte sopatën tjetër te kasollja fqinjë. Të dy filluen nga përleshja me furtunën dhe zjarrin.

Rojet e kooperativës, me të pamë këte zjarr, banë alarmin në fshat. Fshatarët u lëshuen me vrap te pasunia e përbashkët. Ata e kishin të vështirë që të ecnin ose të vraponin sepse duhesh veprue në të kundërt të erës. Por ashtu me inat i kaluen tanë ato vështirësi dhe mbërrinë në vend. Lufta e Hilmiut dhe Aliut me zjarrin dhe furtunën vazhdonte.

Filluen të nxirrnin dhentë nji nga nji. Taraba, që nga vendi ku kishin stufën këta dhe deri në gjysmë, ishte rrënue plotsisht, kurse pjesa tjetër vetëm ishte mënjanue dhe dhentë kishin marrun andej nga fundi. Në këtë çast ja behën kryetari me të rinjtë. Kryetari i bërtiti Aliut, i cili kish hy në mes të flakës dhe aty, me atë sopatë, vazhdonte të priste tarabën.

— Ali, dil nga flaka! — po ku ndigjonte Aliu në ate furtunë? Në ate luftë me natyrën e me zjarrin, ai e ndjente veten si fajtor, dhe donte të shpëtonte dhentë o të digjej edhe ai. Ai mendonte për dhentë e kooperativës, për ekonominë, për pasuninë e vllazënve të tij fshatarë.

Të gjithë të rinjtë, me kryetarin në ballë, u shpërndanë nëpër stallën që po digjej. Mbërrinë edhe fshatarët me sopata dhe lopata, mbërrini edhe zjarrfiksjja, por kur mori të hynte nga shtëgu i humbën rrotat në baltën e qullët nga shiu dhe ujët e kanalit. Kështu që rrotat i banin xhiro në vend dhe maqina aty mbeti që mbeti.

Fshatarët, të bashkuem njeni me tjetrin, nxirrnin dhentë nga tarabat; nisi të përhapej era e mishit të djegun dhe e leshit, një erë e randë zhari.

Edhe kryetari u fut nëpër flakë; kapi Aliun për krahu dhe e nxori jashtë. Ai ende donte të punonte, por kryetari e pa se si qe përzhitë e djegë dhe s'ndjente që edhe kambët i kish vu mbi një dërrasë prush.

Dhentë e nxjerra nuk ndigjonin që të shkonin në errësirë. Ato të hutueme, ndiqnin dritën dhe donin që të hidheshin në zjarr. Disa fshatarë të kapun dorë më dorë, ruenin dhentë që vraponin nga zjarri.

Nji pjesë fshatarësh vazhdonin të kontrollonin dhe të sillnin tarabat për dhen, nji pjesë tjetër ruenin zjarrin, që të mos binte në kasollet e tjera (megjithëse flaka shkonte nga lindja), dhe nji pjesë tjetër mundoheshin që të shtynin zjarrfiksen. Ajo kish mbetun në kanal, pranë rrugës dhe maqinës së Gjinit, pikërisht në shtegun që hynte nga rruga në arë. Posa e shtynë dhe e nxorën nga balta, maqina u drejtue nga zjarri. Njerëzit morën masat e nevojshme dhe ajo filloi të nxirrite ujin me presion. Zjarrfiksit filluen të shuenin zjarrin andej nga fundi i kasollës, kurse fillimi deri nga gjysma kish marrë tashma fund. Shiu që binte i përziem me erë, as e kishte tulatë.

Mbas pak pushuen edhe shiu dhe furtuna. Flaka



Û shue, kurse dhentë që u shpëtuen, i futën në kashollën tjetër dhe i përzier të gjitha bashkë. Fshatarët ishin të lodhun e të drobitun, të lagun dhe tanë baltë, por ata nuk donin t'ja dinin për këtë, donin të dinin vetëm për shëndetin e Aliut dhe sa dhen ishin djegë.

Hilmiut, me flokët dhe vetullat të përzhituna nga zjarri, filluen t'i dhambin duert, kambët e djeguna vende-vende, gjoksi dhe shpatullat. Kurse Aliu ishte shumë keq.

Kryetari i lodhun, i lagun dhe i bamë qullë, i mblodhi fshatarët ashtu në atë gjendje siç qenë. Edhe atyre nga kryet u kullonte uji i shiut. Ai u tha: «U lumtë, o burra, pasunia kolektive shpëtoi nga zjarri, jeni tregue të shpejtë dhe të shkathët...» Dhe të gjithë të lodhun e të gëzuem që pasunia shpëtoi, u nisën për në shtëpitë e tyre tue marrë me vete edhe shqetësimin për shokun e plagosun. Shumë prej tyre, ata që ishin të rinj, u nisën fill në spitalin e qytetit për t'i ndenjë pranë shokut të djegun.

Retë filluen të çrregulloheshin. Vende vende filluen të ndriçonin yjet po vendi i ndezun ende nxirrte tym.

Vajzat dhe Gjergji që kishin mbetur në qytet, prisnin me padurim që të mirrin vesh për ngjarjen. Kur arriti atje Gjini dhe morën vesh gjithçka, u erdhi keq që nuk kishin mundë të ndihmonin edhe ato. Mandej hypën në karrocerinë e maqinës së lagun dhe të bamë qullë u nisën për në fshat.

Të nesërmen lindi një ditë e bukur. Ajri ish i pastër dhe dielli i lamë nga shiu. Retë ishin zhdukun përveç ndonji që si rrugëtar i vonuem kishte ngelun në majën e malit. Natyra sikur donte të lante mëkatet e ditës së maparshme, e tregonte veten të fshehtë dhe jipte përshtypjen sikur disa orë ma përpara nuk kish ndodhun gja. Po atë mëngjes përgjegjësi i blegtorisë, kryetari, sekretari i partisë shkuen të numronin dhenët dhe të dinin damin e zjarrit. I numruen të gjitha dhe dolën dhetë dhenë dhe gjashtë qingja të djegun.

Sikur të mos ishin sakrifikue Hilmiu dhe Aliu, me siguri, të gjitha bagëtitë që ishin strukun në fundin e tarabës do të digjeshin, dhe ato s'ishin pak; kjo ishte bindja e të gjithëve.

Ma vonë erdhën dy punëtorë me lopata. Hapën një gropë të madhe dhe hodhën mbrenda dhentë e djegun. Kooperativistët vunë re se flaka dhe nxehtësia e zjarrit kishin shkue aq larg sa edhe ullijtë që qenë mbas kasollës ishin djegun deri nalt. Ishin prishun 22 rranjë. U çuditën se si Hilmiu me Aliun dhe bashkë me ta të gjithë fshatarët që kishin qenë tue punue fare afër kishin shpëtue kurse ullijtë ishin djegun në atë largësi.

Por njeriun s'e lodh e keqja, të vendosunin s'e përkul vështirësia as pengesa. Forca dhe vetmohimi e mposhtin të keqen... Njerëzit vunë re që midis tyne paskish trima dhe vetmohues që ata s'i kishin njohun.

## 5

Punëtorët morën, dikush shatin, dikush qeserin dhe shkuen në duhan për me qeserue e prashitë, tamam në ato vende ku ishte zallishte dhe toka ishte ma nalt.

Amatorët këte ditë do të punonin përsëri së bashku. Duhani kish marrun gjelbërim dhe ishte rritun. Atij duhej t'i hiqej një qeser dhe një shat i mirë dhe mandej me ate lagështinë të rritej e të fluturonte.

I gjithë grupi ja filloi punës. Kur ishte puna të losnin apo të banin shaka ata ishin të vetmit, por ata ishin edhe të punës, me përjashtim të Metit, që s'ja kishte fort qejfi. Por edhe ate e mirrte grupi mbas vetes, megjithëse nganjisherë mundohej që t'i mbante shokët me llafe, po këto hile nuk i ecnin. Në arat e mbjella me duhan, specat, domate e kultura të tjera, puna zjente dhe pothuej të dukej sikur të gjithë punonin me një ritëm. Në parcelat e duhanit zbardho-

nin shamitë e vajzave dhe të grave, duert e tyne lue-  
nin plot shpejtësi e forcë. E ku nuk zjente puna dhe  
kanga. Këtu buçistë traktori, atje ndihej hareja dhe  
fushat jehonin plot jetë. Mbasdite, pak ma herët se  
zakonisht, punëtorët lanë punën, hodhën veglat në  
krah dhe shkuen në qendrën e kooperativës, ku do të  
zhvillohej mbledhja e të gjithë anëtarëve. Të gjithë  
erdhën në sallë në orën e caktueme.

Kryetari i kooperativës foli për detyrat që i dilnin  
çdo kooperativisti në fushatat e ndryshme dhe theksoi  
me të madhe shërbimet që i duhen bamë çdo kulture.

Në pranverë çdo kulturë — tha kryetari — asht  
në rritje, në lulëzim, prandaj bëma hedh shtat e rritet  
shpejt e mirë dhe bahet e shëndoshë po të kujdesemi  
qysh tash; kjo i ngjet tamam kujdesit që duhet tregue  
me fëmijën që në vogëli e rini...

Ma në fund ai foli mbi ndihmën që dhanë koope-  
rativistët natën e furtunës. Lexoi emnat e atyne koo-  
perativistëve që u treguen ma të guximshëm dhe tha  
se me të tillë njerëz, kooperativa, partia, atdheu ynë  
nuk pësojnë kurrë humbje. Mandej kritikoi disa që  
nuk kishin dalun atë natë nga shtëpia po ndenjën tue  
shikue zjarrin nga dritarja.

— Ne — tha kryetari — nuk kërkuem dhe nuk  
kërkojmë që në luftë me furtunën të vijë plaku apo  
ai që s'mundët; kundra zjarrit dhe furtunës duhen  
njerëz të fortë, të vendosun, me vullnet të çeliktë. Dhe  
në atë çast bani me dorë tue diftue xha Selimin. Ky  
plak me të vërtetë ka ndërgjegjen, cilësitë dhe forcën  
e njeriut socialist. Por të mos ndodhi ma siç ndodhi  
me Riza Bajramin që atë natë nuk doli fare nga shtë-  
pia; ai le që s'doli vetë, por nuk la as djemtë e tij. Ma  
e keqia, ditën e nesërme u ka thanë shokëve: «ç'më  
duhet mue ose djalit që të dal nëpër shi e furtunë,  
hala s'i ka hy zjarri këndeje e t'i dalë andej?... kur  
s'kanë kujdes...» Këtu të ndalemi pak, të mendojmë  
për këte njeri negativ në shoqëninë tonë socialiste,  
në kolektivin tonë. Këto fjalë nuk janë të popullit

tonë, këto janë të hueja, janë të një njeriu të huej, të cilit nuk i pëlqen as kolektivi, as shoqëria jonë socialiste. Edhe sekretari i partisë foli gjanë për sjelljen e padenjë të Rizait. . . . «Në qoftë se ndonjeni do ecë kështu, atij do t'i shkasë toka nga këmbët. . . » përfundoi sekretari. Këto fjalë i tingëlluen thellë në vesh Rizait. Ngriti sytë si pa dashje dhe fytyra iu zverdh edhe ma tepër. Ky njeri çdo punë kur e bante, e bante keq, dhe kur i kontrollohej puna hiqej si i trashë. Ai ishte kritikue disa herë në mbledhje, ishte thirrur disa herë në organizatë dhe çfajsohej disi. Atë para disa vjetësh, bashkë me të birin e kishte nxjerrë fshati para të gjithë kooperativistëve për të dhanë llogari, pse ai kish marrë për djalin e tij të bijën e një kulaku, që s'kishte pasë sjellje të mirë. Rizai ishte njeri i prekur nga reforma dhe shpesh herë kishte çfaqë pakënaqsi. Tek ai shumë fshatarë shikonin një anmik, një dallaveraxhi, një rranjë të kalbun të botës së vjetër.

Mbasi mbaroi mbledhja e të gjithë anëtarëve të kooperativës u ba mbledhja e organizatës së rinisë. Mbledhjen e hapi sekretari i organizatës së rinisë Ylvi Muça. Ai foli për punën mujore që kishin bamë të rinjtë gjatë një muaji. Lavdoi punëtorët ma të mirë dhe kritikoi ata që kishin ndenjë shumë nën hije.

Aty u ba problem puna e anëtarit të bashkimit të rinisë, Lec Dodës i cili gjatë muajit kish punue keq, u kritikue për disiplinën e tij, për llafazanllëqet, për fjalët që përdorte vend e pa vend. «Këtë të ri ne e kemi thirrë disa herë në Byronë e Komitetit të Rinisë, kemi folë me te, i kemi dhanë këshilla, e kemi kritikue. kena marrë masa e të gjitha, por ç'e do! Sa që në Byronë e Komitetit i pranoi të gjitha gabimet, mori angazhim që nuk do t'i përsëritë ma dhe se do të bante një kthesë të fortë e do të punonte si të gjithë shokët. Por ç'ndodhi? Posa doli nga ne dhe u nis për në shtëpi takoi në rrugë një vajzë që po vinte në kooperativë, e ngacmoi keq dhe e fyejti me fjalë që s'mundemi me i përmendë.

Vajza, që ishte shoqe pune e tij, erdh dhe u ankue, kur ne ende s'kishim dalë mirë nga mbledhja. Na erdh keq dhe s'na e mori mendja që Leci kish ra kaq poshtë. Të tillë njerëz organizata e rinisë nuk i pranon në gjinin e saj. — Kështu foli Ylviu.

Leci rrinte në mes të shokëve dhe nuk bante za. Nji herë u skuq por mandej ju duk si diçka e natyrshme.

Kishin vendosun që ta përjashtonin nga radhët e anëtarëve të Bashkimit të Rinisë. Disa të rinj si Qemali, Ademi, u ngritën dhe diskutuen me keqardhje për këtë të ri. Ata thanë të marrë angazhim Leci para të gjithë anëtarëve të Bashkimit të Rinisë se do të ndryshojë rrugë.

Leci nuk po bante za.

— Po angazhimet e tij filluen që të bahen të kota dhe të zakonshme. Ja p.sh. në mbledhjen që bani organizata e rinisë, ai mori angazhim që nuk do t'i përsëritte ma ato çka kish ba. Për disa ditë e mbajti fjalën. Filluen të bijshin në sy disa ndryshime, nisi t'i zhdukë disa të meta që i kishte si të vjetra po i lindën të reja. Normën filloi ta realizonte, fjalët e tepërta nisi me i lanë por i lindën vese që nuk i kishte, që na banë edhe ma përshtypje, — fliste Murati i revoltuem. — Shkonte në kinemanë e qytetit sa herë dilte ndonji film i bukur, blente shumë bileta dhe ua shiste njerëzve për qar. Bante edhe matrapazllëqe të tjera. Atje edhe asht rrahun disa herë me të rinj të qytetit, sigurisht me ndonji shokun e tij; lene që në fshat na turpnoi por edhe në qytet s'po i le gja mangut rrugaçëve të njihershëm... Ai tashti nuk asht ma i vogël, e di se ç'asht e mira dhe e keqja.

— Me leje! — u ndigjue nji za burri andej nga fundi.

— Urdhëno! — foli njeni nga presidiumi.

— Ne të gjithëve na vjen keq që në gjinin e kësaj organizate të shëndoshë, të disiplinueme, fliste Ibrahimimi, ka nji të ri të padisiplinuem, pa ndërgjegje, pa

edukatë siç asht i riu Lec Doda. Ai me këtë sjellje, në radhë të parë, nuk nderon veten e tij, mandej familjen, organizatën e rinisë dhe fshatin e tij. Që të përjashtohet nga radhët e organizatës së rinisë, për mendimin tim, asht një masë tepër e randë, por jo e vonë dhe pa vend. Por le të mendojmë ma thellë. Të përjashtohesh nga organizata e rinisë do të thotë të mos jetosh ma aktivisht në shoqëni, të përjashtohesh nga grupi dhe reshti shoqnor, të dalësh nga radhët, sikur pat thanë njiherë Nikolla Ostrovski, do të thotë të mos i vlejsh ma shoqënisë. Përkundrazi ajo duhet të merret ma tepër me ndreqjen tande. Leci asht paralajmërue që do të përjashtohet dhe ndoshta kjo nuk i ka bamë edhe aq përshtypje; kjo rrjedh nga që ai nuk mendon thellë, mendon shumë cekët. Partia, rinia, janë zemërgjana. Ato bajnë çmos që t'i ndreqin njerëzit, t'i bajnë të ndërgegjegjshëm e pa vese, po kur ma në fund ata ecin shtrembët, i largojnë nga kolektivi i shëndoshë e i mirë. Të përjashtohesh nga radhët e organizatës së rinisë, nga të gjithë këta antarë, do të thotë të të urrejë shoqënia për punët e këqia, të jesh një damtues, një parazit i saj. Prandaj unë them mendimin tim që kësaj radhe të mos përjashtohet, të çohet dhe të marrë angazhim edhe një herë para nesh, dhe në qoftë se ai merr angazhim, unë shpreh mendimin që nga brigada e perimeve të vijë në skuadrën dhe brigadën time. Të punojë gjithkund me mue; unë zotohem para të gjithë organizatës së rinisë që do të punoj pa u kursye me këte të ri dhe në mbledhjen tjetër mbas një mueji Leci do të përmendet për të mirë.

Të gjithëve u qeshi fytyra nga ky zotim që mori Ibrahim, megjithëse kthesa e Lecit u dukej e pabesueshme.

Vetëm Leci rrinte i turpnuem dhe me sy për tokë. Ai tashti po e ndjente veten me të vërtetë të vramë se ju banë të kjarta të gjitha. Të rinjtë shikonin Lecin, por ai kish ulun kryet e sytë për tokë dhe s'bante za. Nga presidiumi u ngrit në kambë edhe sekretari i organizatës bazë të Partisë:

— Atëhere, mbasi po bahet puna kështu, le të çohet Leci dhe të flasë vetë, të zotohet vetë, po qe se ndjen forca. Por ky angazhim të mos jetë si të tjerët.

Leci u ngrit në kambë, duert i mbështeti në radhën e karrikeve që kishte para, fytyrën e turpnueme e mbante poshtë dhe matej që të fliste. Në kokë i hypën njimijë mendime, njimijë fjalë e shprehje dhe donte që të zgjidhte pak nga këto; t'i përmblydhte, t'i thoshte dhe të ulej. Po në këto raste nuk ke kohë që të mendosh, se qindra sy e vështrime të presin e të duket sikur t'i kryqëzojnë mendimet.

— Shokë! — filloi Leci dhe ngriti kokën, u hodhi vështrimin shokëve, shoqeve dhe presidiumit që e kish karshi. Vështrimi i tij ndeshi në shumë të tjerë që e prisnin, dhe ai përsëri e humbi fillin.

— Tashti në këtë mbledhje po e ndjej veten me të vërtetë të turpnuem... fliste me za të dridhun dhe fjalët i nxirrte si prej ndonji thellësie të madhe dhe me shkëputje.

Të gjitha kritikak janë të drejta, janë me vend... Si tha edhe shoku Ibrahim këto rrjedhin nga cektësia ime, se punoj dhe veproj si të më vijë, si due unë dhe si më pëlqen mue, por tashti e shoh se ato që më pëlqejnë mue nuk janë në të mirë të punës e të shoqnisë.

Asht e drejtë fjala e shokut sekretar që thotë se sa kam marrë angazhime dhe sa kam dalë nga Byroja u kam ra shkelm. Ashtu asht, por ky angazhim që po marr tashti para të gjithë shokëve të mi, anëtarëve të bashkimit të rinisë dhe anëtarëve të partisë, do të jetë për mue gur prove. Do të punoj dhe do të veproj ashtu si të më thoni ju, do të zhduk çdo gja që nuk asht e mirë dhe do të shkoj në skuadrën e Ibrahimit. «Baba im» kështu do ta quej unë Ibrahimin, i cili do të më udhëheqë, megjithëse unë nuk jam i vogël.

U ul dhe s'dijti se si ju mbyll diskutimi ashtu pa dashje. Shokëve përreth në këto çaste sikur ju lehtësue zemra. E mori fjalën përsëri sekretari i organiza-

tës bazë të partisë i cili foli për edukimin komunist të të rinjve, për qëndrimin socialist të çdo të riu ndaj pronës dhe punës socialiste.

Kur përfundoi mbledhja të rinjtë dolën nga salla me mendime të tjera. Nata kish bamë punën e saj. Fytyrat e nxehuna në sallën e mbledhjes ndjenë përkëdheljen e erës që sillte aroma lulësh dhe ajër të pastër.

Të gjithë po ecnin tue bisedue. Edhe Leci ishte në mes tyre, po kësaj radhe i heshtun... Rrugës ecte i menduem. Mendonte për dënimin që do t'i jepte shoqëria dhe ndjente se s'ka dënim ma të randë se dënimi i shoqërisë, i shokëve, po kuptoi ama se s'ka dënim ma të vlefshëm se ai. Shoqëria asht ajo që të sjell në rrugë të drejtë dhe shoqëria asht ajo që mund të të sjellë edhe në rrugë të shtrembët. Këtë Leci e kuptonte mirë tashti.

6

Ditën e enjte kooperativistët punuen deri në mesditë dhe mandej u banë gati të shkonin në fshatin tjetër. E ndërruen krahun, dhe nga fshatrat e lindjes shkuen në ato të veriut të qytetit. Edhe kooperativistët e atjeshëm mbetën shumë të kënaqun. Të premtën punuen dhe nuk dhanë çfaqje. Erdhi edhe dita e shtunë, kur do të jepnin çfaqje në fshatin e tyre. Atë ditë punuen deri vonë dhe normën nuk e lanë pa realizue. Shkuen në shtëpi, pushuen, u veshën, morën ato çka kishin me marrë dhe u mblodhën në qendër të kooperativës. Kishin vendosë që atë ditë të jepnin dy çfaqje, për këte arsëye kishin lajmëruë edhe Kolën.

Njana çfaqje do të jepej posaçërisht për fëmijët, prandaj lajmëruen edhe mësuesit e shkollës së Dobracit dhe Golemit, që t'i binin nxanësit të organizuem aty. Në oborrin para sallës ku jepeshin çfaqje filmash,



çfaqje estrade dhe mbledhje të ndryshme kishte plot gjallni. Mbasi u rreshtuen të gjithë, mësuesi u prini atyne që të hynin në sallë. Ma në fund skena u hap. Qindra shikime u lëshuen në te. Nxnësit po kënaqeshin. Kur erdhi koha që të mbaronin doli Tefiku me një peliçe të vjetër, me qeleshe të bardhë në krye dhe me mustaqe të mëdha. Në dorë kishte një dru, të cilin e mbante mbas trupit. Ai u tha nxanësve:

— Ndigjoni fëmijë, tashti shkoni në shtëpi, hapni librat e mësoni mirë dhe merrni dheta; në shkollë mos bani mungesa. Po që se mësoni, do t'ju duen prindërit, mësuesit, unë e të gjithë. Por ai që nuk mëson e në shkollë ka me mungue, unë do ta kap në dru. Dhe Tefiku tundi drunë. Të gjithë fëmijët qeshën me të madhe, dolën nga salla tue i tregue njëni tjetrit se si e luate pjesën njëni apo tjetri.

Të gjithë kishin dalun jashtë përveç Kolës, Qemalit dhe Zaides. Zaideja ishte një çupë e vogël në klasën e tretë, një leshverdhë fytyrë rrumbullake.

Kola ja mirrte lehtë kangës dhe ajo mundohej që të këndonte simbas ritmit të tij. Nga jashtë ndigjohesh zani i Kolës që i thoshte: Më ndigjo mue si e çoj zani: Dhe ajo mundohej ta ndryshonte siç thosh ai:

— Shumë mirë, edhe një herë.

Kur Kola i thoshte shumë mirë, asaj ju bante qejfi dhe e përsërite kangën me dëshirë.

— Bravo, të lumtë! — i thoshte përsëri — edhe një herë prej fillimit.

— Sa mirë nuk mërzitet ai Kola, qysh se kena mbarue çfaqjen dhe deri tash, bile edhe para se me fillue çfaqja asht tue u marrë me Zaiden — foli Meti.

— Po ai nuk asht shoku ynë, mor vëlla, — u përgjegj Faiku; — atij nuk i mërzitet as arti dhe as njerëzit që e duen kangën e kanë dëshirë për te. Çdo njeri që merret me art duhet të jetë i durueshëm. Po e le artin të le ai ty. E ndigjove si këndonte atëhere në fillim e si këndon tashti?

Meti nuk bani za, por ndigjonte Zaiden që këndonte atë kangë për mrekulli. Ora po kalonte, koha për të dhanë çfaqjen po afrohej.

Në këtë kohë, kur po bisedonin, ra çanga e kooperativës për të lanë punën. Kola la fizarmonikën në tryezë, përkëdheli voglushen dhe i tha:

— Shumë mirë, kështu ke me këndue edhe në mbramje, kur të rritesh do të të marr me këndue në teatër të madh.

Vogëlushja uli sytë për tokë, pohoi me krye dhe vuni buzën në gaz. Pranë Suadës dhe Ditës u ul edhe Kola.

— Po afron koha, foli ai kur pa orën.

— Edhe pak fillojnë të mblidhen tashti, — shtoi Suada.

Filluen që të mblidheshin kooperativistët. I gjithë grupi hyni mbrenda nga dera e mbrapme e sallës dhe u ulën në dhomën që ishte posaçrisht për materialet.

Veç kryetarit të kooperativës e sekretarit, qenë ulë në radhë të parë edhe Zeqiri me Selimin. Ata e patën vendosë qyshkur me ardhë të parët në çfaqje. Në sallë kishte pëshpëritje. Ajo ishte mbushun plot e përplot me kooperativistë, bile kishin ardhun edhe nga qyteti, nga Kirasi dhe lagjeja Partizani.

Në skenë doli Afërdita veshë e stolisë me kostum kombëtar. Dy pleqtë që qenë në radhën e parë nuk po e njihnin kush ishte dhe bisedonin ndërmjet tyre:

— Po më duket si Afërdita e Malos apo më bajnë sytë?

— Jo, mor! — foli i habitun Selimi.

— Njajo asht — pohoi i sigurt Zeqiri.

— Po kjo kenka çfarë vajze more! Unë e kam pa ashtu me shami po s'e kam kqyrë mirë — dhe me të vërtetë bukuria, shprehja e saj i bani pleqtë ta shikonin me kureshtje.

Fustani i bardhë, i premë për trup, sikur nuk ishte qepun por i kishte mbi në trup. Flokët e zes të lëshuem, vetullat e zeza, qepallat e mëdha dhe sytë e

ndritun i shkëlqenin në atë fytyrë të kuqe si mollë. Edhe mënyra e të folurit të saj e bante spektatorin që në fillim për vete.

Mbasi dha programin, Afërdita u zhduk nga skena. Mandej mbrenda në skenë filloi melodia e këngës së postjerit.

Kupleti i postjerit që interpretoi Meti me shokë e shoqe të tjerë kundër dembelëve, që u reshten punës, që mjaft zbavitës dhe edukues, prandaj u ndoq me vemendje e i bani të gjithë me qeshë.

Salla oshëtiu nga duartrokitjet e spektatorëve. Mbas atij kupleti, Faiku këndoi një këngë nga ato të festivalit të këngës në radio. Vijuen mandej disa intermexo, këngë e parodi u çfaq shtëpi «Nëpër oborrin e kooperativës». Këtu kritikohet kryesia që s'mirrite masa për kullimin e oborrit para godinave gjatë dimnit.

Programi mbaroi mbas shumë këngësh e pjesësh të tjera. Spektatorët u ngritën të kënaqun dhe të çuditun nga që një program kaq të pasun e të interpretuar bukur nuk e prisnin. Të nesërmen pushuen. Të hanën paradite konkurruen me lokalitetin e qendrës, dhe fituen çmimin e parë, mandej, një javë ma vonë, konkurruen me kooperativat e rrethit. Të gjithë ishin konkurrentë të fortë, sepse ishin fitues të çmimit të parë në lokalitete.

Çfaqjet i banin në teatrin e vjetër «Migjeni». Edhe aty patën atë sukses që e kishin pasë kudo. Në sallë tashti nuk ishin spektatorë fshatarët e tyne. Aty pothuajse të gjithë ishin qytetarë dhe njerëz që merrnin vesh nga arti dhe thonin: «ky qenka një grup estrade që nuk i mungon asgjë». Kur mbaroi festivali, komisioni i dha çmimin e parë këtij fshati. Gjithashtu ju dhanë fletë lavdërimi Afërditës, Qemalit, Nurijes, Tefikut dhe Faikut. Suksesi që i madh.

Sekretari i mbledhi të gjithë pjesëmarrësit, i lavdëroi për çfaqjen që e dhanë atë mirë dhe nderuen kështu kooperativën. U foli për punën e palodhën që kishin bënë, për sakrificat gjatë provave, mbas ora-

rit të punës, e të tjera. U vuni në dukje se tashma duhet të ketë një lëvizje të vazhdueshme artistike dhe jo vetëm me raste.

Ma në fund u tha se fjalën që ka dhanë organizata e partisë me kryesinë do ta mbajë, dhe mbas një jave, ata të përgatiteshin për të dalë në ekskursion jashtë rrethit.

7

Duhani i gjithë u prashit. Disa punëtorë shkuen që të ndihmonin brigadën e perimeve në prashitjen e domateve të dyta dhe të bostanit. Gruni po mirrte ngjyrenë e verdhë. Të korrat po afronin, në fushat para liqenit traktorët po lesonin dhe po mbillnin misrin e lashtë. Nga domatet e lashta u volën arkat e para.

Kur u ba mbledhja e anëtarëve mbas prashitjes së duhanit, doli që brigada IV e kish mbarue planin katër ditë para afatit dhe para të gjitha brigadave të tjera. Dita kur do të niseshin për në ekskursion po afronte. Sekretari i Partisë me kryetarin dhe sekretarin e rinisë vendosën që në ekskursion të merrnin edhe Lecin, i cili kish fillue të ndryshojë. Atë e kishin çue në skuadrën e Ibrahimit. Ai e mirrte në punë gjithkund mbas vetes dhe ata punonin bashkë. Ibrahimit nuk e linte të bante punë të keqe, e këshillonte dhe, kur donte të shkonte në kinemanë e qytetit, shkonin bashkë.

Kur kryetari dhe sekretari i partisë po shëtisnin të martën mbas dreke nëpër ara, takuen dembelin që qe shtrimë nën hijen e një fiku.

— Paska ndenjë pa gjumë mbramë — i tha kryetari kur ju afrue.

— Jo, mor shoku kryetar, po s'jam hiç mirë, jam i këputun krejt, — foli Rrema pa lëvizë nga vendi dhe pa e prishun gjakun fare.

— Nuk i shikon shokët, sa punojnë, o Rremë, si nuk ndryshove një herë po gjithmonë njisoj, — i tha

kryetari, dhe nxori nga xhepi kutinë e duhanit e mandej u ul pranë tij.

— Dridhe një cigare.

— Jo për zoten, me e dredhë kam mërzi. Unë gjithmonë i blej paketa.

— E mirë pra, po ta japim prej paketës. Po deri kur do të vazhdosh ti kështu, o Rremë, po a fitohet buka kështu, mor mik?

— Besa unë e di, mor shoku kryetar, fliste Rrema, po edhe ju ama nuk punoni drejtë. Si nuk ma gjetët një vend të mirë po më keni pru në shatë?

— Po ku me të gjetë vend ma të mirë, o Rremë? më thuej.

— Në roje, kishe ruejtë një kështu ndenjun e s'ishe mërzitë.

— Po çka me ruejt këtu? — pyeti sekretari gjoja se s'po kuptonte.

— Po ndokund roje në bahçe — foli Rrema pa vonue.

— Po ti ishe roje në bahçe, po nuk ruejte mirë. Bahçja nuk ruhet i shtrimë nën hije. Kur të lamë ty s'i mbeti gja me vjelë kooperativës.

— E po ata hem marrin hem lanë. Ju thurnie me gardh që të mos mundet me hy asnjëri as bagëtia.

Kur e pa se nuk i dilet me atë dembel Stambolli kryetari i tha:

— Ndigjo, o Rremë, ti qofsh një dhe kooperativa pastë fat e mos pastë të tjerë si ti; po nuk luejte kambët nuk lot as dhambët. Por ti po jeton në krahët e grues sate. Ti nuk do, se çdo gja mund ta bajsh. Nuk asht puna që ti nuk ke shëndet dhe nuk je i zoti për punë, ti i ke të gjitha mundësitë por nuk do. Fëmi-jët po t'i rrit grueja e ti po bahesh turp i botës. Sikur të punoje do të ishte shumë ma mirë, dhe grueja e fshati do të të donin. Ata do të flasin atëhere vetëm mirë për ty.

Rrema ndigjonte fjalët e sekretarit si asnjëherë tjetër; kësaj radhe po i banin përshtypje dhe ai po e mblidhte mendjen.

— Ti, Rremë, nuk mbërrin as një të katërtën e ditëve të punës, kurse grueja jote kalon çdo vit edhe ma të rejat, veç që asht ndër punëtorët e mira të kooperativës. Mos harro se fëmijët nuk janë vetëm të saj, ajo nuk ta ka borxh t'i rrisë vetë. Si mendon ti? — e pyeti sekretari Rremën. Ky, nga që kishte ndigjue me vemendje, kish harrue me thithë edhe cigaren dhe ajo i ishte shue në dorë. U mblodh, luejti vendit dhe foli: — Po, shoku sekretar, ashtu asht, nuk e luen gja.

— E pra, e shikon se nuk je në binar e doemos duhet me ndryshue? Po me të pyetë diçka?

— Hë, fol. — A ke qejf me dalë e me shetitë andej kah Durrësi?

— Vallahi boll!

— Po a ma jep fjalën që do punojsh?

— Jo, ma thuej atë çka don me thanë atëhere të jap fjalën.

— Nësër do të shkojë rinia për shetitje, ekskursion si i thonë të rinjtë, në Durrës. Kena mendue me të përzi edhe ty me rininë, mbasi nuk je i vjetër dhe hokat i ke në majë të gjuhës. Po a ma jep fjalën që kur të kthehesh të bajsh si të kam thamë?

— Po, për nder, do të punoj ma tepër, ta jap dorën e fjalën e burrit, — tha pa vonue Rrema — e i shtrini dorën.

— Po ndigjo, nisja do të bahet në orën katër mbas mesit të natës dhe, po e theve orarin si në punë, autobuzi të ikë dhe të le.

— Mos u ban merak ti për këte, — foli Rrema pak si i penduem për ate që tha.

— Tashti a po çohesh e punon, se ma dhe dorën e fjalën?

— Unë dorën e fjalën ta dhashë që do të punoj kur të kthehem.

— Mirë po mbaje fjalën, ama! Ditën e mirë! — i tha sekretari, i cili u ngrit dhe iku te punëtorët që po punonin. Rrema u shtri në shpinë, u rregullue mirë dhe po mendonte: «Kqyre sekretarin, erdhi dhe më tha me shkue me rininë në Durrës! Kujton se po më rrenë

mue ai, po më çojnë me shëtitë, po baj qejf një ditë ose dy e po lodhem tue punue tanë vitin! Po edhe në qoftë se lodhem, unë për vete punoj e jo për sekretarin. Grueja me të vërtetë po lodhet, ajo po i rrit fëmijët dhe unë po jetoj në krahët e saj. Kështu më kanë thanë edhe disa të tjerë. Jo! kjo nuk asht e mirë për mue, asht turp. Sa të kthehem due me punue, bile qysh tashti. — Mori të ngrihej, por vendi ku ishte ulun iu duk ma i mirë; shikoi diellin që gadi po perëndonte, u ul përsëri dhe shtoi: — Edhe sot po rri, tashti asht vonë. Nesër, ditë e re, rrugë e re.

Kur shkoi në shtëpi filloi të rregullohej, të rruhej e të bahej gadi për të nesërmen. Në gjumë ra qysh herët. Të shoqen e porositi që ta ngrinte nga gjumi që në gjysmë të natës. Po të shoqes së lodhun gjatë ditës nuk i kish dalë gjumi në orën dymbëdhjetë po në orën katër.

Nuk i la gja pa i thanë... Ashtu i inatosur e i përgjumun u vesh shpejt e shpejt. Mori xhaketen po nuk i hynte dora; mandej shikoi se ajo ishte xhaketa e djalit të tij tetëvjeçar. E hodhi atje në mes të dhomës dhe e shoqja ja solli xhaketen e tij.

As ai nuk e dijtë se si u vesh dhe çka veshi, po me vrap zbriti shkallët dhe u drejtue nga kooperativa.

— Edhe thonë se asht dembel e i ngathët, ja sa shpejt e hedh hapin — tha e shoqja dhe mbylli derën e shtëpisë.

— Rrema po vraponte gjithnji dhe, kur shkoi në oborrin e kooperativës, ndigjoi një za që i tha: — Ndal! — Dhe Rrema, kur pa se i ishte drejtue pushka, u ndal stop sikur të kishte frena.

— Ti, Rremë, je? — e pyeti roja kur e njohu.

— Po, unë jam... dhe gati ju mirrte fryma.

— Kanë ikë -a?

— Kush? — pyeti roja.

— Ata.

— Kush iku? — pyeti roja dhe u ba i dyshimtë.

— Ata me maqinë për në Durrës.

— Aha, jo mor jo, — ju përgjegj roja i qetësuem.

Roja bisedoi gjanë e gjatë dhe i tha se autobuzi nisej në orën gjashtë e jo në orën katër. E ndryshuen, i tha roja, e shtynë, por ti nuk e paske marrë vesh. Ndenjën të dy bashkë dhe kur doli drita e kjartë, roja pa se si ishte veshun.

— Po mirë, o Rremë, a je veshë fjetë apo si?

— Unë? S'ka ma shpejt, vallahi — i tha Rrema pa shikue fare veten.

— Po ti shikoje se çka ke veshë, këpucët e mira pa çorapë. Ke veshë pantallonat e punës e nën xhakëtën e mirë ke veshë këmishë të ndyeme.

— A uuu... qyre, po çarapët më duket se i kam veshë një herë, ja ku i paskam futë në xhep, dhe i veshi.

Atëhere Rrema shkoi në shtëpi që mos ta shikonte kush ashtu. U vesh mirë, lau edhe një herë faqet, që t'i dalë gjumi mirë, dhe përsëri shkoi në qendër. Filluen të mblidheshin të rinjtë. Dita ishte e bukur, qielli i kaltër e i qartë.

Të gjithë ishin veshun bukur, rrugës vinin tue bisedue e tue qeshun njeni me tjetrin. Rrema po rrinte me rojen, Malo Alinë. Autobuzi kishte ardhun. Mbasit u mblodhën të gjithë, u banë gati të niseshin.

Maloja, babai i Afërditës, i tha së bijës:

— Afërditë, kur të shkoni në Durrës takoje Skënderin në shkollë!

— Po kur ta takoj, babë, unë nuk kam kenë asnjëherë në Golem të Kavajës.

— Hajt se e din ndonjeni — i foli i ati.

— E din Qemali, se ai ka kenë disa herë. — i tha Suada.

— Epo shumë mirë.

— Po mirë, po a na lejon sekretari që të ndahemi prej grupit? — pyeti Afërdita.

— Po i tham unë, — tha Maloja dhe shkoi të fliste me të.

Shoferi ndezi autobuzin dhe të rinjtë filluen të



hypnin. Kur po hynte Rrema në autobus, kryetari i tha:

— He, more Rremë, sot e paske zbatue orarin.

— Kam ardhë edhe ma herët se orari — ju përgjegj Rrema dhe u ul në karrike.

Maloja ja tregoi kryetarit të gjitha, si kishte ardhë që herët me çorapë në xhep dhe në vend të pantallonave dhe këmbishës së mirë kish veshun ato të punës.

Kryetari sa s'u shkye gazit.

— A jeni gati? — pyeti shoferi.

— Gati jena, gati për nisje! — i foli sekretari.

Autobuzi ishte mbushun plot, aty nuk ishin vetëm ata të grupit të amatorëve; autobuzi ishte plotësue edhe me punëtorë të dalluem. Ate çast filloi të ecë dhe të marrë kthesë. Pasagjerët përshëndetën shokët që ishin në oborr mandej i lanë mbas. Faiku kish marrë fizarmonikën dhe Qemali kitarën. Ata kishin zanë vend në karriken e gjatë pesëvendëshe që gjindej mbas shoferit, kështu që ishin me fytyrë nga shokët e tjerë. Në mes të Faikut dhe Qemalit ishin Nurija, Afërdita dhe Fatmira. Ata këndonin. Kurse në të kundërt të tyne, në radhën e parë, ishte Suada, Sadetja, një mjelëse e dallueme në blegtari, dhe Zana; mbas saj rrinte Xhemali, Ibrahim, Gjergji e të tjerë me radhë.

Posa hynë në Parrucë kanga buçiti ma e fortë. Ajo rrugë e drejtë ishte në ndërtim e sipër dhe çante përmes apartamenteve të reja në të dy anët. Në fundin e saj qëndronte nalt Kalaja Rozafat.

Mbrapa lanë qytetin dhe dolën te rruga e asfaltueme që gjarpënonte nëpërmes të gjelbërimeve e kodrave... Kudo të shihte syni ara të mbjelluna, taraca dhe toka të reja të çeluna tani afër, kooperativistë që punonin, kudo ndihej ritmi i punës.

Të gjithë këndonin, përveç Rrem Dembelit. Kur mbërrinë te Mali i Kakariqit, Rrema u mërzit, sepse e kishin lanë nga ana e djathtë. Atij s'i shihte syni gja tjetër përveç shkambinjsh e gurësh që për një kohë të gjatë nuk ju ndanë nga sytë. Mandej filloi të ko-

tej në gjumë. Kur mbërrinë në Lezhë pushuen pak dhe u nisën. Tek ujët e ftohtë autobuzi u ndal. Aty morën secili mëngjezin dhe hangrën me shije.

Në Laçin e rilindun autobuzi e pakoi shpejtësinë. Të gjithë pasagjerët ishin kureshtarë që të shikonin. Aty të shihte syni që po bahej një punë e madhe; të hutonte lëvizja, gjallnia, forca... Punëtorët që punonin në skelat dhe që ngrinin muret, vinçi që ngrinte land ndërtimi nalt, elektrikisti që rregullonte telat në shtyllë, maqinat që transportonin materiale, dhe ja, në një qoshe, tek po bisedonin njëni me tjetrin, me disa letra në dorë, dy inxhinjerë, njëni shqiptar dhe tjetri kinez. Sa të thjeshtë, të dashun dhe të sinqertë aq të zot, punëtorë e trima janë këta kinezët — tha Qemali.

Populli ynë nuk e harron kurrë ndihmën e madhe vëllaznore të këtij populli... — I a ktheu shokun pranë.

Autobuzi çante rrugën, e cila pothuej ishte mbyllun nga plepat, po vështrimi i udhëtarëve tretej larg dhe syni u kapte fusha e kodra plot gjelbërim. Vende-vende kish fillue të korrej gruni. Në fund kaluen Sukthin, Shijakun dhe mandej hynë në Durrës. Qyteti bregdetar, edhe po s'e pe detin, të bie në sy, me vinçat e mëdhej që ngarkojnë dhe shkarkojnë mallnat.

Para se të niseshin, Afërdita i kërkoi leje sekretarit që të shkonte dhe të takonte vëllain e saj. Me të shkuen edhe Suada, me Qemalin. Të tre i hypën autobuzit dhe shkuen në plazh, mbasi në atë orë nuk kishin tren. Shokët e tjerë shkuen të vizitonin kënetën që thahej. Aty ishte bamë gjithë ajo punë e madhe. Tri elektropompa nxirnin ujë me fuqi dhe presion të madh. Kudo ndihej thirrja e Partisë për toka të reja dhe njerëzit e kishin kthye kënetën moçalishte, kënetën e mushkojave, në tokë buke, në hektarë të tanë të shëndetshëm. Kooperativistëve u bahej zemra mal kur mendonin se çdo ditë po shtohej toka pjellore, toka e bukës në atdheun e tyne.

Ate mbasdite shetitën e panë vendet ma interesante të këtij qyteti të lashtë. Në mbramje arritën dhe Afërdita, Suada e Qemali, që kishin takue Skënderin i cili vazhdonte shkollën. Mandej, të bashkuem me të gjithë shokët dhe shoqet, vallëzuen në një pistë anës detit.

Aty ndigjoheshin përplasjet e lehta të dallgëve që bashkoheshin me tingujt e instrumentave muzikorë të parkut dhe kooperativistët nuk ngopeshin me pamjen e asaj nate të bukur bregdetare.

Të nesërmen në mëngjes shkuen të vizitonin portin. Ata i shoqnoi sekretari i partisë të portit, një burrë i gjatë, i mbushun e trupmadh, me mustaqe të zeza që i shkonin asaj fytyre të madhe dhe zeshkane. Ata vizituen anijen «Skënderbeu».

Nji kapiten vapori u shpjegoi mbi të gjitha pjesët e jashtme e të mbrendëshme të anijes, që nga timoni deri te kuzhina. Sekretari u foli atyre për guximin e marinarëve tanë, për vështirësitë gjatë lundrimit, për shkathtësinë dhe zotësinë e tyne. U foli mandej për flotën tregtare që po shtohet vazhdimisht.

Kur qenë aty, takuen edhe nji nga timonierët e asaj anijeje që ishte prej fshatit të tyne. Ata u çuditën për pastërtinë e madhe aty brenda. Ma në fund, tek zbritnin nga anija, doli nji burrë i vjetër, i shëndoshë, me nji xhakëtë të bardhë dhe u tha:

— Hajde shikoni akshihanan tonë, hajdeni!

— Po, ejani të shkojmë, se edhe kuzhinjerin e kena shkodran — tha sekretari i partisë.

Disa marinarë kur ndigjuen kuzhinjerin që tha «akshihane» ja dhanë gazit me të madhe.

Kuzhinjeri i pyeti se nga ishin dhe ata i treguen; ai i pyeti se kush e njihte Maliq Latifin, por kish pyetë pikërisht Ademin, të birin e tij. Dolën të njohun njeni me tjetrin dhe u përqafulen. Ai u dëftoi atyne se kishte njizet vjet që punonte në anije... Mandej ata zbritën shkallët e saj dhe u ulën në tokë. Sipër tyne uleshin e ngriheshin vinçat të ngarkuem me arka

të mëdha, që i zbarkonin dhe i ngarkonin. Në ato arka futej edhe duhani për eksport që kooperativistët prodhonin në fushat e tyre. Kjo i bani ta ndjejnë veten krenarë dhe të lidhun ngushtë me gjithë industrinë tonë.

Posa vizituen portin, i hypën autobuzit dhe shkuen të vizitonin fabrikën e cigareve «Telat Noga». Vizituen të gjitha repartet e fabrikës. U bani veçanërisht përshlyetje puna e vajzave që mbushnin paketat me cigare.

Duert e tyre të shpejta dhe të shkathëta, si të genë automatike, rregullonin paqetat. Mandej vizituen N.I.S.H. Gomën. Njeni nga përgjegjësit i shoqënoi dhe u shpjegoi të gjitha proceset e punës, që ku përgatitej brumi dhe deri atje ku dilte çizmja ose këpuca e punueme. Vizitën e fundit e banë në një kooperativë bujqësore të Shijakut. Këmbyen eksperiencën e njeni tjetrit dhe panë domatet. Ato ishin rritun dhe pjekun. Punëtorët i vilnin, i sillnin në hije, i zgjidhnin dhe i vendosnin nëpër arka të eksportit. Në këte kooperativë, domatet ishin pjekun ma shumë dhe ma shpejt se në kooperativën e Dobraçit. Mandej shkuen që të vizitonin stallën lopëve. Atje shërbenin disa vajza të reja; stallat ishin të ajrosuna dhe çdo gja në rregull. Mjelëset ranë në bisedë njena me tjetrën.

Në orën gjashtë mbas dreke u nisën për në Shkodër. Rrema nuk kish qejf të vizitonte e të lodhej dhe, kur ish puna që të shkonin pak larg me kambë, ai rrinte në autobus o në ndonji hije aty pranë. Autobuzi po ecte dhe kanga po kumbonte. Po ktheheshin të gjithë të gëzue për ato gjana që kishin pamë dhe për ato që s'i kishin njohun ma parë. Kënduen e qeshën gjithë rrugës. Kur mbërrinë në Milot, dielli kish kohë që kish perëndue. Pushuen pak dhe u nisën përsëri. Kaluen Milotin, Urën e Matit, dhe autobuzi filloi të gjëmonte tue ju ngjitun Pllanës. Kur po uleshin nga Pllana, Leci i tha sekretarit se Rrema mungonte

— Ndaloje, Sulë, mbaje — i tha sekretari shoferit.  
 — Pse mor? — pyeti shoferi.  
 — Se na mungon nji — dhe Sula ndali autobuzin.  
 — Kush mungon? — pyeti Sula.  
 — Rrem Dembeli — ju përgjegj njeni nga të rinjtë.

— Oh, ai na pastë faqen e zezë. Po a nuk ju ra ma parë në mend?

— Po kush dreqi i ka vue vesh atij, ai ka ndenjë atje në fund e s'ka ba za, tha Ramizi dhe pasagjerët u ulën nga autobuzi dhe ndenjën të pushonin në shkambijtë e vegjël që ishin në Pllanë. Kur po zbriste nji makinë, Sula e pyeti shoferin e saj se mos e kish pamë nji burrë tue kërkue maqinën që i kish ikun. Shoferi i tha që asht tue ardhë me nji maqinë tjetër, mbasi i patën thanë se autobuzi kaloi.

Mbramja filloi të binte, ma në fund maqina me Rremën erdhi. Kur u ul Rrema, të gjithë i folën, por ai nuk e prishte gjakun fare. Autobuzi filloi që t'i ulej Pllanës plot dredha. Kanga filloi përsëri. Shoferi ndezi dritat dhe maqina çante rrugën dhe errësirën. Të rrinjtë vazhdonin të këndonin dhe ndjenin ate gëzim që ndoshta s'e kishin ndje kurrë ashtu në kolektiv. Nji trumbë mbresash u kish mbetë në mendje, mbresa që lidheshin me viset e shëndetshme të atdheut që po rriten, po pasunohej, po bahej ma i begatshëm e ma i stolisun.

## Pjesa e tretë

### 1

Kaluen sa ditë që kur u kthyen nga ekskursioni, po ende bisedohej për ato kujtime të bukura e të paharrueme. Edhe Rrema mendohej të tregonte diçka. Ai ekskursion e kish ba të mendohej. Kohët e fundit e kish fillue punën mbarë, punonte ma tepër dhe nuk rrinte ashtu si ma parë. Përveç që i kish dhanë fjalën kryetarit dhe sekretarit të partisë që do të punojë, edhe diçka tjetër i shkaktoi këto ndryshime te Rrema. Nisi ta kuptojë që po jetonte me krahët e së shoqes; fëmijët po i rriste e shoqja dhe ai vetë po bahej turpi i botës. Nuk i harronte fjalët e sekretarit të partisë dhe sa herë që ulesh të pushonte, sikur i tingëllonin gjithnji në vesh. Ai po vërente shumë ndryshime, si në veten e tij, si në sjelljet me të shoqen dhe me fshatarët. Ma parë të gjithë e quenin Rrem Dembali, kurse tashti nuk e thërrisnin ma kështu, veç ndonjenit që harronte, nga që ishte mësue. Fshatarët filluen të flasin fjalë të mira për të. Dhe atëhere ai kuptoi se shoqënia nuk mendon për njeriun ashtu siç ka mendue ma parë, po i ven re ndryshimet e secilit. Edhe e shoqja filloi ta donte dhe ta respektonte si asnjëherë tjetër. Këto giana i ranë Rremës menjisherë në sy. Ditët

e para e pati të vështirë, se e nisi punën me hov por edhe filloi të mësohej dhe të hynte në radhën e shokëve të tjerë.

Fshati kish ndryshue ngjyrë. Gruni dukej si flori dhe ishte ba për t'i hy draoni. Duhani zbardhonte nga lulet dhe kish fillue të vjelej, posa kish mbarue prashitja e dytë. Domatet po piqeshin dhe nga arat filluen të nxjerrin për treg dhe eksport me dhetna kuintalë në ditë. Misri i lashtë kishte mbi. Edhe pak ditë dhe ai kërkonte prashitjen e parë. Të gjitha bimët dukeshin të mbara, por secila donte punën dhe shërbimet e saj, e këto ishin punë të mëdha. Për t'i përballue të gjitha duhej mjaft forcë punëtoare. Buiqësia në verë ka shumë punë, punë dhe fronte e probleme të mëdha. Gruni, po të mos korret në kohë, derdhet në arë dhe rrëzohet, domatet, po të mos vilen me kohë, prishen nga vjekja e tepërt, duhani digiet në arë dhe thahet e ban firo. Të gjitha këto pra kërkonin forca të mëdha pune, muskuj, përveç të tjerave. Ky ishte ba problem për të gjithë anëtarët e kooperativës. Organizata bazë e partisë, kryesia dhe brigadat, në orët e mbaspunës banë mbledhje ku u shtrua çështja se si t'u dilnin në krye këtyne fushatave. Atje shtruen detyra të randësishme dhe morën inisiativa të mira dhe të vlefshme. Brigadieri dhe komunisti Hekuran Shkambi u zotue se do të punonte me ditë dhe me natë me anëtarët e brigadës së tij dhe njëkohësisht do të bante edhe punën e brigadierit. Nën shembullin e tij ecën edhe të tjerët. Nuk ngeli njeri pa i vu krahët kësaj fushate. Në administratë, blegtori e kudo morën të tilla inisiativa. Ndihmësmagaziniери i kooperativës, Gani Daja, tue ju përgjegjë thirrjes së organizatës së Partisë u zotue të kalojë në prodhim.

— «Unë due të shkoj në frontin e punës, atje ku jap ma tepër dhe ku asht ma e nevojëshme. Punën që kemi ba dy vetë ta bajë vetëm njeni d.m.th. magazinieri. — Po a mund ta bajë ai vetëm — pyeti kryetari. — Unë kam besim që atë e kryen pa tjetër, por nuk

do mend se duhen përpjekje. Po të pyesim magazinierin, a i përballon punët vetëm, o Met? — Do t'i përballoj se nuk ban, shoku kryetar, do të përpiqem me mish e me shpirt që jo vetëm t'i përballoj por t'i kryej ato mirë ashtu siç duhet.

— Të lumtë!

U ba shkurtimi i disa kuadrove që vetë çfaqën dëshirën të shkojnë në prodhim. Mbase mbaruen diskutimet i aprovuen të gjithë një nga një e vendosën për ta.

Hajrije Tahiri, që bashkë me një shoqen e saj mërraj me rritjen e vëçave, kërkoi që këte punë ta bante njëna nga ato dhe tjetra të dilte në prodhim, atje ku i kërkonte puna e madhe. Edhe arsimtarët e fshatit erdhën që të banin punën fizike. I madh e i vogël dolën në fushë. Atje priste korrja, shirja, kallinjët, ma tutje hamullorët, në kopshte domatet, bostani, perimet; duheshin marrë masat për vaditje e sa e sa punëtorë e punëtore kërkoheshin në këte kohë! Fshatarët në të tilla periudha, edhe pse lodhen e këputen, e kthejnë natën në ditë dhe bajnë çmos që ta shpëtojnë mundin e vitit. Në këto ditë flitësh që do të vinn aty edhe aksionistë. Kooperativistët e banin natën ditë, ata e kishin për turp që të shikonin njëri të kthehej nga puna para se të errej plotësisht. Fjala që kishin ndigjue për aksionistët doli e vërtetë. Ata erdhën pa vonesë dhe qysh ditën e parë ja filluen punës me turr. Ditët e para u caktuen punë të lehtë si në mbledhjen e kallinjve mbas autokombajnës, në vjeljen e domatëve apo në ndonji vend tjetër. Ma vonë ata kërkuen të punonin njisoj me fshatarët dhe punën e lehtë t'ua lenin fshatarëve me moshë të thyeme. «Ne do të rrahim shatin dhe kazmën, do të prashisim e do të tëharrim krah për krah me fshatarët» pat thanë njëri i ri. «Ne, djemtë dhe vajzat e qytetit, nuk duem të jemi nga ata që vadisim lule për qejf, por duem të jemi nga ata që vadisin misrin, domatet, e çdo bimë tjetër. Ne, studentët e studentet, nuk duem të jemi nga ata që rrinë



vetëm hijeve dhe venë gjyslykë kundra diellit, apo nxihen me ngjyrën e bronxit plazheve; po duem të derdhim djersë në punë; ngjyrën e bronxit do ta marrim në fushë, në punë, aty të piqemi me kallinin e misrit, me bukën; të derdhim djersë në frontin e punës». Shpirti luftarak dhe revolucionar i studentëve me të vërtetë ishte i madh. Ata, megjithëse nuk ishin mësue të punonin në bujqësi, dalloheshin për punë me cilësi të mirë. Edhe ata punonin si kooperativistët me orë të zgjatuna. Kish nga ata që për çdo ditë tejkalonin dhe thyenin edhe nga dy norma.

Autokombajnat u futën të korrnin grunin. Këte vit gruni po paguente mirë; thasë të tanë mbushte autokombajna dhe maqinat i dërgonin në depot e shtetit. Autokombajneri punonte me parrullën: «Asnji kokër gruni të mos shkojë dam», kurse korrësit dhe mbledhësit e kallinjve mbas autokombajnës punonin me qëllim që «Asnji kalli të mos shkojë dam». Kështu vepronin të gjithë, sepse ajo ishte kafshata e gojës. Atje ku korrej gruni, në parcelat matanë rrugës së Koplikut, të kënaqej shpirti kur shikoje të gjithë ata krahe pune që lëvrinin. Punëtorët mblidhnin kallinj të rrëzuem që nuk i kapte kosa, i fshinin, i banin duej dhe ja hidhnin autokombajnës, që me dollapet e kosat e mprehta, i gëlltiste duejt me të parën si ndonji përbindsh i uritun dhe mandej e nxirrte bykun në pjesën e mbrapme. Mbas tyne shkonin bujqit, ngarkonin grumbujt e bykut që i lente autokombajna mbrapa, i vendosnin në kavaleta të mëdha e të gjata pastaj i lëshonin vendin traktorit që lesonte tokën për misër hamullor. Dhe përsëri mbas traktorit të parë me plug, shkonte traktori i dytë me disk, që e bante dheun në thërmia të imta. Mbas tyne shkonin pulëbardhat, serrat e shpend të tjerë, që hanin insektet e nxjerruna jashtë në sipërfaqe. E gjithë fusha zjente nga kjo punë e madhe. Fusha ndryshonte krejt pamjen dhe s'ta mirrte mendja se disa orë ma parë gjithë ai vend kish qenë i mbjellun me grunë. Punët po mundeshin me

forcën e madhe të kooperativistëve dhe aksionistëve. Kudo zjente puna. Nuk i harrohet Hekuranit kur një ditë shkoi dhe punoi në mes të aksionistëve. Ate ditë në krah të djathtë kishte Lilianën, një aksioniste që prashiste me dorë të lidhun. Kur erdhi infermierja dhe ja zgjidhi fashon, Hekurani vuni re që plaga e filluskës që ishte ba nga shati i ishte hapë dhe pezmatue. Mbase ja zgjidhi e ja dizinfektoi dhe me një fasho tjetër të bardhë e të pastër ja lidhi dorën siç e kishte. Liliana ja filloi punës përsëri si ma parë.

— Si punon kështu me këtë dorë kaq të pezmatueme? — e pyeti Hekurani i çuditun. Liliana vuni buzën në gaz dhe i tha me tonin e saj të butë dhe në mënyrën ma të thjeshtë: — Jo, mor Hekuran, kjo nuk asht plagë sa për të lanë punën, — dhe ndroi kraahun e shatit ashtu siç e kishin mësue fshatarët, që të prashiste ma lehtë e të lodhej ma pak. Edhe këtu duhet të përdorte ma tepër mjeshtëri se sa forcë.

— Si? po unë e pashë, ajo nuk asht plagë e lehtë, të paktën ban ndonji punë tjetër, — i foli Hekurani përsëri.

— Jo, Hekuran, unë kështu due ta kalis këtë. Po të rri, kjo prapë do të më dhembë, e dora nuk do të forcohet. Hekurani ngeli nga përgjigja e kësaj studenteje që nuk ishte mësue të kapte shat ndonjherë. Ajo, megjithse kishte dorën e sëmënë, nuk mbetej mbrapa shoqeve, por gjithnji printe e para. Ai këtu punoi disa ditë dhe i takoi të shikonte edhe një rast tjetër. Një shoqe e skuadrës së Lilianës, që quhej Drita, ishte e sëmënë. Këtë ajo nuk ja tregoi kujt, por Liliana dhe shoqet e tjera e diktuen, posa e panë. Kishte dhimbje dhe temperaturë. I thanë që të shkonte të vizitohej, por ajo nuk u bind, nuk donte të largohej nga puna. Ato lajmëruen infermierën. Termometri tregoi temperaturë të naltë. Infermierja e urdhënoi të shkonte të binte në kaponon dhe t'i jepte ndonji ilaç. Drita përsëri nuk u bind, donte të punonte. Infermierja lajmëroi komandantin e kompanisë që Drita ishte e së-

munë dhe nuk dëgjonte të lejë punën. Komandanti erdh dhe ajo, ma në fund, ju bind atij.

Kur shikonte vrullin e tyne, Hekuranit i gufonte zemra dhe thoshte se rinia ishte me të vërtetë një rini me vullnet të çeliktë. Puna e aksionistëve i çudiste të gjithë fshatarët. Ata, sapo u shtruen dhe u mësuen mirë me punën, nuk donin që t'u lenin gja mangut kooperativistëve si në cilësinë e punës ashtu edhe në realizimin e normave. Në punë e ndjenin tashti veten ma mirë dhe me shëndet, sepse trupi i tyne forcohej, po kalitej dhe mbushej me forcë. Kështu kaluen disa ditë dhe punët filluen të lehtësoheshin, sepse u ba një forcë e madhe punëtore. Nga ky mobilizim i madh korrrjet u kryen një javë para afatit. Planin e grumbullimit të grunit e tejkaluen. Hamullorët e lëruen dhe i mbollën ashtu tue punue terr më terr, pa marrë parasysh lodhjen, kështu që edhe ato përfunduen si çdo fushatë tjetër para afatit. Sa djersë e mund derdhën për t'ja mbërritë këtij qëllimi!

Forcat punëtore, që ishin në mbledhjen e kallinjve dhe korrrjeve, i dërguen për këputjen e lules së duhanit, sepse lulja sa ma shumë që të rrinte aq ma tepër u pinte yndyrën gjetheve. Aksionistët propozuen që orët e pushimit që kishin në mesditë t'i paksonin dhe kohën tjetër të përshkonin duhan. Ky ishte një mendim i mirë i aksionistëve, kjo ishte një ndihmë tjetër e madhe.

Ishin bamë tri ditë që aksionistët ishin largue nga shtëpitë e tyne, nga nana, baba dhe vëlleznit. Kur i përcollën, ata i porositën bijtë e tyne që të punonin mirë dhe të mos kursenin forcat. Dhe ja, me të vërtetë, ata, përveç zotimeve mbanin edhe porositë e prindërve. Të djelën e tretë aksionistët banë pushim dhe e lanë që të shkonin në liqe për të lamë ndresa e çfarë kishin. Po atë ditë erdhi në kooperativë një grue e pjekun në moshë, me një trup të shëndoshë dhe të shkurtën. Mbante një çantë të madhe që ja randonte dorën. Posa hyni në oborrin e kooperativës, pyeti për

aksionistët. Ata i thanë se kishin shkue në breg të liqenit, i treguen rrugën për atje dhe ajo u nis. Afër bregut pa këmishët e ndeme në degët e shelgjeve. Kish dalë nga ana e kundërt e rrugës nga i kishin thanë; kështu që të kalonte deri në breg të liqenit duhej të kapërcente një vijë, e cila nuk kish as një pëllambë ujë por rrethohej nga disa metra batak. Grueja uli çantën, xhveshi pantoflat dhe mendoi të kalonte ujin e cekët, e mandej të hidhej në breg, ku të takonte vajzën e saj, «shpirtin e mamit të saj». Mori pantoflat në dorën e majtë dhe me të djathtën kapi çantën e randë dhe u ba gadi të kalonte vijën; po, kur e hodhi kambën e parë, u zhyt në ujë dhe baltë deri në nyjet e kambës, kur hodhi të dytën u zhyt pak ma thellë dhe kur mori të hiqte të parën dhe të ecte, kamba e dytë u fundos edhe ma thellë. Fustani i hollë veror, i premë pak ngushtë nga fundi, ju shqep, ajo qëndroi në kambë që të pushonte. Pantoflat që i kishte në dorë ju dukën të randa dhe ajo mendoi që t'i hidhte në breg, prandaj i flaku tej, por ato ranë në ujë dhe nuk u panë ma. «E mjera unë, mbeta këtu» psherëtiu, i dha vetes të ecte por më kot. Balta e randë dhe e ngjeshun nuk e lëshonte. Nga bregu ndigjonte fjalët dhe të qeshunat e aksionistëve. Për të pa nuk shikonte gja, sepse sipër saj ishte bregu dhe shelgjet e shpeshta. Mendohej të dallonte zanin e së bijës dhe i thirri:

— Flora-aa! — me sa za që kish, por zani i saj dilte nga vija si za i mbytn. E kush ndigjonte? Atje dikush këndonte, dikush qeshte apo bisedonte; edhe Flora ndoshta qeshte atje në breg, kurse mami i saj gati sa s'qante në mes të baltës. Ajo vazhdonte të thërriste deri sa ju çorr zani dhe s'ish e zonja të thërriste ma. Fustani dhe fytyra i ishin ba gjithë baltë, vetëm gjysma e trupit i kishte mbetë në sipërfaqe. Njeri nuk lëvizte andej. Nga e djathta kishte zhuga të denduna dhe shelgje ujëse.

Luani, një i ri aksionist, kish hypun në majën e një shelgu të madh që të këpuste një degë të drejtë dhe

të bukur e t'i vente shatit të tij një bisht të ri. Kur pa nga pylli poshtë i shkuen sytë te vija me pak ujë ku lëvizte diçka. Në fillim i ngjau se ishte ndonji dosë, por mandej e dalloj që ishte grue. I shkoi mendja që ajo vijë ka baltë, ku humb, dhe grueja duhej ndihm-mue. Ai ndigjoi sërish zanin e mbytnun që thërriste: Flora, Flora...

— Kush thërrret andej? — pyeti Besniku.

— Nji grue ka mbetë në vijë para bregut dhe ka humbë deri në mes në baltë; thërrret Flora; mos asht nana e Florës, se nuk asht grue fshatare.

— Pse, çdo ajo këtu? Po ulemi ta ndihmojmë, — tha Luani dhe bani të ulej. Këte bisedë e ndigjuen dhe disa vajza ma larg, që sapo dolën nga ujët e liqenit. Në mes tyne ishte edhe Flora. Ajo u pre menjherë. U skuq në fytyrë nga turpi. Luani i tregoi ç'kish ndodhë me të amën dhe të dy morën të nisen.

— Luan, ku po shkoni? — pyeti komandanti i kompanisë.

Ai i tregoi dhe u nis bashkë me ta. Flora ecte me fytyrë për tokë dhe nuk e hapte gojën. Posa u afruen, u shkuen sytë te grueja që bante përpjekje të kota të dilte. Aksionistëve, me të pa këte skenë, u vinte hem keq, hem për të qeshun. Flora e pa nanën e saj që kishte ngelë në baltë, dhe pa folë u ba gati të hynte.

— Më ndihmoni, se mbeta, — fliste nana e Florës tue u përpëlitë e tue ju marrë fryma.

— Ku do të shkosh, Flora? — i foli Luani asaj — e di se do të ngelësh edhe ti brenda? Rri, se e nxjerrim ne. — Flora e turpnueme u tërhoq. Të gjithë filluen të mblidhen në anë të vijës.

— Kush asht ajo që ka mbetë në baltë, pse nuk e rimorkioni, — tha Latifi që po zbriste nga bregu. Disa qeshën fshehtas tue iu ruejtnun së bijës, që e shikonin se ishte me turp. — Për ta nxjerrë shpejt ne do të veprojmë kështu, — u khye e u tha aksionistëve Luani, — të gjithë kështu siç jemi të lëshohemi dhe të thyejmë kallamishte pylli dhe degë shelgjesh e t'i

shtrojmë sipër, në mënyrë që të mos humbasim edhe ne. — Pranuen të gjithë dhe me vrap filluen të thyejin degët dhe t'i shtronin sipër baltës së trashë. Mbasi i shtruen, Luani me Besnikun ecën mbi to, e kapën për krahësh gruen dhe me njimijë halle e nxorën sipër degëve, Nga të tërhequnit gati ja shkulën krahët. Kur grueja doli sipër bregut, fustani nuk i dallohej fare nga balta. Ata e morën, e ngjitën sipër dhe i thanë të futesh në liqe dhe të lante baltën. Kështu u ba. Mbasi u la mirë e mirë, grueja doli në breg që të thahesh dhe të fliste me të bijën. E bija ishte ba helm e vnerë nga kjo dhe fytyra sa nuk i binte përtokë nga turpi i shokëve dhe i shoqeve. Deri në këte ditë nuk kish ardhun asnjë prind që t'i takonte. Dhe e ama, le që erdhi po u ba edhe gazi i të tjerëve! Fustanit të saj nuk mund t'i përcaktoje se çfarë ngjyre kish pasë, sepse balta e moçalit e kish nxi dhe ba me danga. Nuk panë si ndejtën as e ama me të bijën dhe as e bija me të amën. Mbasi u çlodh e ama, Flora nisi t'i thotë se nuk kish ba mirë që kish ardhë. Të gjithë ata të rinj kishin prind, por e ama përsëri e përkëdhelte: Flora e nanës; Flora e mamit, e si m'u rrinte mue pa ardhë me të pa? Këtu jeni lodhë. A e sheh sa je dobësue? Ç'ka t'i baj se të gjitha ushqimet m'u banë me baltë, edhe pulat e pjekuna, edhe byreku dhe të gjitha.

— Jo, nanë, — i thonte ajo, — ke ba shumë keq, më ke turpnue para të gjithëve këtyne shokëve.

— Oh, të marrshin të keqen ata ty! Po s'di si t'ja baj për me shkue në shtëpi; fustani m'u shkye, pantoflat humbën në baltë, me hangër gja nga këto që të solla nuk hahen, se për të tjerat nuk po nxej kryet.

Aksionistët ndenjën aty deri në të perënduem të diellit. Ata u lanë dhe u kënaqën në ujët e liqenit. Të nesërmen do të dilnin në punë me forca të reja. Bashkë me ta u nis edhe nana e Florës. Rrugës ecte zbathun dhe fustanin e shkyem e mbante në dorë. Ne vend të fustanit të hequn kish veshun atë që e bija e

kish marrë tepër në aksion, si të gjithë. Po fustani i Florës i binte gadi deri në fund të kambëve. Kur përcolli nanën, Flora u kthye te shokët dhe shoqet e turpnueme, sepse një gja e tillë me të vërtetë nuk ishte e hijshme. Po ata nuk ja zunë me gojë këte punë. Prindërve ca gjana ua falim. Çdo gja ishte e qartë, ajo e pësoi vetë ate që e meritoi, kjo që ndodhi me te ishte dënimi ma i madh që i bani vetes. Të nesërmen aksionistët përsëri u ngritën herët si ditët e tjera. Kjo ishte java e fundit e punës dhe gjatë atyne ditëve derdhën djersë e mund. Duert e studentëve dhe studenteve tashma nuk ishin të buta e të bardha. Në to ishin formue kallo të forta. Ditët e fundit të aksionit ata nuk do t'i harrojnë kurrë. Ato qenë ditë kur u kalitën, forcuen trupin dhe vullnetin dhe u përgatitën për të ardhmen. Po në mendjen e tyne mbeti si një kujtim i ndritun dashunia për punë e fshatarëve të palodhun e heroikë që lagnin me djersën e tyne çdo kokër grun, çdo pëllambë toke.

## 2.

Kooperativistët nuk do të harrojnë kurrë ndihmën e madhe të aksionistëve. Nuk e prisnin që ata të bënë një punë aq me zemër dhe aq të madhe. Kjo punë dhe ndihmë bani që secilës bimë t'i plotësoheshin të gjitha kërkesat e nevojshme dhe bimët u rritën të shëndetshme.

Mbas korrjes dhe shirjes së grunit, misri i lashtë u ba për shat. Të rinj dhe të reja shkuen atje ku i kërkonte puna. S'kish asnjë të ri apo të re që nuk realizonte dhe tejkalonte normën. E të tejkalosh normën me shat, mu në tokat e trasha buzë liqenit, nuk asht lehtë. Në brigadën e katërt dhe pikërisht në skuadrën e Ibrahimit, edhe pse gjendeshin në tokat ma të vështira, e tejkalonin të gjithë nga një normë e gjysme. Edhe Leci ecte bashkë me ta. Ai tashti kishte ndryshue rrugë. Nuk e thente ma disiplinën. Ate zotim

që kishte marrë në mbledhje të organizatës së rinisë me të vërtetë po e vente në jetë. Ibrahim i ndigjonte si babën e tij. Kudo punonin bashkë. Edhe në qytet, sa herë që delnin, delnin bashkë. Por kjo kthesë që kishte ba Leci, në radhë të parë, ishte frut i punës së gjithë shokëve të skuadrës dhe veçan e Ibrahimit, sepse ai e këshillonte gjithnjë dhe e kish në mbikqyrje. Po t'ja përmendje Lecit ato që kish ba ma përpara ai turpnohesh shumë, skuqej dhe thoshte: «Atëhere isha më të vërtetë në rrugë të gabueme».

Për çdo ditë të martë në kooperativë banin mbledhje brigdash. Secila brigadë në vete mernte në analizë punën dhe problemet e javës së kalueme dhe ato të javës së ardhme. Secila rrihte problemet e saj aty ku i kishte ma keq. Gjithashtu një herë në javë bahej edhe informacioni politik. Gjaja që të bante ma shumë përshtypje ishte interesimi i madh që tregonin fshatarët për ato që ndodhnin në të katër anët dhe adheut tonë dhe kudo në botë. Njëpërmjet diskutimesh nxirreshin shkaqet e të metave në punë dhe përvëqë kësaj, kooperaivistët njiheshin ma mirë me problemet e politikës së jashtme e të brendshme. Kur kish mbledhje të tilla, puna lihej një orë para orarit. Qemali dhe Agimi qenë tue shkue në mbledhje dhe rrugës po bisedonin njëri me tjetrin për punën gjatë ditës. Atyne u ra në sy një plak që vështronte dhe shkone si i habitun sa andej këtej. Kur u afruen, ai i pyeti:

— A është fshati Drobaç këtu, or djem? —

— Po, o xhaxho — i tha Qemali.

— Ahmet Shabani ku e ka shtëpinë? — pyeti i panjohuni, një plak i thinjun, bardhosh e i mbajtur në veshje dhe trup.

— Ja edhe pak, po unë jam biri i Ahmetit.

— Ti je djali i Ahmetit? — pyeti plaku i çuditun dhe ju hodh në qafë e përqafoi.

— Po si jeni nga shtëpia, Ahmetin si e kam me shëndet?



— Mirë asht, mirë, po juve si jeni? — pyeste Qemali tue e përçafue.

— Që ta dish, or bir, unë jam Petro Rrapi nga Fieri, mik i vjetër i Ahmetit.

— Po, më shkoi mendja, sikur të njoha pak, po s'isha i sigurt, më ka dftue baba shumë herë për miqsinë tuej. Po që të njihesh me këtë shokun, o xha Petro, ky asht djali i Hysen Gurrës.

— Oh, po unë paskam takue në dy djemtë e miqve! — tha xha Petrua dhe u përçafue edhe me Agimin. Agimi dhe Qemali kthyen nga rruga futën xha Petron në mes dhe u nisën për shtëpi.

— Po paska ndryshuar fshati fare! — filloi të flasë xha Petrua; — mua më drejtuen gjer këtu, pyesja ku është Dobraqi dhe më thoshin se në Dobraq isha. Nuk kanë lanë asnjë shtëpi nga ato që qenë para gjashtë-shtatëmbëdhjetë vjetve kur isha këtu. Vetëm andej nga fundi paskan mbetë ca; atëhere fshati ishte mbushur plot kasolle. Ja ajo shtëpia tani po më kujtohet që ishte e re. Tani, po ta krahasosh me këto të tjerat, duket e vjetër. Për ndër akoma nuk më besohet që gjendem në Dobraq. As gjëja më e vogël s'paska ngelur nga e kaluara... Po si i keni punët këtej? Fliste dhe shikonte si i hutuem gjithandej.

— Shumë mirë, — u përgjegj Qemali.

— Po Ahmeti me Hysenin si janë, a janë mplakur?

— U plakën o xha Petro. Helbete moshë e vjetër janë.

— Po, or bir, ne u plakëm tani, ju qenkeni rritur e bërë burra. Kur isha unë të fundit herë ju lashë fëmijë.

— Të kthejmë këtu në të djathtë, xha Petro se ja, kjo asht shtëpia jonë, — tregoi me dorë Qemali dhe morën kthesën.

— O... paskeni ndërtuar shtëpi të re thiri plaku tue e vërejtur me admirim. Hynë në oborr dhe aty jashtë gjetën Ahmetin ulun në karrike. Ai shikonte

këtë njeri që i dukej i njohun po nuk po i binte në te. Ajo fytyrë sikur i ngjante dikujt, por plaku nuk po pikaste kush ishte. Kur ja ndigjoi zanin, menjherë i shkoi mendja se ai ishte Petroja, miku i tij i vjetër. Atëhere u ngrit në kambë dhe thirri i gëzuem: O ti, mirë se na erdhe, o mik i vjetër, po sa mirë e paske ba!

— Epo thashë që të kujtojmë miqësinë edhe një herë tani që u mplakëm, se po na mbarojnë ditët... — i tha xha Petroja tue qeshun. Të dy qeshën dhe u përçafuen si dy miq që s'janë pa për një kohë të gjatë.

— Po si je, o Petro, me shëndet, a je mirë?... — e sa e sa pyetje të tilla i banë njëni tjetrit tue u përçafue me dashuni.

— O plakë, del, se na ka ardhë një mik! — thirri Ahmeti gruen e tij nga jashtë. Plaka doli, u përçafue me xha Petron dhe mandej hynë mbrenda në shtëpi, në dhomën e miqve, e cila ishte rregullue ma së miri.

— Po ulu, Petro, ulu.

— E pra... thashë të shkoj një herë atje në Shkodër që t'i shoh edhe një herë miqtë e vjetër gjersa të jem një çikë i fortë.

Në dhomë erdhi edhe Hyseni. Biseda u gjallëue edhe ma shumë nga pyetjet e ndodhitë që i tregonin njëni tjetrit:

— Po andej a ka ndryshue katundi, Petro?

— Si jo, i gjithë, si këtu dhe atje. Ja, o Ahmet, kur bisedonim dikur për luftën dhe komunistët. Të gjitha këto m'i thonte djali im që ra dëshmor, por unë nuk i besonja atëhere të gjitha. Thosha se ato ndoshta bëhen, por unë s'do të jem gjallë. Po erdhi dita që unë t'i shoh me sytë e mi. Nga erdha rrugës kudo pashë ndërtime, ndryshime, vendi zbukurohet dita-ditës.

E pra erdhi edhe dita jonë që mos me punue ma për atë tjetrin... ndërhyri Ahmeti. Plaka solli tri gota të vogla, i vendosi sipër tryezës, solli shishen

e rakisë, pirunj, pjata dhe i bani gati që të uleshin të tre. Tre pleqë të ulën rreth tryezës. Ahmeti mori shishen dhe i mbushi gotat e vogla me raki.

— Çoje, pra, Petro! Mirë se na erdhe në shtëpinë tonë të re! — i tha Ahmeti mikut dhe që të tre i njomën buzët dhe mandej e kapërdinë nga pak. Mbasi morën edhe meze, Ahmeti pyeti:

— Po si e keni senen sivjet andej? a keni gjetë bereqet? — Kështu e shtruen bisedën për shtatë palë qejfe tue bisedue për të kaluemen e tyne të hidhun, për ditët e bukura që po kalonin tashti në pleqëni, për bujqësinë, e gjithëcka. Ma vonë erdhi edhe Ismaili, djali i madh i Ahmetit bashkë me të shoqen dhe Qemalin. Mbasi u përshëndetën me mysafirët, Ismaili zuni vend pranë Hysenit, kurse Qemali karshi tre pleqëve.

— Po na trego, o Ahmet, ndonjë nga ato historitë për luftën nacional-çlirimtare, se unë në atë zjarr lufte ndënja pa ditë këtu — tha tha Petrua në kohën që ngriti potirin.

— Posi, o Petro, sonte do t'ju tregoj ca — foli Ahmeti, teksa mori pak meze e u kollit dy tri herë, — ca të tjera do t'i lemë për nesër mbrama.

Xha Petroja, Xha Hyseni dhe djemtë e Ahmetit bashkë me nusen e re ndigjonin me vemendje historitë e plakut dhe heshtnin të menduem.

— Çoje, o Petro, për ditët e gëzueme që na erdhën — tha ma në fund Ahmeti dhe të gjithë ngritën dollinë. Atë natë ndejtën deri vonë tue bisedue, tue pi e tue u kënaqë njeni me tjetrin. Të nesërmen në mëngjes, mbasi u zgjuen nga gjumi, pinë nga një kafe dhe mandej dolën të shëtitnin bashkë me Ahmetin në kopsht dhe në arat e kooperativës. Xha Petroja nuk shikonte asgja nga e kaluemja. Gjerdhe dhe rrugë, brigje dhe hendeqe ishin ba një. Ahmeti filloi t'i tregonte për të kaluemen e këtij fshati:

— Qindra vjet përpara Dobraçi s'ka qenë ku asht i vendosun sot, por buzë liqenit. Fshati ishte i

madh, bile shtëpitë thuhet se kanë qenë të puthituna njena me tjetrën dhe ka pasë një popullsi prej 1500-2000 vetash. Shtëpitë e fshatit kanë qenë përdhese ose kasolle prej kashte, ndërsa shtëpitë e bejlerëve kanë qenë dykatëshe. — Xha Petroja ndiqte me vemendje bisedën e mikut të tij të vjetër, ai mendohej të imagjinonte fshatin e vjetër buzë liqenit. U ndalën, drodhën nga një cigare të trashë dhe me nge banë të ecnin përsëri nëpërmes fushave. — «Popullsia e fshatit asht marrë me bujqësi e blegtori, tokat që punoheshin mbilleshin me grunë e misër dhe ishin mjaft prodhuese. Fshatin buzë liqenit, në të kaluemen, e dëshmojnë edhe mbeturinat e xhamisë së vjetër. Ma vonë fshati u zhduk nga sëmundja e kolerës e cila bani kërdrinë në popullsi dhe i detyroi ata pak njerëz që mbetën të shpërnguleshin andej dhe të vendosen diku asht fshati i ri sot. Me kohë u rrenuen shtëpitë, u prishën rrugët, dhenat, dhe sot, kur lavrojnë tokën qilizëm, gjejmë mbeturina të shumta tjegullash, kapulesh gjymesh, ibrikësh, brinë kaprolli etj.

Fshati ka qenë pjesë përbasë e Shtoit, bile thohet se Bazhdari ka pasë qëndrimin e tij të gështenjat, — dhe tregoi me dorë vendin. — Thuhet se aty peshohesh rrushi, pemët e të tjera sende bujqësore e blegtorale që ngarkoheshin në karvane e nxirreshin jashtë nga sunduesit e huej. Ndërsa në parcelën që quhet xhelepe, tagrambledhësit e asaj kohe mblidhnin tokat e fshatarëve. Simbas disa thanieve, tridhetë e pesë vjet mbas kolerës, fshati numuronte ma se 2000 krenë bagëti, të cilat i kullosnin çobejtë. Fshati filloi të shpëhej edhe në popullsi; u ndanë mjaft familje të tjera, shtëpi të tjera u ngritën (natyrisht të ulta) me gurë të sjelluna nga Kiri e tjegulla të punueme në vend. Kështu filloi formimi i fiseve dhe familjeve të mëdha me nga 30-40 vetë si: Dizdart, Ademt, Manajt, Hysen Aliajt, Dergjint, Vucajt dhe Çobejt. Emnat e këtyne fiseve i gjejmë nëpër tokat e tyne dhe deri tashti ato kështu njiheshin. Ka pasë vite që fshati ka vuejtë

shumë për ujë e bukë, kjo ka ndodhë nga thatësinat e mëdha që kanë mbajtur në ato vite. Bile thuhet se dhetë shtëpi kanë çue me blue me një kalë në mullinin e Boriçit të Vrakës dhe kali, megjithëse ka pasun blojën e dhetë shtëpive, ka shkue lehtë. Për bartje kanë qenë qerret e mëdha prej druni të tërhequna prej qesh. Rrugët kanë qenë të këqia e të ngushta. Rruga, që quhet rruga e Bultit, ka qenë rruga kryesore e fshatit. Andej kalonin të gjithë fshatarët dhe malësorët e veriut të Shkodrës. Ajo ish e gjanë katër metra. Në mes të saj ka qenë i vendosun kalldrëmi në formë kurrizi.

— Po veshjen si e kishin më përpara a di të më tregosh Ahmet? — e ndërpreu bisedën xha Petroja.

— Edhe për veshjen di të të kallxoj diçka nga ç'më ka ditue gjyshi im. Këte veshje e kish mbërrir edhe ai. Veshja ka qenë e thjeshtë, burrat me dollama e shallvare, ndërsa gratë me barnavekë gjatë dimnit dhe me syre e fustane të gjata gjatë kohëve të tjera. Ma vonë veshja nuk pati ndryshim; gjithnji visheshin me çakçirë, anteri, xhamadanë të punuem nga artizanët shkodranë, me qeleshe të bardha, qylafe e brepantallona kadifeje, me këmisha të bardha. Për këpucë përdornin opinga gome. Syret e grave kanë qenë me ngjyra të ndryshme, të stolisuna me ojna që i punonin vajzat e gratë e fshatit. — Mbërrinë pranë një parcele të madhe të mbjellun me domate. Aty punëtorët po vilnin, ndërsa disa të tjerë vadisnin specat.

— Domatet qenkan të mira, Ahmet.

— Po, sivjet me të vërtetë kanë nxjerrë prodhim. Në fillim të thonte mendja se nuk e nisën mbarë, por puna e mirë i bani kështu të rriten të mira.

— Epo u muar vesh që puna e mirë të nxjerr gjithmonë mirë, — tha xha Petroja dhe këputi një kërr domateje të kuqe, e shikoi dhe mandej me brisk e ndau në dysh. Njenën ja dha Ahmetit dhe tjetrën e mbajti.

Shëtiten atë ditë sa u lodhën dhe nuk lanë gja pa

pa. Xha Petroja mbeti i kënaqun nga Ahmeti, i cili jo vetëm që e njohu me fshatin po edhe me lashtësinë dhe historikun e tij. Tue ecë ngadalë u kthyen përsëri në shtëpi. Aty i priste Hyseni, i cili nuk kishte mundun t'i shoqñonte këte ditë, sepse e kishin kërkue në mëngjes herët për një punë të kooperativës. Petroja kish ardhun të rrinte katër net, dy te Ahmeti dhe dy net të tjera te Hyseni, dhe kështu veproji. Që të dy nuk deshën ta lejonin që të shkonte, por ai nuk ndigjoi kurrsesi. Ate ditë që u nis xha Petroja për në Fier, Ahmeti dhe Hyseni e përcollën miqësisht. Petroja u tha atyne që të vinin edhe ata në Fier dhe të shikonin fshatin e tij e mandej i lanë shëndetin njëni tjetrit të mallëngjyem.

\* \* \*

Ditët kalonin njena mbas tjetrës. Mesi i verës erdhi. Dielli digjte si saç. Duhani mbërrini në gjethet e mesit dhe pjekja e tij ishte e mirë dhe e njihershme. Ai lypte një pjesë të mirë të forcave punëtore. Tendat filluen të mbushen plot me vargje duhani të thatë e të njomë.

Vjeljen dhe përshkimin e duhanit në vargje e banin gratë që ngriheshin herët në mëngjes pa le dielli, i vendosnin nëpër kosha dhe mandej i dërgonin në stallë, ku i përshkojshin në vargje. Stalla mbushej plot me punëtorë. Ishte një repart i tanë punëtorësh; kush kish fëmijë shtatë vjeç e tej, të gjithë vinin e banin vargje duhani; kështu ngjante me brigadën duhanore. Kurse në brigadën e perimeve punët ndryshonin; atje fronti i punës ishte ma i gjanë.

Të gjithë motorat e vaditjes dolën në fusha. Tash-ti toka dhe bima donte lagështinë, ujë. Që nga xhadeja e Koplikut e andej nga liqeni tokat i vaditnin me motora, kurse nga xhadeja e nalt i vaditnin me ujin e kanalit të Postribës. Misri i lashtë donte ujë. Dalngadalë po bahej edhe misri hamullor; domatet donin ujë,

bostani, e të gjitha po ashtu, përveç duhanit që njihë për njihë s'donte. Motorat u vendosën, dhe u montuen nëpër puse. Çdo parcelë kishte nga një puse ose ma tepër; si të ishte nevoja. Kryetari kish dhanë urdhën që motorat të punonin ditë e natë pa ndërpreme. Fushat kishin gjallni edhe natën. Në çdo anë ndigjoje motora, traktorë, punëtorë. Qemalin e caktuen që të shkonte ndihmës-motorist me një motor «Deutz». Ky motor punonte me benzinë dhe shkonte mirë, megjithëse ishte i vjetër. Ma parë kish qen i një zotnie të Shkodrës, që në atë kohë e pat blenë në Itali për të vaditun tokat e tij, por kur zotërinjtë falimentuen ua morën tokat dhe motorin. Koha e vaditjeve nuk asht e shkurtën. Ajo zgjatte me javë. Gushti kish hy. Fiqtë, rrushi dhe bostani filluen të piqeshin. Qemali po vaditte domatet. Motori ku punonte ai ishte në mes të misrit të rritun, por ujët përcillej në kanal dhe nga kanali në domate. Sa herë që Afërdita shkonte për të marrë ujë te motori, e gjente Qemalin tue lexue ndonji libër nën tendën me sanë që e kish ba vetëm për hije. Ajo mbushte grushtin me ujë dhe ja hidhte në trup befasisht. Ai posa ndjente piklat e ftohta të ujit ngrihej me të shpejtë dhe shikonte se kush po e lagte. Shikonin njeni tjetrin, buzëqeshnin dhe mandej rrinin bashkë një copë herë deri sa Afërdita ikte përsëri në punë.

Vaditja e parë mbaroi. U derdh djersë, mund. Fill mbas saj filloi prashitja e dytë. Prodhimet po baheshin të mira. Domatet, bostani, frutat e të gjitha filluen të vilëshin me shpejtësi. Domatet sikur s'po mbaronin kurrë, vjelëset s'pushonin të mbledhunit ndër to. Tendat e duhanit ishin mbushun plot e përplot me vargje. Për çdo ditë lidhnin duhan të thatë. Në oborrin e madh të kooperativës, në stalla, në hangarë nuk shikoje gjë tjetër përveç duhanit që thahej në diell.

Shtatori po afronte dhe kooperativistët duhej të grumbullonin duhanin, ta vilnin simbas rregullave, ta përshkonin dhe ta thanin sa ma shpejt. Të gjithë shpej-

tonin, i madh e i vogël. Edhe burrat, që nuk u vinte dore për duhan, edhe ata mësuen. Po ikte vapa me gushtin. Nji ditë, kur po mbyllej gushti, koha u prish. Disa re filluen të lundronin nëpër qiell si në kalim dhe zenin vend në male. Në mes të natës çanga nisi të binte pa pushim. Të gjithë ato mija e mija vargje duhani duhej të strehoheshin me të shpejtë sa pa i zanë piklat e shiut, ndryshe duhani do të njollosej dhe do t'i binte kualiteti dhe vlera. I madh dhe i vogël vrapuen atje. Vetëtimat t'i verbonin sytë. Çanga binte pa pushim, dhe kjo i bante të shpejtonin edhe ma shumë. Nga dyert e shtëpive rendnin me nji frymë burrat, gratë, të rinjtë dhe fëmijët. Ishte si nji alarm i madh për të shpëtue mundin dhe djersën e nji viti. Po të mos vraponin kështu, duhani ndoshta do të lagej dhe do të prishej. . . Duhani u strehue i gjithë. As gjethet s'i lanë në tokë, por edhe ato i mblodhën. Mbas pak filluen piklat e shiut. E në verë, në këto anë ndodh rrallë që të bjerë shi i butë siç mund të bjerë gjetiu. Mbas piklave të rralla filloi të binte nji shi i fortë. Po tashti ai le të binte. Duhani ishte strehue. Punëtorët e lodhun u nisën për në shtëpia. Shiu vazhdonte të binte me shtama. Të nesërmen koha gjithnjë ishte e mvrejtun. Toka ishte lagun dhe e ngopun me ujë. Gropat dhe hendeqet ishin mbushë me ujë shiu. Punëtorët shkuen nëpër stalla që të rregullonin dhe t'i sistemonin vargjet që ishin futë nji natë ma parë të ngatërrueme me njeni tjetrin. Mandej, kur i sistemuen, morën duhanin gjysmë të thamë dhe ndanë gjethet e ngjituna nga njena tjetra në mënyrë që të ajroshin. Me këte punë u morën tanë ditën. Të nesërmen, me që qielli ishte i kthjellët, nxorën sërish duhanin jashtë dhe vazhdoi kështu tharja normale.



Në fillim të shtatorit u ba mbledhja e organizatës së rinisë. Aty folën për punën që kishin bamë të rinjtë gjatë asaj kohe. U përmendën punëtorët e mirë e ndër ta edhe Leci që kish bamë një kthesë të fortë e të madhe. Analizuen punën mujore dhe punët e tjera që u dalin tashti gjatë këtij mueji. Ma në fund u ngrit sekretari i organizatës dhe tha me një ton të qetë: «Ne, më datën pesë, si të gjithë të rinjtë e kooperativave bujqësore dhe ndërmarrjeve të shtetit, do të marshojmë në kambë për në Reç. Atje, me rastin e 21 vjetorit të luftës së Reçit, do të përkujtojmë heroizmat e partizanëve tanë trima. Nisja do të bahet në kambë dhe e rregullt. Secila organizatë e çdo kooperative apo ndërmarrjeje do të jetë më vete. Do të marrim edhe ushqim vetëm sa për rrugë, se kur të mbërrijmë atje ka dyqane për çdo gja që do të kërkojmë. Atje do ta kalojmë natën, prandaj duhet të merrni ndonji fanelë apo ndonji send tjetër». Aty pati përshtëpërjtje nga disa vajza, të cilat thonin se ndoshta do të kishin pengesë nga familja.

— Me leje! — u ndigjue një za që tinglloi si një krismë metalike.

— Urdhëno! — tha njëni nga presidiumi, dhe ai që kish folë u ngrit në kambë.

— Nga disa vajza po ndigjoj përshtëpërjtje se atyne mund t'u dalin pengesa në familje, po as ne, as familjet tona nuk duhet të mendojmë kështu. Në lëvizjen nacional-çlirimtare ne të gjithë e dimë se ka marrë pjesë i gjithë fshati, edhe gratë e vajzat kanë dhanë ndihmën e tyne. Në luftën partizane morën pjesë edhe vajza fare të reja, që marshuen nëpër male, stuhi e borë, shpartalluen anmikun dhe ka nga ato që u vranë e vdiqën tue thirrë me të madhe «Vdekje Fashizmit». Ka nga ato të reja që edhe u dogjën nga zjarri

i luftës. Ato ishin një me partizanët, u banë vëllëzën e motra, luftuen bashkë me to. Ne jena dhe duhet të jemi krenarë për fitoret dhe heroizmat e tyre. Si të dalë sot pengesë familja, kur ne shkojmë të shohim vendin ku luftuen dhe derdhën gjak vëllaznit dhe motrat tona? Këte unë s'e kuptoj. S'duhet të qesim arësye. Të gjithë duhet të shkojmë pa përjashtim... — dhe kur mbaroi fjalën, të tjerët heshtën dhe shikonin të menduem.

— Asht e drejtë ajo që tha Vlasi, kush nuk asht në një mendje me ardhë? — pyeti sekretari:

— Të gjithë do të vijmë — u përgjegjën të rinjtë në kor dhe midis tyre u ndjenë edhe zana vajzash. Atëherë pra, vazhdoi sekretari, nesër të bahemi gati dhe të nisemi për marshim... \* \* \*

Mesditë. Vapë. Vargu i gjatë i kooperativistëve, i rreshtuem në kolonë, kalonte në rrugën plot dredha. Ata që qenë rreshtue në kolonë ecnin në mënyrë të parrregullt tue bisedue me shokun pranë. Dikush qeshte dikush tregonte për rrugën, për vendin ku do të arriheshin, kurse disa të tjerë vështronin dhe tretnin shikimin në horizontin që i rrethonte. Dielli ishte varë nga zeniti, ai po shkëputej gjithnji dhe po ndiqte rrugën e tij shekullorë. Fshatin e lanë mbrapa.

Natyra e ndan rroben e saj në mijra copa dhe ngjyra. Ajo asht ma shumë e dashun se sa e egër. Në gjinin e kësaj natyre, në shtratin e kësaj toke të butë e herë të ashpër, lindin e lëvizin të gjitha krijesat. Mandej frutet e arrira të këtyre krijesave korren, hahen dhe treten, kurse vetëm një pjesë fare e vogël, një kokërr për çdo kalli ruhet... dhe ajo kokërr mbillet përsëri në pranverën e ardhshme dhe përsëri del prej saj një kalli, një frut... Atëherë gjithçka mbin e re. Kështu ndodh edhe me njerëzit. Edhe ne lindëm, u mbollëm atëhere kur dimni i ashpër luftoi me pranverën dhe kjo me ernet e nxehta të afsheve të saj e

mundi acarin e ftohtë dhe të ngurtë. Pranvera e lindit ajo e rriti njeriun, këte njeri të mbujtun me dëshira të mëdha.

Po ashtu si në natyrë nuk ka vetëm fruta po edhe ferra edhe hithra që duhen qerue, ashtu edhe te njerëzit ka të liq e me vese. Po shumë nga këto ferra e hithra i qeruen vëllezënit tanë, heronjtë dhe dëshmorët e lirisë. E ata vetë mbetën si bimë të përjetshme, të lidhur fort me tokën, si bimë që lundin gjithmonë frute të shëndetshme.

...Qindra e mijra luftëtarë marshuen gjatë këtyne maleve të veriut vite me radhë, dhe nga malet në ditën e fitores sollën lirinë. Nga malet zbriti agimi, në male pësoi disfatë armiku, në male brohoritën për fitore, në male u derdh gjaku. Në male, me pushkë në krah, u rrit Partia... Për në male marshojnë të gjithë këta të rinj që gumëzhijnë nga gjallnia.

Mbi buzët e thame nga etja vërvitej era ledhatonjëse. Mbas katër orë rrugë kambësorët banë dhetë minuta pushim. U ngritën dhe përsëri ecën, kanga buçiti dhe rruga gumëzhiu. Para kolonës printe flamuri, vargu i rreshtave ishte i gjatë me qindra metra. Mbas vinin të rinjtë e ndërmarrjeve të qytetit. U afruen kodrave që qëndronin si pararojë e alpeve të Shqipënisë. Arat aty pranë qenë të mbjella dhe në to punonin kooperativistët. Traktori çante fushat, nga prapa ngrinte me forcë plugun e futun thellë në dhe dhe plisat vërviteshin mbi te. Lopët kullotnin tërfilin dhe barin e njomë të hamullores. Fshati qëndronte para tyne në rranzë të një kodre. Shtëpitë e grumbullueme pothuej në një anë të kujtonin një lagje të qytetit. Shtëpitë e reja, rrugët e drejta ishin dëshmi e fshatit të ri. Disa fëmijë luenin me top në oborrin e shkollës.

Në vitet paraçlirimit këtu punoi Migjeni, dhe Luli i vocërr e shokët e tij u drodhën nga ethet dhe vuejtjet e përditshme.

Si kaluen fshatin hynë në një luginë, mandej në një përrue që gjarpënonte nëpër shumë kthesa.

Kangët partizane buçisnin në ate luginë të përmneshme dhe ajo ushtonte e gjitha. Hekurani u printe në ballë. Edhe ai kish marrë pjesë në luftën e Reçit. Kur kaluen pak mullinin e prishun, ata morën në të majtë të përroit dhe filluen që t'u ngjiteshin shkallëve të Dukës. Që nga fillimi dhe deri në majën e atij mali kishte shkalla rrase plot kthesa zik-zake dhe të njëmbasnjishme, të punueme nga vetë dora e njeriut. Ato i kishin ba nga nevoja malësorët e dikurshëm, që t'i binin për shkurt rrugës.

Hekurani, që po u printe, sillte kryet mbrapa dhe shikonte shkallët dhe luginën atje poshtë. Kangët partizane dhe revolucionare që këndonin të rinjtë tue u ngjitë përpjetë i kujtonin atij çetën, marshimet, operationin e dimnit. . . Po Hekurani nuk ishte tashti ai që marshonte 21 vjet ma përpara, tashti e kish ma të vështirë t'u ngjitej shkallëve të Dukës, megjithëse nuk ish i ngarkuem në shpinë si atëherë me armë e municion. Por e gjithë ajo forcë rinie me fuqi të pashteruna, që po ngjitej nalt me kangë në gojë, e shtynte edhe atë si dikur.

Të gjithë e kapën majën dhe u ulën në shkëmbinj. Luginat e thellë atje poshtë dukej e errët si fundi i ndonji pusi.

Era ledhatonjëse e perëndimit frynte dhe përkëdhelte fytyrat dhe trupat e njomun nga djersa dhe të lodhun nga rruga. Dhe kjo erë nisi të fryjë posa ata u ngjitën në majë të malit. Para tyne qëndronte madhështor Maranaji i veshun me pyje të denduna, që ja kishte nxjerrë gjoksin leshtor rrezeve të diellit. Nga veriu s'të shihte syni tjetër përveç male, shkëmbinj të thepisun.

Të rinjtë e fshatit u grumbulluen rreth Hekuranit dhe ai nisi t'u tregojë ndodhi interesante.

— Sa vjeç ke dalë partizan? — e pyeti Qemali Hekuranin.

— Partizan kam dalë gjashtëmbëdhjetë vjeç e gjys-

më. Unë jam rritë në luftë, në përpjekje, në vështirësi, nëpër këto male të egra, me pushkë në krah, me dhimbjet e plagëve të shokëve e të mijat. Që kur u çlirue Shqipëria e deri në gushtin e vitit 1955 i shërbeva atdheut në rroben ushtarake.

Të gjithë të rinjtë shikonin njeni tjetrin në sy, mandej Hekuranin dhe mendonin.

— Eh, mor djema, vuejtjet, gëzimet, andrrat, trimënitë, aksionet e partizanëve janë të pasosuna.

Të rinjtë e qytetit ju ngjitën shkallëve. Atçherë Hekurani u ngrit dhe së bashku me ta vazhduen rrugën. Ushtima e kangëve partizane jehoi përsëri. Të rinjtë nuk ndjenin ma aq lodhje kur ndigjuen vuejtjet e partizanëve.

Mbramja filloi të binte. Shpatet e maleve i mbuloi një mjegull e hollë dhe mandej kjo u zhduk në errësinën e thellë të luginës. Ekskursionistët donin edhe tre çerekë ore që të mbërrinin në vendin e caktuem. U duel përpara prap një luginë malesh. Në fillim ajo vinte e shtrime, mandej ngushtohej e ngushtohej dhe bahej aq e mbyllët sa që, sikur të shikoje poshtë nga rruga sipër, të hynte frika. Në luginë kalonte uji i përroit. Aty u ndalën përsëri, pinë pak ujë, lanë faqet, u freskuen, pushuen dhet minuta dhe vazhduen rrugën përsëri.

Errësina mbuloi të katër anët, po ata ecnin me kujdes, sipër rrugës, në atë luginë të thellë e të thepisun. Krisma e hapave të tyre humbiste në oshëtimen e përroit që nuk pushonte.

4

Secili kish në mendje ato që u kish tregue Hekurani. U kish ba shumë përshtypje dashunia e singërtë e partizanëve, urrejtja e tyre për anmikun.

Ah, kjo dashunia që gjendet kudo, në çdo kand të zemrës dhe të botës. Edhe në malet e thepisuna, edhe në vuejtje e gëzime! E kush nuk dashunon? Po të mos ishte kjo ndjenjë çfarë do të bante njeriu! S'ka njeri ma

të vendosun së njeriut që dashunon ose urren me të vërtetë... Pranon çdo gjë veç të mos humbë ate që e ka në zemër, pranon vdekjen dhe s'e mohon ate; edhe në qoftë se ai vdes për qëllimin dhe idealin e tij, ai vdes tue dashunue... Kurrë partizanët nuk do të fitonin, po të mos dashunonin thellë: Ata donin dhe dashunonin thellë Atdheun, fitoren, socializmin; urrenin në kulm shtypësit dhe tradhëtarët ishin të vendosun për dashuninë dhe urrejtjen. Edhe dëshmorët vdiqën tue dashunue... tue urrejtë...

Edhe këta të rinj rreth zjarrit janë bijtë e atyne që dashunuen dhe urrejtën... që deshën Atdheun, idealin e tyre, fitoren, miqtë dhe vajzën; që urrejtën anikun, pushtuesit, shtypësit tradhëtarët... dhe janë të vendosun deri në vdekje edhe për dashuninë dhe për urrejtjen... Ata na kanë mësue edhe ne të dashuonjmë dhe të urrejmë ashtu si etërit dhe të jemi të vendosun si ata.

Zjari partizan i ndezun atë mbramje po kuqëronte. Të gjithë kishin rrethue zjarrin si unazë. Herë këndonin të gjithë së bashku dhe herë disa si Faiku, Afërdita, Nurija, Qemali e ndonji tjetër.

Hana lindi dhe nxori kryet si një bukë misri e pjekun e me rrezet e saj të prarueme ndriçoi luginën e thellë e të thepisun, gështenjat dhe ngadalë filloi të fshihej midis gjethëve dhe degëve të denduna. Era e freskët e bjeshkëve të nalta zbriste ngadalë, i përkëdhelte fytyrat dhe i tundte gjethet e gështenjave lehtë. Disa dru kërcisnin në zjarr. Afërdita ngadalë dhe në heshtje e ktheu kryet nga Qemali. Ky çast i kujtoi asaj mbramjen kur u kthyen nga puna, kur Qemali e shpëtoi që të mos binte në kanal, fjalët e Qemalit dhe shumë të tjera.

Kënduen dhe hodhën valle deri kur zbardhi. Edhe atyne që u vinte gjumë para se të fillonin këngën u iku fare, sikur të kishin fjetun gjithë natën.

Mbi kreshtat e majave të thepisuna filloi të vijë-zohej një hark i zbetë, i hollë drite. Thikat e mprehta të shkambinjve të Rrjollit dilnin sipër nga kurrizi i

atij mali të ashpër. Ato male ja kishin drejtue majat e tyne të mprehta qiellit, sikur domin të shkyenin perden e lehtë të asaj natë me hanë. Drita po zbriste ngadalë nga ato thika, tamam sikur kishte frikë se mos ato do t'ja prisnin rrugën e lindjes.

Filluen të zbardhonin majat e tjera, yjet në qiell sikur u arratisën të gjithë dhe i vetmi që kishte mbetur qe ylli i lindjes. Ai mundohej të qëndronte krenar. Edhe nën pyllin me gështenja ku nisi të përhapej drita, ajo po zbulonte fytyrat, sheshin, vendet dhe dalngadalë po bante të kjartë çdo gja. Zjarret ende ishin të ndezuna. Malet u dukën të kjarta, mjergulla e hollë po zbriste ngadalë tue u rrokullisun në luginë sikur ndonji kope dhensh që zbret për ujë.

Në çdo vend shikoje të rinj që ndigjonin me vemendje ndonji nga partizanët që u tregonte historinë e luftës së Reçit. Ishte përvjetori i asaj përpjekjeje të ashpër. I gjithë urbane i qytetit qe vu në shërbim të kësaj feste. Në atë shesh njerëzit sa vinin e shtoheshin. Të thoshte mendja se nga qyteti e fshatrat e afërta e të largëta të Shkodrës s'kish mbetur njeri pa ardhë...

Në orën 9.30 u bë rreshtimi i çdo organizate rinie përpara tribunës. I gjithë sheshi i madh u mbush plot e përplot. Nga Komiteti i Rinisë së Rrethit ju dha flamuri tranzitor organizatës së rinisë ma të mirë të rrethit, mandej organizatave të tjera të dallueme ju shpërndanë flet lavdërimi. Në mes këtyne mija e mija manifestuesve të shihte syni malësorë e malësore të veshuna me kostume karakteristike. Kishin ardhë ish partizanët e kësaj krahine, familjet e dëshmorëve si dhe nga rrethet fqinje.

Mbas metingut u zhvilluen aktivitete kulturele-artistike. Mandej të gjithë shkuen në grupet e tyne. Në sheshin e sipërm ishin bamë tryeza të gjata me dërrasa, ku u shtruen të hanin drekë të ftuemit, kolektivat e qëndrave të punës dhe kooperativistët e malësorët. Filluen të pijnë e të këndojnë, të gëzojnë e të qeshin. Kudo shihje grupe kooperativistash, punëtorësh apo

shkollarësh. Kudo ndigjoje melodi të ndryshme, zana gjithfarësh, valle lloj-lloj dhe fytyrat ishpartizanësh dhe të rinjsh që, ashtu pranë e pranë, tringëllinin gotat me njani tjetrin. Vendi zjente, malësorët kishin sjellë me vete edhe borë alpesh. Kudo lëvizje. Të bante për vete kërcimi i atyne malësorëve me ato valle të bukura, me ato rrobe të bardha si ajo bora e alpeve, me shkathtësinë e lëvizjeve. E ç'nuk shihje aty nga krahinat e ndryshme! Të gjithë vraponin atje ku kishte diçka të panjohun, diçka karakteristike. Në valle e sipër i hidhnin krahët njeni tjetrit, formonin një rreth të madh, këndonin vetë kangën dhe vetë e hidhnin vallen.

Kaluen kështu orë të tana me brohori e kangë, deri sa dita po shuhej, dielli po afrohej nga perëndimi. Maqinat shkonin e vinin. Të gjithë hypën në maqina. Mbas pak u nisën tue marrë me vete kënaqësitë dhe kujtimet, gëzimet dhe mbresat që s'do t'i harronin kurrë.

\* \* \*

## 5

Kaloi dhe gjysma e shtatorit. Koha po mbante mirë. Vargjet e duhanit thaheshin për mrekulli. Ai s'kish edhe pak sa të piquej; kishin mbetun vetëm gjethet e majës. Misri ishte bamë i shëndetshëm dhe secila rranjë kishte nga dy kallinj të mëdhenj. Edhe nga domatet e dyta vazhdonin që të nxirrnin disa kuintalë për çdo ditë, kurse domatet e lashta kishin mbarue.

Kryesia tashti po mendonte për vjeshtën, për grumbullimin e të ardhunave dhe sidomos për sigurimin e bazës ushqimore të blegtorisë. Depot e silazhit po pregatiteshin atje ku ishte nevoja, gropat pastroheshin për çdo nevojë. Kishin marrun masa edhe për mbulesën e kavaletave dhe stregave të sanës dhe të bykut të thatë. Punët në këtë periudhë ishin pakue, sepse vaditja e prashitja kishin përfundue së bashku me shumë punë



të tjera, kurse ma vonë përsëri do të shumoheshin, sepse delnin procese të reja pune si silazhi, korrja e misrit, xhveshja e misrit, dorëzimi i duhanit në uzinë e të tjera.

Në ato ditë një pjesë e burrave punonin në pyll deri në të perënduem të diellit. Në një natë të tillë mjergulla e hollë e livadheve ende pranë pyllit dhe liqenit. Ajo nisi të përhapej nëpër fushat e gjelbra e të gjana të kooperativës. Muzgu filloi të binte në fusha. Nga perëndimi kishte mbetun ende një ngjyrë e kaltër e zbetë. Errësina dhe mbramja ranë thellë në fshat. Heshtja dhe nata zotënonin kudo. Nga lodhja dhe djersa e derdhun gjatë ditës punonjësit humbnin thellë në gjumin e randë. Ishte vonë. Asgja nuk pipëtinte, çdo gjë rreth e qark dukej e heshtun, e fjetun. Edhe gjumi asht i thellë e i randë kur lodhja asht e madhe. Vetëm hapat e randa të plakut roje, që lëvizte sa andej këndeje për të ruejtun pasuninë e kooperativës, dhe të lehnat e ndonjë qeni atje në fund të fshatit, ndigjoheshin panda. Ai shikonte tendat e duhanit pa vargje që i kishin bo-shatisun. Gjethet i kishin futë mbrenda që në mbramje, para se të linin punën sepse në këto net kishte shumë lagështinë. Ai shikonte hanën dhe qiellin ku ende s'kishin dalë yjet e largët. Thellë nga jugu, ndigjonte gjamë si të humbuna dhe përsëri vazhdonte rrugën e tij me pushkë në sup. Në ato çaste thoshte me vete: «Kështu janë netët tashti, të heshtuna, të qeta, po edhe të bukura». Përfytyronte netët e dimnit të ftohtë, të ashpra dhe plot acar, kur murlani fshik degët e xhveshuna të pemëve që mblidhen sikur mërdhihin në trupin e tyne lakuriq dhe fërshellejnë në vajtim, kohën kur era i rrihte fytyrën e tij të futun në jakat e mëdha të kapotës.

Kështu po e kalonte ai atë natë të heshtun, ndërsa me mendje të vetë qe zhytun në përfytyrime e kujtime. S'vonoi dhe qetësinë e asaj nate të bukur e prishën gjamët e largëta të bubullimave dhe rrezet e përflakuna të vetëtimitave të pandame. Re të denduna e të zeza mbu-

luen qiellin. Gjamët e motit që po prishej shtoheshin gjithnjë e ma shumë. Në ato çaste natyra lajmëronte ardhjen e një stuhie të fortë. Ora s'kish kalue ende dy e dhjetë minuta. Mbas pak, kooperativistët si bleta do të lëshoheshin arave të duhanit, të domateve e kudo. Mbi qytet dhe mbi dy fshatrat afër tij shpërtheu një stuhi e papame ndonjiherë, një tufan i shoqënuem me erna të forta, me shi e vetëtima, me bubullima e gjama nga të katër anët. Plaku roje kish zanë vend nën derën e madhe të magazinës. Era shtohesh, para syve të tij tjegullat thyeshin dhe vërtiteshin në ajër si copa letrash; degë pemësh fluturonin pa numrim. Gjamët shtoheshin, dritat verbonjëse të vetëtimave dhe zhurma e madhe shurdhonyjëse të krijuar nga gjithçka që lëvizte e banë edhe ma të tmershme pamjen e asaj nate.

S'mjaftoi kjo, një breshën i fortë, por që nuk zgjati shumë, shoqënoi këtë furtunë. Shiu binte papushim dhe derdhej nga retë si me shtama; era e fortë ulërinte me zhurmë, sikur donte të përmbyste edhe themelet. Të gjithë njerëzit pa përjashtim ishin ngritur nga gjumi: edhe i vdekuni për gjumë në ato çaste s'mbet fjetë. Roja shkonte i mbrojtun nën perdet prej betoni dhe priste se çfarë do të ndodhte.

Në rrugën që të çonte përmes stallash dhe hangarësh, nën dritën e mekun, ai dalloi një njeri që po vinte. U trondit, hoqi pushkën nga krahu, vështroi përsëri dhe mendoi: «Po ky njeri në furtunë! Anmiku të sulmon në kohën ma të mirë ose ma të keqe». E kjo asht nata ma e keqe!

— Ndal! — thirri roja nga vendi ku ishte dhe doli në furtunë para njeriut të panjohur. Kur e pa u ndal. E njohën njëri tjetrin. Djaloshi i ri, i përgjakun, mezi mirrte frymë, donte të fliste diçka por nuk mundi. Goja dhe fryma i ishte marrun krejt. Roja e kapi për gjoksi dhe e shkundi.

— Ferit! — fol çka ke? — briti me të madhe roja. Djaloshi nuk u përgjegj, vetëm bani me dorë nga liqeni në të kundërt të furtunës. Roja e kapi djalosin, e

mori në duar dhe e çoi mbrapa derës së magazinës. E pa edhe një herë fytyrën e tij të drobitun që e ndriçoi vetëtima dhe u pezmatue. S'kish ç'të bante vetë. Duhej dhanë alarm. Ndihma duhej të shkonte patjetër. Rrotulloi pushkën e gjatë, i dha shulit, shkeli kambëzën dhe filloi të shtinte një mbas një. Ato të shtime pushkësh i dhanë natës një pamje edhe ma të trishtueme. Pushkët këtu zakonisht lajmërojnë zjarrin, po zjarr nuk dukej ndokund.

Të largëta dhe si të humbuna nëpër atë lamsh furtune ndigjoheshin edhe të shtimet andej nga bregu i liqenit. Natyra s'pushonte; me atë furinë e tërbueme sikur donte të përpinte të gjithë fshatin. E çka mund të kish ndodhë pra në breg të liqenit, në mes të asaj nate të tmerrshme? Të gjithë anëtarët e kooperativës e merrnin me mend: Atje strehoheshin lopët e kooperativës. E kujt nuk i shkonte ndërmend se atje stallat e mbulueme me kashtë do të ishin rrëzue prej atij tufani që rokulliste edhe shtëpinë prej guri?

Burrat, të rinjtë, ata që nuk tremben as nga tufani ma i egër, as nga gjamët e motit me dritat e forta dhe verbonjëse të vetëtimës dhe as nga era ma e fortë brofën në kambë, dolën jashtë shtëpive dhe u drejtuen andej nga vinin krismat e largëta të pushkëve, pa marrë parasysh as rrezikun që mund t'u kërcënohej në ato çaste të vështira. Dhe ata mendonin dhe vepronin drejt. Pasunia e madhe e kooperativës po vihej në rrezik, ajo po kërcënohej nga furtuna. Të rinjtë vrapuen drejt stallave. Era që frynte ishte në të kundërt, po rinia, me gjoksin e çelniktë, e çante rrugën e vështirë. Era e fortë u hynte në gojë, u mirrte frymën dhe shpesh i rrëzonte; bubullima trondiste dheun, zhurma e saj të pickonte veshët dhe drita e fortë dhe verbonjëse ta hutonte mendjen. Rrugët u mbushën me ujët që kullonte nga arat. Pemët kërcitnin nga degët që thyheshin. Era, që vazhonte me sa fuqi kish, i lodhi shumë dhe nisi t'i rrëzonte. Mandej ata u kapën dora dorës dhe vazhduen rrugën e vështirë. Shiu u kishte hy në mish, bubullima

i shurdhonte, vetëtimat u verbonin sytë; të gjitha këto të këqia natyra i mblodhi në një natë, në një vend, dhe i bani pengesë; po kurrë nuk mundi të ndalte hapin e fortë, forcën fizike e morale dhe shpirtin e njeriut të ri.

Të gjithë ishin gati të banin çdo sakrificë për pasurinë e përbashkët. Prej saj ushqeheshin e jetonin, prej saj rriteshin e baheshin ma të fortë muskujt e tyne.

Me përpjekje e mundime mbërritën në livadhe, në vendin ku kishte ndodhun dami. Stalla ishte rrëzue mbi lopët e lidhuna me zinxhirë. Po përlesheshin me furtunën dhe po banin përpjekje punonjësit e blegtorisë që flinin aty e punonjës të tjerë. Edhe gratë u treguen të gatshme për të mbrojtun këte pasuni të madhe nga furtuna e egër dhe grabitqare. Ata që erdhën të parët nëpër rrugën e vështirë qenë Qemali, Agimi, Faiku, Hekurani dhe Ibrahim. Me zgjuetësi e vullnet, pa sjellë çrregullime, pa u habitun, filluen të çonin rrënojen e randë dhe të nxirrnin lopët.

Sa skena të çuditshme! Sa i fortë asht njeriu kur lufton me natyrën e egër! Nga njena anë era e fuqishme, shiu i fortë, vetëtimat e bubullima rrënqethëse, që përplasin valët e tërbueme drejt bregut tue lëshue gjamë të llahtarshme, krisma të forta shelgjesh që thyeshin, britma lopësh që dergjeshin nën peshën e randë të rrenojës, në anën tjetër njeriu i ri, i pajisun me forcë, i bashkuem me shokun për me mbrojtë pasurinë e përbashkët, pronën kooperativiste, me punue, me gëzue bashkarisht.

Çaste të jashtëzakonshme, çaste prove!

— Kujdes, shokë, kujdes! Jepni edhe pak! — ndigjoheshin zanat që ushtonin dhe përplaseshin me shtëllungat e mëdha të tufanit të egër dhe shpërndaheshin deri në fshat.

— Ju, vajza, me vrap te viçat, burrat te lopët! — ndigjohet zani i kryetarit.

Gra e burra kishin një qëllim, kishin një vendosmëni dhe një shpirt.

— Forcani, burra!... — ndigjoheshin zana sa në

njenën anë në tjetrën. Ndërsa tufani jepte e mirrte me tërbim.

— Ngrejeni shokë atë traun atje që ra mbi Shegën!... ndigjohej një za tjetër. Zanat shtoheshin, britmat e lopëve baheshin ma të mëdha nën peshën e çatisë.

— Shpëtuen, shokë, edhe dy të tjera! Epni se për pak po i shpëtojmë! — ndigjoheshin zanat e gëzuese të fshatarëve.

Edhe në tufan, edhe në luftë të rreptë, me gjithë fatkeqësitë dhe plagët që mernte në trup, fshatari çfaqte gëzimin dhe i buzëqeshte fitores!...

— U lumtë, o sokola! — u tha kryetari të rinjve dhe të rejave që ishin grumbullue rreth tij, ashtu të bamë qullë si edhe ai. Si për çudi era mbas pak mehu, shiu e ndali hovin, valët e forta të liqenit ranë në qetësi, bubullimat u larguen drejtë maleve, sikur donin me thanë se natyra u lodh, e humbi davanë në përleshje e me tregue andej se sa i fortë asht njeriu në shoqëninë tonë socialiste. Pasunia e përbashkët shpëtoi. Ajo natë e tmershme tregoi vullnetin e fortë, ndërgjegjen e pastër të çelniktë dhe besimin në forcat e njeriut të ri. Të lodhun por të gëzuem nga fitorja kooperativistët u kthyen për në fshat. Qemali kish lidhun kryet me një copë këmishë, sepse i kish ra një binar i trashë shelgjeje. Faikut i kish hy në kambë një gozhdë e madhe. Asnji thueise s'u nda të paktën pa një plagë të vogël. I riu Ferid Kasa, posa kishte ramë stalla, ishte lëshue me vrap për në kooperativë. Kur po vraponte, era e mirrte para dhe e flaktë tutje; ai shkante tue u rrokullisun dhe tue u rrëzue nëpër kanal ose nëpër ferra dhe u vra keq. Plagën ma të madhe e kish në ballë. E kish marrun furtuna përpara edhe e kish përplasun në trupin e trashë të një shelgjeje. Ashtu i lodhun, i dërmuem, i gjakosun dhe me plagë e me vështirësi e lajmëroi fshatin për çka po ndodhte.

Furtuna kish sjellun shumë fatkeqësi. Kësi furtune as pleqtë s'mbanin mend të kish ra ndonjiherë. Por

dami që bani në lopë nuk qe i madh, sepse kooperativistët qenë të shpejtë dhe të gatshëm. Vetëm disave u theu kurrizin dhe mandej atyne që ishin në gjendje të keqe u vunë thikën, kurse të tjerat i mjekuen dhe mbas disa ditësh ato nisën të shëroheshin. Po të gjitha shtëpive të nalta e të ultave ma pak, u kish hequn tjegullat, sidomos atyreve që i kishin faqet e çative nga perëndimi. Pemët i kishte sakatue të gjitha, u kishte thye degët, i kish mënjanue ose i kish nda përgjysmë. Misrin e rritun e kish shtrua për tokë, disa stallave të mbushuna me duhan që u kishte zbulue një pjesë, u kish hy ujët e shiut mbrenda.

Plëqtë thanë se mbas furtunës me breshën do të dilte moti i mirë. Dhe me të vërtetë ashtu ndodhi. Dielli dhe koha e mirë doli përsëri. Duhani e lagun nga shiu e nxorën të gjithë jashtë të thahej në diell. Mbas dy ditësh duhani i lagun u tha. Për stallat që i zbuloi era u morën masat e nevojshme dhe ato u rregulluen ashtu siç kishin qenë. Por furtuna i kish lanë gjurmët e saj. Pemët i kish lanë si mos ma keq, misri, që ishte rrëzue, filloi të ngrihej po plagët e disa lopëve të racës ende s'ishin shërue; ato gjithnji ecnin si të frikësueme dhe si të përdredhuna. Edhe Qemali, Faiku mbanin ende plagët e lidhuna me fashio.

Njiherë për njiherë disa forca pune të zgjedhuna, i dërguen që të punonin në pyll. Atje do të prisnin landë të nevojshme druni, kallamishte dhe rrogozë, të cilën e punonin gjatë dimnit. Atje kishte punë dhe duhej shkue qysh në këte kohë, se po të kapnin shinat e vjeshtës liqeni do të afrohej, do të hynte mbrenda dhe njerëzit do të mbetnin pa rrogozë.

## 6

Ate mëngjes u nisën të gjithë së bashku. Rruga që nga fshati dhe deri te pylli ishte e gjatë. Posa shkuen në livadhe, disa u ndalën që të punonin në stallat ve-rore, të cilat ishin në rindërtim e sipër, kurse të tjerët

ecnin gjithnji përmes gjelbërimeve të barit dhe të shelgjeve.

Agimi kish marrë me vete zagarin dhe çiften. Tashti duhej çiftja, se nëpër pyll dhe në amullin e liqenit dhe të vijave me ujë patjetër kishte rosa dhe shapka mali. Që të dy, Agimi dhe Qemali, dredhuen dhe hynë përmes pyllit, kurse të tjerët hynë në rrugën e re, që ishte hapun e që çante pyllin më dysh; ajo të çonte në breg të liqenit. Posa hynë në pyll dhe kaluen disa metra, zagari ra në erë gjahu dhe filloi të nuhasë. Papritmas një rosë doli nga trangu i një zhavari fare afër zagarit. Agimi e qëlloi, por s'mundi ta vriste.

Hynë në mes të pyllit; ai bahej gjithnji e ma i dendun dhe kishte vështirësi për kalim. Ishte i dendun, me kallamishte dhe rrogozë, që i kalonin të dy metrat, me shelgje të trasha e të mëdha, shelgje të bardha që rriten shumë të shtrime. Të dy shokët i ndigjonin të gjitha zhurmat e shpendëve dhe kafshëve të tjera të vogla nëpër pemë. Një njeri që s'kishte hy kurrë në atë pyll, le që hynte e s'dinte të dilte, por edhe tmerohet nga britmat dhe zanat e trishtueshëm dhe nga gjarpërinjtë e ujit që i takonin dendun.

Ata shkuen te pusi i pyllit ose te gropa e pyllit, siç e quenin gjahtarët dhe fshatarët atë vend. Aty ishte si pus, vendi mbante ujë gjithë verës deri në brez. Pusi ishte i rrethuem me shelgje të bardha të shtrime, me kallamishte, zhugë, zhavar, rrogos e çdo gja tjetër. Agimi e bani gati çiften dhe priste kur po dilte gjahu. Zagari u fut në një vrimë që ishte nën disa trunge zhavari dhe u zhduk. Qemali dhe Agimi vështruen njëri tjetrin në sy dhe heshtën... Shikuen rreth e rrotull dhe panë gjurmë... dy lloje gjurmash: këpucësh dhe çizmesh.

Heshtja që ra në dy shokët i bani të mendonin!...

— Lajdi! — thirri Agimi zagarin e tij që ende s'kish dalë dhe uli kryet të shikonte vrimën ku kish hy zagari. Lajdi lehu dy herë dhe doli jashtë. E lehuna e tij u dha të kuptonin se kish ramë në erë gjahu, por asgja nuk lëvizte aty mbrenda, përveç aty pranë i ndi-

gjonin zanat e trishtueshme të shpendëve sikur t'i zinte njeri për fyti dhe t'u mirrte shpirtin.

Vrima ku hyni zagari nuk dukej se ishte vrimë: Dy trungje zhavari të afruem njeni me tjetrin dhe lart të mbuluem me fijet e denduna, të gjata dhe të mprehta si brisku, ashtu si të gjithë. Kjo gja i bani që të dy djemtë të mendonin. Qemali i kërkoi çakmakun Agimit dhe hyni në vrimë. Mbrenda ishte errësinë dhe atë dritë që hynte nga vrima e zuni Qemali me trup. Ndezi çakmakun dhe vështroi rreth e rrotull dhe vrejti sanë të thatë, disa copa të vogla letrash dhe bishta cigaresh. Agimi priste se ç'po ngjante... rrinte i hesh-tun tue i përqëndruë të gjithë vemendjen.

— Agim, hyn mbrenda, hyn e shiko! — i tha Qemali Agimit. — Ai veproi si i tha shoku, hyni mbrenda. Mbasi tij u fut edhe Lajdi.

— Shiko! — i tha Qemali tue e sjellun çakmakun nga të katër anët. Agimi pa i çuditun vendin që ishte si dhomë, largonte sanën dhe mendonte.

— Këtu as shiu nuk paska hy! — tha Agimi.

— E ka mbrojtë zhavari që asht nalt, nuk e ka lanë me rrjedhë këtu, po uji ka rrjedhë anash — foli Qemali dhe të dy dolën jashtë.

— E çka të merr mendja ty se asht ky vend? — pyeti Qemali.

— Këte e kanë bamë gjahtarët me pushue ose me fjetë, — u përgjegj Agimi. — Po ti çka thue? — pyeti mandej.

— Unë them se këtu strehohet ndonji i huej.

— Diversant?

— Unë kështu them!

— Jo, mor Qemal, çfarë diversanti! po ku po vjen diversanti e futet këtu? Çka kërkon ai këtu?

— Unë kështu them, Agim, jam ma se i sigurt dhe i bindun për këte.

— Na, për disa ditë jena tue punue këtu, do të vimë prapë nesër po në këtë vend dhe në qoftë se shohim ndonji gjurmë të re ose ndonji njeri të dyshim-



të, atëhere bajmë si të dësh ti; në daç lajmërojmë në daç vepromë...

Mirë, ashtu po bajmë — dhe u nisën nga bregu i liqenit.

Kur dolën në breg Lajdi ngriti një rosë, Agimi e qëlloi dhe ajo ra në liqen. Zagari vrapoi me të katra mbas saj dhe u hodh në ujë e nisi të notonte me të dy kambët e para, kapi me dhambë rosën. u kthye, doli në breg, e shkundi trupin nga ujët dhe ja solli gjahun të zot në dorë.

— Bravo, Lajdi! — i tha Agimi, i mori rosën dhe i fërkoj shpinën. Zagari e drodhi trupin i gëzuem, u hodh përpjetë sikur i vinte mirë që i zoti e lavdëroi për punën që bani.

Bregu i liqenit ishte zallishtë dhe sipër zallit kishte lym që sillnin valët e liqenit gjatë kohës kur ai u zgjantonte. Në breg të tij dukej si një bisht dhelpe një rryp toke që hynte thellë në liqen dhe formonte aty një si gjë deti. Agimi dhe Qemali shkuen atje ku po punonin shokët. Hangrën mëngjesin, u ngritën, morën drapat dhe hynë në pyll që të korrnin rrogözë. Kur dolën nga pylli që të pushonin e të hanin drekën, u lanë në liqen. Uji ishte i mirë dhe kishte pak valë. Atje, në breg ndigjonin të qeshurat e vajzave që po pushonin nën hije. Hangrën bukë, pushuen dhe përsëri filluen punën. Vajzat korrnin, kurse djemtë bartnin rrogozat dhe i nxirrnin nga pylli në breg. Normën e kishin plotësue që në mesditë, kurse tashti mbas dreke luftonin për tejkalimin e saj.

Kur arritën te rruga e pyllit, Qemali dhe Agimi u ndanë dhe vazhduen të ecin bregut.

— Qemal, s'doni me ardhë në shtëpi, a? — i pyeti Afërdita.

— Jo, Dita, po dalim këndeje e gjuejmë ndonji rosë. Natën e mirë! — u thanë të gjithëve.

— Natën e mirë e mirë u pafshim nesër — u thanë të dy shokët dhe morën rrugës së pyllit.

Çiften e kish marrë Qemali dhe e mbante në krah.

Këta të dy dhe zagari po ecnin anës bregut, në të djathtë vinte liqeni që s'kishte as ma të voglën lëvizje. Anës bregut ishin rreshtue çapkat e bardha. Dielli që shkëlqente, gati po fshihej mbrapa malit dhe i jepte gjithë atij qarku një bukuri që të kishte anda ta shijojë.

Në të majtë, poshtë bregut, ishte pylli ku kallamish-tet me rrogizat e gjata vinin në një nivel, mandej sipër tyne kishin nxjerrë gjysmën e trupit shëlgjet. Në anë të pyllit u ngritën dy rosa. Qemali e kish bamë gadi çiften dhe me dy të shtime i ndali që të dyja.

Njena ra në breg kurse tjetra në kallamishten e dendun të pyllit, por zagari mbas disa përpjekjesh e gjeti edhe ate.

— Kthejmë këtu në të majtë? — i tha Qemali Agimit që ishte pak para tij.

— Kthejmë — pranoi Agimi dhe hynë përsëri në pyll. Ecën nëpër ate rrugë të vështirë, deri sa arritën te gropa e pyllit.

Shikuen rreth e rrotull po s'panë gja: as gjurmë të reja dhe asgja tjetër, çdo gja ishte sikur në mëngjes. Të dy shokët kur panë se s'kish gja të re, morën drejtim nga rruga e pyllit. Posa dolën nga pylli në rrugë panë se në kanalën e thellë dhe plot ujë po kulloste një zhytyrr<sup>1)</sup>, që posa i pa këta u zhyt në ujë e s'u duk ma.

Retë e holla flakëronin me ngjyrën e trandafilit e mandej nalt baheshin ma të çilta. Tufa zogjsh fluturonin për në çerdhe. Disa re puplore lundronin në hapësinë me ate ngjyrën e tyne të kuqe të ndezun, mandej vinin e baheshin të bakamta, si të verdha, si ai polemi i luleve dhe si ata zogj të bukur pylli, që tue fluturue, lëshojnë puplat e tyne shumëngjyrëshe.

Era e freskët dhe e lehtë frynte ngadalë tue krijue valëza të buta në liqen. Nata sikur kish marrë brushën dhe po i jepte ngjyrën e zezë qiellit. Muzgu ishte përhapun kudo. Të dy shokët ndanë për gjysmë gjahun e vramë.

1) Zhytyrr = Shpend që ushqehet me peshk dhe rri zakonisht në ujë.

Qemali dhe Agimi po shpejtonin për në shtëpi.

— Agim, nesër nadje po vi herët e të baj za.

— Mirë, Qemal, gati jam! — i tha Agimi dhe u ndanë në rrugën e fshatit tue i urue njeni tjetrit natën e mirë.

\* \* \*

Të nesërmen Qemali u ngrit ma herët se ditët e tjera. I bani za Agimit dhe të dy u nisën për në atë vend. Kur po mbërrinin para pyllës, dielli sapo lindte. Kambët deri në gjunjë u ishin lagun nga vesa e madhe që kish ra. Anës pyllit panë një burrë. Shiko!... i tha Qemali lehtë Agimit tue i ra me bërryl.

— Po, e shoh... — dhe shpejtuen që ta mbërrinin. Ate çast djelmoshave filloi t'u rrihte zemra. Edhe ata çuditeshin: pra, as frikë nuk kishin!

I panjohuni kur ndigjoi çape që po i vinin nga mbrapa u drodh, solli kryet, lëvizti sikur desh të bante diçka, por e la, mandej u qetësue dhe u ndal që të priste dy djemtë e rinj.

— Mirë mëngjes, o shokë! — u tha dhe i vështroi i shqetësuem.

— Mirë mëngjes, si u gëdhine? — i foli edhe Qemali.

— Po juve ku po shkoni kaq herët? — pyeti i panjohuni sipër të hapë muhabet, ndërsa fytyra e tij e egër dhe e vrazhdë, me ata sy si të dhelpnës, i ishte zverdhun dhe thue se nuk i kish mbetun pikë gjaku në fytyrë.

— Na po shkojmë në punë, po ty çka të hodhi këndeje? — pyeti Qemali.

Mbasi mendoi, i panjohuni i vështroi të dy djelmoshat mandej pa atje larg dhe tha:

— Po edhe unë i kam punët herët si ju.

— Po çfarë pune ke?

— Unë jam natyralist, studjoj familjet e ndryshme të shpendëve — tha ai ngadalë dhe tue menduem —

më kanë thanë se pylli këtu ka shpend të ndryshëm dhe kam ardhë të studjoj mos... ka ndonji shpend që ka ardhë i ri... Për këtë punë ka disa ditë që kam mbërritë; vetëm dje kanë ardhun këtu punëtorët për të punue, kurse ditët e tjera vetëm me një burrë që ruente kuajt kam ndeshë...

— Po me atë burrin ke bisedue ndonjiherë? — pyeti Agimi.

— Jo, jo, them se vetëm e kam pamë e... Po çfarë pune bani në pyll? — pyeti i panjohuni.

— Korrim rrogoze dhe presim landë druni.

— Po nga cila anë e pyllit, këndeje nga rruga apo në anën tjetër?

— Në anën tjetër, se këndeje rrogoza asht e dobët, në këtë anën këtej s'punon asnjëri. Po a keni hy në mes të pyllit, se anës nuk rrijnë zogjtë, ma tepër ka në mes, apo jo?

— Po, ashtu asht, po në mes asht vështirë të kalosh, se pylli asht i dendun dhe s'kam hy ende atje.

— Ashtu asht! — pohoi Qemali, pastaj pyeti përsëri.

— Po prej nga të kena? —

— Nga Tirana, u përgjegj i panjohuni shpejt e shpejt, pa u mendue fare.

— Ndërkaq ishin tue ecë afër njëri tjetrit. Kur u ndodhën afër kanalit të thellë të rrugës së pyllit, Qemali i tha të panjohunit.

— Ju lutem! a ka mundësi të na jipni pasaportën?

I panjohuni i shikoi rreptë dhe u tha me një ton miqësor që s'i shkonte fare asaj shprehjeje të fytyrës.

— Po... ne u njohme, u dëftova se ç'ka jam. Mua nuk më vjen keq përkundrazi... kjo asht një detyrë e lartë, shoku Enver ka thanë: «në njerën dorë kazmën dhe në tjetrën pushkën, po megjithatë unë po jua jap që ta shikoni. Urdhënoni. Qemali e mori dhe e shikoi. I panjohuni ishte zverdhë në fytyrë dhe herë shikonte Qemalin që vërente pasaportën herë Agimin që mbante çiften në dorë.

Qemali e mbylli shpejt dhe i foli me një ton miqësor dhe tue buzëqeshun:

— Na falni, por ne dyshuem, kurse tashti të njohim se kenke i joni!

— Po unë ju thashë... foli i panjohuni dhe kësaj radhe i dha fytyrës me të vërtetë një buzëqeshje të zakonshme. Veç syt që i kishte si të dhëlpnës nuk i ndryshuen.

— Po mirë po ju pse me çifte, zogjtë e rosat në këte kohë janë të ndaluara? — pyeti ai, dhe tashti që e hoqi dyshimin kish qejf që t'i ndërronte edhe dy fjalë e pastaj të shkonte.

— Jo, tashti asht e lejueshme me gjuejtë; ju natyralistat duhet ta dini këte, se ato janë të ndalueme vetëm në pranverë, në kohën e shumëzimit të tyne; por ne sidoqoftë e marrim çiften me vete gjithmonë, se shpendët grabitqarë lejohet që t'i vrasim në çdo stinë... apo jo?

— Po... foli i panjohuni dhe këtë fjalë e shqiptoi ngadalë.

— Mirë u pafshim! — thanë Qemali me Agimin dhe u ndanë. Kaluen kanalim te një urë e ndërtoeme me katër binarë. Ajo kishte sipër druj të hollë dhe sanë, në mënyrë që të mos humbisnin kambët. Ata dolën në anën tjetër të pyllit. I panjohuni i shikonte nga mbrapa. Vërejtja zagarin që u shkonte mbas dhe mendoj: «Po ai bjondi që kishte lidhë kryet me ate fashion e bardhë përse më tha mirë u pafshim? Unë u thashë se do të nisem për Tiranë! Aha, jo, jo, këta kështu e kanë zakon. Po mue ç'më lindin këto dyshime? apo i djeg atij që e ka mizën nën kësulë...» Shikoi Qemalin dhe Agimin që u zhdukën në pyll dhe mandej me të katra hyni në pyllin këtëj rrugës.

Agimi dhe Qemali kur hynë në pyll u fshehën dhe shikuen se nga po shkonte njeriu i dyshimtë. Edhe Lajdi rrinte edhe shikonte si ata. E vunë re se si njeriu i dyshimtë u fut shpejt në pyll dhe kur ai u zhduk të dy shokët filluen të bisedojnë.

— Diversant asht ai, s'ka tjetër, — foli Qemali.

— A thue?

— Nganjherë m'i hiqte të gjitha dyshimet po në

disa vende prapë më futte në dyshim: për shembull kur tha se tashti shpendët janë të ndalueme e në shumë raste të tjera.

— E si po bajmë? — pyeti Agimi.

— Po presim deri sa të vijë Hekurani. Ai në pylli andej rrugës asht deri në mbramje; aty e kena, se s'ka ku me shkue, në qotë se na s'mund ta kapim deri në mesditë lajmërojmë organet.

— Mirë thue ti, hamë nadjen tashti?

— Po, po, e hamë, — dhe që të dy shokët filluen të hanin mëngjesin. Lajdi, që ishte mbrapa tyne, e shikonte Qemalin që hante bukë dhe filloi edhe ai të lëpinte buzët. Ata e kishin harrue zagarin fare. Kur e pa Qemali që ai po lëpinte buzët, i hodhi edhe atij një copë. Dielli ishte ngritun; u dukën punëtorët që po kalonin mbi urë dhe po delnin nga livadhi në rrugë.

— Erdhën! — tha Agimi.

— Kush? — pyeti Qemali dhe ndali kafshatën që po përtypete dhe shikoi nga rruga.

— Erdhën punëtorët.

— Po Hekurani a asht me ta?

— Jo, nuk e shoh... po, po, po vjen me punëtorët e tjerë,

— Mirë, ulu...

Hekurani që ishte brigadjer, u merrte edhe me organizimin dhe korrjen e rrogozës, të kallamishtes, me premjen e landës e të gjitha. Por ai nuk mirrej vetëm me këto, punonte edhe ndonji send tjetër si për shembull ndërtonte ndonji urë, rrafshonte ndonji breg për të kalue karrot ose ndonji send tjetër. Me fjalë të tjera ishte edhe si një gjeometër i kooperativës dhe kurrë nuk rrinte pa punë. Dy shokët u ngritën dhe u dolën përpara punëtorëve. Mbasi u përshëndetën, e ndalën Hekuranin, i treguen se ç'kishin takue e të gjitha me radhë.

— Tash ne ate e kena në kurth, ai s'ka ku me shkue. Simbas fjalëve tueja ai qenka një diversant finok. Gjatë jetës sime në ushtri e në mal kam kapë diversantë e spiunë, po ta dini se tash ata janë të pajisun

nga të gjitha pikpamjet, janë të stërvitun dhe pranda; duhet tregue kujdes shumë i madh, se një gabim i joni rrezikon jetën e ndonjenit. Diversanti duhet të jetë i vetëm gjersa ju ka thanë se jam tash disa ditë këtu. Ai në të vërtetë mund të ketë ardhë tash sa ditë. Për mos me i ngjallë dyshime vetes ju ka thanë se dje s'kanë qenë punëtorë në pyll dhe se ka pamë rojtarin e kuajve; kështu asht puna, mbasi qenka tash disa ditë mund që ndonji nga fshatarët tanë e mban me bukë e ja bjen në pyll. Për këtë jam pak në dyshim.

Të dy ndigjonin fjalët e Hekuranit me vemendje.

— Tashti, si do të veprojmë? Në radhë të parë ty, Qemal, ai do të të njohi menjherë, se ke kryet e lidhun me fasho; por edhe sikur të mos ta kesh, ti ke tipare të tilla që dhe me një të pame nuk harroresh lehtë. Po ta takosh atje në pyll, ai me siguri do të bisedojë, se ai njihet për njihet nuk ka dyshime. Ti do të marrish çiften në dorë, do të marrish edhe zagarin dhe do të shkosh gjoja me gjuejtë andej nga gropa e pyllit. Aty, atë patjetër do ta gjejsh jashtë, se ai rrin e vështron çdo lëvizje njeriu. Kur të të shohi ty, një herë do të tronditet, por kur ka me të njoftë nuk ka me luejtë prej vendit mbasi njiheni. Çiften do ta mbajsh të mbushun me fishekë, në dorë e jo në krah. Më kuptove?

— Po, të kuptova, — tha Qemali.

— Në qoftë se ja mbërrin me bisedue, bisedo ndonji send rreth zogjve, por të kesh kujdes edhe lëvizjen ma të vogël të tij se sado i fortë që të jesh ai asht i stërvitun e nuk i dihet... ti duhet të shkosh i qetë, i qeshun, sikur shkon me gjuejtë shpend e jo diversantë. Kur të afrohem unë nga ana tjetër, fare afër, vepro... Unë po shkoj dhe ja marr çiften Burhanit, po i them se e due për me gjuejtë, ti, Agim, nuk ke gja tjetër përveç drapënit.

Që të tre u ngritën në kambë dhe morën drejtimin përmes rrugës së pyllit.

Qemali u nis nga veriu, Hekurani nga jugu, Agimi

nga perëndimi, dhe që të tre e lanë të takohen në një pikë. Hymjen do ta banin përnjherë.

Që të tre u ndanë. Qemali mbushi çiften. Ate kohë një rosë i kaloi sipër, ai e qëlloi rosën dhe ajo ra në rrugë. Lajdi e kapi dhe ja solli. Hekurani dhe Agimi, që s'kishin ecë as tridhetë metra, i thanë Qemalit. «Mere me vete dhe mbaje në dorë... dhe që të dy u zhdukën nëpër shelgjet e bregut.

Qemali u ul në breg të kanalit dhe mendohej që të imagjinonte ngjarjen se si do të zhvillohej. Lajdi rrinte në bisht, vetullat i mbante të ngrysunat, veshët e ulun dhe as lëvizte, as bante za. Qemali vështronte se mos po ndigjonte të shtimen e pushkës. Ai e priste me padurim atë çast, megjithëse ky mund të ishte një takim i rrezikshëm.

Tik... kauuuuu... u ndigjue një e shtime e çiftes andej pyllit. Qemali u ngrit në kambë dhe hyni në pyll. Zemra nisi t'i trokasë me forcë, për të parën herë po ndeshej vetëm për vetëm me një annik...

Eci nëpër pyll një copë herë dhe mbërrini afër gropës. Lajdi i printe, sikur ta dinte se për ku po niseshin. Qemali as që e shikonte ate, sepse e mbulonte zhavari dhe ecte nën trungje, por shikonte kur lëvizte ndonji degë ose kur ai ndalej dhe hidhte dy kambët e para në trung, nxirrte kryet në mes të zhavarit, shikonte Qemalin dhe përsëri vazhdonte rrugën. Qemali ju afrue vendit të gropa. Njeriu i dyshimtë, që po rrinte në një trung zhavari, kur ndigjoi lëvizje u drodh i tanë, u ngrit në kambë; zgjati veshët, futi dorën në xhëp dhe po priste që të shikonte kush po afrohej. U ul, vetëm kryet e la sipër dhe pa ate djalin e bashëm dhe me krye të lidhun me fasho, e ju kujtue kush ish. Një herë desh të fshihej dhe të futej në strofullën e vet, por te kambët e tij, nga trungjet e ferrat përreth i doli zagari. I mori erë në kambë.

Ham hum!... lehu zagari.

— Lajdi! — thirri Qemali dhe as që vështroi nga gropa.



— Po çka të solli prapë kënde, or derëbardhë? — pyeti njeriu i dyshimtë, i tronditun.

Qemali u ndal nga ky za i papritun, vështroi dhe, si e pa, u përgjegj tue buzëqeshun:

— Epo zagari shkon mbas gjahut dhe gjuetari mbas zagarit — dhe vazhdoi të afrohej gjithnji por pa ja tërhequn vemendjen atij. Kur ju afrue i tha po me të njëjtat shprehje të fytyrës si ma parë: — Paske hekë të zitë e ullinit deri sa paske ardhë këtu.

— Ah, mos e nga... më duket se qëlllove parë me pushkë?

— Po, vrava këte rosë — u përgjegj Qemali — dhe e ngriti rosën nalt.

Kur pa rosën e vramë të panjohunit iu hoqën shumë dyshime, vetja ju lehtësue nga ajo tronditje që kish ndie në fillim.

— Kur u takuem në mëngjes u habitëm tue ba pyetje dhe harruem që t'i japim njeni tjetrit të paktën nga një cigare. Afrohu e merre një! — dhe shtriu paketën.

— Faleminderit, po-o... unë nuk e pi.

— Po digje një, digje, — Qemali u afrue për ta marrë dhe shikoi rreth e rrotull...

— A zbulove ndonji zog të ri sot? — pyeti Qemali dhe shikimin e vështrimin s'e ndante andej nga do të vinte Hekurani. Ai e mbante vështrimin andej aq fort sa kjo gja e bani diversantin të dyshonte dhe filloi të vështronte andej edhe ai. Mandej u ulën që të dy në frungje zhavari. Që të dy shikonin njeni tjetrin vjedhtazi, por ata dy sy dhelpne ishin dinakë dhe shpesh e zinin në kurth Qemalin që megjithate mundohej të mos jepte as ma të voglën shenjë.

Ata kuptuen njeni tjetrin, që të dy e ndjenin veten të tronditun...

Diversanti e ndjente veten ngushtë, e ndjente se të dy shokët dyshonin për te, por gjakftohtësia e Qemalit e bante ate të mendonte përsëri. Mbrapa shpinës së diversantit u ndigjuen disa krisma të thata kalla-

mishtesh që pushuen. Diversanti lëvizi pak dhe u trondit. Majat e kallamishtave dhe të rrogozës lëviznin nga era ngadalë tue u ndeshun me njena tjetrën.

Disa zana të çjerrë shpendësh u ndjenë aty afër dhe Lajdi u ba gadi që të shkonte atje. Kallamishtet kërcitën përsëri... Diversanti shikoi Qemalin që i ndërroi fytyra... shikuen njeni tjetrin... sytë ju zvogëluen, një muskul i shpejtë i lëvizi në fytyrë... në trup ndjente tronditje... që të dy ishin në një gjendje, në sulm dhe kundrasulm, por s'pritën ma dhe ju hodhën njeni tjetrit në fyt. U kapën, u shtërnguen fort dhe u rrëzuen që të dy në bri dhe në mes të trungjeve. Duert e stërvituna ndesheshin me duert e fuqishme të një të riu punëtor.

Por aty, në mes të trungjeve duhej sprovue fuqia. Qemali i dha vetes, e hoqi njenën dorë, e mblodhi grusht dhe e goditi tjetrin në nofull dhe turinj aq fort sa atij i shkoi gjak... Por diversanti nuk dorëzohej kollaj.

Hekurani, që s'po shikonte se çfarë po bahej, vazhonte të ecte ngadalë për të mos ranë në gjurmë. Ata tue u rrokullisun njeni mbi tjetrin, arritën te gropa. Diversanti mudohej që të shfrytëzonte gropën, por Qemali nuk i jepte andej. Në atë çast dora e diversantit u shkëput nga ajo e Qemalit dhe ai me ate dorë i dha një grusht të fort tjetrit mu në hundë sa i nxorën sytë xixa.

Qemali mblodhi edhe një herë të gjitha forcat, e kapi me një lëvizje të rrufeshme dhe e zuni nën vete dhe filloi ta grushtonte. Grushti i parë i fortë e bani diverstantin të lëshonte një «oh» të thellë.

Mandej u sollën, u penguen në kapje dhe u rrokullisën që të dy në gropën e ujit... ranë mbrenda dhe u ndanë. Aty shfrytëzuen ujin dhe donin që të zhytnin kokën e njeni tjetrit.

Përsëri u ndanë tue llomatitun nëpër ujë e baltë. Hekurani, ndigjoi zhurmë dhe u lëshue me vrap tue çu kallamishtet, drunjtë dhe zhavarin e dendun. Po kur u ndanë, diversanti shfrytëzoi rastin dhe nxori thikën. Dora që mbante thikën ishte zaptue prej dorës së Qe-

mallit dhe ai me thikën në dorë s'mundi që t'i jepte as andej as këndeje. Dy duert kishin mbetun nalt bashkë me thikën e bardhë, së cilës i ndriçonte tehu.

Kur ranë në ujë, zagari filloi të lehte dhe kjo e lajmëroi Hekuranin se duhet të vepronte. Kur pa këte skenë të tmershme u hodh në shpinë të diversantit, i mori thikën, e hodhi në breg dhe diversanti u gjend i shtërnguem në duert e tij. Qemali hoqi rripin dhe ja lidhën duert nga mbrapa aq fort diversantit sa togëza i hyni në mish. S'kaloi gjatë dhe nga ana e bregut të liqenit u ndigjue një rënkim dhe një zhurmë drush e kallamishtesh të thata që thyheshin.

Qemali, ashtu i lodhun si ishte u lëshue me vrap nëpërmes kallamishtesh dhe drurësh që mezi i çante dhe shkoi në vendin e ngjarjes tjetër. Dy vetë po përlesheshin... Qemali lëshoi çiften dhe u hodh.

Agimi e kish zanë nën vete dhe po grushtonte Riza Bajramin... Rizai s'ishte i zoti të lëvizte ma.

— Agimi çka po ban, e mbyte! Çohu se boll!... i tha Qemali dhe Agimi u ngrit.

— Rizai kishte mbetun i shtrimë dhe të thuesh pa ndjenja.

— Po ky, Agim?

— Ky po i çonte ushqim diversantit dhe kur të pa ty atje, u kthye me vrap dhe me sopatën që e ka marrë me premë landë druni, desh të më binte kresë po i shkoi bosh se sopata i ndeshi në kazmën që e çova nalt; atëhere unë u lëshova mbi te...

— Edhe na diversantin e kapëm dhe e lidhëm...

— Çohu, mor tradhëtar, mor i shitun — ju kërcënue Qemali Rizait dhe i ra me shkelm kofshës së shtrime...

— Atëhere Qemali, ashtu i lodhun, i bamë tanë baltë e gjak e kapi për krahësh dhe e ngriti në kambë sikur të mos ishte burrë po leckë.

— Hajde, ecë para!... dhe i ra një shkelm të randë mbrapa. E morën para dhe e çuen te diversanti. Ata shikuen njëri tjetrin të lidhun, ulën kryet për tokë dhe s'banë za...

Rizai mezi qëndronte në kambë. I morën para dhe dolën nga bregu... Punëtorët e punëtoret kishin dalun në breg që të pushonin. Kur panë këta njerëz të lidhun, të gjakosun, të lodhun, të shkallmuem e tue ecun me krye poshtë dhe Qemalin e Hekuranin dhe Agimin që i rrethonin u habitën.

Edhe këta të tre ishin të lodhun dhe të ndymë me baltë, por ecnin të buzëqeshun. Mandej të kapunit i hypën në maqinën që kishte ardhë për të marrë landë druni dhe ashtu të lidhun i çuen atje ku e kishin vendin. Qemali dhe Agimi u kthyen, u xhveshën dhe hynë që të laheshin në liqen. Plagën që e kishte pasë të lidhun që ate natë në furtunë Qemali e zbuloi dhe s'i vuni ma fasho.

Kur e lanë punën edhe punëtorët, Afërdita i tha Qemalit që të shkonin bashkë në shtëpi. Kaluen nga bregu dhe dolën në rrugën e pyllit. Të dy ecnin tue bisedue. Afërdita e pyeti për kapjen dhe përlëshjen me diversantin por ai i tha shkurt:

— Ne të tre, Dita, bamë ate që u donte me u ba, bamë ate që na takonte. Njeni ishte diversant dhe tjetri i shitun...

Por ajo donte që Qemali të tregonte të gjithë ngjarjen që nga fillimi në fund dhe ai nisi t'ja tregonte po kurrë nuk e lavdëronte veten.

— Qemal, — tha Dita.

— Folë, shpirt!

— Sot e ndjej veten të lumtun, — i pëshpëriti ajo me afsh. Qysh se të dashunova e ndjeja veten sikur jetoja ma shumë. Po tashti të dashunoj ty edhe ma shumë. Te ti gjeta gjithçka, dashuninë e pastër, gëzimin, trimërinë, thjeshtësinë, e të gjitha. E ndjej veten të lumtun kur gjindem pranë teje.

— Mandej u ndalën te një brez i naltë shelgjesh ku qinda zogj cicronin. Sipër, mbi një çerdhe që ish ndër tue nalt në degët e shelgut, këndonin dy zogj të bukur. Me të ndigjue zanin e tyne të ambël, Afërdita ngriti kryet dhe pa.

— Qemal, shih sa bukur që këndojnë ata dy zogjtë!  
— tregoi me dorë Afërdita.

— Po, Dita, i shoh, ato këndojnë të lumtun mbi çerdhen e tyne që ndërtuen me punë e sakrifica...

— Po na a do të ndërtojmë çerdhen kështu si zogjtë?

— Po, ne, njizetvjeçarët, të gjithë jemi zogj që ndërtojmë foletë... Ne do ta bajmë edhe ma të bukur, ma të kandshëm vendin tonë socialist megjithëse anmiqtë, siç ishin ata sot, do të mundohen të na i prishin foletë, por na jena zogj shqiponjash që i ndërtojmë çerdhet nalt, aq nalt, sa anmiqtë që zvarisen për të na i prishë, do të bien poshtë, do të thejnë qafën...

— Dita, s'ka ma lumtuni kur mposht anmikun, ate që të mundon dhe kur rrëmben ate që dashunon tha Qemali dhe, tue ecë të dy krah për krah, ju afruen fshatit.

## 7

Vjelja e duhanit përfundoi. Erdhi koha që të shkullej kashta. Oborri i kooperativës para stallave u boshatis nga vargjet e duhanit. I gjithë duhani i thamë tashti ishte varun nëpër hangare dhe magazina mbushun plot e përplot.

Të rinj e të reja përqëndronin të gjitha forcat në shkuljen e kashtave. Punonin me hov e vrull për t'i shkulun sa ma parë dhe për t'u lirue kështu vendin traktorëve, që do të kthenin tokën për ta mbjellë me grunë.

Iku vapa me gushtin, vjeshta kishte kohë që kish hy, gjethet ishin zverdhun dhe era i përplaste për tokë, malet nga ana e alpeve filluen ta mbanin kryet në re.

E vështirë asht prashitja, por edhe ma e vështirë asht shkulja e kashtave, e këte e dinin vetëm të rinjtë e të rejat që u ishin bamë duert me flluska; ata kishin marrë përsipër që ta banin shkuljen e kashtave; kur zotohet rinia nuk mposhtet, sado e vështirë të jetë puna.

Njerëzit e kooperativës nuk u trembën nga vjesh-

ta. Ata kishin besim në forcat e tyne dhe besonin se do t'i kryenin punët para afatit.

Të gjithë kishin dalë në punë, në frontet ma te vështira. Fshatarët punonin natë e ditë, lëvronin, diskonin dhe mbillinin. Deri në orët e vona punonin dhe të rinjtë dhe, ma në fund, mbjellja përfundoi pesë ditë para afatit. Pesë ditë, por pesë ditë ishin gja e madhe. Sikur të gjithë ato krahë pune të punonin pesë ditë në mënyrë të zakonshme nuk do të banin as një të tretën e punës.

Po ja me punë të palodhun e të vrullshme qindra mijë farë u futën aty thellë, në tokë dhe ashtu të dergjuna do të rriteshin në stinën e gjatë të dimnit...

Me shinat e para të vjeshtës, duhani i varun në stalla filloi të zbutej. Tashti fshatarët punonin mbrenda në stalla ndenjün. Ulnin duhanin, e palosnin dhe e stivosnin në kavaleta të mëdha. Ai ishte tha e dukej i bukur si florini. Të gjithë kënaqeshin kur e shihnin. Ishin ditë pune, gëzimi e begatie.

Filluen të korrnin edhe misrin. Puna shkonte zinxhir, që nga thyemja e kallinit, korrja e kashtës, transportimi i kallinjve të këputun dhe të paxhveshun deri te silazhi, e të gjitha. Misri ish ba i mirë, për çdo rranjë kishte nga dy kallinj të mëdhenj. Këtu puna ndryshonte, ishte paksa ma e lehtë.

Në brigadën e dytë kishin ardhë në ndihmë të rejat e skuadrës së Gjergj Vatës. Ditën e parë Qemali kish punue në silazh, po mbas dy ditëve erdhi edhe ai të korrte misër. Atë ditë që erdhi, korri bashkë me të rejat. E futën në mes Suada me Afërditën.

Dashuninë e tyne nisën ta merrnin vesh shumë njerëz nga fshati. Por fjala ka kambë dhe shkoi deri në veshin e nanës së saj. Veç baba i saj nuk e kish marë vesh ende. Megjithë këte nuk po merrej aq shumë nëpër gojë, se dashunitë e këtilla filluen të bahen të zakonshme. Afërdita në fillim kish frikë nga dashunia, por ajo e kuptoi ma se dashunisë së fshehtë dhe me frigë i kishte ikë koha: Ajo e dinte se tashti dashunia asht e

lirë dhe se e reja ka të drejtë që të zgjedhë ate që i pëlqen. Nji mbramje, kur po kthehej nga korrja, hyni në shtëpi dhe, kur të tjerët shkuen të flinin, kjo bashkë me nanën e saj ndenjtën ma vonë. E ama sikur donte t'i thoshte diçka e nuk mundej, po ma në fund ja tha:

— Ndigjo, moj bijë, a asht e vërtetë ajo që kam ndigjue për ty?

Afërdita nji herë heshti dhe s'e kuptoi përse e pyeti e ama, por kur e pa në fytyrë, e kuptoi, u skuq dhe ju përgjegj e tronditun:

— Për çka, nanë, — dhe veten e ndjeu sikur u fut në nji humnerë të thellë e të errët, sikur e zuni nji peshë e randë dhe e shtypi.

— Kam ndigjue se duheni me Qemalin e Ahmetit. Më kallxo, bijë, të drejtën, hapja nanës zemrën dhe thueja të drejtën mos të na ndodhi ndonji send... Afërdita e shikoi të amën e saj që fliste si me zor dhe dalngadalë, me fjalë të buta, e qetësoi dhe ajo e mori veten.

— A e don, moj vajzë? — e pyeti Afërditën mbas pak.

— Po, nanë, e due si jetën time... dhe dy pika lot i shpëtuen nga sytë.

— A e din se e ka marrë vesh katundi?

— Po, nanë, e di, por nuk ka gja, ata kanë marrë vesh se na duhena me njeni tjetrin e jo gja tjetër.

— Po, moj bijë, po, por kur të marrin vesh baba i yt... ai asht pak... — foli e ama si me frikë — edhe unë kam kenë vajzë vetë, e di... edhe unë kam dashtë... Jena dashunue me frikë, se... Erdhi koha e më dhanë nji burrë që as nuk e njihshe. E pata të zorshme, jeta m'u dukte vorr, e errët, në fillim. Po shyqyr që babai yt nuk më qëlloi aq i vrazhdë e u mësova. Edhe unë jam me ju, edhe unë them me marrë ate që e do me gjithë zemër... mos ki frikë, i foli e ama Afërditës dhe për të parën herë po i hapte zemrën nji njeriu.

E tregoi ate gja të vjetër që e kish ndrye me dheta vjet, por që në zemër ruhej gjithnji e re dhe é pahum-

bun. Afërdita u gëzue nga kjo bisedë me zemër të çiltë; e përqafoi dhe i tha: — Po, nanë, na duhena me gjithë zemër. Ai më don me të vërtetë dhe të dy jena një.

— Ashtu, bijë e nanës, mue më vjen mirë që don një djalë të mirë, punëtor e të sjellshëm. Më vjen mirë që keni ditë me zgjedhë edhe ti edhe ai. Kur Afërdita e ndau qafimin dhe shikoi të amën e saj që i kishte ulun syt, mendoi për te kur kish qenë vajzë e re, për zemrën e saj të brengosun me vite.

— Ndigjo, bijë, unë nesër do të bisedoj me Hasanin që ta shtimë si shkues tashti shpejt sa s'ka marrë vesh yt atë e të bajmë fejesën. Nesër bisedo me Qemalin për këte dhe në mbramje të më kallzojsh.

— Mirë, nanë, për mue dhe për atë kur të duesh; por baba s'ka çka me thanë; kur ne duhena edhe ai ka me pranue që vajza e tij të marrë një djalë të mirë.

— Po, bijë, mbasi kenka puna kështu gjithçka rregullohet.

— Ma mirë, nanë, ta dijnë dashuninë tonë se sa të shkojë puna ashtu si e Sadetes.

— Pse? — pyeti e ama.

— Nuk e din?

— Jo, po kur?

Afërdita filloi t'i tregojë dhe i dukej sikur po i tregonte një shoqeje të saj e jo një nane. Ato bisedonin lirisht, sepse këte çast i zbuluen zemrat njena tjetrës; ajo dashuninë e saj të lirë dhe e ama dashuninë e fshehtë e të dhimbsun.

— Sadetja, — filloi të tregonte Afërdita, — kishte ra në dashuni disa kohë ma përpara me Astritin. Ata ishin dashunue aq fshehtë sa që nuk ua dinte askush. Dashuni si e një vjollce në ferra, që ja ndimë erën e s'mund ta këputim me e marrë në dorë. Kështu ishin dashunue deri tashti vonë. Një ditë Astriti kish gjetë rastin e mezi ja kishte thanë ate që e kishin dhe e fshehshin në zemër. Pastaj u takojshin dhe deri para katër ditëve nuk e dinte njeri përveç tyne. Një djalë prej qytetit e kishte kërkue Sadeten me u fejue me te.



I ati i Sadetes, tue e dijtë se vajzën e ka të sigurt, ja kishte dhanë fjalën familjes së djalit. Kur ka ardhë puna te vajza për me e pyetë e me ja kallzue punën, ajo kishte thanë: «Unë s'e due ate, kushdo që të jetë; due Astritin e vetëm ate. Kur kishte marrë vesh i ati, që kishte dhanë besën dhe fjalën, ishte ba me vra veten. Po Sadetja i kishte qëndrue edhe zemërimit të babës së saj. Ai s'kishte çka me ba, vetëm me hangër fjalën e besën e dhanun e me thanë se vajza don nji tjetër. Halili tashti ka ra ngushtë e asht turpnue. Të vramë ndjehen edhe Sadetja me Astritin. E moj nanë, cila asht ma mirë dashunia e jonë apo ajo e Sadetes?

— Jo, ajo e Sadetes... belbëzoi e ama e çuditun nga kjo që i tregoi e bija.

— Atë herë pra as baba s'ka çka të më thotë. Unë s'e kam ba ate me turp, due ate që më do dhe due ta marr.

— Po, bijë e nanës — i foli me zemër të butë e ama. Atë herë Afërdita e përqafoi si asnjherë dhe të dyja shkuen të flinin se ish ba vonë.

Të nesërmen vajza shkoi në punë e gëzueme. i tregoi Qemalit dhe ai u gëzue. Punuen atë ditë dhe thyen nga dy norma në korrje.

Ditët kalonin dhe natyra e ndërroi të gjithë pamjen. Filloi të binte shi, të shkundeshin dhe gjethet e fundit. Vjeshta po bante punën e saj. Filluen ditët plot lagështinë. Nuk kish mbetun edhe pak që të grumbullonin misrin dhe të sigurohej silazhi, baza ushqimore e blegtorisë. Gropa të tana u mbushën me silazh, ndër-sa kotecat filluen të mbushen me misër të xhveshun. E peshonin dhe e hidhnin aty. Në ato ditë bollëku, siç i thonë, u ba edhe fejesa. Shkuesi që kishte futun nana e Afërditës, kish bisedue me babën e Qemalit dhe mandej me babanë e vajzës. Kur biseduen për këte çeshtje, që të dy ja shtërnguen dorën njeni tjetrit miqsisht. Caktuen edhe ditën e fejesës, ate të dielë që vinte. Shokët dhe shoqet e Afërditës dhe të Qemalit shkuen të dielën mbas dreke në shtëpitë e të dyve.

U dërguen nga një dhuratë si brigadë, si skuadër dhe si grup estrade. Ma e bukura ishte ajo e grupit të estradës. Në këte dhuratë kish kontribue edhe Kola. Ai kish marrë vesh për fejesën dy ditë përpara, kur kish ardhun për të drejtue grupin e amatorëve që donin të pregatitnin edhe një çfaqje tjetër për festat e nandorit.

Kola kish ardhun për shoqëni. Ai ishte bamë i afërt e i dashun me këta njerëz të thjeshtë të fshatit. Për të tillë shokë ai shkonte edhe ma larg, bante sakrificë edhe ma të mëdha. Shkuen të gjithë me i urue. Faiku kish marrun me vete edhe fizarmonikën.

Mbasi i uruen fejesën Qemalit, nanës dhe babait të tij, Kola mori fizarmonikën dhe filloi t'i binte. Shokët e banë Qemalin që të mirrte kitarën dhe ta shoqëronte. Ai kishte turp që edhe për ditën e fejesës së vet t'i binte kitarës ose të këndonte, por si gjithmonë ju bind shokëve dhe e mori. Kënduen këngë dasme e fejesë, popullore dhe të tjera. Erdhën edhe komshitë. Këndonte Nurija, Suada, Faiku e gjithë të tjerët. Mandej ashtu siç ishin, shkuen në shtëpinë e Afërditës. Dhuratat që i kishin sjellë Afërditës i lanë sipër një tryeze të vogël, aty në mesin e dhomës.

— Po pse keni shkue ma parë te Qemali mandej erdhët te na? — u tha krushqëve një grue e hijëshme.

— Po dhandërri merr nusen e jo nusja dhandërrin... foli Tefiku.

— Jo na kena shkue simbas moshës së babës, — ndërhyri Meti dhe ata që e ndigjuen qeshën që të gjithë.

Maloja s'e priste që në shtëpinë e tij të bahej gjithë kjo këngë. Kënduen edhe këtu e banë qejf, ju uruen edhe një herë fejesën dy të fejuemve dhe u ndanë të kënaqun.

Pjesën ma të madhe të forcave punëtore i kish thithun korrja e misrit, xhveshja e tij dhe vijat kulluese të blloqeve të mbjella me grunë.

Megjithse kishin korrur pjesën më të madhe të misrit kooperativistët po shpejtonin edhe ma tepër sepse koha filloi të prishej, malet po ngarkoheshin me re, mjegulla çapitej mbi fusha, e të gjitha këto të jepnin me kuptue se vjeshta si me një dorë magjike i xhveshi natyrës dhe fushës fustanin e bukur të gjelbër.

Mandej ja nisën ditët plot shi e baltë. Deri në këto ditë kooperativistët kishin korrur mjaft misër por disa blloqe buzë liqenit kishin ngelë ende të pakorrura.

Organizata e partisë bashkë me kryesinë e kooperativës kur e panë se shinat e vjeshtës do të vazhdonin gjatë, e pezulluen një ditë të tanë korrjen dhe të gjitha forcat punëtore që qenë në sektorin e korrjes i dërguen në hapjen e kanaleve dhe vijave kulluese. Në këte mënyrë do të ruenin tokat e mbjella me grunë nga lagështira e tepërt dhe erozioni. Kjo ishte punë që nuk priste.

Nga shirat e mëdha që binin u ngrit niveli i liqenit dhe uji nisi të hapej fushave buzë tij. Dalëngadalë po hynte edhe në arat e misrit të pakorrur. Kjo gjë i shqetësonte shumë kooperativistët se uji po u xhvaste mundin, djersën e tyne, bukën e gojës. Asnjënjë nuk i durohej, nuk e zinte vendi mbrenda. Misri duhej shpëtue, duhej gjetë një rrugëdalje pa tjetër. Nuk u hahej as buka pa shpëtue bukën e re, sepse ajo asht buka e të gjithve; partia e ngre me të madhe këte. Duhet ba diçka e shpejtë se shiu dhe liqeni po e banin të tynen. Të rinjtë dhe të rejat dëgjonin baballarët dhe nanat e tyne se sa i shtrenjtë ishte në kohën e luftës qoftë një kalli misri. Dëgjonin për mundin dhe djersën që kishin derdhë ata në arat e bejlerëve e që ma në

fund për vete mezi futnin kafshatën e thatë të bukës. Dëgjonin pleqtë që tregonin për kohnat e zisë së bukës, kur njerëzit hanin barna të egra, si bagëtitë, në ata mote të zinj kùr mëngjezeve gjenin ndonji nga njerëzit e shtëpisë të vdekun dhe mbusheshin plot mallëngjim. E në cepin e syve të tyne shikoje atëhere ndonji pikë lot të bardhë, dridhëronjës, si vesë në fijen e barit, që rrokullisesh nëpër brazdat e rrudhave tue lanë nji vi të lagët...

Të gjithë anëtarët dhe anëtalet e kooperativës kërkuen që të mblidheshin, të çfaqnin mendimet dhe pastaj të vendosnin se si të punonin. Misri duhej shpëtue pa tjetër.

I pari u ngrit Hekurani i cili tha që ishte gati të fillonte punën nëpër shi e baltë, vetëm e vetëm që misrin, djersën e ballit dhe bukën e popullit të mos e lenin të shkonte kot. Kjo inisiativë u përkrah dhe të gjithë ishin gati, por problemi qëndronte gjetkë; pikërisht në kohën që po zhvillohej mbledhja erdhi Lini i cili solli lajmin që liqeni kishte hy në arat e misrit dhe ishte zgjanue. Ky lajm i piklloi të gjithë, sepse misri nuk mund të korrej as për një ditë, as për dy e as për tri në ate terren. Mbas tri ditëve ujët e liqenit do të depërtonte në thellësi të misrit. Kallinjte do t'i mbullonte uji i trubullt plot baltë të sjellun nga fushat e kështu, ai nuk do të vlente ma as për pulat e jo ma për bukë. Atëhere vendosën ta bajnë nji korrje që shumëve ju duk e pamundun... Do të korrnin me lundra.

\* \* \*

Mëngjezi ishte gjithnji i mvrejtur dhe qiellin e nxi- nin retë korb të zeza. Kunora e maleve që rrethon ultësinën e Shkodrës nuk shikohesh. Po shi nuk binte. Gropat e rrugëve dhe hendeqet anash ishin mbushë aq tepër me ujë sa gadi delte sipër rrugës. Arat gjithashtu vende vende mbanin gropa dhe brazda plot ujë. Liqeni kishte fry shtratin dhe kishte dalë ma tepër nga

gdo vit tjetër. Ai mbulonte me ujët e trubullt e me baltë të sjellun nga fushat dhe projt grryes gjithë livadhet e barit dhe një pjesë të mirë të tokave të punueshme. Buzë amullit qëndronin në ujë arrat e egra, karabullakët e zes që gjuenin ndonjë peshk të vogël dhe sipër tyne fluturonin çivikat e bardhë me shpinë të murme që kur shikonin peshkun që lëvizte ujin, suleshin si shigjetë me kokë poshtë e kapnin me sqepin e mprehtë dhe pak të kthym e pasi çanin ujin me gjoks ngriheshin përsëri tue e gëlltitë peshkun të gjallë. Pak ma tej, atje në thellësi ku trupat e mëdhej të shelgjeve i kish mbulue uji dhe atyne u dukeshin vetëm degët. Trumcakët e sorrat fluturonin rreth arave me misër, ndalnin në ndonje kalli dhe hanin kokrat e tyne.

Kooperativistet u afroheshin arave të misrit. Kambët u humbisnin në tokën e zbutun si me qenë batak. Posa arritën në vendin ku do të fillonin punën tufat e rosave dhe karabullakëve u ngritën me zhurmë tue shkumzue ujët dhe zunë vend diku ma larg. Kooperativistet xhveshën këpucët, hoqën xhoket e çdo gja që i pengonte për punë, bashkë me ta u xhvesh edhe kryetari dhe sekretari i organizatës. Ndanë punën dhe mënyrat se si do të punonin. Çdo lundër do të kishte gjashtë korrës: tre në njerin krah dhe tre në krahun tjetër. Misri do të korrej në naltësinë e ujit dhe do hidhesh në lundër. Lundra do t'i çonte kallinjte deri në breg, nëpërmjet një kanali të thellë. Atje kallinjte do t'i ngarkonin në traktor. Nga liqeni po vinin lundrat njena mbas tjetrës tue ça ujin dhe degët e shelgjeve. Lundra e parë vozitesh nga Qemali kurse në fund të saj e ngiste Hekurani i cili i jepte edhe drejtimin. Kryetari që vinte me të tretën tha që lundrat të ndalnin atje ku misri ishte ma thellë. Dhe atje u ndalën.

Të rinj e të reja, me drapna të hedhur në supe, me një ndjenjë entusiaste e mobilizimi, me një ideal të naltë dhe qëllim të përbashkët u futën përmes ujit dhe baltës. Në fillim uji ishte deri në gjunj, po pastaj erdhi tue u ngritë se sa ma larg të shkonin aq ma tepër hynin

në ujë. Kur arritën atje ku mbaronte misri u ra uji deri në brez. Kjo ishte një korrje e papame ndonjiherë. Kallinjtë e misrit gjasonin sikur të kishin mbi prej ujit. Korrësit të mobilizuem të gjithë lëviznin në mënyrë të çuditshme nëpër ujë ku balta nuk të lëshonte fort kollaj kambën qoftë edhe një hap. Drapëna kishin marrë edhe vozitësit, ata nuk rrinin kot qoftë edhe një minutë, por korrnin, dhe kur donin me ecë para, lundrën e shtynte njëni me dorë. Vozitësit dhe korrësit i shpallën garë njëni tjetrit: kush korrë ma shumë dhe kush e çon lundrën me ngarkesë ma shpejt. Ky emulacion i përfshiu të gjithë. Hekurani ja la lundrën Qemalit bashkë me një korrëse dhe vetë shkoi te një lundër tjetër ma tej sepse ata atje nuk dinin të vozisnin mirë.

— Hajde jepi Hekurran se ne e ngarkuem, — i foli Qemali kur mori të nisej me lundrën drejt kanalit që të çonte në breg tue çu ujët përmes.

— E ngarkuet pamasë po mos kujtoni se do të na i kaloni, — foli Hekurani që u hodh në dhe e rrëmbeu lopatat me të shpejtë. Teshat u kullonin ujë dhe u ishin ngjeshur fare tue marrë formën e trupit. Qemali i dha disa herë lopatave por lundra sa lëvizi nga vendi. Ajo përveç që kishte ata, randohej edhe nga pesha e misrit.

— I jepni shpejt Qemal se korrësit po na presin dhe Hekurani po na ze. — Po i japim ma shpejt, — foli Qemali dhe që të dy filluen të lëvizin lopatat me forcë. Lundra çante ujët me ballin e saj dhe mbrapa dallgët e vogla tundnin misrin e pakorrin. Në krye e ngiste Afërdita. Ajo ishte lagun e gjithë që nga koka e deri te kambët. Fanella e pambuktë, e mbyllun në grykë, përveç që ishte lagë, në gjoks ishte përlye me njolla balte. Edhe në fytyrën dhe shaminë e saj të lidhun e të bardhë dukeshin pikat e baltës së njomun nga ujët. Fytyra i kishte marrë një pamje të kandëshme dhe gjallëronjëse, kurse krahët e përveshun lëviznin me forcë lopatat e mëdha. Fanella e lagët i ishte ngjeshun për mishi. Ajo sa herë që i jepte lopatave sillte kryet

dhe shikonte Qemalin atje në cep të lundrës. Ai të dy lopatat e mëdha i përdorte fare lehtë. Ajo vrente krahët e tij të mëdhenj, gjoksin e gjanë që i kish dalë nga këmisha e zbërthyeme, fytyren e tij të qetë, sytë e ndritshëm e të kaltër dhe sa herë që lëvizte trupin kur tërhiqte lopatat mbi ballë i lëviznin ngadalë flokët e lagun e të shpërndamë. Sa herë që shikoheshin në sy, Qemali nënqeshte kurse ajo sillte kryet para dhe vazhdonte e tërhiqte me forcë dy lopatat. Te ata të dy nuk dalloje as shenjën ma të vogël të lodhjes, atyne si dhe të tjerëve nuk u bante përshtypje kjo punë e vështirë, përkundrazi ishin entuziaztë dhe kjo u dukej te sytë plot zjarr dhe optimizën.

Qemali ndali lopatën e majtë i dha fort me të djathtë. Kryet e lundrës mori majtas e pastaj ai e drejtoi për në kanalin që të çonte te traktori. Me të arritur atje shkarkuen menjëherë dhe u nisën përsëri ku i prisnin korrësit. Tashti lundra ishte pa ngarkesë dhe ecte shpejt. Lundrat e tjera vinin njana mbas tjetrës. Qemali preu djathtas dhe e futi lundrën mes korrësve. Afërdita lëshoi lopatat dhe «pllum» u hodh nga lundra në ujë. Pas saj u hodh edhe Qemali. Puna nisi me të shpejtë. Në lundër hidheshin krahët e mistrit fet e fet.

Filloi të frynte pak erë e mbas saj nisi shiu përsëri. Puna vazhdonte gjithnji me ritmin e parë. Asnjeni nuk thonte mjaft punuem, por ngado dëgjoje këto fjalë kuptimplote: «Forca t'ja arrijmë qëllimit». Megjithse shiu dendsohesh ma tepër, punën nuk e ndërpriste asnji. Kaloi dreka dhe asnjenit nuk i shkante mendja për bukë dhe për pushim. Ata dinin vetëm një gjë: Të ecnin sa ma parë dhe të korrnin sa ma shumë. Lundrat filluen të pinin ujë sepse përveç shiut kullonte në to edhe misri, prandaj e derdhnin ujin me kova. Vetëm kur u err u ndigjue një za:

— Nisemi, po vonohemi, shokët u banë gati!

Gjithandej ra mbramja. Errësina mbuloi të katër anët. Shiu vazhdonte të binte i imët e i dendun. Maqina që ishte në rrugë u mbush me punëtorë e u ba gati të

ecte në drejtim të fshatit. Para saj kalonte një gaz i ngarkuem me misër kurse mbrapa vinte maqina e mbushun plot me kooperativistë. Të rinjtë filluen këngën. Kjo u pasue edhe nga të pjekunit në moshë. Të dukesh e çuditshme kjo skenë. Kooperativistët dukeshin sikur po vinin nga ndonji vizitë që kishin ba diku e jo si të kishin punue gjithë ditën pa pushim në shi e në baltë. Po ishte rinia, rinia që nuk pyet për të tilla gjana, ishin njerëzit që mbjellin e korrin grunin, bukën e një populli heroik.

Posa shkuen nëpër shtëpitë, u ndrruen, u veshën dhe ndezën bisedat e zjarra me pjestarët e familjes për punën që ishte ba në korrje. Ata kishin çfarë t'i tregonin njeni tjetrit. Nëpërmjet radios e gazetës ndigjonin që flitej edhe për kooperativistët e punëtorët e ndërmarrjeve të ndryshme të vendit, dëgjonin se kudo punohej me të njejtin vrull, sepse shinat e mëdha që binin ngado po shkaktinin dame të mëdha në bujqësi.

Lumenjt e rrëmbyshëm kishin dalë nga shtretnit e tyne dhe po mbytnin fushat; lexonin dhe dëgjonin për heroizmat e kooperativistëve që rrezikonin jetën për të shpëtue gjanë e gjallë e pasuninë kolektive. Keta, ishin si zjarre që ndiznin zemrat e gjithë punonjësve. Megjithse ishin lodhë, ranë vonë e nuk flinin po rrinin tue bisedue e tue ndigjue radiot. Jashtë dëgjohej që shiu binte me rrëmbim e herë pas here bubullimat tundnin dheun. Ora kaloi dymbëdhetë. Mandej shiu i randë pushoi e ata fjetën. Sa herë që u dilte gjumi gjatë natës u shkante mendja te misri, te buka e popullit.

Të nesërmen u nisën qysh pa le.

Këtë ditë puna u eci; patën një favor nga që nuk ra shi në orët e para të punës. Po u eci mbarë edhe sepse ja morën dorën kësaj pune një ditë përpara. Misrin që çonin në kooperativë e xhveshnin dhe pastaj e hapnin nëpër hangar në mënyrë që të thahesh e të bahej për kotec. Kur i shikoje ata kalling të mëdhenj e plot kokra të shëndosha të vinte keq t'i mendoje që do të kalbeshin. Kooperativistët punonin pa pushim, kjo pu-



në po i nxirte faqebardhë sado që në fillim u dukej e kotë. Pak para se të linin punën, filloi përsëri shiu. Liqeni deri në këtë kohë e kishte ngritur nivelin e tij edhe ma tepër. Atje ku korrën ditën e djeshme po të ishte misri do të qe mbulue deri mbi kallinj. Liqeni po i ndiqte kamba kambës por nuk po mund t'i arrinte dot. Tashti u ngeli pa korrë vetëm pjesa që ishte me ujë të cekët, por deri në ditën e nesërme me siguri që uji do të kërcente ma nalt.

Ditën e tretë u nisën në punë me shi. Ai nuk pushoi deri në orët e drekës e pastaj u pre, po nga malet akoma nxinte rryma e shiut që binte. Mbas dite puna u eci edhe ma mirë. Të gjithë e shikonin që po të mos kishin fillue korrjen ma parë në thellësi, ate misër do ta kishte kalbun uji që të gjithë. Nji ngritje e tillë e liqenit nuk mbahej mend. Uji i tij kishte hy edhe në lagjen e poshtme të qytetit dhe kish bllokue rrugët. Kurse ujët e Drinit kishte mbulue fushat e Kuçit dhe gjithë fushat që shtriheshin gjatë rrjedhjes të tij; kishte mbulue me llum e ranë gjithë arat e mbjella e të pa mbjella e nji dam tjetër të madh kishte ba në ushqimin e thatë të bagëtive. Shtëpive u kishte hy uji në katin e parë, sipër, fshatarët kishin ngjitë gjithë plaçkat dhe bagëtitë. Për këtë Partia po mirrte masa të nevojshme e të shpejta tue i ndihmue me bukë, ushqime e të tjera fshatarët e bllokuem nga uji. Furnizimet bahehim me lundra apo me helikopterë. Këto shina që binin po i sillnin ekonomisë nji dam të madh. Përveç vërsimeve të lumenjve radioja e gazeta lajmoinin edhe për rëshqitje toke në zona kodrinore e malore.

Dita e katërt ishte dita e fundit në korrje. Në këtë ditë ata do t'i jepnin fund. Shi nuk binte ma. Retë nuk nxinin si në ditët e tjera. Në të çamet e tyne dukeshin rrezet e arta të diellit vjeshtuk dhe copat e kaltra të qiellit që herë pas here humbisnin mbas reve të bardha si borë.

Edhe liqenit i kish ra nji pamje tjetër. Rosat, çafkat, çivikat e gjithë shpendët e tjerë fluturonin plot

gëzim anës amullit. Mbi te nuk notonte ma mjegulla e shiut. Kurse në arat e misrit ku punonin kooperativistët vlonte ende puna. Nji gëzim i madh dhe i papërshkuem i kish pushtue të gjithë. Buka dhe djersa e ballit shpëtoi. Qëllimit ja arritën, ndaj kanga kishte nisë si në dasëm. Lundrat shkarkonin misër varg njena mbas tjetrës. Vrulli i punës gjithnji rritesh kurse pjesa e misrit të pakorrin zvoglohesh. U korrën edhe kallinjt e fundit. Vozitsit po shtynin lundrën e fundit. Të parat ishin ngarkue plot kurse të fundit kishin marrë vetëm ndonji krah sa për të mos u kthye pa gja. Korrsit kishin hypun në lundrën ma të madhe me të cilën kish punue Qemali. Ajo ecte ngadalë mbas të tjerave, tue çu ujin e tue u përkund në shpinën e tij të lëvizëshme. Gëzimi i të rinjve nuk përmbahesh. Në fytyrën e cilitdo çfaqesh nji ndjenjë hareje. Në ballin e lundrës, Afërdita voziste tue këndue me sa forcë që kishte. Zani i saj i ambël e kumbues lundronte tue kërcye nëpër valët që lente lundra e pastaj, i qetë e i kandshëm shpërndahej nëpër gjanësinë e liqenit. Ja thanë nji dueti me Faikun e pastaj kënduen të gjithë së bashku. Fytyra e saj si agim i ndezun flakë nga puna dhe kanga dhe flokët e lagët që ja tundte pak era i jepnin bukurinë e një lulëkuqeje të freskueme nga vesa e parë e mëngjesit pranveror. E cilit nuk i këndonte zemra në ato çaste? Megjithse ishin të lagun e të qullun kanga dilte e ngrohët dhe e zjarrtë.

Frynte pak erë vjeshte që sillte aromën e lagështinës. Qielli pothuej ishte pastrue i gjithë nga retë. Ylberi me ngjyrat dhe bukurinë e tij i kish hedhur fjonon shumëgjyrshe në formë harku Cukalit; natyra me dorën e saj sikur donte të lidhte në të nji kordhelë të qindisun.

Ishte fundi i muejit. Ate ditë që ndaheshin lekët kooperativistët kishin mbledhje. Në zyrën e llogarisë hynin e delnin kooperativistë që merrnin të ardhurat e vitit. Në anë të tryezës së llogaritarit, afër dritares ishin ulë dy burra, të cilët kishin ardhë si të deleguem nga komiteti për të marrë pjesë në mbledhjen që do të zhvillohej. Ata shikonin llogaritarin që u numronte lekët kooperativistëve, dikujt ma shumë e dikujt ma pak.

— Pse, Zef, ajo grueja që doli tashti mori aq pak, kurse një tjetër që doli para saj, mori dy herë sa ajo?  
— pyeti i deleguemi llogaritarin.

— Asht e qartë, ajo që mori pak ka punue pak, kurse ajo tjetra ka dalë çdo ditë në punë, — tha llogaritari ndërsa po u gjente emnin Hekuranit dhe Qemalit në listë.

— Po mirë, si janë me realizimin e ditëve të punës në përgjithësi?

— Ka që edhe nuk e realizojnë, — u përgjegj shkurt llogaritari tue marrë një tufë kartëmonedhash në dorë.

— Pse ndodh kjo? — pyeti përsëri i deleguemi, ndërsa shoku i tij vetëm ndigjonte.

— Sepse nuk punojnë.

— Jo, or vëlla, nuk asht puna se nuk punojnë, — tha Hekurani, — po ata që nuk kanë shumë ditë pune merren ma shumë me kopshtet personale. Kujtojnë se me ate rrishtë toke do të sigurohen.

— Pse, sillen shumë mbas saj, ë?

— Po, ka nga ata që rreken me atë copë toke tue kujtue se do të nxjerrin fitime dhe i lenë mangut punët këndeje.

— Besa ka ardhë koha me i hekë ato tre dynymshe e me ja dhanë kooperativës, o vëlla. Ne me të vërtetë rrekemi si thotë Hekurani; në tredynymsh mund të fitojmë një, e në kooperativë, tue u rrejtë mbas kësaj, lamë të shkojnë dam dhetë, — ndërhyri Njaziu.

— E ma e keqja asht se në verë, kur janë fushatat e mëdha, pikërisht atëhere kur duhet forcë e madhe pune, njerëzit rreken me dhetë kallij misri.

— Po sivjet si i kryet këto fushata? — i drejtoi pyetjen Hekuranit po i njejt i deleguem.

— Mirë, ne u aktivizuem të gjithë, nuk nderjten pa e kapë shatin as këta shokët e zyrës e të tjerë që kishin punë me përgjegjësi të ndryshme. Nji ndihmë tjetër na dhanë edhe aksionistët.

— Po mirë, i kërkuet vetë këto ndihma apo? ... ndërhyri i deleguemi.

— Jo, jo, ata që erdhën, qoftë shokët e administratës, qoftë të tjerët, e panë vetë të arësyeshme, por unë them që punët dhe detyrat na dalin ma të mëdha vitin e ardhshëm.

— Unë kam këtë mendim tha nji tjetër që ish aty: Të jemi sa ma afër prodhimit, shembullin e vitit të kaluem ta vemë në zbatim ma tepër, ta bajmë si ligj. P.sh. kur asht fushata e madhe, pse punonjësit e llogarisë të mos marrin pjesë në te ose, atje ku asht organika pak e fryme, pse mos të thjeshtohet e të dalin njerëz në prodhim ku ka nevojë ma shumë? Tek e fundit edhe llogaritari, që mbetet gjithë ditën në zyrë, po të dojë mund të punojë në terren, i ban edhe mirë e freskohet.

I deleguemi që pyeste pohonte me krye, i heshtun sikur diç mendonte, ndërsa tjetri kish nxjerrë nji blok të vogël e shënonte herë pas here në te. Mandej ky, pyeti:

— Si thoni ju, kjo mënyrë a mund të përgjithësohet? Në atë çast hynë në zyrë edhe katër të tjerë.

— Pse jo? Unë e kam vu re në veten time, nuk ndesh në ndonjë vështirësi megjithëse e kryej punën hem si brigadjer hem si punëtor. Kështu edhe ata të administratës që kryejnë punët në zyrë të sakrifikojnë ashtu si sakrifikon punëtori në fushë për tejkalimin e normave. Kështu që punën e dy vetëve ta bajë njani tha Hekurani.

— Po mirë, pa ta pyesim llogaritarin, — tha i deleguemi tjetër që deri atëhere nuk kishte folë, por vetëm kishte mbajtë shënim në blok — Si thoni ju, a mund të bahet kështu si thotë Hekurani?

— Pse jo? — u përgjegj ai, — bahet që ç'ke me te, unë jam gati të dal në prodhim ashtu siç dola verën e kalueme, bile jam gati të dal edhe për gjithmonë.

— Po ju, shokë kooperativistë, çfarë thoni në lidhje me këte që ndigjuet? — ju drejtue kooperativistëve që kishin ndejtun në kambë e mbanin vesh.

— Ajo mund të bahet, — tha një burrë mesatar nga shtati, me një qeleshe të bardhë në krye.

— Sikur të bahej, ajo do të ishte një punë shumë e mirë, — ja priti tjetri.

— Mund të bahet në masë, mund të përgjithësohet?

— Unë them që mund të përgjithësohet — u përgjegj Ismaili që deri në këtë kohë vetëm ndigjonte, — verën që shkoi na ndihmuen shumë aksionistët, shokët e administratës e mësuesit dhe prodhimet shkuen mbarë.

— Po t'i pyesim edhe një herë këta shokë, si thonë këta, a asht i drejtë mendimi yt? — ju drejtue Qemalit mbasi ngriti kryet nga bloku. Qemali solli kryet nga shokët që ishin mbrapa tij dhe i shikoi si për t'u marrë përgjigjen.

— Qe ashtu asht, mor bir, — u gjegj një burrë i shkuem nga mosha që qëndronte bri dollapit ku futehin dokumentat e ndryshme zyrtare, — kjo rinia e populli i sotëm janë tamam si barut e duen vetëm një shkëndijë. Unë për vete jam çuditë me aksionistët...

— Më falni, shoku llogaritar, që ju ndërpreva punën dhe u mblodhën shumë njerëz këtu, po kisha edhe një pyetje.

— Ju lutem, jo një pyetje por sa të doni, ne po bisedojmë për ato që na vlejné e na interesojné.

— Desha t'ju pyes diçka edhe për kopshtet personale.

— Unë i quej plaçka të vjetra që na kanë ngelë hala në ndërgjegjen tonë. Kjo na pengon në punët e kooperativës — tha Ganiu.

— Edhe unë them kështu — tha Hekurani.

— Deri parë folët mirë, por tashti me këte e pri-shët, — ndërhyri me nxitim Kapllani, një burrë i mocëm rreth të pesëdhjetave.

— Pse na pengon ajo në punët e kooperativës?

— Mos fol kështu Kapllan, je gabim kambë e krye. Sa ditë pune ke ba? — e pyeti llogaritari.

— Gjithësej nuk e di.

— Mbasi nuk e din ja po të them unë që nuk ke ba gja as ti as nusja e djalit tand. Arësyeja asht që ti bashkë me te mbetët mbas kopshtit personal, — i tha llogaritari.

— Po çka do me thanë me këte?

— Due me thanë se si ti, si shumë shokë të tjerë po të kishit punue ma tepër në kooperativë do të lehtësonit shokët në punë dhe prodhimet tona do të ishin ma të shumta. E ku merr ma tepër, në kooperativë apo në tredynymsh?

— Në kooperativë, — belbëzoi lehtë Kapllani.

— E shikon pra që je gabim e nuk e kupton?

— Po mirë, si thoni ju, ka të drejtë llogaritari apo ky shoku tjetër, u drejtoi pyetjen të gjithëve përsëri i deleguemi.

— Kapllani nuk asht në vete fare, — thanë disa njiherësh. Ai me gjithë nusen e djalit e me djalin kur i vjen mbas orarit shtoi një i ri, punojnë në kopshtin personal e u duket sikur nxjerrin «fitime». Po nuk asht vetëm ky që mendon kështu, ka shumë. Ne themi se asht ma mirë t'ja japim pjesën ma të madhe kooperativës, të punojmë ma tepër në kooperativë e ta xhveshim ate plaçkë të vjetër që trashigojmë nga e kaluemja. I deleguemi përsëri shënoi diçka në blok dhe mandej bisedoi në vesh me shokun tjetër. Llogaritari mbaroi ndamjen e lekëve dhe si mbyllën zyrën, shkuen të gjithë në mbledhje të kooperativistëve.

Kooperativistët, ma vonë, morën vesh se i deleguemi që mbante shënime e bante pyetje vinte nga Tirana, nga Komiteti Qëndror i Partisë. Ata interesohehin për problemet dhe jetën e fshatarëve.

\* \* \*

Që nga ajo ditë shumë ujë ka rrjedhur nga burimet, shumë gjana dhe punë kanë ndryshue. Në kodrat përreth fshatit janë hapë e mbjellë me grunë e misër plot toka të reja, në shtëpitë e kooperativistëve oshë-tijnë radiot dhe në sytë e njerëzve, vezullon një dritë e shkëlqim i pastër, një flakë e gjallë, e ambël që flet për një hare e lumtuni që vjen çdo ditë tue u shtue.

Dobraç — 1965-67.

43355

IBLIOTEKA E SHËTETIT  
GJIRKASIT